

2021

Draft Raporti i Vlerësimi Strategjik Mjedisor i Planit Zhvillimor Komunal të Komunës së Prishtinës

INSI

Instituti për Shkencë dhe Teknologji

– INSI- Prishtinë

2/23/2021

PËRMBAJTJA

I. HYRJE	6
II. KORNIZA LIGJORE DHE INSTITUCIONALE.....	7
2.1. Direktiva VSM e BE-së.....	7
2.2. Direktiva të tjera të BE-së	7
3.2. Strategjia 2020 e BE-së	8
2.3. Objektivat Zhvillimore të Mijëvjeçarit të KB.....	8
2.4. Konventa Århus, Konventa Espoo dhe Protokolli i Kievit	9
2.4.1. Konventa Århus.....	9
2.4.2. Konventa ESPOO dhe Protokolli i Kievit	9
2.4.3. Protokolli i Kievit.....	9
2.5. Historiku Legjislativ, Organet Administrative Përgjegjëse	10
2.5.1. Ligji i Kosovës për Planifikim Hapësinor.....	10
2.5.2. Ligji i Kosovës për Vlerësimin Strategjik të Mjedisit (VSM)	10
2.5.3. Planet dhe programet e tjera të rëndësishme	11
III. GJENDJES EKZISTUESE - ANALIZA.....	13
3.0. POZITA GJEOGRAFIKE.....	Error! Bookmark not defined.
3.1. KUSHTET FIZIKO-GJEOGRAFIKE	Error! Bookmark not defined.
3.1.1 Hipsometria dhe topografia	Error! Bookmark not defined.
3.1.2. Gjeologjia dhe tokat	Error! Bookmark not defined.
3.1.3. Kushtet klimatike.....	Error! Bookmark not defined.
3.1.4. Hidrografia	Error! Bookmark not defined.
3.2. KUSHTET SOCIO-EKONOMIKE.....	Error! Bookmark not defined.
3.3. Shfrytëzimi i tokës	Error! Bookmark not defined.
3.3.1. Trashëgimia kulturore dhe natyrore.....	Error! Bookmark not defined.
3.4 Infrastruktura teknike	Error! Bookmark not defined.
Infrastruktura e transportit dhe transporti.....	Error! Bookmark not defined.
IV. ANALIZA SWOT	115
4.1 Zonat me Probleme Mjedisore	115
V. PËRMBLEDHJE E PËRMBAJTJES SË PLANIT	120
ZHVILLIMOR KOMUNAL	120
5. 0. VIZIONI DHE SKENARET E ZHVILLIMIT.....	120
5.1. VIZIONI I KOMUNËS SË PRISHTINËS	120
5.2. KONCEPTI I ZHVILLIMIT HAPËSINOR.....	120
5.3. Qëllimet e PZHK-së.....	129
5.4. Ndikimi i PZHK-së në planet dhe çështjet tjera.....	Error! Bookmark not defined.

Problemët dhe mundësit kyçe mjedisore.....	Error! Bookmark not defined.
5.5. Disa nga aspekte kryesore të gjendjes aktuale mjedisore	132
VI. PARIME, OBJEKTIVA DHE KRITERE MJEDISORE	143
6.1. Objektivat e VSM-së	143
6.2. Parime, objektiva e kriteret mjedisore që kufizojnë zhvillimin komunal.....	144
VII. TESTIMI I QËLLIMEVE TË PLANIT KUNDREJT OBJEKTIVAT TË VSM-së	151
6.1. Masat e nevojshme në PZHK për Mbrojtjen e Mjedisit	156
VIII. MONITORIMI.....	175
IX. PËRFUNDIME	93
LITERATURA.....	95

LISTA E SHKURTIMEVE

MMPH Ministria e Mjedisit dhe Planifikimit Hapësinor

AKMM Agjencia Kosovarë për Mbrojtjen e Mjedisit

BE Bashkimi Evropian

KP Komuna e Prishtinës

GIS Sistemit i Informacionit Gjeografik

GNP Grimcat e Ngurta Pezull

NOQ Ndotsë Organike të Qëndrueshem

OBSH Organizata Botërore e Shëndetësisë

OJQ Organizata Jo Qeveritare

OZHM Objektivat e Zhvillimit të Mijëvjeçarit

PZHK Plani Zhvillimor Komunal

HZK Hartë Zonale Komunale

PRRH Plan Rregullues i Hollësishëm

TeR Termat e Referencës

UNDP Programi i Zhvillimit i Kombeve të Bashkuara

UNEP Programi i Mjedisit i Kombeve të Bashkuara

VNM Vlerësim i Ndikimit në Mjedis

VSM Vlerësim Strategjik Mjedisor

ZVM Zona të Veçanta të Mbrojtura

HYRJE

I. HYRJE

Vlerësimi Strategjik Mjedisor (VSM) për Politika, Plane dhe Programe vlerëson pasojat qështjet në fazat e herëshme të vendimëmarjes. Gjithastu VSM-ja është një proces që synon integrimin e konsideratave mjedisore në përgatitjen dhe miratimin e planeve, programeve dhe politikave. Koncepti i Vlerësimit Strategjik Mjedisor vjen nga politikat dhe programet e niveleve me të larta të planifikimit dhe shfrutëzimit të tokës të cilat kanë synime strategjike dhe vizionare dhe për të cilat kërkohet VSM sipas ligjit.

Qëllimi i raportit të VSM-së për Planin Zhvillimor Komunal të Prishtinës është që të bëjë identifikimin, përshkrimin dhe vlerësimin e ndikimeve të rëndësishme që mund të rezultojnë nga zbatimi i Planit Zhvillimor Komunal, si edhe të japë alternativën më të favorshme për zhvillimin e tij nga pikepamja mjedisore. Në raportin e VSM-së duhet të përfshihen edhe propozimi i masave për mënjanimin dhe zbutjen e ndikimeve të dëmshme që dalin nga propozimet e Planit Zhvillimor Komunal.

Metodologjia e ndjekur është në përputhje me Direktivën e BE: 2001/42/EC „Mbi Vlerësimin e Efekteve të disa Planeve

dhe Programeve në Mjedis“ dhe ligjin për Vlerësimin Strategjik Mjedisorë, i cili është transpozimi i direktives së BE 2001/42/EC.

VSM-ja për Planin Zhvillimor Komunal të Prishtinës do të ketë këtë format:

Një përmbledhje të informacionit bazë për vlerësimin mjedisor; Përshkrim të Vizionit, prioritet dhe objektivave kryesore të Planit Zhvillimor Komunal të Prishtinës dhe marrëdhëniet e tij me politikat, Planet dhe Programet e tjera që kanë lidhje me të; Përshkrim të aspekteve të gjendjes aktuale të mjedisit si edhe zhvillimin e pritshëm të tij në rast se nuk zbatohet plani; Përshkrim të karakteristikave mjedisore të zonave që ka të ngjarë të ndikohen në mënyrë të konsiderueshme nga plani; Përshkrim të problemeve ekzistuese mjedisore të cilat kanë lidhje me planin; Përshkrim të objektivave për mbrojtjen e mjedisit të përcaktuara në nivel kombëtar ose ndërkombëtar, të cilat kanë të bëjnë me Planin dhe Programin si dhe mënyrat në të cilat këto objektiva janë marrë parasysh gjatë përgatitjes së raportit; Përshkrim të ndikimeve të mundshme dhe të konsiderueshme në mjedis duke përfshirë shëndetin publik, florën, faunën, biodiversitetin, tokën, klimën, ajrin, ujin, peizazhin, zonat natyrore, vlerat materiale, trashëgiminë kulturore si dhe ndërveprimin ndërmjet këtyre faktorëve.; Efektet komulative të komponenteve mjedisore; Përshkrim të masave të parashikuara për të parandaluar, reduktuar ose lehtësuar ndikimet negative në mjedis, të cilat mund të rezultojnë nga zbatimi i planit. Një përmbledhje për përzgjedhjen e alternativave të shqyrtuara, duke përfshirë vështirësitë e ndryshme ose mungesën e të dhënave që hasen gjatë përpilimit të raportit. Përshkrimin e monitorimit dhe raportimit.

Të dhënat dhe Informacionet për komunën e Prishtinës janë siguruar nga Komuna, nga hulumtimet për këto komunë nga Plani Zhvillimor Komunal i kaluar, hulumtime tjera dhe nga internet.

Ky Raport i VSM-së është dokument i pari i llojit të tij që hartohet për këtë qëllim në këtë komunë, dhe si i till besohet se do mundësojë që zhvillimet e ardhshme të jenë në harmoni me legjislacionin vendor të mjedisit, si dhe me direktivat dhe konventat ndërkombëtare.

II. KORNIZA LIGJORE DHE INSTITUCIONALE

2.1. Direktiva VSM e BE-së

Direktiva e BE-së 2001/42/EC mbi vlerësimin e efekteve të planeve dhe të programeve të caktuara në mjedis u aprovua më 27.06.2001. Kjo direktivë vlen për një varg të gjerë të planeve dhe të programeve publike (p.sh. mbi shfrytëzimin e tokës, transportin, energjinë, mbeturinat, bujqësinë, etj.). Kjo direktivë nuk ju referohet politikave. Direktiva (Parlament i Evropian..., 2001) thotë që planet dhe programet në kuptim të Direktivës VSM duhet të përgatiten dhe të aprovohen nga një autoritet (në nivel kombëtar, rajonal apo lokal) dhe të urdhërohen nga dispozitat legislative, rregulluese ose administrative.

Një VSM është i obligueshëm për planet/programet si vijon:

- Përgatiten e planeve për bujqësi, pylltari, peshkim, energjetikë, industri, transport, menaxhimtë mbeturinave/ ujit, telekomunikim, turizëm, planifikimin të qytetit & venditose hfrytëzimtë tokës dhe të cilat vendosin kornizën për miratimin e zhvillimit të ardhshëm të projekteve të shënuara në listën e Direktivës për Vlerësimin e Ndikimit Mjedisor (VNM);
- Janë përcaktuar për të kërkuar një vlerësim sipas Direktivës së Vendbanimeve. Gjerësisht, për planet/programet që nuk janë të përfshira më lart, shtetet anëtare duhet ta kryejn një procedurë të shoshitjes për ta përcaktuar nëse planet/programet ka mundësi të kenë efekte domethënëse mjedisore. Nëse kanë efekte domethënëse nevojitet një VSM. Procedura e shoshitjes bazohet në kriteret e përcaktuara në Shtojcën II të Direktivës.

Procedura VSM mund të përmbledhet si vijon: raporti VSM përgatitet dhe në të identifikohen efektet domethënëse të mundshme në mjedis dhe alternativa të arsyeshme të planit ose të programit të propozuar. Autoritetet publike dhe mjedisore informohen dhe konsultohen lidhur me projektin e planit ose të programit dhe përgatitet raporti VSM. Raporti VSM dhe rezultatet ekonsultimeve merrën parasysh para aprovimit. Kur të aprovohet plani ose programi, informohen autoritetet mjedisore dhe opinioni dhe informatat përkatëse vihen në dispozicion të tyre. Në mënyrë që të identifikohen efektet e pa parashikueshme të pafavorshme në një fazë të hershme, efektet domethënëse mjedisore të planit ose të programit duhet të monitorohen.

2.2. Direktiva të tjera të BE-së

Ekzistojnë shumë direktiva të tjera të BE-së me të cilat Direktiva VSM ka lidhje të qarta dhe të cilat janë të rëndësishme nëse janë duke ushqyrtuar çështjet mjedisore dhe të. Sipas Marsden (2008) VSM-ja ka lidhje të ngushta procedurale me Direktivën VNM, në veçanti me që vlerësimi i mjedisit për sektorët e shënuar nën këtë të fundit duhet ta vendosë kornizën për projektet e shënuara nën këtë të parën. Po ashtu ka lidhje të ngushta procedurale me Direktivën për Vendbanimet, e cila përmendet qartë në direktivën VSM. Direktiva Kornizë për Ujërat bashkërisht me Direktivën për Vendbanimet përmban kërkesat e veta jo vetëm për paraqitjen e planeve dhe të programeve, por po ashtu edhe të vlerësimit, duke nxitur nevojën për procedura të bashkërenduara ndërmjet ligjeve të ndryshme.

3.2. Strategjia 2020 e BE-së

Përveç dokumenteve të sipërpërmendura legjislativë të BE-së, strategjia 2020 e BE-së me prioritetet, objektivat dhe nismat më të mëdha¹ është dokument i rëndësishëm i politikave si për vetë BE-në ashtu edhe për rajonet fqinje, në veçanti Ballkanin Perëndimor me që bashkëpunimi rajonal me këtë rajonë është identifikuar si njëri prej prioritetëve të politikave për BE-në. Në kuadër të strategjisë 2020 të BE-së (Komisioni Evropian, 2010) zgjerimi i mundshëm i BE-së me vendet e Ballkanit Perëndimor është identifikuar si mjet i jashtëm i politikave për zhvillim dhe vende pune. Prioritetet e strategjisë janë “zhvillimi i shpejtë, i qëndrueshëm gjithëpërfshirës”. Janë shtatë nisma të mëdha, prej të cilave *Evropa efikase sa ju përket burimeve dhe Një politikë industriale për epokën e globalizimit* janë drejtpërdrejt të lidhur me çështje të që ndrueshmërisë, por nismat e tjera si *Agjenda digjitale për Evropën, Unioni i përtëritjeve, Rinia në lëvizje, Një agjendë përshkathtësi dhe vende të reja pune dhe Platforma evropiane kundër varfërisë* dotë mundeshin poashtu të kontribuonin në parimin e zhvillimit të qëndrueshëm po të zbatoheshin në mënyrë efikase. Në strategji poashtu përfshihen objektivat e matshëm që duhet të arrihen gjatë periudhës së zbatimit, nuk ka dyshim që është plotësisht e dobishme sipër shtetet anëtare aktuale ashtu edhe për ato të ardhshmet që të bashkëpunojnë në mënyrë që t’i arrijnë objektivat mjedisore të strategjisë siç është zvogëlimi prej 20% i emetimeve të gazrave të serrave, 20% rritje të shkallës së energjisë nga gjëra tepër të ritshme dhe nga efikasiteti i energjisë. Prandaj është e arsyeshme që drejtimi i këtyre objektivave të integrohet në strategjitë dhe në planet e veprimit mjedisore kombëtare, rajonale dhe lokale, përfshirë procedurat për vlerësimin strategjik të mjedisit.

2.3. Objektivat Zhvillimore të Mijëvjeçarit të KB

KB kan një rol aktiv në zhvillimin e Kosovës, edhe pse Kosova nuk është shtet anëtar, KB vepron në Kosovë nën mandatin e misionit UNMIK në mënyrë që t’isigurojë kushtet për jetë të qetë dhe normale për të gjithë banorët e Kosovës dhe për avancimin e stabilitetit rajonal në Ballkanin Perëndimor. Objektivat strategjike të KB janë aprovuar në vitin 2000, kur udhëheqësit botërorë u mbledhën në NjuJork për të marrë pjesë në Samitin e Mijëvjeçarit, pjesëmarrësit aprovuan Deklaratën e Mijëvjeçarit të KB (Asambleja e Përgjithshme e KB, 2000) me qëllimin kryesor të përgjithshëm për ta zvogëluar varfërinë me afatin e fundit kohor vitin 2015. Kjo nismë është bërë e njohur si Objektivat Zhvillimore të Mijëvjeçarit². Janë 7 objektiva me qëllime specifike, një prej objektivave i kushtohet qëndrueshmërisë mjedisore, në mënyrë që të sigurohet vendosja e qëllimeve në vijim:

- Integrimi i parimeve të zhvillimit të qëndrueshëm në politikat dhe programet e vendit dhe kthim i mbrapsht i humbjes së burimeve mjedisore;
- Zvogëlimi i humbjeve të biodiversitetit duke arritur deri më 2010 një zvogëlim domethënës të shkallës së humbjes;
- Përgjysmimi i përqindjes së popullsisë pa qasje të qëndrueshme tek uji i sigurt i pijshëm dhe higjiena publike themelore deri në vitin 2015;
- Deri më 2020 të arrihet një përmirësim i rëndësishëm në jetëtë së paku 100 banorëve të lagjeve të varfra.

¹http://ec.europa.eu/europe2020/index_en.htm

²http://ec.europa.eu/europe2020/index_en.htm

2.4. Konventa Århus, Konventa Espoo dhe Protokolli i Kievit

2.4.1. Konventa Århus

Kjo Konventë (Konventa për qasje në informata, pjesëmarrje publike në vendimmarrje dhe qasje në drejtësi për çështjet mjedisore) është aprovuar më 25 qershor 1998 në qytetin danez të Aarhus (Århus) në Konferencën e Katërt Ministrove si pjesë e procesit "Mjedisi për Evropën". Ajo hyri në fuqi më 30 tetor 2001.

Konventa Århus vendosë një numër të të drejtave të opinionit në lidhje me mjedisin. Sipas konventës (Konventa UNE CE mbi Qasjen...,1998) Nga palët në këtë Konven të kërkohet t'i hartoj në dis pozitë e nevojshme ashtu që autoritetet publike (në nivel kombëtar, rajonal apo lokal) do të kontribuojnë që këto të drejta të bëhene efektive. Konventa parashikon:

- Të drejtën e secilit që të marrë informata për mjedisin të cilat i mbajnë autoritetet publike. Këtu mund të përfshihen informatat lidhur me gjendjen e mjedisit, por po ashtu edhe politikat ose masat e ndërmarra. Kërkuesit kanë të drejtë t'i marrin këto informata brenda një muaji pas bërjes së kërkesës dhe pa treguar arsyen pse ju nevojiten ato. Përveç kësaj, sipas Konventës autoritetet publike janë të obliguara që në mënyrë aktive t'i shpërndajnë informatat për mjedisin të cilat i posedojnë;
- Të drejtën për të marrë pjesë në vendimmarrjen për mjedisin. Autoritetet publike duhet t'i bëjnë përgatitjet që t'ia mundësojnë opinionit të influencuar dhe organizatave jo qeveritare për mjedisin që të bëjnë komente, për shembull, lidhur me propozimet për projektet të cilat ndikojnë në mjedis, ose për planet dhe programet që kanë të bëjnë me mjedisin, që këto komente të merren parasysh në vendimmarrje dhe informatat të ofrohen në vendimet përfundimtare dhe në arsyet për atë vendim;
- të drejtën për rishikimin e procedurave për kundërshtimin e vendimeve publike të cilat janë marrë pa i respektuar dy të drejtat e sipërpërmendura ose të drejtën mjedisorenë për gjithësi.

2.4.2. Konventa ESPOO dhe Protokolli i Kievit

Konventa Espoo (EIA) (Konventa UNECE mbi..... Mjedisor, 1991) përcakton obligimet e palëve për ta vlerësuar ndikimin në mjedis të aktiviteteve të caktuara në një fazë të hershme të planifikimit. Poashtu i formulon obligimet e përgjithshme të shteteve për ta njoftuar njëra tjetrën dhe për t'u këshilluar me njëra tjetrën lidhur me të gjitha projekte të mëdha që janë në shqyrtim dhe që ka gjasa të kenë ndikim të rëndësishëm të pafavorshëm në mjedis përtej kufijve. Konventa u aprovua më 1991 dhe hyri në fuqi më 10 shtator 1997. Siç thekson Marsden (2008).

2.4.3. Protokolli i Kievit

Është i rëndësishëm për t'u përmendur në kontekst të vlerësimit strategjik të mjedisit, meqë dotë mund të konsiderohej si njëri prej instrumenteve më të rëndësishme ndërkombëtare që parashtron kushte për vlerësimin e propozimeve strategjike (Marsden, 2008). Protokolli është aprovuar në një takim të jashtëzakonshëm të Palëve pjesëmarrëse në Konventën ESPOO, të mbajtur më 21 maj 2003 dhe kërkon nga Palët e saj që t'i vlerësojnë pasojat mjedisore të projekteve të planeve dhe të programeve të tyre zyrtare. Vlerësimi i Strategjiki Mjedisit (VSM) ndërmerret shumë më herët në procesin vendimmarrës se sa vlerësimi i ndikimit mjedisor të projektit (NMP) dhe prandaj

konsiderohet si mjet kryesor për zhvillimine qëndrueshëm. Protokolli poashtu parashikon pjesëmarrje të gjerë publike në vendimmarrjen qeveritare në shumë sektorë të zhvillimit. Protokolli kërkon që vlerësimistrategjikimjedisittë kryhetpër planet dhe programet të cilat përgatiten për bujqësi, pylltari, peshkim, energjetikë, industripërfshirë minierat, transport, zhvillimi rajonal, menaxhim të mbeturinave, menaxhim të ujërave, telekomunikim, turizëm, planifikimi të qytetit ose të fshatit ose shfrytëzim të tokës, dhe të cilat vendosin kornizën për miratimine zhvillimit të ardhshëm për projektet. Sugjerimet për promovimin e pjesëmarrjes publike dhe përfshirja e aktorëve po ashtu janë në përputhje me protokollin.

2.5. Historiku Legjislativ, Organet Administrative Përgjegjëse

2.5.1. Ligji i Kosovës për Planifikim Hapësinor

Ligji për Planifikimin Hapësinor është aprovuar në shtator 2003 dhe është ndryshuar në nëntor 2008 (Ndryshimi i Ligjit për Planifikim Hapësinor, Ligjinr. 03/L-106), ndërkaq në korrik të viti 2013 është aprovuar Ligji i ri i Planifikimit (Ligji Nr. 04/L-174) duke pasur si qëllim kryesor:

- Rregullimin e të gjitha çështjeve që kanë të bëjnë me planifikimin hapësinor dhe urban;
- Duhet t'i respektojë parimet e mbrojtjes së burimeve natyrore të dhe ta përkrahë zhvillimin e qëndrueshëm;
- Duhet t'i përkrahë proceset gjithëpërfshirëse dhe pjesëmarrëse dhe duhet t'i përfshijë të gjitha palët e interesuara dhe komunitetet
- Përkrahja e zhvillimeve hapësinore evropiane që janë duke ndodhur etj.

Sipas Ligji Nr. 04/L-174 në Kosovë ekzistojnë 2 nivele të planifikimit (Qendror dhe lokal) dhe llojet e planeve janë Plani Hapësinor i Kosovës, Harta Zonale e Kosovës, Planet Hapësinore për Zona të Veçanta, Planet Zhvillimore Komunale (PZHK), Harta Zonale e Komunës, dhe Planet Rregulluese Urbane të Hollësishme. Për të gjitha ato lloje të planeve është i obligueshëm rishikimi dhe mundësitë për pjesëmarrje të opinionit. PZHK si lloji më i rëndësishëm për detyrën aktuale është plani multi-sektorial për gjithë territorin e komunës që i përcakton objektivat afatgjata për zhvillimin ekonomik, shoqëror dhe hapësinor. Ai duhet ta përfshijë periudhën prej së paku 8 vjetëve dhe ta përfshijë një Plan për zhvillimin e hapësirave urbane dhe fshatrave brenda komunës. Te gjitha nivelet e Planeve duhet te përfshijnë zhvillimin e qendrueshëm si dhe për secilin Plan obligohet përgaditja e raportit të VSM paralelisht me Planin.

Sipas Ligji Nr. 04/L-174 Ministria e Mjedisit dhe Planifikimit Hapësinor (MMPH) është përgjegjëse për bashkërendimin e planifikimit hapësinor në Kosovë dhe për propozimin për politikat për zhvillim hapësinor në fushën e planifikimin hapësinor, si dhe për hartimin e dokumenteve dhe të raporteve përkatëse për planifikimin hapësinor, shqyrtimin dhe monitorimin e të gjitha dokumenteve planifikuese në mbarë territorin e Kosovës. Ndërsa autoritetet lokale janë përgjegjës për zbatimin zhvillimet urbane të nivelit lokal të cilat duhet të jenë në harmonime politikat dhe programet nacionale si dhe duke rrespektuar përgjegjësitë që dalin nga Ligji Nr. 04/L-174.

2.5.2. Ligji i Kosovës për Vlerësimin Strategjik të Mjedisit (VSM)

Ligji Nr. 03/L-230 nënvizon rëndësinë e integritit të parimeve për mbrojtjen e mjedisit gjatë përgatitjes, aprovimit dhe realizimit të Planeve dhe të Programeve përkatëse nëse është e qartë që këto të fundit kanë ndikime domethënëse në mjedis. Lista e Planeve

dhe e Programeve të obligueshme është e përcaktuar në kuadër të ligjit. Ato Plane nuk mund të aprovohen ose t'i dorëzohen organit legjislativ për aprovim pa raportin VSM. Nëse mendohet që VSM nuk nevojitet vendimi për katë s'duhet të jetë në formë të shkruar dhe duhet t'i përfshijë arsyet e tij. Raport i VSM-së identifikon, përshkruan dhe vlerëson ndikime të mundshme të rëndësishme në mjedis nga zbatimi i Planit ose Programit dhe vlerëson alternativat e arsyeshme. Kërkesat përcaktohen në Ligj në mënyrë që t'iu ofrojnë qasje në dokumente të VSM-së organeve këshilluese dhe opinionit të përgjithshëm. Projekti i dokumenteve VSM-së është një dokument për diskutim publik. Në kuadër të ligjit përcaktohet kërkesa të posaçme për raste të këshillimeve ndërkufitare. Para se të aprovohet raporti VSM, ministria duhet ta shqyrtojë atë dhe të pajtohet me të. Po ashtu janë përcaktuar procedurat për informimin lidhur me aprovimin e vendimeve, për monitorimin dhe mbikëqyrjen. Shtojcat e ligjit përmbajnë kritere të caktuara për përcaktimin e rëndësisë së mundshme të ndikimeve në mjedis dhe informatat e nevojshme që duhet të ofrohen në raportet VSM si edhe kriteret për vlerësimin e raporteve të VSM-së.

2.5.3. Planet dhe programet e tjera të rëndësishme

Përveç legjislacionit raporti i VSM-së duhet të merr parasysh edhe Planin Hapsinore të Kosovës 2010-2020+, Strategjin për Mjedisin dhe Planie Veprimit në Mjedis, si dhe disa Plane, Programe dhe dokumente të ndryshme të politikave të përgatitura dhe të lëshuara rishtazi nga autoritetet nacionale dhe institucionet e tjera relevante për të vazhduar më tutje me zbatimin e objektivave strategjike dhe të kërkesave ligjore.

GJENDJES EKZISTUESE - ANALIZA

III. GJENDJES EKZISTUESE - ANALIZA


2.1.3 Veçoritë mjedisore

Në territorin e Komunës së Prishtinës dominon një peizazh malor që përfshin lindjen, verilindjen dhe juglindjen, ndërsa territori perëndimor i komunës shtrihet në rrafshin e Kosovës. Ujërat që e karakterizojnë këtë rajon janë: Liqeni i Badovcit, Lumi Llap, Prishtevka, dhe Vellusha. Por edhe Liqeni i Badovcit, pyjet, mineralet dhe tokat bujqësore duhet të konsiderohen si burime natyrore me potencial për zhvillim. Vlerë e veçantë natyrore e Komunës së Prishtinës konsiderohet Parku i Gërmisë me status 'Pejzazh i mbrojtur'. E vendosur në verilindje të Kosovës, Prishtina mbulon një sipërfaqe prej 111.05 km². Gjeomorfologjia e kësaj zone është e strukturuar nga kodra me lartësi të ndryshme.

Pedologjia

Relievi i rajonit të Prishtinës, nga aspekti gjeografik dhe ai morfologjik, veçohet me zona bregore valore, zona e rajonit kodrinor- malor, dhe zona fushore që nga aspekti gjeomorfologjik, gjenetik dhe ai klimatik dallojnë mes tyre.

Ndikimi i vazhdueshëm nga aktivitetet njerëzore sjell deri te degradimi i sipërfaqeve tokësore duke shkaktuar edhe pasoja të dëmshme mjedisore dhe socio-ekonomike. Sfidë është që të parandalohet degradimi i tokave përmes masave dhe politikave specifike për mbrojtjen e tokave.



Përberja Prdologjike

Gjeologjia dhe tokat


Vlerësimi i përshtatshmërisë së terrenit për ndërtim, i evidentuar në pikëpamje hapësinore, është bërë sipas kriterëve të bartshmërisë dhe stabilitetit në terrene stabile, kushtimisht-stabil edhe jo stabil. Terreni seizmik aktiv, në kuptimin më të gjerë është karakteristikë edhe për rajonin e Prishtinës me tërmete të mundshme me intensitet deri 9 SH.M (Merkalit) ,Një depozitë minerale e njohur si Artana ndodhet në pjesën lindore të Prishtinës, rreth 18 km nga ajo. Artana llogaritet të përmbajë 9 milion ton mineral, me një përmbajtje mesatare prej 2,5% Zn (zinkut), 2,3% Pb (plumb) dhe 92 ppm Ag (argjend).

Toka e Prishtinës në aspektin gjeologjik apo përmbajtje të shkëmbinjve përbehet kryesisht nga gur gëlqeror, gur ranor, gur mermeri me një sipërfaqe prej 6774 apo 13.32% të territorit.

Kategoritë gjeologjike	Sipërfaqja (ha)	%
Alluvium	2114	4.16%
Andesite	1721	3.38%
Breccias and blocks	84.74	0.17%
Limestone	61.97	0.12%
Clay, sand, gravel, marl, partly lignite	5473	10.76%
Gneiss	53.7	0.11%
Granitic rocks (granite, leucogranite, granite porphyry)	24.03	0.05%
Gravel, sand, clay	42.37	0.08%
Keratophyre, quartz keratophyre	25	0.05%
Limestone, marlstone, calcarenite ëith chert	443.3	0.87%
Limestone, sandstone, conglomerate	2234	4.39%
Limestone, siltstone, sandstone, marlstone	6774	13.32%
Micaschist, gneiss, leptynite, leptynitic gneiss	92.25	0.18%
Gabbro	34.94	0.08%
Olistostrome (sedimentary melange)	531.9	1.05%
Marlstone, limestone	888.1	1.75%
Para-Orthoschist	1231	2.42%
Peridotite (harzburgite, ëehrlite)	926.7	1.82%
Quartzite	5.93	0.01%
Massive coralliferous limestone	491.1	0.97%
Amphibolite, amphibole schist	176.1	0.35%
Biotite gneiss, biotite schist	269	0.53%
Conglomerate, breccia, sandstone, limestone	2342	4.60%
Diabase, spilite, basalt	834.8	1.64%
River terrace	772.5	1.52%
Melange ëith olistoliths	274.5	0.54%
Metagranitic rocks (gneiss granite, leucogranite, granite)	240.7	0.47%
Proluvium	901.2	1.77%
Pyroclastite of the andesite group ëith tuff, lappilli, breccia	491.3	0.97%
Gabbro	1.54	0.00%
Recrystallised limestone and marble olistoliths	307.5	0.60%
Sandstone, mudstone, marlstone, limestone, tuffite, partly magnesite	832	1.64%
Sandstone, mudstone, marlstone, pyroclastic rocks	1077	2.12%
Sandstone, mudstone, siltstone	1412	2.78%
Sandstone, phyllite, marble, calcareous schist	546.1	1.07%
Sandstone, siltstone, partly marlstone	15753	30.97%
Serpentine	515	1.01%
Marble, recrystallised limestone	5.72	0.71%
Deluvium	515.73	1.02%

Tabela .1. Veçoritë gjeologjike³

³ Të dhëna të siguruar nga sistemi i të dhënave GIS mbi bazën të dhënave EULUP



Formacionet Gjeologjike


Karakteristikat hidrografike

Hidrografia është element i rëndësishëm natyrorë. Pasuria në ujëra sipërfaqësor dhe nëntokësore varet nga përbërja gjeologjike.(shtresat ujëmbajtëse e ujëlëshues), format e relievit, klima (temperatura, reshjet, erërat etj), mbulesa vegjetative dhe ndikimi i njeriut në rregullimin e shtretërve dhe shfrytëzimit të ujit për nevoja të ndryshme

Në pikëpamje hidrografike, rajoni i Prishtinës është i varfër. Rrjedhat ujore të rajonit më të gjerë të qytetit i përbëjnë lumi i Prishtinës dhe Vellushës, që së bashku derdhen në Sitnicë me disa përrenj të përherëshëm dhe periodikë. Temperatura mesatare vjetore është 11C kurse për nga lartësia e të reshurave, Prishtina ka mesatarisht 580 mm reshje vjetore.Në rajonin e Prishtinës është edhe Liqeni i Badovcit, i cili shtrihet pjesërisht në juglindje të Prishtinës, u ndërtua në vitin 1960 me qëllimin e ofrimit të ujit të pijshëm për Prishtinën, si dhe ujë për Minierën e Kishnicës. Liqeni përdoret gjithashtu edhe për peshkim.

Pjesa më e madhe e ndjeshmërisë së ujërave nëntokësor në Prishtinë është e ulët me një sipërfaqe prej 39587.76 ha apo 75.67 % të territorit, ndërsa sipërfaqja prej 2030.53 ha apo 3.88 % e territorit të komunës ka ndjeshmëri shumë të lartë të ujërave nëntokësore.

Kategoria	Sipërfaqja (ha)	Përqindja %
Ndjeshmëri shumë e ulët e ujërave nëntokësorë	39587.76	75.67
Ndjeshmëri e ulët e ujërave nëntokësorë	2955.91	5.65
Ndjeshmëri e mesme e ujërave nëntokësore	6516.36	12.46
Ndjeshmëri e lartë e ujërave nëntokësorë	1224.89	2.34
Ndjeshmëri shumë e lartë e ujërave nëntokësorë	2030.53	3.88



Njësitë hidrogeologjike


Lartësia mbidetare

Relievi i territorit të komunës së Prishtinës përbëhet nga disa tërësi, megjithatë, relievi fushor dhe malor formon fizionominë kryesore të kësaj hapësire gjeografike.

Kategorisë së relievit kodrinor dhe malor i takojnë pjesa më e madhe e pjesës lindore veri-lindore dhe jug-lindore.. Kuptohet, pamjes së tyre morfologjike të tanishme i ka paraprirë predispozicioni i lëvizjeve tektonike që ndodhën në kohën e terciarit kur mbi shtresat gëlqerore janë formuar shtresa të trasha të shkëmbinjve vullkanikë. Në pikëpamje gjeologjike dhe morfologjike territori i rrethinës së Prishtinës bën pjesë në sistemin dinamik.

Prishtina shtrihet në mes të lumenjve të vegjël Prishtevkës dhe Vellushës, që rrjedhin nga kodrinat xehetarie në anën perëndimore të malësisë së Gollakut. Në anën jugore dhe perëndimore Prishtina kufizohet me kodrina të vogla që lëshohen në tokat pjellore të Fushës së Kosovës. Lartësia mbidetare sillet prej 585m , 640, 670 dhe rreth 700 m lartësi mbidetare në disa lagje të qytetit.

Pra, Reliefin e Prishtinës e karakterizojnë kurorat malore, të zhvilluara përreth rrafshit të Kosovës dhe territori fushor. Prishtina ka lartësi mbidetare maksimale 1212 m dhe me të ulëtën 515m.



Hipsometria e terrenit

Pjerrtësia e shpatieve


Përcaktimi i pjerrtësisë së territorit e sidomos i pjerrtësisë së shpateve jo stabile ka rëndësi të madhe praktike. Nëpër sipërfaqet e shpateve të pjerrëta zhvillohen shumë veprimtari njerëzore dhe procese natyrore morfodinamike. Proceset si erozioni, rrëshqitjet, shembjet etj. mund të jenë jashtëzakonisht të dëmshme në ato hapësira në të cilat paraqiten. Kriteret për kategorizimin e sipërfaqeve sipas pjerrtësisë së terrenit ndryshojnë varësisht nga qëllimet e kërkimeve shkencore dhe kategorizimit sipas autorëve të ndryshëm.

Sipas A. Bognarit (1991) në sipërfaqe të rrafshëta hyjnë ato sipërfaqe këndi i rënies te të cilat është nga 0-20, terrenet me pjerrtësi të butë 2-50, terrenet me pjerrtësi të konsiderueshme 5-120, terrenet me shpate shumë të pjerrëta 12-350 dhe terrene me shpate të rrëpishme mbi 550. Po ashtu, i njëjti autor ka bërë edhe vlerësimin e përshtatshmërisë së pjerrësisë së terrenit për ndërtim, i cili kategorizim është pak i dallueshëm me kategorizimin e lartpërmendur. Sipas këtij kategorizimi terrene shumë të përshtatshme për ndërtim janë ato me pjerrtësi 0 - 20, terrene të përshtatshme për ndërtim 2 - 50, terrene të përshtatshme për ndërtim me intervenime adekuate 5 - 120, terrene të papërshtatshme për ndërtim me përgjashtime të caktuara 12 - 320 dhe mbi 320 terrene të pa përshtatshme për ndërtim.

Këndi i rënies	Emërtimi
0 - 2°	Terrene shumë të përshtatshme për ndërtim
2 - 5°	Terrene të përshtatshme për ndërtim
5 - 12°	Terrene të përshtatshme për ndërtim me intervenime adekuate
12-32°	Terrene të papërshtatshme për ndërtim me përjashtime të caktuara
Mbi 32°	Terrene të pa përshtatshme për ndërtim

Tabela 2. Pjerrësitë e terrenit


Llogaritjet e këndit të rrënjës së terrenit janë bere duke u bazuar në modelin digjital relievor “EUDEM” i cili ka përmasat e rezolucionit hapësinor 25*25m.



Harta e pjerrtësisë së terrenit

Ekspozicionet e terrenit

Në Komunën e Prishtinës dominon relievi kodrinor-malor që përfshin lindjen, verilindjen dhe juglindjen e komunës, ndërsa në pjesën perëndimore është një rrafsh me nivel mbidetar 535-580 metra dhe shtrihet në Rrafshin e Kosovës. Kodrat janë me pjerrtësi më të ulët, përveç lindjes ku pjerrtësia është relativisht më e madhe. Peizazhi natyror i territorit është i ndryshueshëm dhe i paeksploruar. Prerja dhe djegia e drurëve, dhe hedhja e mbeturinave rrezikojnë këto burime nga degradimi i resurseve natyrore. . Faktori kryesor makro-klimatik që ndikon në veçoritë klimatike të Prishtinës është ndikimi dominant i qarkullimit perëndimor të ajrit. Insolimi mesatar vjetor është 2135 orë apo rreth 160 ditë në vit.



Harta e ekspozicionit të terrenit të komunës

Kushtet klimatike

Klima e Prishtinës ka lidhje të ngushtë me pozitën gjeografike të sajë. Në Prishtinë mbizotëron klima kontinentale mesatare duke rezultuar me verë të ngrohtë dhe dimra të ftohtë me një temperaturë vjetore prej 10,4 °C dhe me reshje vjetore mesatare prej 600 mm. Në korrik arrin temperatura vjetore mesatare prej 30 °C, në janar prej -0,6 °C.

	Janar	Shkurt	Mars	Prill	Maj	Qershor	Korrik	Gusht	Shtator	Tetor	Nëntor	Dhjetor	Mesat.
Temp. Maks. (°C)	2,4	5,5	10,5	15,7	20,7	23,9	26,4	26,7	23,1	17,1	10,2	4,2	15,5
Temp. Mini. (°C)	-4,9	-2,8	0,2	4,2	8,5	11,4	12,5	12,3	9,4	5,0	0,9	-3,1	4,5
Temperatur (°C)	-3	-3	2	7	14	18	20	20	15	11	5	-2	8,7
Reshje (mm)	54,99	48	56	62	81,01	78	60	53	58,99	55,99	74,01	69,01	751
Ditë me diell (h/d)	9,01	10,02	11,05	13,02	14,03	15,01	14,05	13,05	12,03	11,06	9,04	9,01	11,7

Tabela 3 Prishtina - Temperatura dhe reshjet mesatare mujore

Dhjetori dhe Janari janë konsideruar si muajt më të ftohtë. Korriku dhe Gushti, si muajt më të ngrohtë të vitit. Sasia maksimale e reshjeve është arritur ndërmjet Tetorit dhe Dhjetorit. Ndërmjet Nëntorit dhe Marsit, në Kosovë mund të bjerë dëbore, madje dhe

në pjesët e sheshta te vendit. Sasia më e madhe e reshjeve mund të bjerë në rajonet malore të Kosovës

Biogeografia dhe biodiversiteti


Biodiversiteti i Kosovës është mjaft i pasur për shkak të ekspozimit të klimës mesdhetare në përmjet luginës së Drinit të Bardh. Në këtë kontekst, Malet e Sharrit dhe Alpet Shqiptare janë dy zonat më të rëndësishme të biodiversitetit. Edhe Prishtina si rajon ku pjesa më e madhe përbëhet nga zona pyjore ka një larmi të bimëve dhe kafshëve që shtrihen në këto pjesë.

Flora

Rajoni i Prishtinës është mjaft e pasur me bimësi. Ajo ka sipërfaqe të mëdha pamjesh të ndryshme. Pos arave, livadheve, kullosave dhe sipërfaqeve jo të larta malore, ku rriten bimë e drunjë të ndryshëm. Prej drunjëve që rriten në rajonin e Prishtinës janë: ahu, qarri, bungu, pisha, plepi, shelgje etj .. Megjithatë toka në pjesën perindimore të Prishtinës është mjaft pjellore dhe kultivohet gruri, misri, dhe kultura të ndryshme bujqësore.

Fauna

Dikur Rajoni i Prishtinës ka pasur një faunë mjaft të pasur. Në zonat malore kanë jetuar: ujku, dhelpra, lepuri. Prerja e pyjeve pa kriter ka bërë që numri i tyre të bie shumë. Në Prishtinë në periudhën e fundit, për shkak të ndotjes së rrethit ekologjik, janë rralluar edhe kafshët shtëpiake. Numri i lopëve, deleve, dhive, kuajve, buallicave etj. Ka rënë shumë edhe numri i shpezëve: pulave, patave etj.



Vlerat e llogaritura të biodiversitetit

INFRASTRUKTURA TEKNIKE

Në territorin e komunës së Prishtinës, infrastruktura teknike e rrjedhimisht edhe shërbimet publike që lidhen me të nuk është në nivel të kënaqshëm të zhvillimit. Kjo çështje është problem sidomos sa i përket nivelit të zhvillimit të infrastrukturës ujore si dhe ujërave të zeza dhe për këtë arsye ka nevojë për përpjekje më të mëdha të shoqërisë që ky problem të zgjidhet apo të zbutet. Problem është po ashtu furnizimi jo i mirë me energji elektrike ku rrjeti elektrik në disa pjesë është shumë i amortizuar, tensioni i dobët dhe ka reduktime të furnizimit si dhe infrastruktura e tensionit të lartë që kalon mbi vendbanime apo shtëpi banimi që rrezikon jetën e njerëzve.

1.1. Ujësjellësi

Në Komunën e Prishtinës furnizimi me ujë përcjellët me probleme të shumta. Aspekti i furnizimit me ujë është njëri ndër problemet më të theksuar, për arsye të mungesës së ujit dhe infrastrukturës së dobët.

KRU Prishtina e cila është përgjegjëse për furnizim me ujë qytetaret e komunës së Prishtinës me kapacitete aktuale që posedon nuk arrin të sigurojë sasinë e ujit të nevojshëm për qytetaret dhe si rezultat i saj reduktimet e furnizimit me ujë janë të larta

ku në pjesë të caktuara të qytetit niveli i reduktimeve arrin deri në 12 orë në ditë. Po ashtu problem tjetër që qon deri të niveli i tillë i reduktimit është infrastruktura e dobët e ujësjellësit në zona të caktuara ku diametri i gypave nuk i përmbushë kërkesat për furnizim me ujë dhe si rezultat i saj kemi kolapsim të rrjetit të ujësjellësit.

Inventari i infrastrukturës ekzistuese

Fabrika e ujit të pijshëm në Albanik, Badovc dhe Shkabaj e cila furnizon banorët në zonën urbane dhe fshatrat prodhon vetëm $Q=1650\text{ l/s}$ për 288139 banorë (Skenari i ulët) duke iu zbritur 42000 banoret e F.Kosves dhe 22.000 banoret e Obiliqit, gjersa numri aktual i këtyre banoreve është 224138 banorë te zonës urbane te Prishtinës.

Gjendja për zonën urbane dhe rurale me norme te përdorimit $q=150\text{ l/d/banor}$ për banor me numër te banoreve aktual (2020) $N_b=288139$ dhe kapacitet $Q_{\max}=68577.0\text{ m}^3/\text{ditë}$ apo $Q_{\max}=1650.0\text{ l/s}$.

Përpos sasisë së pamjaftueshme të ujit, sipas KUR "Prishtina" sh.a- rreth 60% të sasisë së ujit humbet për shkak të defekteve në rrjetin ekzistues dhe keqpërdorimi nga konsumatorët ilegal.

Përderisa shumica e vendbanimeve janë të kyçur në rrjetin e ujësjellësit, vendbanimet rurale vijuese nuk kanë rrjet që furnizon banorët me ujë të pijshëm:

Busi, Mramor, Mramur, Grashticë, Hajkobillë, Marec, Gllogovicë, Dabishec, Prapashticë, Keqekollë, NIshec, Ballaban, Koliç, Radashevc, Sharban, Siçevë, Rimanishtë, Tenezhdoll, Shashkoc, Dragoc, Kukavicë, Sllivovë, Novosellë dhe Zllatar.

Mbulueshmeria e vendbanimeve me rrjet të ujësjellësit

Mbulueshmeria e vendbanimeve me rrjet të ujësjellësit në komunën e Prishtinës nga 42 vendbanime sipas zonave kadastrale, 19 vendbanime posedojnë rrjet të ujësjellësit pra, furnizim me ujë të pijes nga KRU Prishtina, ndërsa 23 vendbanime nuk kanë rrjet të ujësjellësit pra këto vendbanime ujin e sigurojnë nga pusët individuale. Zona urbane ka një mbulueshmëri të mirë me rrjet të ujësjellësit mbi 95% e zonës urbane është e mbuluar me rrjet dhe qytetaret kanë qasje në ujë të pijes, ndërsa sa i përket zonës rurale gjendja në aspektin e shtrirjes së gypave të ujësjellësit është më e vogël ku përqindja e mbulueshmerisë është rreth 43.90%. Ndërsa në aspektin social një numër prej 5628 banorëve nuk kanë rrjet të ujësjellësit në formë të organizuar dhe si e tillë komuna do të planifikojë zgjerimin e rrjetit edhe në vendbanimet që nuk kanë rrjet por me prioritet më të lart për ato vendbanime që kanë numër më të madhe të banoreve si: Maramor, Koliq Tenezhdoll, Zllatar etj.




Figura 1 Mbulueshmeria e me rrjet të ujësjellësit në nivel vendbanimi

Gjendja e rrjetit të ujësjellësit në komunën e Prishtinës

Rrjeti i ujësjellësit në komunën e Prishtinës nuk është në gjendjen më të mirë të mundshme pasi që në zona të caktuara të qytetit ende ekziston rrjeti i vjetër i ndërtuar 50 vite më parë të cilat rrjete përbehen nga asbest çimento i cili material është shumë i dëmshëm për shëndetin e njeriut.

Gypat datojnë nga vitet '50. Si pasojë e vjetërsisë, ka dhe humbje relativisht të larta, rreth 50% nga të cilat 35% janë humbje teknike dhe 15% humbje komerciale.

Menaxhimi i sistemit të furnizimit me ujë të pijes dhe ujëra të zeza bëhet nga kompania publike "Ujësjellësi Rajonal Prishtina", e cila ofron shërbimet e ujit dhe ujërave të zeza në tetë komuna.

Gypat kryesorë që sjellin ujin nga liqeni i Batllavës dhe Badovcit janë gypa të përbërë nga çeliku dhe me një diametër 900 mm respektivisht 600 mm me një gjendje të mirë fizike.

Rrjeti i ujësjellësit primare dhe sekondare janë të përbërë nga materialet e Çelikut, PVC, AC, HDPE dhe PE-100-RC, ku sipas kalkulimeve të marruara nga Autoriteti Rregullativ dhe KRU Prishtina kemi këtë përbërje: Rrjeti Primar 80% është nga materiali i çelikut, 15% nga materiali HDPE dhe Rrjeti Sekondar 5% Çelik, 5% PVC, 35% AC, 35% HDPE, 20% PE-100-RC.




Figura 2 Përqindja e materialeve të përdorura tek infrastruktura e rrjetit të ujësjellësit

I.1.1. Furnizim me ujë të pijes⁴

Zona e shërbimit me ujë në fushë veprimtarinë e KUR "Prishtina" sh.a. për sa i përket shkallës së mbulueshmërisë me shërbime, numrit të konsumatorëve, profilin të konsumatorëve, rritjes së numrit të banorëve, rritjes së zhvillimit ekonomik, mënyrës së përpunimit dhe distribuimit të ujit është shumë e ndryshueshme dhe e komplikuar duke marrë parasysh zhvillimet e shpejta të ndërtimit në zona të reja si Prishtina e re, Kodra etj.

Zona e shërbimit kryesisht ballafaqohet me mos harmonizimin e planeve zhvillimore të komunës dhe planeve strategjike KRUP.




Figura 3 Trendët e rritjes së shërbimeve me furnizim me ujë të qytetareve në Prishtinë

⁴ Plani i biznesit i KRU Prishtina 2019 - 2020

Krahas rritjes së numrit të popullatës në zonën e shërbimit që është mbi mesataren e rritjes në Republikën e Kosovës, KUR “Prishtina” sh.a. do t’i kushtoj kujdes të shtuar edhe përfshirjes sa më të madhe të banorëve në rrjetin e furnizimit. Shkalla aktuale e vlerësuar në rreth 80.23 % dhe kjo shkallë e mblueshmërisë do të vazhdojë deri në mbulim të plotë me shërbime (100 %).

I.1.2. Vlerësimi i nevojave për të ardhmen

Duke u bazuar në projeksionet (mesatare) e numrit të banorëve për vitin 2030 (10 vjet) prej 32337 banorë, me norme te perdorimit 150 l/d/b (sipas normave teknike te planifikimit hapsinor) për zona rurale. Pas kalkulimeve nevojitet të ngriten kapacitet ekzistuese të furnizimit me ujë sipas projeksionit (skenarit mesatar) prej së paku $Q_{max} = 6791.0 \text{ m}^3/\text{ditë}$ apo $Q_{max} = 138.0 \text{ l/s}$ dhe të ndërmerren veprimet e nevojshme për të eliminuar humbjet që shkakton rrjeti i vjetërsuar i ujësjellësit.

Gjersa për të plotësuar nevojat afatgjate të banorëve për 30 vitet e ardhme, Komuna duhet të ngritë kapacitetet ekzistuese në $Q_{max} = 9329.0 \text{ m}^3/\text{ditë}$ apo 188.0 l/s për të furnizuar me ujë të gjitha vendbanimet rurale.

Kurse duke u bazuar në projeksionet për numr të banorëve për vitin 2030 (10 vjet) prej 340293.0 banorë (skenari mesatar) , me norme te perdorimit 300 l/d/b (sipas normave teknike te planifikimit hapsinor) për zonën urbane. Pas kalkulimeve nevojiten të ngriten kapacitet ekzistuese të furnizimit me ujë sipas projeksionit (skenarit mesatar) prej së $Q_{max} = 142924.0 \text{ m}^3/\text{ditë}$ apo $Q_{max} = 3350 \text{ l/s}$ dhe të ndërmarrë veprimet e nevojshme për të eliminuar humbjet që shkakton rrjeti i vjetërsuar i ujësjellësit.

Gjersa për të plotësuar nevojat afatgjate të banorëve për 30 vitet e ardhme me numer të banoreve 340293.0 dhe shtim te popullates prej 2%, me numer total 505,658 banor , Komuna duhet të ngrit kapacitetet ekzistuese në $Q_{max} = 212377.0 \text{ m}^3/\text{ditë}$ apo $Q_{max} = 4977.0 \text{ l/s}$ për të furnizuar me ujë të gjithë zonën urbane.

Pra marrë parasysh që ngritja e kapaciteteve prodhuese të fabrikës së ujit ne shkaban prej 700 l/s, ndërrimi i gypave të rrjetit ekzistues dhe i rezervuarëve dhe klorinatorëve sipas Direktivës së BE-së për ujë të pijes (98/83/EC) është prioriteti më i lartë i Komunës, buxheti i Komunës për investime është i kufizuar për ndërtimin e rrjetit të ujësjellësit.

Për të monitoruar humbjet në rrjetin e ujësjellësit nevojitet të instalohen ujëmatësit zonal brenda qytetit dhe vendbanimeve rurale. Zonat e burimeve nuk janë të mbrojtura sipas Udhëzimit Administrativ për Zonat e Mbrojtura Sanitare, kështu që nevojitet të zbohen masat mbrojtëse.

I.1.3. Përpunimi dhe distribuimi i ujit

Problemi themelor, që rëndon afarizmin e rregullt të ndërmarrjes është përcaktuar sasia e ujit që humbet qoftë si humbje teknike apo si humbje komerciale. Prandaj në grafikonin në vazhdim është paraqitur trendi mujor i sasisë së ujit të përpunuar dhe sasisë së ujit të adresuar tek konsumatorët përmes faturave mujore të shërbimit. Sipas grafikonit sasia më e madhe e ujit të përpunuar është në muajt e verës ku kërkesat për

ujë janë më mëdha më një përqindje prej 9,50 apo 3,338,016 m³, total përpunim dhe distribuimi i ujit i KRUP për komunën e Prishtinës është 34,841,309 m³.




Figura 4 Cilësia e përgjithshme e ujit të pijshëm

Cilësia e përgjithshme e ujit të pijshëm në Kosovë por edhe në Prishtinë që u ofrohet konsumatorëve nga KRU- Prishtina, dhe që monitorohet nga Qendra e Ujit e IKSHPK-së në kuadër të përgjegjësi të saj për monitorim të jashtëm të përcaktuara në UA 16/2012, ka arritur një përpunshmëri me 99.20 % sa i takon standardeve mikrobiologjike të cilësisë së ujit, ndërkaj 98.00% sa i takon standardeve kimike, duke rezultuar në një nivel të përgjithshëm të përpunshmërisë prej 98.30%. Kjo shkallë e përpunshmërisë është e bazuar në rezultatet e testeve të bëra nga laboratorët rajonal të Shëndetësisë Publike (QRSHP).




Figura 5 Përqindja e përmbajtjes cilësisë së ujit sipas raportit për cilësi të ujit në Kosovë

I.1.4. Vlerësimi i kapaciteteve financiare

Buxheti Komunal i përkushtuar investimeve kapitale vitin e kaluar ishte .per t'u plotësuar.€, që shënon një rritje prej 10% krahasuar me vitin e kaluar. Bazuar analizën e

investimeve kapitale gjatë tre viteve të fundit, tabela vijuese paraqet shumën e projektuar për investime kapitale për secilin vit deri në vitin 2028:

Viti	2020	2021	2022	2023	2024	2025	2026	2027
Kapaciteti financiar (milion €)	per t'u plotesuar	per t'u plotesuar	per t'u plotesuar	per t'u plotesuar	per t'u plotesuar	per t'u plotesuar	per t'u plotesuar	per t'u plotesuar

Tabela 4 Kapaciteti i Komunës për investime kapitale për tetë vitet e ardhme është përafërsisht

1.2. Kanalizimi

KRU "PRISHTINA" sh.a, në të gjithë zonën e shërbimit - ka në shfrytëzim 1093 km të rrjetit primar të dimensioneve dhe materialeve të ndryshme. Në të shumtën e rasteve ky rrjet është i përzier edhe me kanalizimin e ujërave atmosferike. Ndërmarrja përmes personelit, mekanizimit dhe pajisjeve teknike që posedon, bënë: pastrimin, debllokimin dhe sanimin në çdo kohë dhe në çdo vend në zonën e shërbimit të të gjitha defekteve, bllokimeve dhe pengesave tjera.

Komuna e Prishtinës në vitin 2018 ka inauguruar fabrikën për trajtimin e ujërave të zeza në fshatin Mramor i cili ka një kapacitet prej 2400 PE ku maksimumi i hyrjeve ditore është 500 m³/dite = 5,78 l/s, impiant i cili përmbush nevojat për trajtimin e ujërave të zeza për një zonë të caktuar të Prishtinës, ndërsa pjesa më e madhe e komunës ujërat e zeza i shkarkon në kuadër të degëve të lumenjve dhe vazhdojnë tutje.

Sa i përket problemeve në aspektin e menaxhimit dhe mirëmbajtjes së rrjetit të kanalizimit gjatë vitit 2018 janë paraqitur 3696 raste të bllokimeve në kanalizim, ku gjatë kësaj periudhe janë kryer gjithsej 3892 intervenime në de bllokim të kanalizimin, pastrim të pusetave dhe vendosje të kapakëve të pusetave në gjithë zonën e shërbimit të KRUP.

Viti/Mu	I	II	III	IV	V	VI	VII	VIII	IX	X	XI	XII	Total
2017	203	374	265	272	352	302	337	302	255	289	233	367	3551
2018	203	221	221	248	345	407	409	394	280	318	279	371	3696

Tabela 5 Krahësim i rasteve të paraqitura në ndërhyrje në rrjet për vitin 2017/2018:

Rrjeti i kanalizimit në aspektin e mirëmbajtjes ka probleme dhe sfida duke pasur parasysh së vetëm në vitin 2018 ka pasur mbi 3696 raste të bllokimeve të rrjetit në zona të caktuara si dhe dëmtime të shumta të pusetave.

1.2.1. Inventari i infrastrukturës ekzistuese mbulueshmeria

Mbulueshmeria e vendbanimeve me rrjet të kanalizimit në komunën e Prishtinës nga 42 vendbanime sipas zonave kadastrale, 19 vendbanime posedojnë rrjet të kanalizimit pra, ujërat e ndotura të 23 vendbanimeve derdhen në lumeje apo hapësira të ndryshme natyrore.

Aspekti i mbulueshmeris në grumbullimin dhe trajtimin e ujërave të zeza në komunën e Prishtinës nuk është në gjendjen më të mirë duke pasur parasysh se mbi 54% e vendbanimeve nuk posedojnë rrjet të kanalizimit fekale.

Ndërsa në aspektin social një numër prej 5628 banorëve nuk kanë rrjet të kanalizimit në formë të organizuar dhe si e tillë komuna duhet të planifikojë zgjerimin e rrjetit edhe në vendbanimet që nuk kanë rrjet por me prioritet më të lart për ato vendbanime që kanë numër më të madhe të banoreve si: Maramor, Koliq Teneshdoll, Zllatar etj.




Figura 6 Përqindja e mbulueshmerisë së vendbanimeve me rrjet të kanalizimit

Ndotja e lumenjve dhe shkarkimet e ujërave të zeza: Siç edhe e cekem me larte komuna e Prishtinës nuk ka impiant për trajtimin e ujërave të zeza i cili do të trajtonte ujërat e zeza për gjithë territorin e komunës. Mungesa e impiantit i detyron që të gjitha ujërat e zeza shkarkohen në lumeje të cilët shtrihen në territorin e komunës.

Komuna	Vendbanimi	Nr. i banorëve	Vendshkarkimi
Prishtinë	Qyteti	43 0245	Prishtevka
	Bardhosh	2 150	Lumi Llap
	Barilevë	4 200	Lumi Llap
	Besi	907	Lumi Llap
	Hajvali	6 000	Gračankë
	Prroi i njelmët	1 000	Ujëra nëntokësorë
	Prugovc-Leban	800	Lumi Llap
	Shkabaj	1 500	Sitnicë
	Trudë	540	Lumi Llap
	Vranidoll	870	Lumi Llap

Tabela 6 Ndotja dhe derdhjet e ujërave të zeza në lumeje

Siç shihet nga tabela, “lumi” më i ngarkuar në Komunën e Prishtinës është padyshim Prishtevka, e cila mund të thuhet se është shëndrruar në rrjedhë lumore pikërisht nga ujërat e zeza të mbi 430000 banorëve të kryeqytetit. Lumi i dytë i ngarkuar është Llapi me rreth 9450 banorë, Graçanka me 6000 banorë dhe sitnica me 1500 banorë. Në ujëra nëntokësorë shkar-kojnë ujërat e zeza rreth 1000 banorë.

I.2.2. Vlerësimi i nevojave për të ardhmen

Në mënyrë që të mënjanohen problemet ekzistuese në rrjetin e kanalizimit, pjesa e rrjetit që mbledhë ujërat e zeza dhe atmosferike duhet të ketë rrjet të ndarë për mbledhjen e tyre.

Duke marrë parasysh që ujërat e zeza ndotin lumenjtë, Komuna duhet të ndërtojë impiante për trajtimin e ujërave të zeza. Bazuar në studimin e WYG International, të financuar nga Komisioni Evropian, Komuna ka nevojë urgjente për ndërtimin e Impiantit për trajtimin e ujërave të ndotura (zeza).


Dhe atë të ndarë në faza:



Faza 2 - WWTPs + kolektorët kryesor + interceptore primare të kanalizimeve në pjesët urbane.

Qëllimi është për të marur të gjitha ujërat e zeza ekzistuese të larguara nga lumenjtë Prishtevka, Vellusha dhe Matiqan dhe të transferuar në WWTP – Jo shumë konsumatorë të rinj të kanalizimit janë shtuar në sistem

Faza 2 - Zgjerim i sistemeve të kanalizimeve në vendet rreth pjesëve urbane ku nuk ka kanalizim shumë konsumator të rinj

Faza 3- Rritja dhe përmirësimi i kanalizimeve ekzistuese në pjesët urbane për të siguruar kapacitet adekuat dhe zvogëlimi i derdhjes së ujit të shirave në lumen me gypa të PESN 8, PESN 10, PESN 12.





1.3. Ujitja dhe Drenazhimi

Ujitja dhe kullimi janë një nga faktorët kryesorë me ndikim të drejtpërdrejtë në rritjen e qëndrueshme të prodhimit bujqësor në vend. Megjithatë reshjet mesatare vjetore janë të bollshme, gjatë verës bien vetëm 20% e sasisë së tyre. Për të siguruar një bilanc optimal,

është e domosdoshme ujitja me 3000-5000 m³/ha dhe kullimi veçanërisht gjatë periudhës së dimrit, me një hidromodul 4-5 litra/sek/ha.

Komuna e Prishtinës në aspektin hidrografike apo burimeve ujore është e pasur duke ditur se në territorin e komunës kalojnë disa lumenj dhe si e tillë mundësia e ujitjes së tokave bujqësore është e lartë.

Në kuadër të komunës ekziston sistemi i ujitjes së tokave bujqësore për disa zona të caktuar, sistem i cili është i menaxhuar nga kompania regjionale 'Tbër Lepenci'. Në komunën e Prishtinës kalojnë rreth 25,331.83 metra rrjet i ujitjes, 24533.60 metra kanal i hapur dhe 6528.60 metra tubacion ku ujiten rreth 647 ha tokë bujqësore.

Sistemi i ujitjes së tokave bujqësore në Komunën e Prishtinës është i ndërtuar vite me parë dhe si rezultat i saj ka probleme në funksionimin e tij në formën me të mirë.

Ndër problemet kryesore të cilat afektojnë mos funksionimin adekuat të rrjetit të ujitjes janë:

Zhvillimi i banimit në toka ku janë nën sistem të ujitjes: Ndër problemet me të theksuar në kuadër të ujitjes së tokave bujqësore është ndërtimi apo shndërrimi i zonave nën sistem të ujitjes në toka ndërtimore dhe si rezultat i saj këto toka tash me janë të pa shfrytëzueshme për zhvillim bujqësor.




Figura 7 Ndërtimi në kuadër të tokave bujqësore nën sistem të ujitjes

Menaxhimi dhe mirëmbajtja e kanaleve të ujitjes: Sipas informatave rrjeti i ujitjes së tokave bujqësore nuk është në nivelin me të mirë në zona të caktuara për shkak të zhvillimeve të shumta në nivel të këtyre tokave dhe si rezultat i saj këto kanale mbyllen dhe bëhen të pa shfrytëzueshme për përdorim.

Mbulueshmëria e tokës bujqësore me rrjet të ujitjes: Mbulueshmëria me rrjet të ujitjes së tokave bujqësore është e vogël rreth 647 ha tokë bujqësore ujitet në komunën e Prishtinës, gjë që është në nivel të ulët duke pasura parasysh kushtet topologjike të terrenit, sasinë e ujërave nëntokësore dhe sipërfaqësore në pjesët e rrafshit ku toka bujqësore është e kualitetit të mirë janë në nivel të lartë, por në bazë të dhënave edhe kjo sipërfaqe e pakët e cila është e ujitur është humbur në masë të madhe.

Analiza SWOT - UJËSJELLËSI, KANALIZIMIT DHE UJITJA	
Përparësitë	Dobësitë
- Sasia e mjaftueshme e ujit për pije; - 95% e popullatës në zonën urbane furnizohet me ujë dhe 80% të asaj rurale; - Burime të ujit të pijes; - Cilësia e mirë e ujit; - Menaxhimi dhe mirëmbajtja e kanaleve ekzistuese dhe të reja është në kompetencë të KRU Prishtina. - Ujërat nëntokësore shtrihen në 40% të territorit të Komunës; - Vazhdimësia e ndërtimit të kanaleve të reja; - Impianti për trajtimin e ujërave të zeza; - Qasja e gypave primar dhe sekondar në kolektor që bart ujërat e zeza në impiant; - 45.24 e vendbanimeve me rrjet të ujësjellësit; - Ofrimi i ujitjes optimale përkundër kushteve minimale;	- Mos shfrytëzimi i kapaciteteve të ujit për nevoja të pijes; - 5% e popullsisë në zonën urbane nuk kanë qasje në ujësjellës; - 54.76% vendbanimeve nuk kanë rrjet të ujësjellësit; - Reduktim i lartë i furnizimit me ujë në ditë; - Mos shfrytëzim i burimeve ekzistuese të ujit për nevoja të qytetarëve; - Rrjeti pjesërisht i vjetër i ujësjellësit dhe gypa nga materiali AC në disa zona; - Mungesa e sistemit të akumulimit të ujërave; - Domosdoshmëria e shfrytëzimit të pompave në disa pjesë të qytetit (lagjet në zonat e larta); - Mungesa e kyçjes së disa fshatrave në rrjetin kryesor; - Shfrytëzimi jo i duhur i ujit (abuzimet); - Mungesa e koordinimit ndërmjet kompanive publike; - Rrjeti i vjetruar i kanalizimit; - 54% e vendbanimeve pa rrjet të kanalizimit; - Përzierje e rrjetit të kanalizimit me atë atmosferik; - Mungesa e rrjetit atmosferik; - Ndotja e ujit në kanalet e ujitjes; - Sipërfaqe e vogël e ujitur; - Mënyra primitive e ujitjes;
Mundësitë	Rreziqet
- Shfrytëzimi i investimeve të jashtme; - Garantët qeveritarë; - Aplikimi i arritjeve teknologjike; - Trajnimi i stafit; - Ekzistenca e Legjislacionit	- Mos ndërrimi i gypave të vjetër të ujësjellësit; - Cenimi i kualitetit/sigurisë së ujit si pasojë e rrjetit të vjetërsuar; - Humbjet e mëdha të ujit në rrjet; - Keqpërdorimi i ujit;

përkates; - Ridizajnimi i sistemit të ujitjes (futja e kanaleve te hapura ne tubacione); - Inkorporimi i kanaleve të reja të ujitjes në sistemin menaxhues të KRU Prishtina;	- Mospjesëmarrja e komunitetit në vendimmarrje në procesin e ndërtimit të impiantit (çështja e eksproprijimit); - Politika joadekuate; - Dëmtimi i rrjetit të ujësjellësit, kanalizimit dhe ujitjes;
--	--

Tabela 7 Analiza SWOT

1.4. Energjia elektrike

Furnizimi me energji elektrike bëhet nga KEK-u përmes energjisë së prodhuar në termocentralet e Obiliqit. Furnizimi me energji elektrike është jo i qëndrueshëm dhe i pamjaftueshëm, ka ndërprerje të shpeshta të rrymës elektrike. Arsyet për këtë janë kapacitetet e kufizuara të termocentraleve të Obiliqit dhe humbjet teknike dhe ato administrative, si dhe defektet e shpeshta në rrjet. Rrjeti elektrik është i vjetruar dhe shumica e objekteve të banimit furnizohen me energji nga kabllot mbitokësore, e të cilat të shumtën e rasteve janë në gjendje të keqe dhe burim rreziku për qytetarë. Rinovimi i këtij sistemi të vjetruar dhe ndërtimi i kapaciteteve të reja duhet të jenë në prioritet të lartë. Ndërprerjet e shpeshta të energjisë elektrike implikojnë përdorimin e burimeve tjera të energjisë, siç janë gjeneratorët, të cilët janë gjithashtu burim i ndotjeve të ajrit dhe zhurmës së madhe.

Sipas informacioneve të siguruar nga KEK-u dhe KOST-i aspekti i furnizimit me energji elektrike në Komunën e Prishtinës i gjithë territori i komunës ka mbulueshmëri me rrjete që do të thotë çdo qytetar i komunës ka qasje në energji elektrike por përkundër qasjes në energji ky sektor ka problem dhe sfida në aspektin e furnizimit të rregullt me energji të qytetarëve.


Rrjeti i energjisë elektrike: Sa i përket problemeve dhe sfidave në aspektin e energjisë elektriken si në nivelin nacional ashtu edhe komunalë është rrjeti elektrik i cili është i vjetër, pra infrastruktura është vjetërsuar duke filluar nga telat shpërndarës të cilët janë të shtrire po thuaj në të gjithë qytetin dhe gjendja se si janë momentalisht është shumë e rrezikshëm për qytetarin. Po ashtu shtyllat në të cilat mbështetet rrjeti një pjesë e madhe janë nga druri dhe në gjendje jo të mirë fizike të tyre, dhe si rezultat i infrastrukturës së dobët çdo vite kemi humbje të jetës së njerëzve nga energjia elektrike.

Problem tjetër i cili duhet të theksohet është rrjeti i tensionit të lartë i cili kalon në komunën e Prishtinës kryesisht lagjet Sofali, Kalabri, Prishtina Re, gjendja fizike e këtij rrjeti nuk është në nivelin e kënaqshëm, po ashtu ky rrjet kalon mbi shtëpi banimi pra nuk ka një tampon zonë mbrojtëse të respektuar dhe si rezultat i saj është rrezik i lartë për jetën e qytetarëve.

Mungesa e investimeve në sistemin e rrjetit të shpërndarjes: Investimet e pamjaftueshme në sistemin e shpërndarjes së energjisë elektrike kanë bërë që ky sistem të mos mund të përballojë ngarkesën në rritje, veçanërisht të përballojë ngarkesën në

sezonin e dimrit. Kjo ka pasur për pasojë nivelin shumë të lartë të humbjeve teknike që ka rënduar vazhdimisht sistemin.

Investimet në kapacitete gjeneruese: Me gjithë faktin se komuna ka resurse të mëdha energjetike, si zona kodrinor-malore të cilat kanë potencial për krijim të energjisë së ri-



përtrishme por nuk ka pasur asnjë investim në ndërtimin e kapaciteteve të reja apo rehabilitimin e kapaciteteve ekzistuese që do të mundësonte një furnizim stabil me energji elektrike.

Mos shfrytëzimi i energjisë në mënyrë racionale: Me gjithë potencialin e konsiderueshme për kursimin e energjisë, ky potencial nuk është duke u shfrytëzuar sa duhet në Kosovë.

Shiritat Mbrojtës Rreth Linjave Elektroenergjetike

Shfrytëzimi i shiritave rregullohet me norma teknike si dhe me ligje përkatëse (UA) dhe më tutje këto konsiderohen si zona të sigurisë dhe shërbejnë për ndërtimin, shfrytëzimin dhe mirëmbajtjen e tyre në vazhdimësi.

Nr	Linja kablloviqe nëntokësore	Ekzistuese	Planifikuara
1	2x110 kV	16	20
2	110 kV	12	16
3	35 kV	10	10
4	20 kV	6	8
5	10 kV	4	6

Tabela 8 Linjat nëntokësore

Nr	Linja ajrore energjetike	Ekzistuese	Planifikuara
1	2x110 kV	30	40

2	110 kV	20	30
3	35 kV	16	20
4	20 kV	12	15
5	10 kV	10	12

Tabela 9 Linjat ajrore

Qasja, aktivitet e punës, përgjegjësitë dhe detyrat në këto zona janë të rregulluara me ligjin e miratuar mbi energjinë elektrike, si dhe udhëzimi administrative mbi zonat nen dhe rreth stabilimenteve energjetike.

Bazuar nga normat që u cekën më lartlartë për këtë qëllim për linja energjetike kabllorike nëntoksore duhet të sigurohen koridore :

Ndërsa korridoret rreth largëpërquesëve kur ndërtohet si linjë ajrore është e nevojshme që ti sigurohet një shirit mbrojtës me dimensione të përcaktuara në tabelën e mëposhtme.

I.4.1. Ndërtimi i rrjetit

Rekomandimet nga Plani shtesë investues për vitet 2018-2023:

Duke u bazuar në planet zhvillimore sektoriale të hartuara si pjesë e Planit Zhvillimor Komunal, Planit Zhvillimor Urban dhe Planit Rregullues Urban të Prishtinës, si dhe rekomandimet dhe duke marrë për bazë gjendjen ekzistuese të rrjetit energjetik dhe atij të telekomit, është analizuar në tërësi, në të njëjtin janë nxjerrë përfundimet si dhe nevojat për zgjerimin e kapaciteteve energjetike në komunën e Prishtinës.

Rekomandimet nga Plani shtesë investues për vitet 2018-2023:

- Rritja dhe përmirësimi i kapaciteteve të tensionit të mesëm në nënstacionet ekzistuese 110/35kV (zgjerimi i NS 110/35kV me transformatorë të ri me transformim 110/10(20)kV – zgjerimi i kapaciteteve të TM 10(20)kV).
- Rehabilitimi i përgjithshëm i sistemit dhe ngritja e kapaciteteve të tensionit të mesëm për të mundësuar ndryshimin e nivelit të operimit të tensionit të rrjetit.
- Zëvendësimi i transformatorëve 10/0.4 kV me transformatorë 20(10)/0.4 kV .
- Zëvendësimi i linjave 10kV të vjetërsuara dhe të mbingarkuara me linja të reja 20kV.
- Zëvendësimi i shtyllave të drurit me shtylla betoni duke i zëvendësuar edhe pajisjet tjera përcjellëse 20kV (izolatorë, konzolla, etj)
- Zëvendësimi i kabllorëve të vjetra me vaj 10kV me kablo të reja të nivelit 20kV
- Zëvendësimi i përçuesëve, shtyllave dhe transformatorëve 10/0,4 kV të dëmtuar, për të qenë në pajtueshmëri me standardet dhe për të garantuar siguri publike dhe të furnizimit.
- Ndërtimi i NS 10(20)/0.4 kV të reja në rrjetin e ngarkuar të tensionit të ulët .
- Shtimi i fuqive të transformatorëve tek ata të ngarkuar mbi 70%, apo ndërrimi i këtyre transformatorëve me transformatorë më pak të ngarkuar.

- Rikonstruimi dhe rikonfigurimi i rrjetave 0.4 kV me prioritet në qendra të qytetit me rrjet të ri kabllor dhe me puseta.

Sipas rregulloret e IEC, IEEE dhe ANSI për projektet e reja, linjat urbane të furnizimit me energji elektrike dhe ato telekomunikuese duhet të ndjekin të njëjtat trase dhe të ndërtohen njëkohësisht.

Forma e kanalit dhe puseta për shtrirjen e rrjetit dhe instalimeve elektrike

Rekomandimet dhe rregulloret e lartshënuara obligojnë që SEE dhe SK të realizohen ashtu që:

Në të gjitha rrugët e asfaltuara, në njërën anë të trotuarit, të rezervuar për këtë qëllim në thellësi mbi 750mm të ndërtohet i ashtuquajti “kanalizimi kablovik” – fig.4.

Numri dhe dimensionet e gypave fleksibil të vendosur në kanalizimi kablovik përcaktohet në varësi nga nevoja dhe do të ishte dashur të definohet në projektin detal – zbatues.

Zakonisht një kanalizim kablovik përmban gypa të brinjëzuar me diametër prej 100mm, 160mm dhe 200mm që përforcohen me rërë.




Figura 8 Detaj Teknik

Në këta gypa vendosen:

- Linja të tensionit 10(20)kV me kabllor XHP 49A 240mm². Me këtë bëhet furnizimi i trafostacioneve të blinduara me herës 10(20)/0.4kV dhe fuqi 400kVA, 630kVA dhe 1000kVA.
- Linja e tensionit 400/231V me kabllor PP00 4x95mm² për furnizimin e ndërtesave për banim kolektiv.
- Linja e tensionit 400/231V me kabllor PP00 4x25mm² ose 4x16mm² për furnizime të ndriçimit publik dhe banimeve individuale.
- Linja të kabllorve të komunikimit (kabllor me fije optike apo STP 4x0.75mm²).
- Përgjatë trasës së kanalizimit kablovik duhet ndërtuar puseta me dimensione dhe forma të ndryshme sipas rastit.

- Në trasa të linjave të shumëfishta ndërtohen puseta të kombinuara – Elektrike - Telekom sipas fig.5.




Figura 9 Detaj Teknik

Pusetat kanë thellësi së paku 1.8m dhe dimensione të brendshme së paku 1.8mx1.2m.

Puseta e përbashkët është e ndarë me mur betoni 20cm në atë për rrymë dhe në atë për komunikim dhe kanë hyrje (vrime) të ndara.

Pusetat për kryqëzime të linjave të tensionit të ulët dhe linjave telekomunikuese mund të ndërtohen si të ndara dhe mund të kenë edhe dimensione më të vogla (por jo më të vogla se 1.2x1.2x1.2m)

Hyrja në Puseta bëhet nëpër vrimën me formë rrethore me diameter së paku 75cm. Në kapak duhet shkruar për puseta rryme – ELEKTRIKA, ndërsa për ato të komunikimit – TELEKOM.

Trafostacionet 10(20)/0.4 kV duhet të kenë fuqi të mjaftueshme për të furnizuar të gjithë konsumatorët me tension 230/400 $\pm 10\%$ V. Në rast se transformatorët furnizojnë objekte me banesa kolektive, me qëllim të ruajtjes së ambientit përreth objekteve, atëherë kur të ka mundësi teknike, rekomandohet që transformatorët të vendosen në mbrendi të objektit të ndërtuar.

Trafostacionet e vendosur në brendi të objektit do të duhet të plotësojnë kushtet teknike të parapara me standarde për objekte të tilla, që janë

Vendi ku montohen trafostacionet duhet të ketë qasje për piruj, karroca, të jenë të mbrojtur nga vërshimet dhe të sigurohet ventilimi.

Ndërkohe duke marrë për bazë gjendjen ekzistuese do të analizohen kërkesat dhe kushtet për furnizim të sigurtë dhe cilësor me energji elektrike të konsumatorëve në komunën e Prishtinës.

Probleme tjera të identifikuara

- Trafo-stacionet 35/10kv kryesisht janë të vjetruar;

- Linjat 35 kv, 10 kv dhe pjesërisht 0.4 kv janë të vjetra, dhe janë të mbingarkuara sidomos gjate dimrit;
- Trafo-stacionet 10 (20)/0.4 kv të mbingarkuara;
- Linjat 0.4 kV me shtylla të vjetra dhe përçues të mbingarkuar;
- Shpërndarje asimetrike e ngarkesave të shpenzuesit të fundit dhe mospërshtatje e tyre me trafo stacione furnizuese;
- Një pjesë e shtyllave të ndriçimit publik të koroduara dhe të pagalvanizuara;

Grumbullim i kablllove ABC (gërshet) dhe linjave ajrore në shtylla druri pa ndonjë rregull të caktuar;

Gërshetimi i linjave ajrore me kablllo koaksiale të provajderëve të telekomunikacionit dhe televizionit pa ndonjë rregull të caktuar;

SWOT Analiza Energji Elektrike	
Përparësitë	Dobësitë
• Rezervat e mjaftueshme të linjitit për të prodhuar energji elektrike dhe termike me çmime konkurruese; • Përvoja industriale për prodhim dhe eksploitim të linjitit në Kosovë; • Kapacitete transmetuese interkonektive të mjaftueshme që mundësojnë tregti ndërkufitare • Resurset humane të mjaftueshme për të rekrutuar dhe zhvilluar staf me shkathtësi që mund t'i përgjigjen kërkesave të sektorit; • Baza ligjore në harmoni me direktivat e BE-së; • Republika e Kosovës është anëtare e Traktatit për Themelimin e Komunitetit të Energjisë të EJL; • Mekanizma institucionale adekuatë për funksionimin e sektorit të energjisë, në veçanti autoritetet e pavarura	• Mos mirëmbajtje adekuate e rrjetit energjetik; • Rrjet i vjetërsuar si dhe shtylla nga druri; • Kabllot e tensionit të lartë kalojnë mbi shtëpi banimi; • Kapacitete gjeneruese aktuale të vjetëruara që nuk sigurojnë prodhim të qëndrueshëm të energjisë elektrike; • Nivel i lartë i humbjeve teknike dhe komerciale në sistemin e shpërndarjes; • Mundësi të kufizuara për vetë financim të investimeve; • Ngecja në ritmin e investimeve për modernizimin dhe zhvillimin e kapaciteteve prodhuese; • Furnizim jo i sigurt me energji elektrike dhe termike; • Pjesëmarrja e ulët e BRE-ve në prodhimin e energjisë elektrike; • Varësi e pjesshme nga importi i energjisë elektrike; • Eficienca e ulët në procesin e prodhimit dhe shfrytëzimit të energjisë;
Mundësitë	Rreziqet

• Kërkesa në rritje për energji në Kosovë dhe rajon, mundësi për zhvillim të shpejtë të sektorit të energjisë; • Ristrukturimi dhe reformimi i plotë i sektorit të energjisë në përputhje me Direktivat e BE-së; • Liberalizimi i tregut në nivel rajonal dhe zhvillimi i sektorit me kapital privat; • Mundësia e tërheqjes së investitorëve strategjikë; • Ndërtimi i ngrohoreve	• Rritjet e paparashikueshme të çmimeve të importit të produkteve të lëndëve të lëngëta djegëse dhe pengesat e paparashikueshme të furnizimit me produkte të naftës; • Krizat e mundshme financiare globale, me ndikim negativ në investimet nga jashtë; • Vazhdimi i obstrukcioneve nga Serbia në sektorin e energjisë; • Rritje e çmimeve të energjisë elektrike dhe rritja e kërkesës për import deri në ngritjen e kapacitetave të reja prodhuese;
--	---

1.5. Energjia termike (ngrohja)

Sistemi i ngrohjes qendrore në komunën e Prishtinës menaxhohet nga N.P. Termokos SH.A. e cila mbulon disa lagje të zonës urbane të Komunës së Prishtinës me rrjet të ngrohjes. Problemet sfidat dhe kapacitetet e kësaj ndërmarrje janë përshkruar në vazhdim:

Prodhimi, humbjet në rrjet dhe furnizimi/kërkesa aktuale

Sezona	Te prodhuara MWh _{TH}	Te liferuara MWh _{TH}	Humbjet MWh _{TH}	Humbjet %
2015/2016	198,686.00	165,087.45	33,598.55	17%
2016/2017	225,438.00	196,462.20	28,975.80	13%
2017/2018	223,738.00	199,861.75	23,876.25	11%

Tabela 10 Energjia e prodhuar, energjia e liferuar tek konsumatorët, humbjet në rrjet (rrjeti i transportit dhe i shpërndarjes) në sezonat 2015/16, 2016/2017 dhe 2017/2018, ngrohja me kogjenerim.

Energjia termike e ekstraktuar nga TC Kosova B, sipas sezonave

Sezona	Te prodhuara MWh _{TH}	Te liferuara MWh _{TH}	Humbjet ne rrjetin e kogjenerimit MWh _{TH}	Humbjet ne rrjetin e kogjenerimit %
2014/2015	152,397.00	149,806.00	2,591.00	1.7%
2015/2016	198,696.00	193,340.00	5,356.00	2.8%
2016/2017	225,438.00	220,078.00	5,360.00	2.4%
2017/2018	223,738.00	219,954.00	3,784.00	1.7%
Total	800,269.00	783,178.00	17,091.00	2.1%

Tabela 11 Humbjet e energjisë termike në rrjetin e transportimit të energjisë termike nga kogjenerimi.

Konsumi aktual dhe paraprak

Pas funksionalizimit të kogjenerimit ku është arritur një furnizim më cilësorë, konsumi në vazhdimësi ka shënuar rritje.

Të dhënat për furnizimin / konsumin gjatë sezoneve të kaluara janë paraqitur në tabelën e mëposhtme:

Sezona	Te prodhuara	Te liferuara / Konsumi	Humbjet	% e Humbjeve
	MWh _{TH}	MWh _{TH}	MWh _{TH}	%
2013/2014	51,528.21	41,804.43	9,723.79	19%
2014/2015	158,068.08	127,889.79	30,198.28	19%
2015/2016	198,686.00	165,087.45	33,598.55	17%
2016/2017	225,438.00	196,462.20	28,975.80	13%
2017/2018	223,738.00	199,861.75	23,876.25	11%

Tabela 12 Energjia e prodhuar, liferuar dhe humbjet

Në tabelën e mëposhtme është paraqitur numri i konsumatorëve, për pesë sezonat e kaluara;

Numri i konsumatorëve					
Sezona ngrohëse	2013/2014	2014/2015	2015/2016	2016/2017	2017/2018
Konsumatorët Shtëpiak	10,732	11,125	11,578	11,872	12,299
Konsumatorët Biznesor dhe Institucional	610	726	805	997	1160
Total	11,342	11,851	12,383	12,869	13,459

Tabela 13 Numri i konsumatorëve

Në tabelën e mëposhtme është paraqitur sipërfaqja ngrohëse, për pesë sezonat e kaluara;

Sipërfaqja ngrohëse m ²					
Sezona ngrohëse	2013/2014	2014/2015	2015/2016	2016/2017	2017/2018
Konsumatorët Shtëpiak	632,417.10	655,773	685,130	698,602	728,530.27
Konsumatorët Biznesor dhe Institucional	391,708.41	394,106.15	476,225.90	506,715.45	542,268.03
Total	1,024,125.51	1,049,879	1,161,356	1,205,318	1,270,798.30

Tabela 14 Sipërfaqja ngrohëse

Në tabelën e mëposhtme është paraqitur konsumi specifik i përllëgaritur për m² të sipërfaqes ngrohëse, në bazë të llojit të konsumatorëve.

Sezona 2017/18	Sipërfaqja /m ²	Konsumi/MWh _{TH}	Konsumi specifik për sezonë kWh _{TH} /m ²
Konsumatorët Shtëpiak	728,530.3	117,136.32	160.78
Konsumatorët Biznesor dhe Institucional	542,268.0	82,725.38	152.55
Total	1,270,798.3	199,861.75	157.27

Tabela 15 Konsumit specifik për sezonë

Diagramet e mëposhtme tregojnë kërkesën mujore për ngrohje në rrjetin e Termokosit për vitet e kaluara, përfshirë një pikëvështrim për sezonën 2017/2018




Figura 10 Energjia termike mujore (për sezonë) e dërguar në rrjetin e shpërndarjes së Termokosit




Figura 11 Energjia termike mesatare (për sezonë) e dërguar në rrjetin e Termokosit

Kërkesa aktuale për energji termike në rrjetin e shpërndarjes së Termokosit, vlerësohet se arrinë në përafërsisht 225 Gëh_{TH} për sezonë. Vlerësimet e parallogaritura tregojnë se rreth 25 Gëh_{TH} janë humbjet e energjisë termike, kështu që afërsisht 200 Gëh_{TH} i shpërndahen konsumatorëve. Kërkesa specifike për ngrohje shkon në 124 këh_{TH}/m². Kjo është gjithashtu shifër e ulët veçanërisht duke marrë parasysh që furnizimi me ngrohje është i shtyrë nga prodhimi.

Kapaciteti i shfrytëzuar dhe në dispozicion

Në tabelën 37, është paraqitur Kërkesa për kapacitet të konsumatorëve për katër sezona , në të cilën janë përfshirë:

- Kapaciteti elektrik për sezonë (MËh/hEL),
- Energjia termike e realizuar per sezonë (MËhTH),
- Kapaciteti mesatar termik (MËTH),
- Kapaciteti termik maksimal (të pikut) në (MËTH)

Sezona	Kapaciteti elektrik për sezonë (MWh/h _{EL})	Energjia termike e realizuar per sezonë (MWh _{TH})	Kapaciteti mesatar termik (MW _{TH})	Kapaciteti termik maksimal (të pikut) (MW _{TH})
2014/2015	24 352	152 397	47	80.4
2015/2016	30 745	198 696	46	90.8
2016/2017	34 837	225 438	52	83.8
2017/2018	34 532	223 738	52	73.9

Tabela 16 Kërkesa për kapacitet elektrike dhe termike

Në sezonat 2014/15 dhe 2015/2016 janë bërë teste të performancës së sistemit, prandaj ngarkesa e regjistruar për pikun ditor nuk është ngarkesë reale e kërkuar nga konsumatorët në atë kohë.

Aktualisht furnizimi me ngrohje është i shtyrë nga prodhimi, prandaj kapaciteti është konstant. Kjo ilustron në figurën vijuese ku paraqitet shfrytëzimi i kapacitetit në një ditë tipike sezonale. Siç mund të vërehet nga diagrami, kapaciteti maksimal për ngrohje arrin deri në 70 MË, ndërsa kapaciteti i humbjeve të ngrohjes arrin deri në 10 MËTH, kështu që vetëm 60 MËTH kapacitet termik i ofrohet konsumatorëve me një hapësirë totale të ngrohjes prej 1,334.000 m².

Kapaciteti specifik i ngrohjes është vetëm 45 Ë/m² e që është shifër shumë e ulët. Nënstacionet nuk janë të kontrolluara dhe rrjeti i qytetit nuk është i balancuar. Kështu që, ndërtesat afër Termokosit tejngrohen dhe temperatura e kthimit është tepër e lartë, ndërsa në ndërtesat që gjenden më larg Termokosit, nuk ofrohet ngrohje e mjaftueshme.




Figura 12 Situata aktuale (faza 1)

Në diagramin vijues (figura 46) paraqiten kapacitetet mesatare mujore sipas sezonave. Duke krahasuar kapacitetet termike mesatare mujore për katër sezonat e kaluara, vlera më e madhe e kapacitetit termik mesatar ka arritur në 60 MËTH në muajin janar të sezonit 2017/2018.




Figura 13 Kapacitetet termike mesatare mujore

Ngarkesa aktuale e pikut

Bazuar në temperaturat e jashtme në qytetin e Prishtinës, ngarkesa e pikut shfaqet gjatë muajve Dhjetor dhe Janar. Normalisht, ngarkesa e pikut në rrjet determinohet nga temperaturat e jashtme (atmosferike) dhe orarit ditor. Mëngjesi dhe mbrëmja janë intervalet me kërkesa më të mëdha për energji termike.




Figura 14 Kapaciteti i ngrohjes dhe temperaturat e jashtme më 30 janar 2016

Faktorët ndikues në kërkesën për kapacitet dhe për energji termike

Një numër faktorësh kanë ndikim përcaktues në kapacitetin termik dhe sasinë e energjisë termike. Ndër kryesorët janë: masat për përmirësimin e kualitetit të ngrohjes dhe efijencës së energjisë, ndikimi i projekteve zhvillimore, dhe parametrat projektues gjegjësisht temperatura projektuese.

Përmirësimi i kualitetit të furnizimit

Është i njohur fakti se në disa pjesë të qytetit (veçanërisht Kodra e Diellit), cilësia e ngrohjes është më e dobët. Një masë e domosdoshme për përmirësimin e furnizimit është balancimi hidraulik i sistemit dhe implementimi i kontrollit automatik në nënstacione.

Kjo masë, do të ndikoj në shfrytëzimin efikas të kapacitetit termik dhe furnizim në mënyrë të balancuar për të gjitha rajonet e shpërndarjes / furnizimit, rrjedhimisht edhe aktivizimin e 'konsumatorëve pasiv'. Vlerësimet paraprake tregojnë se kapacitetit specifik (për njësi të sipërfaqes - m²) do të jetë 80 Ë/m², ndërsa konsumi specifik do të arrij në 160 kË/m² për sezonë.

Në tabelën e mëposhtme janë paraqitur, sipërfaqja ngrohëse e lidhjeve ekzistuese përfshirë edhe aktivizimin e "konsumatorëve pasiv" dhe përlogaritjet përkatëse të kapaciteteve termike dhe kërkesës për energji termike.

Lidhjet ekzistuese	Hapësira e ngrohur	Kapaciteti	Kërkesa
Upiana	189 667 m ²	15 173 kW	30 347 MWh
Qendra	136 242 m ²	10 899 kW	21 799 MWh
Dardania	312 410 m ²	24 993 kW	49 986 MWh
Kodra e Diellit	214 754 m ²	17 180 kW	34 361 MWh
Institucionet	481 352 m ²	38 508 kW	77 016 MWh
Totali i lidhjeve ekzistuese	1 334 425 m²	106 754 kW	213 508 MWh

Tabela 17 Të dhënat për sipërfaqen, kapacitetin dhe kërkesën për energji




Figura 15 Situata me IHS të kontrolluar dhe rrjet të balancuar (faza 2)

Parashikimi i Kërkesës për energji termike për periudhën 2019-2029

Planifikimi i konsumit, humbjeve të energjisë termike dhe rritjes së sipërfaqes , për periudhën 2018-2028 (për sezonë ngrohëse)										
Sezona	2019 / 20	2020 / 21	2021 / 22	2022 / 23	2023 / 24	2024 / 25	2025 / 26	2026 / 27	2027 / 28	2028/29
Ngarkesa maksimale /MW _{TH}	92	105	115	120	130	140	140	140	140	140
Prodhim i energjisë termike /MWh _{TH}	278,160.00	317,466.00	347,700.00	362,818.00	393,053.00	423,288.00	423,288.00	423,288.00	423,288.00	423,288.00
Kapaciteti i rezervuar elektrik MWh/h (Vjetore)	42,402.00	48,394.00	53,003.00	55,307.00	59,916.00	64,525.00	64,525.00	64,525.00	64,525.00	64,525.00
Energjia e furnizuar /MWh _{TH}	250,344.00	288,894.00	316,407.00	330,164.00	361,608.00	389,424.00	393,657.00	393,657.00	393,657.00	393,657.00
Humbjet ne rrjetin e shperdarjes/MWh	27,816.00	28,571.00	31,293.00	32,653.00	31,444.00	33,863.00	29,630.00	29,630.00	29,630.00	29,630.00
Sipërfaqja/m ²	1,597,195.0	1,843,144.0	2,018,677.0	2,106,449.0	2,307,064.0	2,484,531.0	2,511,537.0	2,511,537.0	2,511,537.0	2,511,537.0

Tabela 18 Planifikimi për konsumin e energjisë termike dhe rritjen e sipërfaqes ngrohëse

1.6. Telekomunikimi

Në fushën e post-telekomit, në Komunën e Prishtinës, i tërë territori i komunës është i mbuluar me telefoni mobile nga dy operatorë Vala dhe IPKO. Infrastruktura mbulohet me kapacitet: E, 3G, dhe LTE (4G). Në kudër të këtij sektori është edhe objekti ekzistues i postes që kujdeset për telefoninë fikse në disa pjesë të komunës, e cila ka një tendencë të zvogëlimi të vazhdueshëm. Sa i përket telefonisë mobile, konkurrenca ka mundësuar shërbime më cilësore dhe çmime relativisht të arsyeshme.

Gjendja e rrjetit të telekomunikacionit në Prishtinë është e dobët. Gjithsej janë 11 zona rurale të mbuluara me rrjet të telekomunikacionit. Në total janë vetëm 6 pika që shpërndajnë rrjet të telekomunikacionit (me tel). Ato kryesisht shpërndajnë linjën në fshatin ku janë të vendosura, por ekzistojnë edhe rrjete të tjera që shpërndajnë linjën në fshatrat përreth.

Emri i pikës postare	Lidhja me kabllo optike	Shpërndarjet në:
Bardhoshi	Po	Bardhosh, Leban, Besi, Trudë dhe Vranidoll
Matiçan	Po	Matiçan, Zllatar
Hajvali	Po	Hajvali
Sofali	Po	Sofali
Iliria	Po	Kolevicë dhe qytetin Prishtinës
Çagllavicë	Po	Çagllavicë

Tabela 19 Pikat shpërndarëse të rrjetit të telefonisë mobile

Ndërsa, mbulueshmëria e rrjetit të kabllovikut nuk është e shtrirë në të gjithë territorin e komunës, kryesisht fshatrat malore nuk posedojnë rrjet të kabllovikut nga asnjë operatore që vepron në nivel komunal.

Sipas të dhënave të siguruar nga operatori Kujtesa mbulueshmëria me rrjete nga ky operator është e vogël vetëm 30% e territorit të komunës është e mbuluar me shërbime ndërsa zona urbane ka mbulueshmëri të plotë. Gjithashtu nga informacionet e Kujtesës aspekti social rreth 15 mijë ekonomi familjare nuk kanë qasje në shërbimet e kujtesës.




Figura 16 Mbulueshmëria me rrjet të kujtesa net në komunën e Prishtinës

Një problem i cili duhet të ceket në kuadër të infrastrukturës së telekomunikimit është mënyra e shtrirjes së kabllove e cila nuk ka një formë të organizuar ku secila kompani ka rrjetin e vet shpërndarës dhe si e tillë sjell probleme në mirëmbajtje të sajë.

Gërshetimi i linjave të kablove të bakrit me rrjetin energjetik dhe rrjetet e provajderëve tjerë të telekomunikacionit.

1.7. Grumbullimi dhe menaxhimi i mbeturinave

Komuna e Prishtinës ka miratuar Rregulloren për Menaxhimin e Mbeturinave në Kuvendin Komunal, në pritje të shqyrtimit nga Ministria e Administrimit të Pushtetit Lokal, së bashku me Planin e Menaxhimit të Mbeturinave. Rregullorja e re dhe të ardhurat nga mbledhja e tarifave të mbeturinave nga komuna janë raportuar të përfshihen në buxhetin e vitit të ardhshëm (2017). Komuna e Prishtinës po planifikon të angazhohet për zbatimin e plotë të Ligjit për Mbeturinat si me mbledhjen e tarifave dhe prokurimin e Operatorit të Menaxhimit të Mbeturinave. Megjithatë, siç raportohet nga GIZ, ata po shqyrtojnë mundësinë e angazhimit të Ndërmarrjes Publike “Pastrimi” përmes një procesi të prokurimit të negociuar në pajtim me Ligjin për PP. Një nismë e tillë ende nuk është e qartë nëse do të pranohet nga Komisioni Rregullativ i Prokurimit Publik.

Ndërmarrje (Pastrimi” Sh.A), është përgjegjëse për largimin e mbeturinave, të cila mbeturina i deponon në deponin rajonale në Mirash. Komuna e Prishtinës përballlet me probleme dhe sfida të ndryshme sa i përket menaxhimit dhe grumbullimit të mbeturinave dhe këto probleme janë radhitur si më poshtë:

Menaxhimi dhe mbulueshmeria e grumbullimit të mbeturinave: që nga viti 2018 komuna e Prishtinës ka arritur mbulueshmerin në menaxhimin dhe grumbullimin e mbeturinave në të gjithë territorin e komunës. Në zonën urbane në pikat e grumbullimit, mbledhja e mbeturinave bëhet çdo ditë, ndërsa në zonat rurale mbledhja e mbeturinave bëhet një herë në jave sipas orareve të caktuara. Por problemi është se në lagje të caktuara nuk kemi pika grumbulluese të mbeturinave dhe si e tillë mbeturinat hidhen në hapësira të ndryshme ku krijohen numër i madh i deponive ilegale, gjithashtu problem është mos funksionimi i 12 pikave grumbulluese nëntokësore në zonën urbane dhe ky fakt vështirëson mbledhjen e mbeturinave në ato zona.



Figura 17 Mbulueshmeria e menaxhimit dhe grumbullimit të mbeturinave

Mbeturinat nga ndërtimi/demolimi dhe mbeturinat inerte: Sipas Udhëzimit Administrativ (UA) Nr. 07/2015, menaxhimi i këtij lloji të mbeturinave është obligim i komunës. Sipas këtij Udhëzimi Administrativ, komuna në bashkëpunim me komunat përreth, mund ta ndërtojë një deponi për mbeturinat nga ndërtimi/demolimi me qëllim të mos degradohet edhe më tej mjedisi. Ky UA gjithashtu përcakton kriteret për përzgjedhjen e vendeve të përshtatshme për këtë lloj të mbeturinave, ku ndër më të rëndësishmet janë: Vende të përshtatshme për deponimin e këtij lloji të mbeturinave mund të jenë vendet që më parë janë shfrytëzuar për eksploatim me qëllim të mbushjes së gropave, kanaleve të ndryshme të formuara në mënyrë të natyrshme, vende të degraduara si rezultat i erozionit ose rrëshqitjeve të dheut, apo vende tjera të ngjashme.

Megjithatë, siç është përmendur edhe më lartë, është përgjegjësi e komunës t'i trajtojë mbetjet e demolimit/inerte. Mund të thuhet se të gjitha komunat në Kosovë kanë mbetur prapa në krijimin e deponive/vendeve të përshtatshme për depozitimin e këtyre mbeturinave.

Komuna e Prishtinës ka problem në aspektin e grumbullimit të mbeturinave inerte pasi që nuk ka ndonjë deponi legale në aspektin e grumbullimit dhe trajtimit të këtyre mbeturinave.

Sipas raportit të vlerësimit të gjendjes së menaxhimit të mbeturinave Komuna e Prishtinës pas mbeturinave shtëpiake, mbeturinat inerte përbëjnë përqindjen më të lartë të deponive ilegale me rreth 14.60%.

Si rezultat i kësaj, shumica e deponive ilegale në komuna përbëhen nga mbeturina të demolimit/inerte.

Nga intervistat e realizuara, është vënë re se komunat aktualisht nuk angazhohen mjaftueshëm në parandalimin e këtij fenomeni, pasi që ky lloj i mbeturinave mblidhet si mbeturinë normale nga kompanitë me vullnet të mirë, por në anën tjetër, rritja në sasinë e mbeturinave, të cilat nuk janë të detyruar që t'i mbledhin, ndikon edhe në çmimin që ata duhet të paguajnë për deponitë.

Të gjitha planet komunale të menaxhimit të mbeturinave kanë të trajtuar mbetjet inerte dhe zgjidhjet që duhet të ndërmerren nga komunat. Për këtë qëllim, komunat duhet të angazhohen më tepër në përmbushjen e kërkesave të përcaktuara dhe të dakorduara prej tyre në këto plane.



Mbeturinat inerte/demolimit

Mbeturinat Industriale: Format e krijimit të deponive industriale janë të natyrave të ndryshme varësisht nga destinimi i prodhimit apo veprimtarisë. Po thuaj çdo industri në të kaluarën ka trashëguar deponi apo mbetje të rrezikshme të cilat kanë efekte negative në mjedis. Gjithashtu, pos këtyre mbetjeve të deponuara në deponi veçanërisht nga metalet e rënda, substanca në forma të ndryshme agregate kanë mbetur një kohë të gjatë pa u përdorur nëpër stabilimente, depo dhe reparte industriale. Me kalimin e kohës, disave nga këto substanca kimike iu ka skaduar afati apo janë degraduar, duke ndryshuar përbërjen e tyre dhe konsiderohen si substanca me rrezikshmëri të lartë. Një sasi e tyre janë të ambalazuara por shume sosh kanë mbetur të pa mbrojtura dhe të ekspozuara me mjedisin. Deri me tani për reduktimin e rrezikut nga substanca të këtilla janë bërë aktivitete në disa ndërmarrje, kryesisht duke u mbështetur nga donacionet dhe aktivitetet e KFOR-it dhe FSK-së. Si rezultat i prodhimit industrial, ndërprerjes së prodhimit dhe aktiviteteve të tjera, hasen edhe shumë materie të rrezikshme. Në tabelën vijuese janë prezantuar të dhëna për llojet e këtyre mbeturinave, lokacionet e deponimit/magazinimit dhe sasinë e tyre.

Lloji i mbeturinave	Sasia/Njësi	Lokacioni	Komuna
Substanca kimike të ngurta	231.80 kg	Laboratori në Kishnicë	Prishtinë
Fuqi plastike me acide	9 fuqi	Laboratori në Kishnicë	Prishtinë
Kuti të plastikës të panjohura	15 copë	Laboratori në Kishnicë	Prishtinë

Tabela 20 Mbeturina industriale

Mbeturinat shëndetësore: Mbeturinat shëndetësore është një problematik tjetër në komunën e Prishtinës pasi që nuk ka ndonjë hapësirë ku mund të trajtohen si të tilla, dhe për këtë arsye mund të kenë pasoja të mëdha në shëndetin e njeriut.

Institucionet shëndetësore në komunën e Prishtinës dhe QKUK brenda një viti prodhon një sasi prej 128,857 mijë/kg mbeturina shëndetësore, ku pjesa më e madhe e këtyre mbeturinave trajtohet në impiantin për trajtimin e mbeturinave shëndetësore në Prishtinë, ndërsa mbeturinat nga institucionet private nuk kanë një trajtman të duhur dhe si rezultat hidhen në hapësira të pa përshtatshme dhe bëhen të rrezikshme për shëndetin e njerëzve.

Ky impiant është i vendosur në hapësirat e QKUK-se. Kapaciteti i këtij impianti për trajtimin e mbeturinave medicinale është 250 deri në 300 kg gjatë një cikli dhe brenda ditës mund të zhvillohen 5 deri në 6 cikle. Nga institucionet shëndetësore publike në këtë impiant trajtohen mbeturinat spitalore nga shtëpitë e shëndetit të qytetit të Prishtinës dhe nga QKUK-ja, si dhe një sasi e vogël vjen edhe nga institucionet private shëndetësore nga KFOR dhe EULEX. Gjendja në këtë impiant është e mirë. Impianti punon me kapacitet të plotë. Sasia mesatare mujore e mbeturinave medicinale që trajtohet në këtë impiant është rreth 11.000 kg.

Mbeturinat shtazore: Mbeturinat shtazore mund të konsiderohen si mbeturinat më problematike që bien nën përgjegjësinë e komunës. Këto mbeturina janë problematike për shkak se nuk pranohen nga deponitë, megjithatë, ka raste që deponitë i pranojnë këto mbeturina në mungesë të hapësirës së duhur për trajtimin e tyre.

Në shumicën e rasteve, burimet e këtyre mbeturinave nuk mund të identifikohen pasi që depozitohen si mbeturina të tjera komunale, si dhe depozitimi i tyre bëhet gjatë natës kur inspektorët komunal nuk janë në detyrë. Prandaj, identifikimi i mishtoreve dhe fabrikave të përpunimit të mishit është i nevojshëm, por përderisa nuk ekziston ndonjë zgjidhje institucionale, propozohet që këto mbeturina të mbliidhen dhe të depozitohen ndaras, ku më vonë pas ndërtimit të deponisë do të na jepte idenë mbi kapacitetin e gjenerimit të këtij lloji të mbeturinave si dhe do të mundësohet krijimi i një baze të duhur të të dhënave që do të shërbente për të identifikuar nëse ndonjë nga këto mbeturina depozitohen në mënyrë të paligjshme. Duke ndjekur parimin “Ndotësi paguan”, këto aktivitete të veçanta të menaxhimit dhe “trajtimit” të mbledhjes së mbeturinave shtazore kërkojnë një tarifë të veçantë.

Komuna e Mitrovicës Jugore nuk ka deponi e cila i trajton mbetjet shtazore dhe si e tillë këto mbeturina trajtohen në forma të ndryshme të cilat janë jo legale, komuna duhet të planifikoj që të rezervoj një hapësirë ku do të trajtohen këto lloje të mbeturinave.

Analiza SWOT – Menaxhimi i mbeturinave	
Përparësitë	Dobësitë
- Deponia në Mirash; - Impianti për trajtimin e mbeturinave shëndetësore; - Rregullorja për menaxhimin e mbeturinave; - Plani komunal për menaxhimin e mbeturinave ; - Komiteti komunal për mbrojtje të	- Shërbime jo të mira në menaxhim të mbeturinave; - Mungesë e deponis për mbeturina inerte/demolimit. - Mungesa e auditimit mjedisor; - Mungesa e stacioneve të vogla të transferuese për mbledhjen dhe selektimin e mbeturinave në zonat

mjedisit;	rurale; - Mos ndarje e mbeturinave në burim; - Raportimet e parregullta mbi gjendjen e ofrimit të shërbimeve; - numër i lartë i deponive ilegale; - Sasi e lartë e mbeturinave industriale dhe sanitare; - Burime të ndotjes radioaktive; - Mungesë e hapësirave për trajtim të mbeturinave shtazore;
Mundësitë	Rreziqet
- Fushata vetedijësuese; - Krijimi i Eko-taksës - Angazhimi i OJQ-ve mjedisore;	- Rritja e ndotjes; - Shfaqja e sëmundjeve infektive; - Ndotje e tokave bujqësore;

Të gjeturat kyçe sipas analizës në aspektin e grumbullimit dhe menaxhimit të mbeturinave janë të radhitura:

- Mbulueshmeria e gjithë territorit me shërbime në aspektin e grumbullimit të mbeturinave;
- Mungesa e deponis për trajtimin e mbeturinave inerte/demolimit, komuna nuk ka të caktuar hapësirën e cila do ti trajtonte këtë lloje të mbetjeve dhe si e tillë duhet të planifikohet një hapësirë e cila do ti përmbushte kriteret si në aspektin vëllimor dhe atë natyrore.
- Mungesa e deponis për trajtimin e mbetjeve shtazore, komuna nuk ka hapësirë të definuar për trajtimin e mbetjeve shtazore është e domosdoshme planifikimi i hapësirës ku do të trajtoheshin ky lloj i mbetjeve.

Deponit ilegale, sipas raportit mbi menaxhimin e mbeturinave numri i deponive ilegale është i lart vetëm në vitin 2017 kemi të regjistruara 155 deponi ilegale, ku pjesa më e madhe e

Infrastruktura e transportit dhe transporti publik

Rrjeti rrugor

Shtrirja dhe gjendja e rrugëve ekzistuese

Referuar ligjit mbi rrugët, rrugët publike, kategorizohen në:

- Autoudhë;
- Rrugë nacionale;
- Rrugë rajonale dhe
- Rrugë lokale

Nëpër territorin e Komunës së Gjakovës nuk kalojnë autoudhë. Lidhja më e afërt e Gjakovës është në autoudhën "Ibrahim Rugova" (afërsisht 30 km) në Prizren.

Përveç autoudhëve të cila nuk përfshihet në kuadër të rrjetit rrugor të komunës së Gjakovës, të gjitha rrugët tjera (sipas kategorive të mësipërme) kalojnë nëpërmjet territorin e Komunës së Gjakovës

Gjakova, në kuadër të rrjetit rrugor ekzistues përmban rrugën nacionale N-9.1 e cila vjen nga Prishtina dhe kalon në pjesën lindore të qytetit. Përmes rrugës nacionale N-9.1, Gjakovës i mundësohet lidhja me pjesën veriore të Shqipërisë.

Territori i komunës së Gjakovës është i mbuluar mirë me rrjetin rrugor. Sipas kërkesave për lëvizje, infrastruktura rrugore përgjithësisht është përmirësuar në aspektin e përmbushjes së kriterëve teknike.

Nga ana tjetër, sfiduese mbetet një pjesë e rrugës nacionale N9.1 e cila kalon nëpër zonën urbane dhe nuk ofron nivel të mjaftueshëm të shërbimit në përmbushje të kërkesave të kapacitetit dhe të sigurisë për lëvizjen e mjeteve. Kjo pjesë e rrugës kalon nëpër zona atraktive në të cilën zhvillohen aktivitete të ndryshme dhe lëvizje të pamotorizuara që ndikojnë në zvogëlimin e kapacitetit të rrugës dhe sigurinë në trafik.

Por, realizimi i projektit për ndërtimin e rrugës “Bujar Roka” në pjesën jugore të qytetit, mundëson devijim e trafikut tranzit dhe orienton e fluksit të trafikut jashtë këtyre zonave të banuara dhe duke lehtësuar qasjen drejt pjesës veriore të Shqipërisë dhe anasjelltas.

Bazuar në standardet teknike të projektimit, të cilat janë paraparë për ndërtimin e rrugës “Bujar Roka”, si gjerësinë e korsive dhe numrin e tyre (dy korsi trafiku për kahe), kapaciteti potencial do të sillet rreth 2000 – 2500 aut/h/kahe, dhe ky kapacitet do të jetë në gjendje të përballoj nevojat për qarkullimin e trafikut aktual dhe në qarkullimin në të ardhmen.

Duke vlerësuar rolin dhe karakterin e kësaj rruge, ndërtimi i kësaj rruge do të jetë sfidues në aspektin e kyçjeve dhe shkëmbimeve të lëvizjeve nga banorët dhe bizneset të cilat janë përgjatë kësaj rruge. Prandaj, në pjesët ku kryqëzohet rruga “Bujar Roka” me rrugët e rangut më të ulët duhet të analizohen dhe vlerësohen format e kontrollit të trafikut në mënyrë që të sigurohet qasje e sigurt në këtë rrugë dhe të respektohen normat sigurisë sipas standardeve të aplikueshme për rrugët e Kosovës. Gjithashtu shpejtësia e lëvizjes së mjeteve, duhet të kufizohet në harmoni me kushtet e sigurisë së trafikut dhe kërkesat për lëvizje nga përdoruesit e tjerë të rrugës (sidomos këmbësorët).

Rrugët rajonale

Katër rrugë rajonale e lidhin Gjakovën me qytetet dhe fshatrat tjera në Kosovën perëndimore. Një ndër rrugët më të rëndësishme rajonale është rruga rajonale R-107 e cila e lidhë Gjakovën me Pejë dhe Prizrenin.

Rruga tjetër, gjithashtu mjaft e rëndësishme e cila ndërlidhet me rrugën nacionale N9-1, është rruga rajonale R-203 e cila kalon nëpër neper qytetin e Gjakovës dhe mundëson lidhjen me qytetin e Kukësit në Shqipëri. Ndërsa, përmes rrugës rajonale R-109, Komuna e Gjakovës lidhet me Junikun Deçanin dhe Pejë.

Përgjithësisht rrugët rajonale ofrojnë kushte të mira për qarkullim të automjeteve motorike. Pjesa më e madhe e tyre janë të asfaltuara, por kanë nevojë për mirëmbajtje, rehabilitim dhe përmirësim të sipërfaqes qarkulluese më qëllim të përmirësimit të kualitetit të lëvizjes dhe rritjes së nivelit të sigurisë gjatë lëvizjes. Plotësimi i kërkesave për lëvizje të pa motorizuara në këto pjesë të rrjetit rrugor po ashtu kërkon trajtim dhe masa konkrete.

Rrugët lokale-urbane

Rrugët në qytetin e Gjakovës, kryesisht janë me nga dy korsi trafiku (2x1), përveç rrugës “Tirana” e cila ka nga dy korsi trafiku për kahe dhe rruga “Nënë Tereza” e cila është rrugë një kahore me dy korsi për kahe (1x2).

Rrugët lokale të cilat lidhin lokacione të ndryshme brenda qytetit të Gjakovës kanë karakter të ndryshëm. Rrugët e karakterit më të lartë janë plotësuar nga rrugë lidhëse të karakterit më të ulët. Shumica e rrugëve lokale nuk kanë gjerësinë e mjaftueshme dhe elementet gjeometrike të tyre nuk ofrojnë kushte të mira për të gjithë pjesëmarrësit në trafik, sidomos mungesa e trotuareve dhe shtigjeve për çiklist shkakton vështirësi për këmbësorë dhe çiklist.

Qyteti i Gjakovës disponon me rrjetin e rrugëve kryesore në brendi të qytetit. Në zonën më të re, “Blloku i ri”, rrugët kryesore janë të gjëra, shumica të asfaltuara, dhe pjesërisht të furnizuara me trotuare. Në pjesët tjera të qytetit, rrjeti është më pak i ngarkuar. Rrugët kryesore në pjesët tjera të qytetit janë të ngushta, dhe kanë standard të ulët. Si rezultat, pengesat e trafikut, dhe bllokimet e rrugëve janë të zakonshme. Në veçanti qyteti i vjetër ka probleme rreth të qasjes brenda tij.

Përzgjedhja e formave të kontrollit të kryqëzimeve nuk ofron funksionalitet dhe operim kualitativ të trafikut, prandaj është e nevojshme të bëhet një analizë dhe vlerësim i gjendjes në mënyrë që oferta të jetë në harmoni me kërkesën e trafikut.

Zona të caktuara në brendi të lagjeve të qytetit paraqiten vështirësi në operimin e trafikut për shkak të parametrave teknik të rrugëve të cilën rezultojnë të pamjaftueshëm për të përballuar kërkesat për qarkullim të automjeteve si dhe për shkak të kërkesave të mëdha për parkingje në afërsi të rrugës.

Modaliteti dominues i transportit është transporti rrugor. Rrjeti i rrugëve lokale është i pakategorizuar, pa funksion të qartë dhe dizajn adekuat. Për pasojë, qarkullimi është i vështirësuar dhe ka probleme me parkim, në veçanti në zonat me dendësi të madhe dhe kërkesa të shumta për lëvizje të pamotorizuara. Probleme të tilla të evidentuara janë në disa lokacione brenda qytetit, veçanërisht në pjesën e qytetit të vjetër.

Në qytetin e Gjakovës, kërkesave për lëvizje të këmbësorëve dhe çiklistëve, nuk u ofrohet hapësirë e sigurt dhe komode. Gjithashtu, edhe në kuadër të rrjetit rrugor periferik, këmbësorët dhe çiklistet nuk kanë qasje të lehtë dhe kushte të mira për lëvizje të sigurt.

Mbuleshmëria

- Ndërlidhja e vendbanimeve me zonën urbane dhe ndërmjet

Trafiku për në qytet vjen nga katër drejtime kryesore: Prishtina, Peja, Prizreni dhe Tropoja-pjesa veriore e Shqipërisë.

Qytete dhe fshatrat në komunën e Gjakovës janë të lidhura me rrjetin rrugor rajonal. Njëra nga më të rëndësishmet është rruga R107 ndërmjet Pejës dhe Prizrenit përmes Gjakovës. Shumica e rrugëve rajonale janë të asfaltuar, dhe kualiteti është i ngjashëm me rrugët magjistrale.

Rrugët e nivelit më të lartë janë plotësuar nga një rrjet i rrugëve lokale. Kualiteti i këtyre rrugëve në shumicën e rasteve është i dobët, dhe shumica nuk mund të përdoren në të gjitha motet. Gjithashtu fshatrat më të mëdha, p.sh. Novosellë dhe Bec, janë të arritshme vetëm nga rrugët lokale.

Në komunën e Gjakovës, të gjitha rrugët e viseve rurale kanë lidhshmëri me zonat urbane edhe pse jo të gjitha rrugët janë të asfaltuara por janë të gjitha të kalueshme.

▪ Shtrirja dhe kategoria e rrugëve të planifikuara nga niveli qendror

Nga niveli qendror, respektivisht nga Ministria e Infrastrukturës, është planifikuar zgjerimi i rrugës nacionale N-9.1 Gjakovë - Dollc me gjatësi 30.43 km. Ndërtimi i kësaj rruge është paraparë të zgjerohet në rrugë me nga dy korsi të trafikut për kahe fizikisht të ndara dhe një pjesë e kësaj rruge kalon nëpër territorin e Komunës së Gjakovës në segmentin Gjakovë – Rakovinë me gjatësi 16.16 km. Punimet në këtë rrugë me karakter nacional janë në proces të ndërtimit.

Gjithashtu nga niveli qendror, në pjesën jugore të qytetit të Gjakovës është projektuar dhe është në realizim e sipër rruga “Bujar Roka” e cila devijon trafikun tranzit nga pjesa e qytetit në drejtim të kufirit me Shqipërinë dhe anasjelltas.

▪ Vlerësimin e intensitetit dhe kapacitetit të kryqëzimeve dhe korsive kryesore

Bazuar në të dhënave nga qarkullimi i automjeteve në rrjetin rrugor të komunës së Gjakovës⁵, është konstatuar se, rruga nacionale N-9.1, është segmenti rrugor më i ngarkuar me trafik të automjeteve. Qarkullimi mesatar ditor vjetor (QMDV) sillet rreth 7000 aut/ditë, ndërsa nga rrugët rajonale, rruga më e ngarkuar ka rezultuar të jetë rruga R-107 me qarkullimi mesatar ditor vjetor (QMDV) me rreth 11000 aut/ditë

Ndërsa, në nivel të rrugëve urbane, qarkullimi më i madh i automjeteve është në rrugën kryesore “Nënë Tereza”, “Tirana” dhe “Hysni Dobruna”, të cilat rrugë kalojnë nëpër pjesën qendrore të qytetit, ku qarkullimi i automjeteve sillet nga 700-1000 automjete/h/drejtim. Ndërsa, në pjesët periferike të qytetit, ngarkesa e rrugëve është më vogël.

Pas analizës së qarkullimit të trafikut dhe ngarkesës së rrjetit rrugor në Komunën e Gjakovës, është vlerësuar se, aktualisht rruga nacionale N-9.1 e cila kalon nëpër pjesën qendrore të qytetit nuk është në gjendje të sigurojnë kapacitet të mjaftueshëm për kërkesën e fluksit të trafikut, që kryesisht është trafik tranzit. Qarkullimi i automjeteve në këtë pjesë të rrugës sillet rreth 1600 aut/h. Prandaj, devijimi i trafikut tranzit është i nevojshëm në mënyrë që të përballoj nevojat për qarkullimin e trafikut aktual dhe në qarkullimin në të ardhmen.

Ndërsa, në pjesën e vjetër të qytetit, për shkak edhe të rolit historik të kësaj zone, kërkesa për lëvizje të pamotorizuara është shumë e lartë, por ngarkesa e kësaj zone me trafikun motorik gjithashtu është shumë e lartë. Ngarkesa e rrugëve në pjesën e qytetit të vjetër sillet nga 500-700 aut/h. Devijimi i trafikut të motorizuar, në veçanti trafikut tranzit, është i rëndësishëm për ruajtjen e karakterit të zonës dhe mundësi për lëvizje më të lirë dhe të sigurt për këmbësorë dhe ciklist.

Ndërsa, gjendja aktuale e intenzitetit të trafikut në rrugët tjera ofron nivel mesatar të shërbimit dhe ofron kapacitet të mjaftueshëm për kërkesat e qarkullimit të trafikut.

▪ Kapaciteti i kryqëzimeve dhe korsive

Në bazë të matjeve të fluksit të qarkullimit në hyrje të udhëkryqeve, në rrjetin rrugor të qytetit të Gjakovës është bërë analiza e kapacitetit në udhëkryqet kryesore. Pas analizës së kapacitetit për udhëkryqet në rrugët kryesore të rrjetit rrugor është konstatuar se, shumica e udhëkryqeve

⁵ PMQU për qytetin e Gjakovës, MI-Drejtoria e rrugëve.

në rrugët kryesore, sipas gjendjes ekzistuese, i përmbushin kërkesat e fluksit të qarkullimit. Ndërsa, rrethrotullimiet dhe udhëkryqet më të ngarkuara janë:

- Në rrethrotullimin ku kryqëzohen rrugët “Skenderbeu”, “Tirana” dhe rruga rajonale “R107” (Gaspër Karaqi), shkalla e ngopjes sillet nga 0,4-0.6 (kapaciteti ekzistues i shfrytëzimit sillet nga 40-60 %), ndërsa në hyrje të rrethrotullimit nga rruga “Skenderbeu” shkalla e ngopjes është mbi kapacitetin e lejuar 1,06)⁶.
- Në rrethrotullimin ku kryqëzohen rrugët “Hysni Dobruna”, “Mitat Frashëri” dhe rruga “Sylejman Hadum Aga”, shkalla e ngopjes sillet nga 0,65-0.85 (kapaciteti ekzistues i shfrytëzimit sillet nga 65-85 %), ndërsa në hyrje të rrethrotullimit nga rruga “Mitat Frashëri” shkalla e ngopjes është mbi kapacitetin e lejuar 1,04.
- Udhëkryqet tjera në rrjetin rrugor të qytetit të Gjakovës, janë në kuadër të kapacitetit normal dhe afrojnë nivel mesatar të shërbimit edhe gjatë orëve kulmore. Në hyrje të këtyre udhëkryqeve shkalla e ngopjes sillet nga 0,2-0.6 (kapaciteti ekzistues i shfrytëzimit sillet nga 20-60 %).

Pas analizës së kapacitetit në hyrje të udhëkryqeve në qytetin e Gjakovës, është vlerësuar se, problemi i cili ndërlidhet me kapacitetin ka të bëjë kryesisht me qarkullimin në udhëkryqe, respektivisht elementet gjeometrike të udhëkryqeve, numrin e korsive të trafikut dhe rregullimin e qarkullimit në hyrje të udhëkryqeve. Në rrethrotullimin ku kryqëzohen rrugët “Skenderbeu”, “Tirana” dhe rruga rajonale “R107” (Gaspër Karaqi) dhe rrethrotullimin ku kryqëzohen rrugët “Hysni Dobruna”, “Mitat Frashëri” dhe rruga “Sylejman Hadum Aga”, gjatë orëve kulmore kapaciteti i shfrytëzimit të rrethrotullimeve është afër shkallës së nga pjesa. Prandaj, në këto udhëkryqe duhet të ndërmerren masat adekuate për rritjen e kapacitetit. Ndërsa, në udhëkryqet të cilat ndodhen në rrugët periferike, kapaciteti i shfrytëzimit të udhëkryqeve është në nivel të mirë.

- Shfrytëzimi i rrugëve nga makinat, këmbësorët, biçikletat dhe metodat tjera të transportit

Bazuar në matjet e qarkullimit të automjeteve, të realizuara në kuadër të PMQU të Gjakovës, mbi strukturën dhe modelet e udhëtimit, vërehet se në rrugët e Gjakovës dominojnë automjetet private me rreth 89%, ndërsa rreth 10% të strukturës së qarkullimit janë biçikletat. Prania e automjeteve të rënda (mbi 3.5 t), përbënë vetëm 1% të strukturës së përgjithshme të qarkullimit.

Pas analizës së të dhënave, është vlerësuar se nga modalitetet e mundura, transporti rrugor është dominues. Nevoja për përmirësimin e infrastrukturës dhe krijimin e kushteve për akomodimin e të gjithë pjesëmarrësve në trafik është e nevojshme. Rëndësi e veçantë duhet kushtuar kushteve infrastrukturore për lëvizje të pamotorizuara, duke vlerësuar konfiguracionin e terrenit dhe kulturën e lëvizjes në këmbë dhe me biçikleta në Gjakovë.

- Tipet e udhëkryqeve dhe rregullimi i trafikut në udhëkryqe

Rregullimi i qarkullimit në qytetin e Gjakovës është i organizuar me tipe të ndryshme të udhëkryqeve. Tipet e udhëkryqeve në rrjetin rrugor janë:

- me sinjalizim ndriçues-semafor (5 udhëkryqe),
- me rrethrotullime (4 rrethrotullime) dhe

⁶ Llogaritja e kapacitetit, sipas rezultateve nga PMQU të qytetit të Gjakovës.

- udhëkryqet tjera janë të rregulluara me rregulla të përgjithshme të qarkullimit.

Në rrugët kryesore, në hyrje të udhëkryqeve, përdoren shiritat e përbashkët për lëvizje drejt dhe majtas. Pra, nuk ekzistojnë shiritat e posaqëm për kthime majtas.

Duke pasur parasysh se lëvizjet majtas janë në konflikt me të gjitha drejtimet e lëvizjes, në hyrje të udhëkryqeve, përpos zvogëlimit të kapacitetit ulet edhe shkalla e sigurisë në trafik.

Kjo dukuri paraqitet, në pjesët e rrugës “Tirana” në të cilën përshkak të karakterit të rrugës dhe shpejtësisë së lëvizjes, ekziston rreziku potencial për lëvizjet majtas nga rruga kryesore, e sidomos rreziku është më i madh për lëvizjet majtas nga rruga dytësore.

Udhëkryqet e rregulluara me semafor, punojnë me kohë fikse. Ndërsa, rregullimi fazor nuk i përgjigjet kërkesave për lëvizje sipas drejtimeve.

Gjithashtu, në hyrje të rrethrotullimit në kryqëzimin e rrugëve “UÇK” dhe “Tirana”, gjerësia e sipërfaqes qarkulluese në rrethrotullim nuk i përgjigjet numrit të shiritave në hyrje të rrethrotullimit. Për shkak të kësaj gjendje, në orët kulmore kur numri i automjeteve është më i madh, vjen deri te bllokimi i rrethrotullimit.

Udhëkryqet e rregulluara me semafor, punojnë me kohë fikse. Ndërsa, rregullimi fazor nuk i përgjigjet kërkesave për lëvizje sipas drejtimeve.

Në udhëkryqet në të cilat rregullimi i qarkullimit është i rregulluar me sinjalizimin përkatës dhe nga rregulla të përgjithshme të qarkullimit, mungon sinjalizimi adekuat, sidomos për kyqjet nga rruga dytësore, duke krijuar konfuzitet për nga prioriteti dhe siguria e lëvizjes.

Me qëllim të zvogëlimit të ngarkesave dhe eliminimit të pikave të konfliktit, disa rrugë janë rregulluar me qarkullim një kahësh.

Rrugët më të rëndësishme në të cilat qarkullimi zhvillohet vetëm në një kahje janë:

- Rruga “Nënë Tereza” e cila kalon nëpër qendër të qytetit me gjerësi 9.0 metra,
- Rruga “Beqir Kastrati” me gjerësi 7,0 m dhe me trotuare në të dy anët me gjerësi prej 3.5 m.
- Rruga “Mithat Frashëri” me gjerësi 5.0 m, e cila kalon në pjesën perëndimore të qytetit të vjetër dhe
- Disa pjesë të rrugëve në qytetin e vjetër.

Gjendja e rrugëve njëkahëshe në qytetin e Gjakovës, është dhënë në Fig




Figura 18. Rrugët njëkahëshe në qytetin e Gjakovës

▪ Vlerësimi i hapësirave ekzistuese për parkim

Në Gjakovë parkingjet janë të organizuara nga sektori publik, privat dhe me partneritet publiko-privat.

Bazuar në të dhënat nga KK i Gjakovës, oferta e parkingjeve në qytetin e Gjakovës është, rreth 581 parkingje publike, 387 parkingje private dhe 120 parkingje të cilat janë dhënë me partneritet publiko-privat. Pra, oferta e përgjithshme e parkingjeve publike është rreth 1088 parkingje.

▪ Menagjimi i parkingjeve

Sipas Rregullores për menagjimin e parkingjeve⁷, tarifa për parkimin e automjeteve është ndarë në tri zona.

Për parkingjet në Zonën 1 (Rrugët: „Nënë Tereza“, „Skenderbeu“, „Ismail Qemali“ dhe para Spitalit „Isa Grezda“) është caktuar tarifa 0,30€/orë. Ndërsa, në të gjitha zonat tjera është caktuar tarifa 0,20€/orë.

Kjo rregullore, nuk është zbatuar për menaxhimin e parkingjeve publike në qytetin e Gjakovës.

Parkingjet publike

Për momentin, parkingjet publike në qytetin e Gjakovës janë në shërbim:

⁷ Rregullore për taksë, tarifa dhe ngarkesa nga shërbime Komunale, Gjakovë 2015.

- pa pagesë dhe
- pa kufizime kohore gjatë qëndrimit në parkingje.

Parkingjet me Partneritet Publiko Privat

Parkingu në rrugën „UCK“ (prapa Teatrit të qytetit) është parkingu i vetëm i cili është në managjim me Partneritet Publiko-Privat. Çmimi në këtë parking është 1 euro/dite dhe nuk ka ndonjë kufizim kohorë për shfrytëzim.

Parkingjet Private

Parkingjet private menaxhohen nga sektori privat. Parkingjet private e ushtrojnë veprimtarinë e tyre në prona private dhe kjo veprimtari nuk është e regjistruar në Komunë. Prandaj, Kuvendi Komunal nuk ka ndikim në kushtet, kohëzgjatjen e veprimtarisë dhe çmimin e parkingut. Çmimi për parkim në parkingjet private sillet 1 euro/ditë.

Gjendja e mënyrës së pagesës së parkingjeve në pjesën qendrore të qytetit të Gjakovës është dhënë në Figurem e me poshtme:





Figura 19. Menaxhimi i parkingjeve

▪ Kërkesa për parkingje

Pas analizës së kërkesës për parkingje në pjesën qendrore të qytetit është vlerësuar se parkingjet nuk shfrytëzohen në mënyrë adekuate (Fig....a):

- Në qendër të qytetit, më pak se 50% të parkingjeve shfrytëzohen për qëndrim të shkurtër (deri në një orë),

- rreth 50% e përdoruesve, shfrytëzojnë vetëm 10 deri në 15% të ofertës, ndërsa rreth 20% shfrytëzojnë më tepër se gjysmën e ofertës në dispozicion
- më tepër se 50% të parkingjeve shfrytëzohen për qëndrim të gjatë kohorë,
- rreth 20% e parkingjeve shfrytëzohen në intervale kohore mbi 4 orë,
- një numër i automjeteve qëndrojnë vazhdimisht në parking mbi 12 orë (3%).
- Koeficienti i ndërrimit në qendër të qytetit sillet rreth 3,8 – 4,2, d.m.th. përafërsisht rreth 4 automjete kanë shfrytëzuar një vend parkim.



a) Shfrytëzimi i parkingjeve në qendër

b) shfrytëzimi i parkingjeve në pjesën periferike

Ndërsa, jashtë pjesës qendrore, në parkingun afër Spitalit Rajonal, parkingjet më tepër shfrytëzohen për qëndrim të shkurtër (Fig...b).

- Rreth 70% të parkingut shfrytëzohet për qëndrim të shkurtër,
- Rreth 20% të parkingut shfrytëzohet për qëndrim nga 1-3 orë
- Ndërsa, rreth 10% nga 4-5 orë.
- Koeficienti i ndërrimit për parkingun në afërsi të Spitalit Rajonal sillet rreth 4,8.

▪ Zënia e parkingjeve në zonën qendrore të qytetit

Me qëllim të analizës së parkingjeve në qytetin e Gjakovës, janë bërë matjet e disa nga lokacionet në zonën qendër. Nga rezultatet e matjeve është konstatuar se:

- Në parkingun gjatësor në rrugën “Nënë Tereza” zënia e përgjithshme është rreth 76%. Kapaciteti maksimal i parkingjeve nuk arrihet për shkak të manovrave shtesë që kërkojnë parkingjet gjatësore dhe parkimit jo të rregullt si rezultat i mungesës së sinjalizimit adekuat horizontal.

- Në parkingun “Përballë Komunës” zënia maksimale është rreth 90%. Në shumicën e kohës ky parkim shfrytëzohet maksimalisht.
- Në parkingun “Përballë lumit Krena” zënia maksimale është rreth 93%. Gjithashtu edhe ky parkim në shumicën e kohës shfrytëzohet maksimalisht.
- Në parkingun “Te Spitali” zënia maksimale është rreth 60%. Shfrytëzimi maksimal në këtë parkim arrihet gjatë orëve 10:00-12:00.

Zënia e parkingjeve në zonën qendër, për qytetin e Gjakovës është dhënë në Figurën e mëposhtme.



Figura 20. Zënia e parkingjeve

Është e rëndësishme të futen masa të kufizimit të kërkesave dhe të hulumtohen/iniciohen opsione të mëtejshme për zhvillim të ardhshëm, duke përfshirë rritjen e tarifave për parkimit të automjeteve në rrugë dhe jashtë rrugës (parkingje), zhvillimin e kufizimeve të qasjes në qendër të qytetit dhe zvogëlimin e vendparkimeve në dispozicion për qëndrim të gjatë në qendër të qytetit. Menaxhimi efektiv i kërkesave luan një rol kyç në këtë qasje për të ndihmuar menaxhimin e rritjes së vazhdueshme në nivelet e trafikut dhe për të inkurajuar njerëzit të marrin parasysh alternativa tjera dhe në këtë mënyrë të mbështesin opsione më të qëndrueshme të udhëtimit, duke marrë parasysh ndërkohë nevojën për qasje në qendër të banorëve dhe bizneseve lokale.

Rrjeti hekurudhor

Rrjeti hekurudhor në Kosovë momentalisht ka standard relativisht të ulët. Tradicionalisht ai është shfrytëzuar vetëm për transport të mallrave, me vetëm një numër të vogël të trenave për transport publik. Ekziston një linjë hekurudhore që kalon përmes Dukagjinit- deri ne qytetin e

Pejës, por kjo linjë nuk kalon nëpër qytetin e Gjakovës. Stacioni më i afërt hekurudhorë gjendet në Xërxë, në komunën e Rahovecit, rreth 10 km nga qyteti i Gjakovës. Megjithatë ka pasur plane të ndryshme për linjat hekurudhore. Plani Gjeneral Urban i viti 1980 ka paraparë një linjë në pjesën jugore të qytetit. Kjo linjë do ti lidhte zonat më të mëdha industriale këtu, dhe do ta shkarkonte trafikun në këtë drejtim. Gjithashtu ka pasur plane që të zgjerohet kjo linjë deri në Shqipëri. Plani Hapësinor i Kosovës i vitit 2010 ka paraparë një lidhje ndërmjet pjesës veriore të qytetit të Gjakovës dhe Kromovikut në linjën Prizren-Klinë. Qasja e drejtpërdrejt në rrjetin hekurudhor, Gjakovës do t'i afronte shumë mundësi, si: transport të shpejt publik ndërmjet Gjakovës dhe qendrave tjera urbane në Kosovë, lidhje më të mirë me linjat ndërkombëtare, mundësi për t'i transportuar mallrat industriale. Zhvendosja e transporti publik dhe transportit të mallrave nga rrugët në hekurudha, gjithashtu mund t'a zvogëloj ndotjen e ajrit dhe ta përmirësoj mjedisin. Një lidhje e tillë e rrejtë ekzistues, mund ta ndërpresë izolimin hekurudhor të Gjakovës. Kjo gjithashtu mundet me qenë alternativa më e lirë, së paku në perspektivën afat shkurtër. Trafiku në lidhjen e rrugëve pa dalje, të merr shumë kohë dhe, stacioni i fundit nëse do të ishte e mundur të shmangej nga shumica operatorëve Evropian të Hekurudhës. Alternativat tjera si pasoj duhet të analizohen.

Transporti ajror

Aeroporti i vetëm në Kosovë dhe i vetmi për përdorim civil është Aeroporti Ndërkombëtar i Prishtinës "Adem Jashari". Ndërsa, një aeroport i vogël ushtarak i cili për momentin është jashtë funksionit, gjendet afër Gjakovës.

Aeroporti i Gjakovës ndodhet rreth 3 km në pjesën veri-lindore të Gjakovës. Deri në vitin 1999, kur është marrë nën mbikqyrje të KFOR-it, ky aeroport ka shërbyer si aeroport bujqësor.

Deri sa ky aeroport ka qenë nën mbikqyrje të KFOR-it janë zhvilluar vetëm fluturime për nevoja ushtarake apo humanitare me kryesisht avion dhe helikopter transportues ushtarak. Pista e vetme është e asfaltuar në gjatësi prej 1800 m, e gjerësi 30 metra, si dhe heliodromi i ri, në tërësi sipas standardeve ndërkombëtare të aviacionit, ndërsa lartësitë përreth aeroportit janë kodra që nuk kalojnë 1000 m.

Në të ardhmen, për shkak të kushteve superiore atmosferike ndaj Aeroportit Ndërkombëtar "Adem Jashari" të Prishtinës, aeroporti i Gjakovës mundet me qenë i hapur edhe për qëllime tjera, për përdorim civil si plotësim – alternativë e Prishtinës. Avancimi i aeroportit të Gjakovës në aeroport civil është paraparë edhe me Planin Hapësinor të Kosovës⁸.

Gjithashtu, edhe në Hartën Zonale të Kosovës⁹, në kuadër të veprimeve për përmirësimin e gjendjes së infrastrukturës së transporti, është paraparë funksionalizimi dhe shndërrimi i Aeroportit të Gjakovës në aeroport civil.

Transporti

Lëvizjet e pamotorizuara (këmbësorët dhe çiklistët)

▪ Mobiliteti i këmbësorëve

Këmbësorët dhe çiklistët përbëjnë aktualisht numrin më të madh të pjesëmarrësve në komunikacion. Gjendja e trotuareve për lëvizje të këmbësorëve në qytetin e Gjakovës, nuk është e kënaqshme. Në disa pjesë të rrugëve mungojnë trotualet ose edhe nëse ekzistojnë janë të ngushtë dhe nuk i plotësojnë kriteret për lëvizje të lire dhe të sigurt.

⁸ Ministria e Mjedisit dhe Planifikimit Hapësinor- PLANI HAPËSINOR I KOSOVËS, 2010.

⁹ Harta Zonale e Kosovës 2020 – 2028+

Në zonën më të frekuentuar në qendër të qytetit, përgjatë rrugës “Nënë Tereza” trotuaret janë me gjerësi të mjaftueshme dhe mundësohen lëvizje grupore të këmbësorëve.

Nga ana tjetër, në disa zona periferike të qytetit të Gjakovës dhe ato rurale mungojnë trotuaret dhe bankinat e rrugës, ashtu që gjendja në disa pjesë të rrugës konsiderohet e rrezikshme, sidomos për lëvizje të këmbësorëve.

Pas analizës së infrastrukturës për qarkullim të këmbësorëve dhe kërkesave për lëvizje të këmbësorëve është konstatuar se:

- Gjendja e trotuareve për lëvizje të këmbësorëve në qytetin e Gjakovës, nuk është e kënaqshme. Në disa pjesë të rrugëve mungojnë trotuaret ose edhe nëse ekzistojnë janë të ngushtë dhe nuk i plotësojnë kriteret për lëvizje të lire dhe të sigurt.
- Shpejtësia jo adekuate, respektivisht mosrespektimi i shpejtësisë së lëvizjes së automjeteve kushteve urbane, gjithashtu praqet rrezik shtesë për lëvizje të lirë të këmbësorëve. Kjo vërehet në Rr. “Tirana” në të cilën koncentrimi i këmbësorëve është mjaft i madh.
- Parkimi jo i rregullt i automjeteve në trotuare dhe sipërfaqe tjera të dedikuara për lëvizje të këmbësorëve, është problem mjaft i theksuar në shumë pjesë të rrugëve, në veçanti në pjesën e vjetër të qytetit.
- Prania më e madhe e këmbësorëve është vërejtur në rrugën kryesore “Nënë Tereza” ku numri i këmbësorëve sillet rreth 900-1000 këmb/h.
- Trupimi i rrugës dhe lëvizja e këmbësorëve në rrugë është një problem tjetër i evidentuar në rrugët e qytetit të Gjakovës.

▪ Mobiliteti i çiklistëve

Megjithëse, Gjakova është e vendosur në zonën malore, është një qytet relativisht i rrafshët. Përkundër distancave relativisht të shkurta, qytetaret e Gjakovës kanë krijuar traditë të ngasjes me biçikleta. Kjo paraqet potencial të rëndësishëm për jetë dhe mjedis të pastër në qytet. Me infrastrukturën adekuate të favorshme për ngasje të biçikletave, p.sh. shtigjet për çiklist, parkingu i biçikletave i ndarë në lokacione të rëndësishme, duhet të reduktohet sasia e trafikut të motorizuar në brendi të qytetit. Përdorimi i biçikletës konsiderohet si një aktivitet fizik i moderuar, i dobishëm njëherësh si për shëndetin, ashtu edhe për mjedisin, prandaj biçikleta mundet me qenë një alternativë e arsyeshme e transportit për përmbushjen e kërkesave për lëvizje brenda qytetit

Në Gjakovë ka një numër të konsiderueshëm të qytetarëve që përdorin biçikletën si mjet transporti. Sipas të dhënave nga matjet e strukturës së qarkullimit në rrjetin rrugor të qytetit të Gjakovës, është konstatuar se prania e biciklistëve në strukturën e përgjithshme të qarkullimit sillet rreth 8-15%. Në zonat periferike ky numër sillet rreth 8%, ndërsa në zonat më atraktive (zona qendër dhe pjesa e vjetër e qytetit ky numër arrin deri në 15%.

Pas analizës së infrastrukturës për çiklist në Gjakovë është konstatuar se:

- Në mungesë të shtigjeve adekuate për çiklist, ndodhë shumë shpesh që çiklistët shfrytëzojnë sipërfaqen e njëjte qarkulluese të rrugës së bashku me automjetet, duke rritur rrezikun e lëvizjes për çiklist.

- Përpos mungesës së shtigjeve për çikliste, në qytetin e Gjakovës ka edhe mungesë të parkingjeve për biçikleta.
- Shtigjet ekzistuese për çiklist, të cilat kryesisht janë të ndërtuara dhe të shenjëzuara në zonën “Blloku i ri” dhe në pjesët e rrugëve “UÇK” dhe “Tirana” kanë ndërprerje dhe nuk lidhen me pjesët më të rëndësishme të qytetit.
- Vlerësimet e palëve të interesit kanë treguar që nevojitet përmirësimi i infrastrukturës së këmbësorëve/çiklizmit për të nxitur shtimin e aktivitetit të ecjes/çiklizmit.

▪ Linjat transportuese ndërkomunale e brenda komunës urbane dhe rurale

Transporti i udhëtarëve në komunën e Gjakovës realizohet në tri nivele:

- Transporti ndërurban dhe ndërkombëtar (i cili lidhë Gjakovën me qytetet tjera të Kosovës dhe jashtë Kosovës),
- Transporti urbano-periferik (i cili lidhë qytetin e Gjakovës me fshatrat brenda Komunës) dhe
- Transporti urban (i cili lidhë zonat e ndryshme brenda qytetit të Gjakovës).

Aktualisht në qytetin e Gjakovës funksionon vetëm një linjë e transportit urban të udhëtarëve. Kjo linjë itinerarin e udhëtimit e fillon nga Piskota (në veri) kalon pranë objekteve kryesore të qytetit të cilat ndodhen në qendër të qytetit dhe si pikë të fundit ka stacionin pranë Spitalit Rajonal “Isa Grezda”. Ndërsa, në kthim kalon pranë shkollave të mesme dhe përfundon në stacionin fillestar të itinerarit. Kjo linjë në dy drejtime ka gjatësi rreth 17 km.



Figura 21. Linja urbane

Linja ekzistuese e transportit urban, ka një shtrirje jofunksionale, sepse rruga “Nënë Tereza” është rrugë njëkahëshe dhe gjatë kthimit ka një ndërprerje me pjesën më të rëndësishme të qendrës së qytetit. Gjithashtu, linjat ekzistuese kanë përthyerje të panevojshme të cilat zgjatën kohën e udhëtimit.

▪ Mbulueshmëria në pjesën rurale

Ekzistojnë linjat e drejtpërdrejta nga Gjakova me shumicën e fshatrave të komunës, si dhe me qytetet tjera të Kosovës. Stacioni qendror i autobusëve ndodhet në pjesën veriore të qytetit, i cili arrihet lehtë nga të gjitha pjesët e qytetit. Për qarkullimin e autobusëve në trafikun ndër komunal paraprakisht janë të regjistruara linjat me orare të udhëtimit të cilat qarkullojnë në relacione të caktuara. Gjatë ditës nga qyteti bëhen 75 nisje në linjat ndër komunale.

Bazuar në të dhënat e Drejtorisë për Shërbime Publike, mbulueshmëria e transportit urbano-periferik, respektivisht lidhja me pjesët rurale të Komunës, është në nivel të kënaqshme.

▪ Modelet e transportit

Rrugët e qytetit të Gjakovës në kuadër të zhvillimit të transportit (lëvizjeve) karakterizohen me përdorues të ndryshëm:

- lëvizjet e motorizuara (veturat për përdorim personal dhe autobusët urban) dhe
- të pamotorizuara (lëvizja e këmbësorëve dhe çiklisteve).

Formë tjetër të transportit- lëvizjeve në kuadër të qytetit nuk realizohet.

Duke analizuar dimensionet dhe shtrirjen e rrjetit rrugor të qytetit të Gjakovës, rezulton se në shumicën e gjatësisë së rrjetit përgjatë rrugëve primare prioritet i është dhënë lëvizjeve të motorizuara në kuptimin e akomodimit të lëvizjeve.

Të dhënat lidhur me mënyrën e udhëtimit në qytetin e Gjakovës janë dhënë në Tabelë¹⁰.

Mënyra e udhëtimit në brenda Komunës së Gjakovës	
Ecje në këmbë	58,5%
Udhëtimi me veturë	16,0%
Udhëtimi me autobus	13,5%
Biçikletë	12,0%

Përgjatë rrugëve dytësore, pothuajse në tërë gjatësinë paraqitet mungesa e lëvizjes komode të lëvizjeve të pamotorizuara (këmbësorëve dhe çiklistëve), ku ekzistojnë trotuare me gjerësi të pamjaftueshme, si dhe në pjesët ku nuk ekzistojnë trotuaret, lëvizja realizohet në hapësira të përbashkëta të qarkullimit me automjetet. Përpos në disa pjesë të rrugëve UÇK dhe “Tiranan në shumicën e rrugëve, lëvizja e çiklistëve realizohet pa asnjë shënim përkatës përgjatë sipërfaqes qarkulluese duke shfrytëzuar skajin e djathtë të korsisë së trafikut.

Kalimi i rrugës nga këmbësorët dhe çiklistet realizohet në të njëjtin nivel, ku në pjesë të caktuara mungojnë sinjalizimet përkatëse për vendkalim të këmbësorëve.

Vlerësim i nevojave në të ardhmen për një infrastrukturë transportuese

- Vlerësimi i nevojave infrastrukturore për rrugët nacionale

Nga niveli qendror, respektivisht nga Ministria e Infrastrukturës, është planifikuar zgjerimi i rrugës nacionale N-9.1 Gjakovë - Dollc me gjatësi 30.43 km.

Punimet në rrugën nacionale N9.1 Dollc- Gjakovë janë në proces të ndërtimit. Nga niveli qendror (Ministria e Infrastrukturës) është planifikuar zgjerimi i rrugës nacionale N-9.1 Gjakovë - Dollc me gjatësi 30.43 km.

Ndërtimi i rrugës Rakovinë – Gjakovë, (me gjatësi 16.16 km) i cili përfshinë territorin e Komunës së Gjakovës është paraparë të zgjerohet në rrugë me nga dy korsi për kahe dhe me kahe fizikisht të ndara. Përgjatë kësaj rruge, sidomos në afërsi të qytetit të Gjakovës zhvillohen veprimtari të ndryshme ekonomike të cilat me rastin e zgjerimit dhe ndarjes fizike të kaheve të rrugës, mund të krijoj edhe vështirësi të kycjes/shkycjes për biznese dhe banorët e këtyre zonave.

Prandaj, është e nevojshme të krijohen kushte adekuate infrastrukturore, kryesisht përmes rrugëve paralele, në mënyrë që të mundësohen shkëmbimet e lëvizjeve dhe funksionimi normal i bizneseve dhe banorëve të zonës. Duhet të planifikohen kycje të kontrolluara dhe të zbatohet Udhëzimi Administrativ për kycje në rrugët nacionale dhe rajonale, përmes së cilit do të precizohen kriteret dhe standardet teknike të kycjes në rrugë.

¹⁰ Burimi: Draft dokumenti i përgatitur për Konferencën e Investitorëve nga Komuna e Gjakovës

▪ Planifikimi i autoudhës së Dukagjinit

Gjatë vitit 2018, Qeveria e Kosovës, kishte marrë vendim për krijimin e Komitetit Drejtues Ndërmjësor për zhvillimin e projektit “Autoudha Istog-Pejë-Deçan-Gjakovë-Prizren”¹¹.

Nga ana tjetër, sipas Strategjisë Kombëtare për Zhvillim (2016 – 2021), në kuadër të prioritetëve infrastrukturorë, kishin paraparë rikonstruimin e rrugës Istog-Pejë-Deçan-Gjakovë-Prizren, respektivisht opsionin e zgjerimit të rrugës Rajonale R107 dhe R101 dhe R103, edhe për dy shirita të trafikut për kahe.

Bazuar në të dhënat e Ministrisë së Infrastrukturës¹², numri mesatar i automjeteve që qarkullojnë brenda ditës në rrugën rajonale R107 (Pejë – Deçan – Gjakovë – Prizren) është rreth 11. 500 automjete për 24/h.

Përmes autoudhës së Dukagjinit, Gjakovës i mundësohet kyçje direkte dhe lidhje shumë të rëndësishme në rrjetin infrastrukturor kombëtar dhe ndërkombëtar.

▪ Vlerësimi i nevojave infrastrukturorë për rrugët lokale - urbane

Në zona të caktuara në brendi të lagjeve të qytetit të Gjakovës paraqiten vështirësi në operimin e trafikut për shkak të parametrave teknik të rrugëve të cilët rezultojnë të pamjaftueshëm për të përballuar kërkesat për qarkullim të automjeteve si dhe për shkak të kërkesave të mëdha për parkingje në afërsi të rrugëve. Probleme të tilla të evidentuara janë kryesisht në pjesët më atraktive të qytetit siç është zona historike “Qarshia e Madhe” dhe zona në pjesën qendrore të qytetit.

Rruga e vetme nacionale N-9.1 në Komunën e Gjakovës kalon nëpër rrugët e qytetit, duke shkaktuar ngarkesë të trafikut në zona të rëndësishme të qytetit. Problemi më i theksuar mbetet ngarkesa e qytetit të vjetër. Bazuar në matjet e fluksit të automjeteve, rreth 550 aut/h e shfrytëzojnë pjesën e vjetër të qytetit si tranzit.

Prandaj, nevoja për devijim e trafikut motorik, sidomos trafikut tranzit nga pjesët më atraktive të qytetit, është vlerësuar si nevojë për përmirësimin e nivelit të shërbimit, rritjen e sigurisë në trafik dhe mundësinë për lëvizje aktive në qytetin e Gjakovës.

Me qëllim të përmirësimit të qarkullimit dhe devijimin e trafikut tranzit nga pjesa e qytetit, janë vlerësuar nevojat për kapacitete infrastrukturorë të rrugëve qarkore, si në vijim:

1. Rruga qarkore në pjesën jugore të qytetit- Kjo rrugë, e cila është në ndërtim e sipër, do të devijoj trafikun tranzit në rrugën nacionale N-9.1 nga pjesa veriore e Shqipërisë dhe anasjelltas;
2. Rruga qarkore në pjesën lindore të qytetit - Rruga nacionale N-9.1 lidhet me rrugën rajonale R-107, duke devijuar trafikun tranzit nga Prishtina në drejtim të Prizrenit dhe anasjelltas;
3. Rruga qarkore në pjesën veriore të qytetit - Rruga nacionale N-9.1 lidhet me rrugën rajonale R-107, duke devijuar trafikun tranzit nga Prishtina në drejtim të Pejës dhe anasjelltas;

¹¹ Vendimi i Qeverisë së Kosovës i datës 13.02.2019

¹² Ministria e Infrastrukturës-Drejtorria e rrugëve, KMDV në rrugët e Kosovës.

-

Gjakova nuk është e lidhur në rrjetin hekurudhorë. Në ish Planin Gjeneral Urban të Gjakovës nga viti 1980, janë bërë plane për ndërtimin e një linje në zonën industriale në pjesën jugore të qytetit. Kjo linjë kryesisht është planifikuar për transportin e mallrave. Edhe në “Planin Hapësinor të Kosovës” është parapare ndërtimi i një linjë qorre (rrugë pa dalje) nga qyteti i Gjakovës për në Prizren- linja e Klinës.

Qasja e drejtpërdrejt e rrjetit hekurudhor, Gjakova do të përfitonte shumë dhe atë: transport të i shpejt publik ndërmjet Gjakovës dhe qendrave tjera urbane në Kosovë, lidhje më të mirë me linjat ndërkombëtare, mundësin për ti transportuar mallrat industriale. Zhvendosja e transporti publik dhe transportit të mallrave nga rrugët në hekurudha, gjithashtu mund ta zvogëloj ndotjen e ajrit dhe ta përmirësoj mjedisin. Një lidhje e tillë e rrejtë ekzistues, mund ta ndërpresë izolimin hekurudhor të Gjakovës. Kjo gjithashtu mundet me qenë alternativa më e lirë, së paku në perspektivën afat shkurtër. Trafiku në lidhjen e rrugëve pa dalje, të merr shumë kohë dhe, stacioni i fundit nëse do të ishte e mundur të shmangej nga shumica operatorëve Evropian të Hekurudhës. Alternativat tjera si pasoj duhet të analizohen.

▪ Funksionalizimi i Aeroportit të Gjakovës

Aeroporti i Gjakovës ndodhet rreth 3 km në pjesën veri-lindore të Gjakovës. Deri në vitin 1999, kur është marrë nën mbikëqyrje të KFOR-it, ky aeroport ka shërbyer si aeroport bujqësor.

Nga aspekti Hapësinor kjo nyje ajrore për Kosovën, e posaçërisht për rrafshin e Dukagjinit ka një rëndësi shumë të madhe, posaçërisht në aspektin e zhvillimit ekonomik të rrafshit të Dukagjinit dhe të Kosovës.

Ndërsa, për shkak të kushteve shumë të mira atmosferike ndaj Aeroportit Ndërkombëtar “Adem Jashari” të Prishtinës, aeroporti i Gjakovës mundet me qenë i hapur edhe për qëllime tjera, për përdorim civil si plotësim – alternativë e Prishtinës. Avancimi i aeroportit të Gjakovës në aeroport civil është paraparë edhe me Planin Hapësinor të Kosovës¹³.

Gjithashtu, edhe në Hartën Zonale të Kosovës¹⁴, në kuadër të veprimeve për përmirësimin e gjendjes së infrastrukturës së transporti, është paraparë funksionalizimi dhe shndërrimi i Aeroportit të Gjakovës në aeroport civil.

▪ Vlerësimi i nevojave infrastrukturore për Zonën Ekonomike Amerikane

Në komunën e Gjakovës, është planifikuar operimi i Zonës Ekonomike Amerikane, e krijuara konform Ligjit për Zonat Ekonomike, që nga viti 2018.

Kjo zonë do të shtrihet, në afërsi të Aeroportit të Gjakovës, pranë rrugës nacionale Gjakovë-Prishtinë dhe afër autoudhës së ardhshme të Dukagjinit.

Lokacioni i favorshëm i Zonës Ekonomike Amerikane, i ofron bizneseve kyçe të mirë dhe direkte në rrugën nacionale N-9.1 dhe në auto rrugën e Dukagjinit e cila është planifikuar të realizohet në të ardhmen. Gjithashtu, nga ky lokacion është e mundur çasja e mirë edhe në Aeroportin e Gjakovës.

1.1. Shëndetësia

1.1.1. Vlerësimi i gjendjes ekzistuese

Normat Teknike të Planifikimit Hapësinor kanë përcaktuar normën minimale prej 0.20 m²/banor për sipërfaqe të parcelës së infrastrukturës së institucioneve shëndetësore të nivelit parësor.

Duke marrë parasysh supozimin që në Komunë të Prishtinës aktualisht banojnë 288,139 banorë dhe normën minimale prej 0.20 m²/banor për sipërfaqe të parcelës së

¹³ Ministria e Mjedisit dhe Planifikimit Hapësinor- PLANI HAPËSINOR I KOSOVËS, 2010.

¹⁴ Harta Zonale e Kosovës 2020 – 2028+

infrastrukturës së institucioneve shëndetësore të nivelit parësor, Komunës i mungojnë gjithsejtë 11,631 m² sipërfaqe të destinuar për institucione shëndetësore të nivelit parësor.

	Numri aktual i banorëve	Sipërfaqja aktuale e parcelave kadastrale (m ²)	Sipërfaqja e kërkuar për kokë banori (m ²)	Sipërfaqja e përgjithshme që kërkohet (m ²)	Bilanci i sipërfaqes së nevojshme (m ²)
Zone Urbane	184,208	27,552	0.20	36,842	-9,290
Zone Rurale	103,931	18,445	0.20	20,786	+2,342
Gjithsejtë	288,139	45,997	0.20	57,628	-11,631

Tabela 21 Vlerësimi i kërkesave hapësinore për sipërfaqe të parcelës së infrastrukturës së institucioneve shëndetësore të nivelit parësor për numrin aktual të banorëve

Sa i përket institucioneve shëndetësore të nivelit parësor, Komuna ende nuk ka spital të përgjithshëm që i shërben banorëve të Komunës së Prishtinës dhe të Komunave fqinje.

Normat Teknike të Planifikimit Hapësinor kanë përcaktuar normën minimale prej 1.20 m²/banor për sipërfaqe të parcelës së infrastrukturës së spitalit të përgjithshëm.

Duke marrë parasysh që planifikimi i spitalit duhet të bazohet në projeksione afatgjate të numrit të banorëve jo vetëm të Komunës por edhe të Komunave më të afërta, të cilat bashkërisht supozohet që në vitin 2045 të kenë mbi 700,000 banorë, atëherë Komuna duhet të përcaktojë një sipërfaqe prej 840,000 m².

I.1.2.Vlerësimi i nevojave hapësinore për të ardhmen

Normat Teknike të Planifikimit Hapësinor kanë përcaktuar normën minimale prej 0.20 m²/banor për sipërfaqe të parcelës së infrastrukturës së institucioneve shëndetësore të nivelit parësor.

Duke marrë parasysh supozimin që në vitin 2028 në Komunë të Prishtinës do të banojnë 353,700 banorë dhe normën minimale prej 0.20 m²/banor për sipërfaqe të parcelës së infrastrukturës së institucioneve shëndetësore të nivelit parësor, Komunës i mungojnë gjithsejtë 24,744 m² sipërfaqe të destinuar për institucione shëndetësore të nivelit parësor.

	Nr. i prognozuar i banorëve 2028	Sipërfaqja aktuale e parcelave kadastrale (m ²)	Sipërfaqja e kërkuar për kokë banori (m ²)	Sipërfaqja e përgjithshme që kërkohet (m ²)	Bilanci i sipërfaqes së nevojshme (m ²)
Zone Urbane	232,120	27,552	0.20	46,424	-18,872
Zone Rurale	121,580	18,445	0.20	24,316	-5,871
Gjithsejtë	353,700	45,997	0.20	70,740	-24,744

Tabela 22 Vlerësimi i kërkesave hapësinore për sipërfaqe të parcelës së infrastrukturës së institucioneve shëndetësore të nivelit parësor për numrin e prognozuar të banorëve 2028

Sa i përket vendbanimeve dhe numrit të prognozuar të banorëve për vitin 2028, nevoja më e lartë hapësinore për institucione shëndetësore të nivelit parësor është në vendbanimet Prishtinë, Matigan dhe Kolovicë, si vijon:

Vendbanimi	Nr. i prognozuar i banorëve 2028	Sipërfaqja aktuale e parcelave kadastrale (m ²)	Sipërfaqja e kërkuar për kokë banori (m ²)	Sipërfaqja e përgjithshme që kërkohet (m ²)	Bilanci i sipërfaqes së nevojshme (m ²)
Prishtinë	232,120	27,207	0.20	46,424	-19,217
Matigan	61,511	3,910	0.20	12,302	-8,392
Kolovicë	6,179	0	0.20	1,236	-1,236

Tabela 23Vendbanimetme nevojat më të larta hapësinore për institucione shëndetësore të nivelit parësor të bazuar në numrit të prognozuar të banorëve për vitin 2028

1.2. Institucionet arsimore

1.2.1. Vlerësimi i gjendjes ekzistuese

Normat minimale për sipërfaqen e parcelës së infrastrukturës së institucioneve të arsimit parashkollor janë si në vijim:

- Ndërtesat e çerdheve: 0.30 m²/banor; dhe
- Ndërtesat e kopshteve: 1.00 m²/banor.

Normat teknike për planifikim hapësinor kanë përcaktuar 1.30m² sipërfaqe minimale për parcela kadastrale të destinuara për institucione parashkollore për kokë banori. Duke marrë parasysh supozimin qënëKomunëtëPrishtinës aktualisht banojnë 288,139 12

Vendbanimi	Numri aktual i banorëve	Sipërfaqja aktuale e parcelave kadastrale (m ²)	Sipërfaqja e kërkuar për kokë banori (m ²)	Sipërfaqja e përgjithshme që kërkohet (m ²)	Bilanci i sipërfaqes së nevojshme (m ²)
Zonë urbane	184,208	37,772	1.30	239,470	-201,698
Zonë rurale	103,931	0	1.30	135,110	-135,110
Gjithsejtë	288,139	37,772	1.30	374,580	-336,808

Tabela 24. Vlerësimi i sipërfaqeve aktuale krahas kërkesave hapësinore për institucione parashkollore sipas NTPH bazuar në numrin aktual të banorëve

Sa i përket mbulueshmërisë së lagjeve urbane të destinuara për banim me institucione publike parashkollore, 21 lagjet urbane të paraqitura në vijim nuk kanë institucione publike parashkollore:

Aktash,	Bërnice e ulët,	Kolovica,	Medrese,	Prishtina e re- zona qendër,
Arbëria 1,	Dodona,	Lakrishte,	Muhaxhirët,	Taslixhe, Velania,
Arbëria 2,	Kodra e Trimave 1,	Mati 2,	Prishtina e re- zona lindore,	Vellusha,
Arbëria 3,	Kodra e Trimave 2,	Mati 3,	Prishtina e re- zona perëndimore,	Vreshtat,

Tabela 25. Vlerësimi i mbulueshmërisë së lagjeve urbane të destinuar për banim me institucione publike parashkollore




Figura 23 Rrezet e mbulueshmërisë së çerdheve/kopshteve të fëmijëve publike

Normat minimale për sipërfaqen e parcelës së infrastrukturës së institucioneve të arsimit fillor dhe të mesëm të ultë janë si në vijim:

- Ndërtesat e shkollave fillore: 1.60 m²/banor; dhe
- Ndërtesat e shkollave të mesme të ulëta: 1.20 m²/banor.


Normat teknike për planifikim hapësinor kanë përcaktuar 2.80m² sipërfaqe minimale për parcela kadastrale të destinuar për institucionetë arsimit fillor dhe të mesëm të ultë për kokë banori.

Duke marrë parasysh supozimin që në Komunë të Prishtinës aktualisht banojnë 288,139 banorë dhe normën minimale prej 2.80 m²/banor për sipërfaqe të parcelës së infrastrukturës së institucioneve të arsimit fillor dhe të mesëm të ultë, Komunës i mungojnë gjithsejtë 429,041 m² sipërfaqe të destinuar për institucione të arsimit fillor dhe të mesëm të ultë.

Vendbanimi	Numri aktual i banorëve	Sipërfaqja aktuale e parcelave kadastrale (m ²)	Sipërfaqja e kërkuar për kokë banori (m ²)	Sipërfaqja e përgjithshme që kërkohet (m ²)	Bilanci i sipërfaqes së nevojshme (m ²)
Zonë urbane	184,208	233,742	2.80	515,782	-282,039
Zonë rurale	103,931	144,005	2.80	291,007	-147,002
Gjithsejtë	288,139	377,747	2.80	806,788	-429,041

Tabela 26. Vlerësimi i sipërfaqeve aktuale krahas kërkesave hapësinore për institucione të arsimit fillor dhe të mesëm të ulët sipas NTPH bazuar në numrin aktual të banorëve

Sa i përket rrezes së mbulueshmërisë së lagjeve urbane të destinuara për banim shumica e sipërfaqeve të lagjeve urbane është e mbuluar me institucione të arsimit fillor dhe të mesëm të ulët.



Harta 1 Rrezet e mbulueshmërisë së shkollave fillore dhe të mesme të ulëta

Normat minimale për sipërfaqen e parcelës së infrastrukturës së institucioneve të arsimit të mesëm të lartë janë si në vijim:

- Ndërtesat e shkollave të mesme larta: 1.00 m²/banor.

Normat teknike për planifikim hapësinor kanë përcaktuar 1.00m² sipërfaqe minimale për parcela kadastrale të destinuara për

Vendbanimi	Numri aktual i banorëve	Sipërfaqja aktuale e parcelave kadastrale (m ²)	Sipërfaqja e kërkuar për kokë banori (m ²)	Sipërfaqja e përgjithshme që kërkohet (m ²)	Bilanci i sipërfaqes së nevojshme (m ²)
Zonë urbane	184,208	85,365	1	184,208	-98,843
Zonë rurale	103,931	0	1	103,931	-103,931

73

Zonë urbane	232,120	37,772	1.30	301,756	-263,984
Zonë rurale	121,580	0	1.30	158,054	-158,054
Gjithsejtë	353,700	37,772	1.30	459,810	-422,038

Tabela 28. Vlerësimi i sipërfaqeve aktuale krahas kërkesave hapësinore për institucione parashkollore sipas NTPH bazuar në numrin aktual të banorëve

Sa i përket vendbanimeve dhe numrit të prognozuar të banorëve për vitin 2028, nevoja më e lartë hapësinore për institucione parashkollore është në vendbanimet Prishtinë, Matiçan, Hajvali, Çagllavicë, Kolovicë, Sharban, Nëntë Jugoviq, Prugoc, Barilevë dhe Llukar, si vijon:

Vendbanimi	Nr. i prognozuar i banorëve 2028	Sipërfaqja aktuale e parcelave kadastrale (m ²)	Sipërfaqja e kërkuar për kokë banori (m ²)	Sipërfaqja e përgjithshme që kërkohe (m ²)	Bilanci i sipërfaqes së nevojshme (m ²)
Prishtinë	232,120	37,772	1.30	301,756	-263,984
Matiçan	61,511	0	1.30	79,964	-79,964
Hajvali	13,118	0	1.30	17,053	-17,053
Çagllavicë	9,671	0	1.30	12,573	-12,573
Kolovicë	6,179	0	1.30	8,033	-8,033
Sharban	4,762	0	1.30	6,190	-6,190
Nëntë Jugoviq	4,447	0	1.30	5,781	-5,781
Prugoc	2,435	0	1.30	3,165	-3,165
Barilevë	2,430	0	1.30	3,160	-3,160
Llukar	2,131	0	1.30	2,770	-2,770

Tabela 29 Vendbanimetme nevojat më të larta hapësinore për institucione parashkollore bazuar në numrit të prognozuar të banorëve për vitin 2028

Duke marrë parasysh supozimin që në vitin 2028 në Komunë të Prishtinës do të banojnë 353,700 banorë dhe normën minimale prej 2.80 m²/banor për sipërfaqe parcelave të destinuara për institucionet e arsimit fillor dhe të mesëm të ultë, Komunës do të i nevojiten së paku 612,613 m² sipërfaqe shtesë të destinuar për institucione të arsimit fillor dhe të mesëm të ultë.

Vendbanimi	Nr. i prognozuar i banorëve 2028	Sipërfaqja aktuale e parcelave kadastrale (m ²)	Sipërfaqja e kërkuar për kokë banori (m ²)	Sipërfaqja e përgjithshme që kërkohe (m ²)	Bilanci i sipërfaqes së nevojshme (m ²)
Zonë urbane	232,120	233,742	2.80	649,937	-416,195
Zonë rurale	121,580	144,005	2.80	340,423	-196,418
Gjithsejtë	353,700	377,747	2.80	990,360	-612,613

Tabela 30. Vlerësimi i sipërfaqeve aktuale krahas kërkesave hapësinore për institucione të arsimit fillor dhe të mesëm të ultë sipas NTPH bazuar në numrin aktual të banorëve

Sa i përket vendbanimeve dhe numrit të prognozuar të banorëve për vitin 2028, nevoja më e lartë hapësinore për institucione të arsimit fillor dhe të mesëm të ultë është në vendbanimet Prishtinë, Matëçan, Hajvali, Çagllavicë, Kolovicë, Sharban dhe Nëntë Jugoviq.

Vendbanimi	Nr. i prognozuar i banorëve 2028	Sipërfaqja aktuale e parcelave kadastrale (m ²)	Sipërfaqja e kërkuar për kokë banori (m ²)	Sipërfaqja e përgjithshme që kërkohet (m ²)	Bilanci i sipërfaqes së nevojshme (m ²)
Prishtinë	232,120	233,742	2.80	649,937	-416,195
Matëçan	61,511	34,739	2.80	172,230	-137,491
Hajvali	13,118	11,651	2.80	36,730	-25,079
Çagllavicë	9,671	8,305	2.80	27,079	-18,774
Kolovicë	6,179	0	2.80	17,302	-17,302
Sharban	4,762	0	2.80	13,333	-13,333
Nëntë Jugoviq	4,447	596	2.80	12,451	-11,855

Tabela 31 Vendbanimetme nevojat më të larta hapësinore për institucione të arsimit fillor dhe të mesëm të ultë bazuar në numrit të prognozuar të banorëve për vitin 2028

Duke marrë parasysh supozimin që në Komunë të Prishtinës aktualisht banojnë 288,139 banorë dhe normën minimale prej 1.00 m²/banor për sipërfaqe të parcelave të destinuara për institucione të arsimit të mesëm të lartë, Komunës do të i nevojiten së paku 268,335m² sipërfaqe shtesë të destinuar për institucione të arsimit të mesëm të lartë.

Vendbanimi	Nr. i prognozuar i banorëve 2028	Sipërfaqja aktuale e parcelave kadastrale (m ²)	Sipërfaqja e kërkuar për kokë banori (m ²)	Sipërfaqja e përgjithshme që kërkohet (m ²)	Bilanci i sipërfaqes së nevojshme (m ²)
Zonë urbane	232,120	85,365	1.00	232,120	-146,756
Zonë rurale	121,580	0	1.00	121,580	-121,580
Gjithsejtë	353,700	85,365	1.00	353,700	-268,335

Tabela 32. Vlerësimi i sipërfaqeve aktuale krahas kërkesave hapësinore për institucione të mesëm të lartë sipas NTPH bazuar në numrin e prognozuar të banorëve

Sa i përket vendbanimeve dhe numrit të prognozuar të banorëve për vitin 2028, nevoja më e lartë hapësinore për institucione të arsimit fillor dhe të mesëm të ultë është në vendbanimet Prishtinë, Matëçan, Hajvali, Çagllavicë, Kolovicë, Sharban dhe Nëntë Jugoviq.

Vendbanimi	Nr. i prognozuar i banorëve 2028	Sipërfaqja aktuale e parcelave kadastrale (m ²)	Sipërfaqja e kërkuar për kokë banori (m ²)	Sipërfaqja e përgjithshme që kërkohet (m ²)	Bilanci i sipërfaqes së nevojshme (m ²)
Prishtinë	232,120	85,364	1.00	232,120	-146,756
Matëçan	61,511	0	1.00	61,511	-61,511

Hajvali	13,118	0	1.00	13,118	-13,118
---------	--------	---	------	--------	---------

Tabela 33 Vendbanimetme nevojat më të larta hapësinore për institucione të mesëm të lartë bazuar në numrit të prognozuar të banorëve për vitin 2028

Sa i përket trendit të numrit të nxënësve, bazuar në numrin e nxënësve të regjistruar në klasë të parë dhe në klasë të nëntë, vërehet një rritje pozitive prej +8.82% apo 1.10% në vit.

1	2	3	4	5	6	7	8	9
3,503	3,399	3,355	3,337	3,309	3,209	3,120	3,217	3,194

Tabela 34 Numri i nxënësve të regjistruar në shkollat fillore dhe të mesme të ulëta, klasat1 – 9

Bazuar në trendin e numrit të nxënësve të regjistruar sipas klasave me 1.10% rritje vjetore, rezulton që gjatë 8 viteve të ardhme do të gjithsejtë 36,457 nxënës të regjistruar në Shkolla Fillore të Mesme të Ulëta, 6,814 nxënës shtesë.

1	2	3	4	5	6	7	8	9
3,824	3,782	3,741	3,700	3,660	3,620	3,581	3,542	3,503

Tabela 35Projeksiioni i numri tënxënësve në shkollat fillore dhe të mesme ulëta, për klasat1 – 9 gjatë 8 viteve të ardhme

Sa i përket trendit të numrit të nxënësve, bazuar në numrin e nxënësve të regjistruar në klasë të parë dhe në klasë të nëntë, vërehet një rritje pozitive prej -10.48%apo -3.49% në vit.

10	11	12
3,503	3,399	3,355

Tabela 36 Numri i nxënësve të regjistruar në shkollat e mesme të larta,klasat10 - 12

Bazuar në trendin e numrit të nxënësve të regjistruar sipas klasave me 0.73%rritje vjetore, rezulton që gjatë 3 viteve të ardhme do të gjithsejtë 10,626nxënës të regjistruar në Shkolla Fillore të Mesme të Ulëta, 6,814 nxënës shtesë.

10	11	12
3,581	3,542	3,503

Tabela 37 Projeksiioni i numri të nxënësve në shkollat e mesme të larta për klasat10 - 12 gjatë 3 viteve të ardhme

1.3. Administrata publike

1.3.1. Vlerësimi i gjendjes ekzistuese

Normat Teknike të Planifikimit Hapësinor kanë përcaktuar normën minimale prej 0.62 m²/banor për sipërfaqe të parcelave të destinuara për institucione të administratës publike.

Duke marrë parasysh supozimin që në Komunë tëPrishtinës aktualisht banojnë 288,139 banorë dhe normën minimale prej 0.62 m²/banor për sipërfaqe të parcelave të destinuara për institucione të administratës publike, Komunës i mungojnëgjithsejtë72,299 m² sipërfaqe të destinuara për institucione të administratës publike.

	Numri aktual i banorëve	Sipërfaqja aktuale e parcelave kadastrale (m ²)	Sipërfaqja e kërkuar për kokë banori (m ²)	Sipërfaqja e përgjithshme që kërkohet (m ²)	Bilanci i sipërfaqes së nevojshme (m ²)
Zone Urbane	184,208	105,900	0.62	114,209	-8,309
Zone Rurale	103,931	447	0.62	64,437	-63,990
Gjithsejtë	288,139	106,347	0.62	178,646	-72,299

Tabela 38 Vlerësimi i kërkesave hapësinore për sipërfaqe të parcelës së infrastrukturës së institucioneve të administratës publike për numrin aktual të banorëve

1.3.2. Vlerësimi i nevojave hapësinore për të ardhmen

Normat Teknike të Planifikimit Hapësinor kanë përcaktuar normën minimale prej 0.20 m²/banor për sipërfaqe të parcelave të destinuara për institucione të administratës publike. Duke marrë parasysh supozimin që në vitin 2028 në Komunë të Prishtinës do të banojnë 353,700 banorë dhe normën minimale prej 0.20 m²/banor parcelave të destinuara për institucione të administratës publike, Komunës i mungojnë gjithsejtë 112,947 m² sipërfaqe të destinuara për institucione të administratës publike.

	Nr. i prognozuar i banorëve 2028	Sipërfaqja aktuale e parcelave kadastrale (m ²)	Sipërfaqja e kërkuar për kokë banori (m ²)	Sipërfaqja e përgjithshme që kërkohet (m ²)	Bilanci i sipërfaqes së nevojshme (m ²)
Zone Urbane	232,120	105,900	0.62	143,915	-38,015
Zone Rurale	121,580	447	0.62	75,379	-74,932
Gjithsejtë	353,700	106,347	0.62	219,294	-112,947

Tabela 39 Vlerësimi i kërkesave hapësinore për sipërfaqe të parcelës së infrastrukturës së institucioneve të administratës publike për numrin e prognozuar të banorëve 2028

Sa i përket vendbanimeve dhe numrit të prognozuar të banorëve për vitin 2028, nevoja më e lartë hapësinore për institucione të administratës publike është në vendbanimet Prishtinë, Matëçan, Hajvali, Çagllavicë, Kolovicë, Sharban dhe Nëntë Jugoviq.

Vendbanimi	Nr. i prognozuar i banorëve 2028	Sipërfaqja aktuale e parcelave kadastrale (m ²)	Sipërfaqja e kërkuar për kokë banori (m ²)	Sipërfaqja e përgjithshme që kërkohet (m ²)	Bilanci i sipërfaqes së nevojshme (m ²)
Prishtinë	232,120	105,900	0.62	143,915	-38,015
Matëçan	61,511	0	0.62	38,137	-38,137
Hajvali	13,118	447	0.62	8,133	-7,686
Çagllavicë	9,671	0	0.62	5,996	-5,996
Kolovicë	6,179	0	0.62	3,831	-3,831
Sharban	4,762	0	0.62	2,952	-2,952
Nëntë Jugoviq	4,447	0	0.62	2,757	-2,757

Tabela 40 Vendbanimet me nevojat më të larta hapësinore për institucione të administratës publike bazuar në numrit të prognozuar të banorëve për vitin 2028

1.4. Ndërtesa të komunitetit

1.5. Vlerësimi i gjendjes ekzistuese

Normat Teknike të Planifikimit Hapësinor kanë përcaktuar normën minimale prej 0.62 m²/banor për sipërfaqe të parcelave të destinuara për ndërtesa të komunitetit.

Duke marrë parasysh supozimin që në Komunë të Prishtinës aktualisht banojnë 288,139 banorë dhe normën minimale prej 0.62 m²/banor për ndërtesa të komunitetit, Komunës i mungojnë gjithsejtë 72,299 m² sipërfaqe të destinuar për ndërtesa të komunitetit.

	Numri aktual i banorëve	Sipërfaqja aktuale e parcelave kadastrale (m ²)	Sipërfaqja e kërkuar për kokë banori (m ²)	Sipërfaqja e përgjithshme që kërkohet (m ²)	Bilanci i sipërfaqes së nevojshme (m ²)
Zone Urbane	184,208	16,533	0.45	82,894	-66,360
Zone Rurale	103,931	0	0.45	46,769	-46,769
Gjithsejtë	288,139	16,533	0.45	129,662	-113,129

Tabela 41 Vlerësimi i kërkesave hapësinore për sipërfaqe të parcelës së ndërtesave të komunitetit për numrin aktual të banorëve

1.5.1. Vlerësimi i nevojave hapësinore për të ardhmen

Normat Teknike të Planifikimit Hapësinor kanë përcaktuar normën minimale prej 0.20 m²/banor për sipërfaqe të parcelave të destinuara për ndërtesa të komunitetit.

Duke marrë parasysh supozimin që në vitin 2028 në Komunë të Prishtinës do të banojnë 353,700 banorë dhe normën minimale prej 0.20 m²/banor për parcelave të destinuara për ndërtesa të komunitetit, Komunës i mungojnë gjithsejtë 112,947 m² sipërfaqe të destinuara për ndërtesa të komunitetit.

	Nr. i prognozuar i banorëve 2028	Sipërfaqja aktuale e parcelave kadastrale (m ²)	Sipërfaqja e kërkuar për kokë banori (m ²)	Sipërfaqja e përgjithshme që kërkohet (m ²)	Bilanci i sipërfaqes së nevojshme (m ²)
Zone Urbane	232,120	16,533	0.45	104,454	-87,921
Zone Rurale	121,580	0	0.45	54,711	-54,711
Gjithsejtë	353,700	16,533	0.45	159,165	-142,632

Tabela 42 Vlerësimi i kërkesave hapësinore për sipërfaqe të parcelave për ndërtesa të komunitetit për numrin e prognozuar të banorëve 2028

Sa i përket vendbanimeve dhe numrit të prognozuar të banorëve për vitin 2028, nevoja më e lartë hapësinore për ndërtesa të komunitetit është në vendbanimet Prishtinë, Matigan, Hajvalidhe Çagllavicë.

Vendbanimi	Nr. i prognozuar i banorëve 2028	Sipërfaqja aktuale e parcelave kadastrale (m ²)	Sipërfaqja e kërkuar për kokë banori (m ²)	Sipërfaqja e përgjithshme që kërkohet (m ²)	Bilanci i sipërfaqes së nevojshme (m ²)
Prishtinë	232,120	16,533	0.45	104,454	-87,921
Matiçan	61,511	0	0.45	27,680	-27,680
Hajvali	13,118	0	0.45	5,903	-5,903
Çagllavicë	9,671	0	0.45	4,352	-4,352

Tabela 43 *Vendbanimet me nevojat më të larta hapësinore për ndërtesa të komunitetit bazuar në numrit të prognozuar të banorëve për vitin 2028*

1.6. Kultura

1.6.1. Vlerësimi i gjendjes ekzistuese

Normat minimale për sipërfaqen e parcelës të infrastrukturës së kulturës janë si në vijim: Ndërtesat e bibliotekave: 0.25 m²/banor; dhe Ndërtesat e teatrove: 0.20 m²/banor. Normat Teknike të Planifikimit Hapësinor kanë përcaktuar normën minimale prej 0.45 m²/banor parcelave të destinuara për infrastrukturë të institucioneve kulturore. Duke marrë parasysh supozimin që në Komunë të Prishtinës aktualisht banojnë 288,139 banorë dhe normën minimale prej 0.45 m²/banor për sipërfaqe të parcelës së infrastrukturës së institucioneve kulturore, Komunës i mungojnë gjithsejtë 92,039 m² sipërfaqe të destinuara për institucione kulturore.

	Numri aktual i banorëve	Sipërfaqja aktuale e parcelave kadastrale (m ²)	Sipërfaqja e kërkuar për kokë banori (m ²)	Sipërfaqja e përgjithshme që kërkohet (m ²)	Bilanci i sipërfaqes së nevojshme (m ²)
Zone Urbane	184,208	37,623	0.45	82,894	-45,271
Zone Rurale	103,931	0	0.45	46,769	-46,769
Gjithsejtë	288,139	37,623	0.45	129,662	-92,039

Tabela 44 *Vlerësimi i kërkesave hapësinore për sipërfaqe të parcelës së infrastrukturës së institucioneve kulturore për numrin aktual të banorëve*

1.6.2. Vlerësimi i nevojave hapësinore për të ardhmen

Normat Teknike të Planifikimit Hapësinor kanë përcaktuar normën minimale prej 0.45 m²/banor për sipërfaqe të parcelës së infrastrukturës së institucioneve kulturore. Duke marrë parasysh supozimin që në vitin 2028 në Komunë të Prishtinës do të banojnë 353,700 banorë dhe normën minimale prej 0.45 m²/banor për sipërfaqe të parcelës së infrastrukturës së institucioneve kulturore, Komunës i mungojnë gjithsejtë 121,542 m² sipërfaqe të destinuar për institucione kulturore.

	Nr. i prognozuar i banorëve 2028	Sipërfaqja aktuale e parcelave kadastrale (m ²)	Sipërfaqja e kërkuar për kokë banori (m ²)	Sipërfaqja e përgjithshme që kërkohet (m ²)	Bilanci i sipërfaqes së nevojshme (m ²)
--	---	---	--	--	---

Zone Urbane	232,120	37,623	0.45	104,454	-66,831
Zone Rurale	121,580	0	0.45	54,711	-54,711
Gjithsejtë	353,700	37,623	0.45	159,165	-121,542

Tabela 45 Vlerësimi i kërkesave hapësinore për sipërfaqe të parcelës së infrastrukturës së institucioneve kulturore.

Vendbanimi	Nr. i prognozuar i banorëve 2028	Sipërfaqja aktuale e parcelave kadastrale (m ²)	Sipërfaqja e kërkuar për kokë banori (m ²)	Sipërfaqja e përgjithshme që kërkohet (m ²)	Bilanci i sipërfaqes së nevojshme (m ²)
Prishtinë	232,120	37,623	0.45	104,454	-66,831
Matiçan	61,511	0	0.45	27,680	-27,680
Hajvali	13,118	0	0.45	5,903	-5,903
Çagllavicë	9,671	0	0.45	4,352	-4,352
Kolovicë	6,179	0	0.45	2,781	-2,781
Sharban	4,762	0	0.45	2,143	-2,143
Nëntë Jugoviq	4,447	0	0.45	2,001	-2,001

Tabela 46 Vendbanimet me nevojat më të larta hapësinore për ndërtesa kulturore bazuar në numrit të prognozuar të banorëve për vitin 2028

Sa i përket vendbanimeve dhe numrit të prognozuar të banorëve për vitin 2028, nevoja më e lartë hapësinore për ndërtesa të komunitetit është në vendbanimet Prishtinë, Matiçan, Hajvali, Çagllavicë, Kolovicë, Sharban dhe Nëntë Jugoviq.

1.7. Objektet e rinisë, sportit dhe rekreacionit

1.7.1. Vlerësimi i gjendjes ekzistuese

Normat Teknike të Planifikimit Hapësinor kanë përcaktuar normën minimale prej 0.20 m²/banor parcela të destinuar për infrastrukturë të rinisë, sportit dhe rekreacionit.

Duke marrë parasysh supozimin që në Komunë të Prishtinës aktualisht banojnë 288,139 banorë dhe normën minimale prej 0.20 m²/banor për sipërfaqe të parcelës së infrastrukturës së rinisë, sportit dhe rekreacionit, Komunës i mungojnë gjithsejtë 1,031,902 m² sipërfaqe të destinuar për institucione të rinisë, sportit dhe rekreacionit.

	Numri aktual i banorëve	Sipërfaqja aktuale e parcelave kadastrale (m ²)	Sipërfaqja e kërkuar për kokë banori (m ²)	Sipërfaqja e përgjithshme që kërkohet (m ²)	Bilanci i sipërfaqes së nevojshme (m ²)
Vendbanimet ≤ 5000 banorë	30,713	176,432	2.50	76,782	+99,650
Vendbanimet 5001 20000 banorë	24,404	29,265	4.50	109,818	-80,553

Vendbanim ≥ 20001 banorë	233,022	114,110	5.00	1,165,109	-1,050,999
Githsejtë	288,139	319,807	2.50 - 5.00	1,351,709	-1,031,902

Tabela 47 Vlerësimi i kërkesave hapësinore për sipërfaqe të parcelës së infrastrukturës së institucioneve të rinisë, sportit dhe rekreacionit për numrin aktual të banorëve

1.7.2. Vlerësimi i nevojave hapësinore për të ardhmen

Normat Teknike të Planifikimit Hapësinor kanë përcaktuar normën minimale prej 2.50 m²/banor për sipërfaqe të parcelës së infrastrukturës së institucioneve rinisë, sportit dhe rekreacionit. Duke marrë parasysh supozimin që në vitin 2028 në Komunë të Prishtinës do të banojnë 353,700 banorë dhe normën minimale prej 2.50 m²/banor për sipërfaqe të parcelës së infrastrukturës së institucioneve rinisë, sportit dhe rekreacionit, Komunës i mungojnë gjithsejtë 1,359,721 m² sipërfaqe të destinuar për institucione të rinisë, sportit dhe rekreacionit.

	Nr. i prognozuar i banorëve 2028	Sipërfaqja aktuale e parcelave kadastrale (m ²)	Sipërfaqja e kërkuar për kokë banori (m ²)	Sipërfaqja e përgjithshme që kërkohej (m ²)	Bilanci i sipërfaqes së nevojshme (m ²)
Vendbanimet ≤ 5000 banorë	31,101	176,432	2.50	81,015	+95,417
Vendbanimet 5001 20000 banorë	28,968	29,265	4.50	130,358	-101,093
Vendbanim ≥ 20001 banorë	293,631	114,110	5.00	1,468,155	-1,354,045
Githsejtë	353,700	319,807	2.50 - 5.00	1,679,528	-1,359,721

Tabela 48 Vlerësimi i kërkesave hapësinore për sipërfaqe të parcelës së infrastrukturës së rinisë, sportit dhe rekreacionit

Vendbanimi	Nr. i prognozuar i banorëve 2028	Sipërfaqja aktuale e parcelave kadastrale (m ²)	Sipërfaqja e kërkuar për kokë banori (m ²)	Sipërfaqja e përgjithshme që kërkohej (m ²)	Bilanci i sipërfaqes së nevojshme (m ²)
Prishtinë	232,120	105,953	5.00	1,160,602	-1,054,649
Matiçan	61,511	8,157	5.00	307,553	-299,396
Hajvali	13,118	7,360	4.50	59,031	-51,671
Kolovicë	6,179	0	4.50	27,807	-27,807
Çagllavicë	9,671	21,905	4.50	43,521	-21,616
Sharban	4,762	704	2.50	11,905	-11,201
Nëntë Jugoviq	4,447	0	2.50	11,117	-11,117
Prugoc	2,435	0	2.50	6,086	-6,086
Barilevë	2,430	0	2.50	6,076	-6,076
Bërnice e Epërme	1,815	0	2.50	4,536	-4,536

Tabela 49Vendbanimetme nevojat më të larta hapësinore për infrastrukturës së rinisë, sportit dhe rekreacionit bazuar në numrit të prognozuar të banorëve për vitin 2028

Sa i përket vendbanimeve dhe numrit të prognozuar të banorëve për vitin 2028, nevoja më e lartë hapësinore për ndërtesa të komunitetitëshhtë në vendbanimet Prishtinë, Matëan, Hajvali, Kolovicë, Çaëllavicë, Sharban, Nëntë Jugoviq, Prugoc, Barilevë dhe Bërnice e Epërme, si vijon:

1.8. Hapësirat e hapura publike

1.8.1. Vlerësimi i gjendjes ekzistuese

Normat Teknike të Planifikimit Hapësinor kanë përcaktuar normën minimale prej 2.00 m²/banor për sipërfaqe të parcelave të destinuara përhapësira të hapura publike.

Duke marrë parasysh supozimin që në Komunë tëPrishtinës aktualisht banojnë 288,139 banorë dhe normën minimale prej 2.00 m²/banor të destinuara për hapësira të hapura publike, Komuna tejkalon sipërfaqe të destinuar për hapësira të hapura publikepër19,581,356m².

	Numri aktual i banorëve	Sipërfaqja aktuale e parcelave kadastrale (m ²)	Sipërfaqja e kërkuar për kokë banori (m ²)	Sipërfaqja e përgjithshme që kërkohet (m ²)	Bilanci i sipërfaqes së nevojshme (m ²)
Zone Urbane	184,208	1,614,100	2.00	368,416	-1,245,684
Zone Rurale	103,931	18,543,533	2.00	207,862	-18,335,671
Gjithsejtë	288,139	20,157,633	2.00	576,277	-19,581,356

Tabela 50 Vlerësimi i kërkesave hapësinore për sipërfaqe të parcelës së infrastrukturës së hapësirave të hapura publike për numrin aktual të banorëve

1.8.2. Vlerësimi i nevojave hapësinore për të ardhmen

Normat Teknike të Planifikimit Hapësinor kanë përcaktuar normën minimale prej 2.00 m²/banor për sipërfaqe të parcelave të destinuara për hapësira të hapura publike.

Duke marrë parasysh supozimin që në vitin 2028 në Komunë tëPrishtinës do të banojnë 353,700 banorë dhe normën minimale prej 2.00 m²/banor për sipërfaqe për hapësira të hapura publike, Komuna tejkalon sipërfaqet e kërkuara për 19,450,233m² sipërfaqe të destinuar për hapësira të hapura publike.

	Nr. i prognozuar i banorëve 2028	Sipërfaqja aktuale e parcelave kadastrale (m ²)	Sipërfaqja e kërkuar për kokë banori (m ²)	Sipërfaqja e përgjithshme që kërkohet (m ²)	Bilanci i sipërfaqes së nevojshme (m ²)
Zone Urbane	232,120	1,614,100	2.00	464,241	-1,149,859

Zone Rurale	121,580	18,543,533	2.00	243,159	-18,300,374
Gjithsejtë	353,700	20,157,633	2.00	707,400	-19,450,233

Tabela 51 Vlerësimi i kërkesave hapësinore për sipërfaqe të parcelës së infrastrukturës së hapësirave të hapura publike për numrin e prognozuar të banorëve 2028

Sa i përket vendbanimeve dhe numrit të prognozuar të banorëve për vitin 2028, nevoja më e lartë hapësinore për hapësira të hapura publike është në vendbanimet Matičan, Hajvali dhe Kolevicë, si vijon:

Vendbanimi	Nr. i prognozuar i banorëve 2028	Sipërfaqja aktuale e parcelave kadastrale (m ²)	Sipërfaqja e kërkuar për kokë banori (m ²)	Sipërfaqja e përgjithshme që kërkohe (m ²)	Bilanci i sipërfaqes së nevojshme (m ²)
Matičan	61,511	0	2.00	123,021	-123,021
Hajvali	13,118	0	2.00	26,236	-26,236
Çagllavicë	9,671	0	2.00	19,342	-19,342

Tabela 52Vendbanimetme nevojat më të larta hapësinore për hapësira të hapura publikebazuar në numrit të prognozuar të banorëve për vitin 2028

1.9. Objektet e religjionit dhe varrezat

1.9.1. Vlerësimi i gjendjes ekzistuese

Normat Teknike të Planifikimit Hapësinor kanë përcaktuar normën minimale prej 1.50 m²/banor për sipërfaqe të parcelave të destinuara përvarreza.

Duke marrë parasysh supozimin që në Komunë tëPrishtinës aktualisht banojnë 288,139 banorë dhe normën minimale prej 1.50 m²/banor të destinuara për varreza, Komunës i mungojnëgjithsejtë42,992m² sipërfaqe të destinuar për varreza në zonën rurale.

	Numri aktual i banorëve	Sipërfaqja aktuale e parcelave kadastrale (m ²)	Sipërfaqja e kërkuar për kokë banori (m ²)	Sipërfaqja e përgjithshme që kërkohe (m ²)	Bilanci i sipërfaqes së nevojshme (m ²)
Zone Urbane	184,208	370,241	1.50	276,312	-93,929
Zone Rurale	103,931	112,904	1.50	155,896	+42,992
Gjithsejtë	288,139	483,145	1.50	432,208	-50,937

Tabela 53 Vlerësimi i kërkesave hapësinore për sipërfaqe të parcelës së infrastrukturës së varrezave për numrin aktual të banorëve

1.9.2. Vlerësimi i nevojave hapësinore për të ardhmen

Normat Teknike të Planifikimit Hapësinor kanë përcaktuar normën minimale prej 1.50 m²/banor për sipërfaqe të parcelave të destinuara për varreza.

Duke marrë parasysh supozimin që në vitin 2028 në Komunë të Prishtinës do të banojnë 353,700 banorë dhe normën minimale prej 1.50 m²/banor për sipërfaqe për varreza Komuna tejkalon sipërfaqet e kërkuara për 19,450,233m² sipërfaqe të destinuar për varreza.

	Nr. i prognozuar i banorëve 2028	Sipërfaqja aktuale e parcelave kadastrale (m ²)	Sipërfaqja e kërkuar për kokë banori (m ²)	Sipërfaqja e përgjithshme që kërkohet (m ²)	Bilanci i sipërfaqes së nevojshme (m ²)
Zone Urbane	232,120	370,241	1.5	348,181	-22,060
Zone Rurale	121,580	112,904	1.5	182,370	69,466
Githsejtë	353,700	483,145	1.5	530,550	47,405

Tabela 54 Vlerësimi i kërkesave hapësinore për sipërfaqe të parcelës së infrastrukturës së institucioneve të rinisë, sportit dhe rekreacionit për numrin e prognozuar të banorëve 2028

Sa i përket vendbanimeve dhe numrit të prognozuar të banorëve për vitin 2028, nevoja më e lartë hapësinore për varreza është në vendbanimet Matëçan, Hajvali dhe Kolevicë, si vijon:

Vendbanimi	Nr. i prognozuar i banorëve 2028	Sipërfaqja aktuale e parcelave kadastrale (m ²)	Sipërfaqja e kërkuar për kokë banori (m ²)	Sipërfaqja e përgjithshme që kërkohet (m ²)	Bilanci i sipërfaqes së nevojshme (m ²)
Matëçan	61,511	13,090	1.50	92,266	-79,176
Çagllavicë	9,671	4,193	1.50	14,507	-10,314
Hajvali	13,118	11,381	1.50	19,677	-8,296
Nëntë Jugoviq	4,447	359	1.50	6,670	-6,311
Sharban	4,762	1,746	1.50	7,143	-5,397
Kolovicë	6,179	4,755	1.50	9,269	-4,514
Llukar	2,131	0	1.50	3,196	-3,196
Orlovicë	1,271	0	1.50	1,907	-1,907
Vranidoll	1,132	0	1.50	1,699	-1,699

Tabela 55 Vlerësimi i kërkesave hapësinore për sipërfaqe të parcelës së infrastrukturës së varrezave për numrin aktual të banorëve

Përparësitë	Dobësitë
-------------	----------

Shtirje dhe mbulueshmëri e mirë territorit me institucione shëndetësore të nivelit parësor	Mospërmbushja e kriterit minimal të NTPH për sipërfaqe të parcelës së infrastrukturës së institucioneve shëndetësore të nivelit parësor për së paku 11,631 m ²
Trend pozitiv i ndërtimeve të çerdheve dhe kopshteve për fëmijë	Nuk ka çerdhe dhe kopshte për fëmijë në 20 lagje urbane
Shtirje dhe mbulueshmëri e mirë territorit me shkolla fillore dhe të mesme të ulëta	Mospërmbushja e kriterit minimal të NTPH për sipërfaqe të parcelës së infrastrukturës së institucioneve parashkollore çerdhe dhe kopshte për fëmijë për së paku 336,808 m ²
Shtirje dhe mbulueshmëri e mirë territorit me shkolla të mesme të larta	Mospërmbushja e kriterit minimal të NTPH për sipërfaqe të parcelës së infrastrukturës së institucioneve arsimore shkolla fillore dhe të mesme të ulëta për së paku 429,041 m ²
Përmbushja e kriterit minimal të NTPH për sipërfaqe të parcelavekadastrale për hapësira të hapura publike	Mospërmbushja e kriterit minimal të NTPH për sipërfaqe të parcelës së infrastrukturës së institucioneve të arsimit të mesëm të lartë për së paku 202,774 m ²
Parku i Gërmisë	Mospërmbushja e kriterit minimal të NTPH për sipërfaqe të parcelës së infrastrukturës së institucioneve të administratës publike për së paku 72,299 m ²
Parku i Qytetit	Mospërmbushja e kriterit minimal të NTPH për sipërfaqe të parcelës së infrastrukturës së institucioneve ndërtësive të komunitetit për së paku 113,129m ²
	Mospërmbushja e kriterit minimal të NTPH për sipërfaqe të parcelës së infrastrukturës së institucioneve kulturore për së paku 92,039m ²
	Mospërmbushja e kriterit minimal të NTPH për sipërfaqe të parcelës së infrastrukturës së institucioneve të rinisë, sportit dhe rekreacionit për së paku 1,031,902m ²
	Mospërmbushja e kriterit minimal të NTPH për sipërfaqe të parcelës së infrastrukturës së varrezave për së paku 50,937m ²
Mundësitë	Kërcënimet
Përmbushja e kriterit minimal të NTPH për sipërfaqe të parcelës së infrastrukturës së institucioneve shëndetësore të nivelit parësor	Mungesa e buxhetit komunal për të plotësuar kriterin minimal të NTPH për sipërfaqe të parcelës së infrastrukturës

Përmbushja e kriterit minimal të NTPH për sipërfaqe të parcelës së infrastrukturës së institucioneve parashkollore, çerdhe dhe kopshte për fëmijë	Mungesa e alokimit të buxhetit të nivelit qendror për të paguar kuadrin shtesë shëndetësor
Përmbushja e kriterit minimal të NTPH për sipërfaqe të parcelës së infrastrukturës së institucioneve arsimore shkolle fillore dhe të mesme të ulëta	Mungesa e alokimit të buxhetit të nivelit qendror për të paguar kuadrin shtesë arsimor
Përmbushja e kriterit minimal të NTPH për sipërfaqe të parcelës së infrastrukturës së institucioneve të arsimit të mesëm të lartë	Çmimi i lartë për shpronësimin e tokës në territorin e Komunës
Përmbushja e kriterit minimal të NTPH për sipërfaqe të parcelës së infrastrukturës së institucioneve të administratës publike	
Përmbushja e kriterit minimal të NTPH për sipërfaqe të parcelës së infrastrukturës së institucioneve ndërtësive të komunitetit	
Përmbushja e kriterit minimal të NTPH për sipërfaqe të parcelës së infrastrukturës së institucioneve kulturore	
Përmbushja e kriterit minimal të NTPH për sipërfaqe të parcelës së infrastrukturës së institucioneve të rinisë, sportit dhe rekreacionit	
Përmbushja e kriterit minimal të NTPH për sipërfaqe të parcelës së infrastrukturës së varrezave	

Tabela 56 SWOT analiza e infrastrukturës publike dhe sociale

MJEDISI DHE SIPËRFAQET ME RREZIKSHMERI

Prishtina, si shumica e qyteteve të tjera, përballlet me një sërë problemesh mjedisore, si p.sh. Cilësi e dobët e ajrit, Nivel i lartë i trafikut, Nivel i lartë i zhurmës së ambientit, Mjedis i ndërtuar me cilësi të ulët, Toka të braktisura, Emetime të gazrave, Shtrirje të gjerë urbane, dhe Trajtimi i mbeturinave e kanalizimeve, etj. Këto probleme lidhen me një zhvillim urban që nuk është i orientuar drejt mjedisit.

Gjendja e përgjithshme mjedisore e qytetit të Prishtinës nuk mund të cilësohet ndryshe, veçse një gjendje jo e kënaqshme si në gjithë Republikën e Kosovës, qoftë në pjesët urbane, rurale apo përreth zonave industriale. Ndër Problemet mjedisore që janë evidente për Komunën e Prishtinës Janë; **Qasja akoma e ultë në kanalizime, furnizimi me ujë të pijshëm , ujërat urbane, rurale e industriale pa trajtim adekuat, menaxhim i kufizuar i mbeturinave, ndotja enorme e ajrit, zhurma e lartë, antena të telefonisë mobile, kujdesi jo i duhur ndaj gjelbërimit në qendër të qytetit dhe mungesa e vendeve për pushim e rekreacion, janë indikator kyç që alarmojnë për veprime të ngutshme në financim dhe përmirësim të mjedisit në Qytetin e Prishtinës. Qytetin e Prishtinës e karakterizon një trafik shumë i dendur, me numër të madh makinash, vende të pakta për parkim dhe cilësi Jo e duhur e karburanteve, që drejtpërdrejt ndikojnë në ndotjen ajrit dhe rrezikimin e shëndetit të popullatës. Sektori energjetik është një ndër ndotësit më të mëdhenj të mjedisit në Kosovë, posaçërisht në rajonin e Prishtinës.**

Për të penguar ndikimet e dëmshme në mjedis duhet promovuar “Sistemin e integruar për mbrojtjen e mjedisit” i cili i obligon autoritetet publike të bashkëpunojnë dhe koordinojnë punët mes veti për hartimin dhe zbatimin e çdo mase, standardi apo aktiviteti me qëllim të mbrojtjes së mjedisit.

☐ Duhet bërë fuqizimin e zbatimit të ligjeve dhe bëjnë inspektimin e zbatimit të ligjeve që

kanë të bëjnë me mbrojtjen e mjedisit dhe zhvillim të qëndrueshëm brenda territorit të Komunës së Prishtinës.

☐ Duhet të përgatiten dhe sigurohen informata për qytetarët në lidhje me mbrojtjen e mjedisit dhe zhvillimin të qëndrueshëm;

☐ Askujt nuk mund të ju lëshohet leja për shfrytëzimin e resurseve natyrore pa pëlqimin

mjedisor për projektin i cili duhet të përmban masat e mbrojtjes dhe rehabilitimit mjedisor.

☐ Strategjitë për menaxhimin e mbeturinave duhet të kontrollohen gjithmonë nga komuna

në mënyrë që të shmangen ndikimet në mjedis.

☐ Projektet Zhvillimore në shkallë prej 5 hektarëve duhet të dëshmojnë që nuk shkaktojnë

ndikime (përplasje) në mjedis.

☐ Gjatë dhënies së Lejeve Urbanistike për objekte zhvillimore ekonomike, nëse është e nevojshme, në pajtim me rregullat mjedisore, të sigurohen masat parandaluese për ndikimet negative në mjedis si ndotja e ajrit dhe zhurma, vibrimet, rrezatimi, ndotja e ujit

dhe ndikimet nga mbeturinat e ngurta. Vlerësimi i ndikimeve në mjedis është i nevojshëm për përmbajtjet prodhuese

NDOTJA E AJRIT

Normativat e cilësisë së ajrit në Kosovë janë të rregulluara me Udhëzimin administrative për Vlerat Kufitare- Normat e cilësisë së Ajrit, Nr.02/2011 dhe Direktivën 2008/50/EC për Cilësinë e ajrit mjedisor dhe ajrit të pastër për Evropë

Komuna e Prishtinës sa i përket ndotjës së Ajrit përballet me probleme dhe sfida jo të pakta sa i përket kësaj fushe. Ndër problemet dhe sfidat më të theksuar në Komunën e Prishtinës mundë ti radhisim si më poshtë.

1.Ndotja e lartë e ajrit. Që Paraqet një problem kritik mjedisor nëpër viset urbane, por në nivel shtetit ndotja është e nivelit më të ulët. Cilësia e ajrit është veçanërisht e ulët në zonën Urbane të Prishtinës. Burimet kryesore të kontaminimit janë dyoksidi i sulfurit (SO_2), oksidet e azotit NO dhe NO_2 (NO_x), ozoni (O_3), plumbi (Pb), dyoksidi i karbonit (CO_2), grimcat (PM Apo pluhuri) dhe dyoksina.

Disa nga ndërmarrjet publike private përdoren materie të rrezikshme për shëndetin e njeriut dhe e ndotin ambientin, siç janë: gaz butani, thartira, materiali bazë për prodhimin e hidrogjenit etj. Ndotës potencial të ajrit, ujit, por edhe tokës janë: KEK-u, Depoja e hedhurinave, automjetet e vjetra, trajtimi Jo adekuat i ujërave të zeza, depot e derivateve, Termokosi etj. Sipas shënimeve të siguruar nga Instituti Hidrometeorologjik i Kosovës, ndotja e ambientit në territorin e komunës është 22% për ajrin, 19% për ujin dhe 20% për Tokën

2.Stacionet për Monitorimin e cilësisë së ajrit në Komunën e Prishtinës Monitorimi i cilësisë së ajrit, që është në shkallë të kufizuar në Prishtinë dhe, kryhet nga Instituti hidrometeorologjik i Kosovës (IHMK) që menaxhon me Dy stacione. Njëri gjendet afër ndërtesës Rilindja në qendër të Prishtinës, afër rrugës me qarkullim të dendur, dhe është i konfiguruar për të matur vetëm fraksionet PM10, PM2.5, dhe PM1, ndërsa tjetri është stacion në periferi në objektin e IHMK-së, i pajisur me analizues automatik për dyoksid të sulfurit, okside të azotit, monoksid të karbonit, ozon dhe grimca të imta (PM10 ose PM2.5).po ashtu edhe Komuna e Prishtinës ka 6 nën stacione në këto lokacione:

1. Bregu i Diellit - Rr. Enver Maloku
2. Ulpiana - Rr. Mujë Krasniqi
3. Kodra e Trimave - Rr. Vëllazërit Fazliu
4. Dodona - Rr. Afrim Loxha
5. Dardania - Rr. Ilaz Kodra
6. Qendra -Sheshi Zahir Pajaziti

Krahasuar ndotjen e ajrit sipas lagjeve, atëherë vërehet se lagja Dardania është lagja më e ndotur, ndërsa lagja Bregu i Diellit më e pastër. Diferencat në ndotjen e ajrit janë të vogla ndërmjet lagjeve

TABELAKRAHASAUESE - MESATARET DITORENËMATJETNGAMMPH dhe KOMUNA E PRISHTINËS NË MUAJIN DHJETOR 2017 DHE JANAR 2018 (njësiamatëse $\mu\text{g}/\text{m}^3$ – mikrogram/metërkub)

Data	Dhjetor 2017		Janar 2018	
	MMPH	KOMUNA	MMPH	KOMUNA
1	14.1	15.9	114.6	128.9
2	16.4	18.3	110	123.2
3	55.2	61.8	34.2	38.7
4	38.5	42.7	43.3	48.1
5	53.8	59.2	102.1	119.5
6	67.2	75.3	74.6	86.8
7	53.6	59.7	85.5	99.2
8	54	61.6	123.8	142.4
9	13	14.7	76.5	88.1
10	21.9	24.5	51.4	58.8
11	13.3	15.3	56.7	64.3
12	22.5	26	27.7	31.4
13	22.6	26.2	13.8	15.5
14	11.7	12.9	36.4	41
15	11.2	12.4	27.7	31
16	9.8	10.8	25.9	28.6
17	17.5	19.6	9.5	10.5
18	28.6	32.2	41.2	45.3
19	34.6	38.6	42.1	48.8
20	26.9	30.5	63.3	73.1
21	30.7	34.8	43.6	50.1
22	47.2	54	35.4	39.6
23	61.3	70.6	56	63.4
24	52	59.8	51.8	59.1
25	66	121.9	103	114.7
26	104.8	51.1	116	129.9
27	43.7	13.3	135.7	149.3
28	12	25.8	151	167.6
29	22.8	44	155.8	174.5
30	39.7	5	118.9	132.6
31	75.3	84.7		146.9
Mesatarja	36.83	41.79	72.82	82.29
		13		

Vlersimi Bazohet në ndotjen e Ajrit nga grimcat e imta (PM10 dhe PM2.5), duke ditur dëshmitë e mjaftueshme se grimcat e imta në veçanti kanë efekte të dëmshme në shëndet .PM2.5 rritë nivelin e mortalitetit për shkak të kancerit kardiopulmonar dhe të mushkërive, dhe PM10 rritë morbiditetin kryesisht për shkak të bronkitit kronik, sëmundjeve të traktit të poshtëm respirator te fëmijët dhe simptomave të traktit respirator

Për të ndikuar në ngritjen e nivelit të cilësisë së ajrit në Komunën e Prishtinës rekomandohen këto masa:

- ☐ Ulja e numrit të automjeteve, përmes nxitjes së transportit publik kundrejt atij privat
- ☐ Menagjimi i rrjetit rrugor

- ☐ Përmirësimi i transportit public
- ☐ Promovimi i teknologjive të pastërta
- ☐ Nxitja e qiklizmit
- ☐ Rritja e sipërfaqeve të gjelbra

- ☐ Bizneset të cilat përdorin lëndë djegëse të kontrollohen dhe të obligohen të paisen me LMK (përmirësimi i ventilimit dhe cilesisë së lëndës djegëse).

- ☐ Vendosja e brezave dhe shiritave të gjelbër me kapacitete për absorbim të aerosolëve, gazrave azotike, të sulfurit dhe karbonike, metaleve të rënda për gjatë rrugëve kryesore të Prishtinës

- ☐ Rivitalizimin e parqeve ekzistuese dhe ngritjen e parqeve të reja në hapësirat e identifikuar
si të lira dhe të mundshme për ngritjen e këtyre parqeve

- ☐ Mbrojtja, zhvillimi e sidomos kultivimi i pyjeve të reja edhe me kapacitete për thithje të
Gazrave që e Ndotin Ajrin.

- ☐ Përcaktimin e kriterëve për sipërfaqet e gjelbra të detyrueshme në lejet e reja të ndërtimit,
me prioritet në qytetin e Prishtinës dhe nën – qendrat.

- ☐ Përmirësimin e qarkullimit rrugor për shmangien e fluksit të madh të makinave nëpër qendra të vendbanimeve, ku është e përqendruar dhe pjesa më e madhe e popullsisë;
- ☐ Pengimi i shkarkimeve të ndotësve në ajër nga Industria dhe makinat lëvizëse me vendosjen e katalizatorëve dhe rregullimeve tjera në aspektin teknik dhe largimin e të vjetrave nga trafiku.
- ☐ Shfrytëzimin e energjive alternative (kryesisht energjia diellore, rrjedhat e ujit, e erës dhe energjia gjeotermale)
- ☐ Minimizimin e shfrytëzimit të automjeteve dhe shfrytëzimin e transportit publik.
- ☐ Promovimin e lëvizjeve jo të motorizuara duke planifikuar edhe stazat për çiklist dhe ecje në këmb siç shihet në hartë.
- ☐ Rikonstruktimi rrugëve (çarkoreve dhe bajpaseve në qendrën urbane, kanalizimeve dhe

mënjanimi i deponive të mbeturinave që janë burim i ndotjes së ajrit nga djegiet dhe oksidimet
e mbeturinave etj.

NDOTJA E UJIT

Komuna e Prishtinës përballet me probleme dhe sfida jo të pakta sa i përket Ndotjes së ujit Ndër problemet dhe sfidat më të theksuar në Komunën e Prishtinës Janë.

1.Problemi i shkarkimit të ujërave të ndotur në lumenjë apo hapësira sipërfaqësore:Prishtina si shumë komuna tjera në Kosovë ka problem dhe sfida të lartë në menaxhimin e derdhjeve të ujërave të zeza derdhjet kryhen në kuadër të lumenjve. Krahësuar me komunat tjera dhe bazuar në madhësinë e saj në komunën e Prishtinës evakuimi i ujërave të zeza në vendbanimet jashtë qytetit është pak i organizuar. Janë vetëm 8 vendbanime me kanalizim publik apo kanalizim vetjak ku tre prej tyre pjesërisht.

Komuna	Vendbanimi	Nr.Banorve	Vendshkarkimi
PRISHTINË	Qyteti	430 245	Prishtëvka
	Bardhosh	2 150	Lumi Llap
	Barilevë	4 200	Lumi Llap
	Besi	907	Lumi Llap
	Hajvali	6 000	Gračankë
	Prroni i njelmët	1 000	Ujëra nëntokësorë
	Prugovc-Leban	800	Lumi Llap
	Shkabaj	1 500	Sitnicë
	Trudë	540	Lumi Llap
	Vranidoll	870	Lumi Llap

2.Ruajtjen e cilësisë, resursit dhe burimeve të ujit

Siq po shihet nga tabela, “lumi” më i ngarkuar në Komunën e Prishtinës është padyshim Prishtëvka, e cila mund të thuhet se është shëndërruar në rrjedhë lumore pikërisht nga ujërat e zeza të mbi 430,000 banorëve të kryeqytetit. Lumi i dytë i ngarkuar është Llapi me rreth 9450 banorë, Graçanka me 6000 banorë dhe Sitnica me 1500 banorë. Në ujëra nëntokësorë shkarkojnë ujërat e zeza rreth 1000 banorë.

Lumenjtë që kalojnë në territorin e Komunës së Prishtinës një problem e kanë ta ruajnë cilësinë e ujit pasi që kanë ndotje nga shkarikimi i ujërave të zeza, hudhja e mbeturinave në shtretit e Lumenjëve etj.

Monitorimi i ndotjes së ujit ..Monitorimi i cilësisë së ujit është i mangët dhe bën instituti hidrometrologjik i Kosovës. Prishtina si kryeqytet i Kosovës duhet të ketë më shumë pika për matjen e shkallës së ndotjes së ujit pasi që nuk është nga ato komuna që kanë resurse të mjaftueshme ujore. Pasi që nuk është e pasur me lumenjë ata ujë që e kanë duhet të jetë i cilësisë së mirë .Lumi Prishtina- Monitorimi i këtij lumi bëhet në Bresje të Fushë Kosovës para derdhjes së tij në lumin Sitnica. Ky nuk mund të quhet lum sepse nuk plotëson asnjë kriter të tij, por ky është kolektor i të gjitha ujërave të shkarkuara urbane

e etj. të kryeqytetit të Kosovës. Gjithashtu ka tejkalim të sasisë së nitriteve, materie të suspenduara, shpenzim kimik dhe biokimik të oksigjenit, mungesë të oksigjenit të tretur, detergjente etj.

Nga analiza e gjendjes në komunë e bërë nga grupet punuese sa i përket cilësisë, resursit dhe burimeve Ujore është konstatuar se shqetësimi kryesor ka të bëjë me mbrojtjen e cilësisë, resursit dhe burimeve të ujit. Parashikohet edhe zhvillimi dhe menaxhimi i burimeve të ujit për plotësimine nevojave për të sotme dhe të ardhmen.

Prandaj është parashikuar që:

□ Të gjitha burimet e ujërave natyrale, dhe ujërave tjerë nëntokësorë dhe sipërfaqësor të mbrohen, bashkë me caktimin e zonës së mbrojtjes së obligueshme rreth burimeve, kaptazheve, rrjedhave të lumenjve dhe akumulacioneve, me regjim të caktuar të mbrojtjes, varësisht nga destinimi i objektit. Në këto zona nuk mund të ndërtohen objekte e të zhvillohen punime tjera, as të shfrytëzohet toka në mënyrën e cila rrezikon sasinë dhe kualitetin e ujit.

□ Merren masat për mos lejimin e ndotjes së lumenjve, ujërave nëntokësore dhe sipërfaqësore nga ujërave të përdorura dhe ndyta prej vendbanimeve duke rekomanduar trajtim në dalje me gropa septike dhe forma tjera vendosja e aparateve për pastrim deri te impianti.

□ Në të ardhmen është e domosdoshme të merren masa afatshkurtra dhe afatgjatë që ujërat e përdorura, të ndyta (urbane, industriale) para se të lëshohen, të pastrohen në pikëpamje fizike biologjike dhe kimike. Për këtë qëllim, është e nevojshme:

□ Dokumentacioni investivo-teknik për industrinë e reja duhet të përmbajë edhe vendimin e pastrimit të të gjitha ujërave të përdorura, të ndyta. Puna e kapaciteteve të reja industriale nuk duhet të lejohet pa u montuar më parë aparatet të cilat do të sigurojnë pastrimin e ujërave të nxeta në mënyrën e duhur.

□ Nevojat e popullsisë për ujë do të rriten vazhdimisht. Në periudhën e ardhshme sigurimi i sasisë së nevojshme të ujit të shëndosh të pijes për popullsinë e Prishtinës do të jetë edhe në të ardhmen probleme serioze. Disa zgjidhje për qendrën komunale dhe vendbanimet për rreth janë paraparë edhe këto dokument, për sigurimin e sasive të parapara të ujit dhe të sasive plotësuese rezervë është e domosdoshme mbrojtja e disa burimeve, rrjedhave të lumenjve dhe akumulacioneve. Për këtë shfrytëzimi racional i ujërave në këtë komunë është detyrë me rëndësi e të gjithë faktorëve të planifikimit dhe të shfrytëzimit të ujit dhe hapësirës.

□ Mbrojtje e veçantë e ujërave duhet të kushtohet edhe nga përdorimi i pa kontrolluar i plehrave artificiale për bujqësi (nitratat, nitritet, fosfatet dhe nutrient tjerë.)

□ Mbrojtje tjetër parashikohet edhe nga mbeturina (të gjitha tipat e mbeturinave) duke planifikuar deponi që janë të organizuara dhe të cilat kanë marr parasysh këtë faktor deri te planifikimi i varrezave kolektive të kafshëve në raste emergjente.

NDOTJA E TOKËS

Në Komunën e Prishtinës me 55.18% dominon toka pyjore, pastaj toka bujqësore me 30.26% dhe banimi me 7.32% Toka konsiderohet si një burim thelbësor dhe kryesisht jo i rinovueshëm, bazuar në analizën e grupeve punuese për rolin kyç që luan toka brenda sistemit të gjerë të mjedisit, vazhdimi i humbjes së tokës do të kishte efekte shkatërruese në jetën tonë. Bujqësia dhe pylltaria dhe një varg aktiviteteve, janë të varura nga toka dhe këto do të kërcënoheshin, e deri te furnizimi me ujë dhe lëndë ushqyese për rritjen e bimëve dhe përkrahjen fizike të bimëve dhe të gjallesave tjera: një varg funksionesh e lidhesh me ruajtjen e ekosistemeve. Për shkak të kësaj game të gjerë të funksioneve që kryhen nga toka dhe marrëdhëniet e saj me mjedisin tjetër, komponenta e tokës nuk është konsideruar si e izoluar, andaj në fazën e analizës iu është kushtuar rëndësi e veçantë. Për këtë arsye, parashihet: mbrojtje fizike dhe cilësore e tokës. Përpos mbrojtjes së ajrit dhe të ujit, parashohim edhe futjen e politikave për mbrojtjen e tokës për të siguruar "Lidhjen e humbur" në mbrojtjen e mjedisit edhe në komunën Prishtinës.

Tabela... Diferenca në mes të shfrytëzimit aktual të tokës sipas PZHK 2012 dhe shfrytëzimit aktual të tokës në vitin 2019

Kategoria e shfrytëzimit	Sipas PZHK – 2012-2025 sip/ha	Sipas Shfrytëzimit Aktual sip/ha	Diferenca në ha	Diferenca në %
TOKË BUJQËSORE	20,358 ha	15832.14 ha	4525.86ha	28.59%
TOKË PYJORE	30,000 ha	28870.93ha	1129.07ha	3.91%
TOKË NDËRTIMORE	3089.85 ha	4545.74ha	1455.85ha	32.03%

Faktorët kryesorë që shkaktojnë humbje të tokës në Kosovë dhe në Komunën e Prishtinës janë:

- Zgjerime të përhershme të vendbanimeve -ndërtime
- Zhvillime të industrisë dhe mbeturina të krijuara nga këto lloj zhvillimesh, gjërmime, etj.
- Ndërtime të rrugëve dhe autoudhave,
- Mbeturinat e ekonomive familjare dhe gropat e mbushura me mbeturina,
- Erozioni,
- Gjermime të pakontrolluara.

Problemet e Komunës së Prishtinës për ndotjen e Tokës janë:

Parandalimi i humbjes së tokës bujqësore nga ndërtimet Pas luftës së fundit në Kosovë sidomos Prishtina si kryeqendër është zhvilluar shumë saj përket banimit në kuptimin

hapsinorë shumë sipërfaqe të tokave janë zënë me ndërtime duke uzurpuar tokën bujqësore.

Degradimi I tokave Bujqësore dhe ndotja e tyre. Ndikimi i vazhdueshëm nga aktivitetet njerëzore ka sjell deri të degradimi i sipërfaqeve tokësore në komunën e Prishtinës duke shkaktuar edhe pasoja të dëmshme mjedisore dhe socio-ekonomike. Sfidë është që të parandalohet degradimi i tokave dhe ndotja e tyre përmes masave dhe politikave specifike për mbrojtjen e tokave

Duke e konsideruar tokën si një burim thelbësor dhe kryesisht jo i renovueshëm, bazuar në analizën e grupeve punuese dhe gjerësinë e dijes dhe të kuptuarit e sistemeve të tokës dhe

rolin kyç që luan toka brenda sistemit të gjerë të mjedisit, vazhdimi i humbjes së tokës do të

kishte efekte shkatërruese në jetën tonë. Bujqësia, pylltaria dhe një varg aktiviteteve që janë të

varura nga toka do të kërcënoheshin, deri te furnizimi me ujë dhe lëndë ushqyese për rritjen e

bimëve dhe përkrahje fizike të bimëve dhe gjallesave tjera. Një varg funksionesh e lidhesh me

ruajtjen e ekosistemeve.

Për shkak të kësaj game të gjerë të funksioneve që kryhen nga toka dhe marrëdhëniet e saj me mjedisin tjetër, komponenta e tokës nuk është konsideruar si e izoluar andej në fazën

e analizës iu është kushtuar rëndësi e veçantë dhe për këtë arsye parashihet : mbrojtje fizike

dhe cilësore e tokës për pos mbrojtjes së ajrit dhe ujit –parashohim edhe futjen e politikave për

mbrojtjen e tokës për të siguruar "Lidhjen e humbur " në mbrojtjen e mjedisit edhe në Komunën tonë.

Planet e më hershme nuk kanë pasur kufinj ndërtimor mirë të planifikuar por edhe ato që i kanë pasur nuk janë respektuar mirë ose fare nuk janë respektuar.

ZHURMA

Në mënyrë që vendbanimet të mbrohen nga tejkalimi i nivelit të zhurmës së lejuar është e nevojshme të ndërtohen pengesa dhe të zhvillohen breza të gjelbër në mes të korridoreve të automjeteve motorike dhe vendbanimeve. Shfrytëzuesi i pajisjeve të cilat prodhojnë zhurmë dhe vibracion, mund të vë në qarkullim ose të përdor pajisjet sipas kushteve të parapara për aplikimin e masave mbrojtëse për zvogëlimin e zhurmës dhe

vibracionit, respektivisht të bënë përdorimin e impianteve, pajisjeve, makinave, mjeteve transportuese dhe aparateve të cilat lirojnë zhurmë deri në nivelin e paraparë me ligj të veçantë.

1 Si problem llogoritet Niveli i lartë i zhurmës është i pranishëm, si ditën, ashtu edhe natën. Kjo zhurmë krijohet nga fabrikat, edhe pse nuk janë shumë në numër, si dhe nga aktivitetet private, qofshin këto lokale apo kafiteri. Burimet kryesore të zhurmës së mjedisit përfshijnë: trafikun, industrinë, ndërtimin etj. Matje të nivelit të zhurmës ka edhe Komuna e Prishtinës në pjesë të ndryshme të qytetit, por akoma nuk ka matje të përditshme, siç e definon Ligji për mbrojtjen nga zhurma, Për arritjen e qëllimeve të cekura, duhet të hartohen dy dokumente themelore, të cilat trajtojnë të gjitha aspektet e efekteve të zhurmës: Harta Strategjike e zhurmës dhe Plani i Veprimit për mbrojtje nga zhurma.

Andaj për zvoglimin e zhurmës në Komunën e Prishtinës Parashikohet.

- ☐ Planifikimi i nivelit të tolerueshëm të ndotjes dhe zhurmës sidomos në zonat me veprimtari të ndjeshme (afër shkollave, spitaleve etj)
- ☐ Të Hartohet Harta Strategjike e zhurmës dhe Plani i Veprimit për mbrojtje nga zhurma.

BIODIVEZITETI

Edhe Prishtina si edhe shumica e vendeve të Kosovës po përballet me problemin e humbjes së biodiversitetit. Faktori kryesor që ka shkaktuar kërcënim serioz për ekzistencën e shumë llojeve bimore dhe shtazore, padyshim është faktori njeri; ndërkaq shpyllëzimet masive, shfrytëzimi intensiv i tokës, ndotjet e ajrit dhe ujit, si dhe gjuetia e pa kontrolluar janë vetëm disa nga faktorët tjerë që vazhdojnë të rrezikojnë biodiversitetin. Nga të gjitha këto, humbja e sipërfaqeve pyjore që ka përfshirë me të madhe ekosistemin natyror, është një nga problemet më emergjent për natyrën e Prishtinës. Reduktimi i sipërfaqeve pyjore dhe degradimi i vazhdueshëm i tyre ka ardhur, kryesisht si pasojë e shfrytëzimit pa kriteret e zonave pyjore. Si pasojë e këtyre ndikimeve rrjedh edhe kërcënimi për zhdukje të shumë llojeve bimore dhe shtazore sidomos në rajonin e Gërmisë si zonë e mbrojtur tani.

Kafshët e rralla në vendin tonë si: ujku, derri i egër, kaprrulli, dhelpra, vjedulla, dreri, dhia e egër, macja e egër, lepuri, ketri, thëllëza, shqiponja, petriri, pata e egër, lejleku etj. janë rrezikuar të pakësohen si pasojë e dëmtimit dhe ndryshimeve të habitateve të tyre, si gjuetisë së pakontrolluar, varfërimit dhe degradimit të ekosistemeve, erozionit dhe shpyllëzimit. Për llojet shtazore është shqetësuese, sidomos gjuetia e ushtruar gjatë periudhës së riprodhimit, ndërsa për llojet bimore grumbullimi i tyre gjatë fazës së

lulëzimit dhe nxjerrja me rrënjë.

PËRPARSIT	DOBËSIT
1Ka ligjin për Prishtinën Nr. 06/L-012 2 Prania e zonave natyrore të mbyllura, prania e qytetit me Parkun Natyror Rajonal të Gërmisë, i pasur me bimësi, florë dhe faunë, 3-Qyteti i Prishtinës me pozitë qendrore në Kosovë, me koncentrim të institucioneve qeveritare, administrative e zhvillimore hulumtuese të rëndësishme, 4 Ka Stacione për Monitorimin e Cilësisë së Ajrit 5 Vullnet politik për zbatimin e reformave në mjedis 6 Ka sistem të ngrohjes qendrore të Qytetit TERMOKOS	1.Ndotja e ajrit në formë pluhuri me PM_{10} dhe $PM_{2.5}$ 2.Ndotja e ajrit nga ngrohtorja në Prishtinë 3.Ndotja e ajrit nga termocentrali në Obiliq 4.Përdorimi I qymyrit (linjit) për ngrohje 5.Ndotja e ujit nga kanalizimet 6.Mungesa e laboratorit për testimin e tokës dhe ujit 7.Deponit Ilegale 8.Rrjeti I dobët Infrastruktures teknike (ujësjells, kanalizimi) 9. Uzurpimi I tokave bujqësore me ndertime 10Taksë e ulët për mjedisin; 11Ndërtime të paligjshme në Parkun e Gërmisë; 12 Implementimi i pakët i aktiviteteve në ndërgjegjësimin dhe vetëdijësimin e komuniteteve për krijimin e një komuniteti të sigurt dhe të qëndrueshëm 13 Përmytje nga ujërat atmosferike në disa zona të komunës gjatë sezoneve të shirave 14.Tejkalimi I vlerave të ndotësve të ajrit (PM_{10}, $PM_{2.5}$, NO_2 Blozë ejt) në qender dhe në periferi të Prishtinës në krahasim me vlerat e lejuara. 15Zbatim I dobët I ligjit 16. Tejkalimi i vlerave të lejuara të zhurmes 17. Buxheti I limituar për sektorin e mjedisit 18. Ndotja e mjedisit nga deponit ilegale 19. Përkeqësimi i natyrës / mjedisit / biodiversitetit
MUNDËSIT	RREZIQET

1.Përdorimi I lëndëve të pastërta djegëse për ta zezvendësuar qymyrin(linjitin)
2 Shtimi I pikave për monitorimin e cilësis së ajrit
3 Mbështetje e donatorve në fushën e mjedisit
4 Zgjerimi I hapësirave gjelbruse në Prishtinë që kishin bër ruajtjen e ekujlibrit mjedisor
5. Vullnet politik për zbatimin e reformave në mjedis
6 Zbatimi I programeve për reciklim të mbeturave
7 Ritja e buxhetit për sektorin e mjedisit në komunën e Prishtinës
8.Krijimi i pellgjeve (për ruajtjen e ujit nga shirat) dhe trajtimi i mbeturinave
9.Hapja e lumenjve të mbuluar në të ardhmen
10Modernizimi i shërbimit meteorologjik
11Ruajtja dhe menaxhimi i parqeve;
12Arritja e një mënyre shumë më efikase menaxhimi i mbeturinave në qytetin e Prishtinës (në aspekt kohe të grumbullimit, trajtimit të tyre, riciklimit etj)

1. Mbipopullimi i qytetit;
2. Perceptimi për Prishtinën si jostabile dhe me ndotje të lartë të ajrit ,tokës dhe ujit
3. Humbja e të interesuarve për investime në lëmin e mjedisit
4. Dëmtim i pa kthyeshëm i ekosistemeve lumore, dhe tokësore.
5. Thatësira – konsiderohet si kërcënim për furnizimin me ujë gjatë sezonit të verës kur temperaturat janë më të larta dhe reshjet e shiut më të rralla

SIPËRFAQET ME RREZIKËSHMERI

EROZIONI

Erozioni në territorin e Prishtinës rrezikon natyrën dhe pasuritë shoqërore dhe private të krijuara dhe të planifikuara nga njerëzit. Erozioni manifestohet me degradimin e tokës bujqësore, pyjore, rrjetit rrugor dhe hekurudhor si dhe me degradimin e objekteve ndërtimore dhe vendbanimeve.

Andaj komunës i rekomandohet:

Reduktimi i shkallës së erozionit përmes pyllëzimit në zonat e identifikuar me erozion të lartë dhe ndërgjegjësimi i qytetarëve për mbrojtjen e pyjeve nga shpyllëzimet e mëtejshme dhe kontrolli i duhur i zhvillimeve të reja është një sfidë tjetër.andaj më posht ju paraqesim tabelen me Nivelin e Erozionit në Komunën e Prishtinës.

Kategoritë e erozionit për komunë të Prishtinës	Sipërfaqe ha	%
Erozion shumë i Fortë	16052.17	30.69
Erozion i Fortë	6538	12.50
Erozion Mesatar	16125.12	30.83
Erozion i Dobët	13589.68	25.98
Totali	52304.97	100.00

Tabela 57. Niveli i erozionit në komunë të Prishtinës

RRËSHQITJA E TOKËS

Rrëshqitjet e tokës janë karakteristik e të gjithave Komunave në Kosovë e sidomos në Komunën e Prishtinës ku ditë e më shumë po ndërtohen ndertime të larta andaj saj përket rrëshqitjes së tokës Komunën e Prishtinës e përcjellin këto probleme:

Lokacionet me potencial të rrëshqitjes së dheut të evidentuara:

- Rruga “Malush Kosova” - Prishtina e Re,
- Lagja Arbëri, Rr. “Bashkim Fehmiu”
- Veterniku ana e majtë, apo pjesa perëndimore e Prishtinës së Re,
- Zona afër rrugës magjistrale Prishtinë – Grashticë afër Pompës së karburanteve “Nasa Ptol” dhe hapësira mbi të me rrezikshmëri të lartë.
- Rrëshqitje e dheut në rrugën Siqev – Radashec (rruga e gurëthyesit),
- Rrëshqitje e dheut në fshatin Prapashticë afër lagjes “Fanaj,
- Rrëshqitje e dheut në fshatin Dabishec, për shkak të ujërave nëntokësore,
- Rrëshqitje e dheut dhe gurëve në fshatin Marec, në rrugën Viti – Bullaj,
- Rrëshqitje e dheut Busi - Slivovë në lagjen Mukat (Tullar).
- Rrëshqitje e dheut, Keqekoll - Ballaban.

Fatkeqësia	Sipërfaqja e afektuar (ha)			
	2015	2016	2017	2018
Rrëshqitjet	9	1	1	6

Tabela 58. Sipërfaqet e afektuara nga rrëshqitja e dheut në komunë të Prishtinës

TËRMETET

Tërmeti është fenomen i cili shkaktohet nga çlirimi i papritur i energjisë së grumbulluar, i cili shkakton krijimin e valëve sizmike. Në sipërfaqen e tokës tërmeti shfaqet në dridhjet ose zhvendosjet e tokës dhe nganjëherë edhe në krijimin e dallgëve detare, Në të gjitha këto raste, tërmeti mund të shkaktojë dëmtime të mëdha njerëzore dhe materiale.

Nisur nga fakti se tërmetet paraqesin një rëndësi nga fatkeqësitë më të mëdha natyrore në zonat aktive sizmologjike në të cilën zonë ndodhet edhe Prishtina, me shkallë të rrezikshmërisë 9 mk, dhe duke pasur parasysh dëmet e shkaktuara gjatë historisë nga këto tërmete, e të cilat kanë ndodhur në vitet: 1922, 1931, 1963, 1979 si dhe disa dridhje që kanë ndodhur në vitet: 1980, 1983, 1984, 2000, 2002 edhe gjatë vitit 2008 lëvizje të cilat edhe në të ardhmen mund të përsëritën, vlerësohet se rreziku nga fatkeqësitë e tilla është i pranishëm në Komunën e Prishtinës dhe se duhet menduar në këtë drejtim në mënyrë që të parandalohen dëmet që mund të vin nga tërmeti

Reshjet atmosferike, erërat dhe ndryshimi i temperaturave janë faktor përkeqësues, si në mundësinë e dridhjeve të mëvonshme, po ashtu edhe në përkeqësimin dhe krijimin e kushteve të vështirësuara për reagim dhe perkujdesje për banorët goditur. Ndërtimi pa kriteret dhe cilësia jo adekuate e strukturave ndërtimore në Prishtinë i bënë të ndjeshme vendbanimet e saj

RROKULLISJET E MASAVE SHKËBORE DHE ORTEKËT E DËBORËS

Pasi që Prishtina nuk ka një lartësi mbidetare të lartë dhe nuk është e rrethuar me male të larta mundësia e rrezikimit të popullsisë nga dëbora klasifikohet e mundshme, me periudhën e rrezikut shumë të rrallë (1 herë në vit ose më pak), me dëme të vogla për popullsinë dhe në dëme materiale. Rrugët më të rrezikuara gjatë sezonit dimëror janë rrugët kodrinore – malore të fshatrave të Gollakut. Ortekët e borës dhe ngricat të cilat në një masë të konsiderueshme pengojnë funksionimin e përshtatshëm në mundësinë e furnizimit me prodhime vitale, ndërprerjen e komunikacionit, pamundësinë e ofrimit të ndihmës mjekësore në pjesët rurale të komunës (Llukar, Koliq, Keqekollë, Prapashticë, Nishec, Dabishec, Hajkobillë, Glllogovicë, Zllash, Kukavicë, Dragoc

ERËRAT

Prishtina është një regjion në përgjithësi që nuk goditet me shpejtësi të madhe të erërave të cilat kryesisht janë të intensitetit të mesëm dhe të ulët, ku drejtimi i erës kryesisht është nga veriu

Elementet e lartcekura ndikojnë në drejtimin e fryrjes së erërave (rrymës ajrore), e që më e theksuara është era veriore dhe verilindore, me shpejtësi mesatare 1.1 deri 1.7 m/sek, ndërsa shtypja atmosferike mesatare vjetore është 947.50 milibar

Erërat edhe në vitet e kaluara e kanë goditur komunën Prishtinën dhe kanë shkaktuar dëme të konsiderueshme materiale

Faktorët që ndikojnë në intensitetin e rreziqeve nga erërat e fuqishme konsiderojmë se mund të jenë: distanca e konsiderueshme nga bregdeti, relievi me pyje të mbuluara me vegetacion të cilat mund të ndikojnë ndjeshëm në frenimin natyror, duke zvogëluar intensitetin e erërave.

DIELLOSJA

Insolacioni ose Diellosja është ndriçimi i Diellit brenda kohës së caktuar (ditë, muaj, vit). Vlera e diellosjes zakonisht shprehet në orë me diell mesatarisht në vit.

Diellosja varet nga shumë faktorë. Disa prej tyre janë të qëndrueshëm dhe quhen faktorë klimatik (gjerësia gjeografike, lartësia mbidetare, përhapja e masave tokësore dhe ujore etj.), ndërsa të tjerët u nënshtrohen ndryshimeve dhe quhen elemente klimatike (lagështia e ajrit, retë, temperatura e bazës dhe e ajrit, erërat etj.) Ditët me diell zgjasin rreth 44 % prej ditëve të mundëshme që është një vlerë e lartë. Mesatarisht numri i ditëve me diell mbi 9 orë në Prishtinë është 90 ditë gjatë vitit, e mbi 1200m.lartësi mbi detare ka 112ditë

Në bazë të vrojtimeve të diellosjes në katër stacionet metrologjike (Prishtinë, Ferizaj, Prizren, Pejë), Kosova ka mesatarisht 2079 orë me diell gjatë vitit ose mesatarisht 5,7 orë në ditë. Vlera më e lartë e diellosjes e regjistruar në Prishtinë është 2140 orë /vit (h/v)

dhe më e ultë në Pejë: 1958 orë /vit (h/v). Gjatë vitit në muajin korrik ka më së shumti diellosje, kurse në dhjetor më së paku.

SIPËRFAQET ME NDOTJE TË LARTË (HOT-SPOTET)

Në këte pikpamje, rrezik përmanenent paraqesin hedhurinat e ngurta nga të cilat në teritorin e Komunes tone ishin krijuar oaza në sipërfaqe të mëdha duke gëlltitur sipërfaqë të mëdha të tokës bujqësore dhe asaj të gjelbërueshme me tendencë të zgjerimit të më tutëjeshem. Kjo gjendje karakterizohej nga materialet e shtëpive të rrenuara, si pasoj e luftes së fundit, beton armatur , gur, tulla etj , si dhe mbeturina të pashëmangëshme të amvisëris dhe aso sanitare të cilat vërehen kudo Kjo gjendje ka ardhur si pasoj e menaxhimit të dobët të mbeturinave nga shërbimet publike, mos seleksionimi i mbeturinave, mos caktimi i lokacionit të deponive si dhe mungesa e legjislacionit për rregullimn e kësaj çështje. Momentalisht në teritorin e Komunës së Prishtinës ka lokacion për deponimin e Mbeturinave ne deponin regjionale ne “Mirash”, në të cilën nuk bëhet riciklimi i mbeturinave duke filluar nga qendra komunale e deri në pjesët rurale të komunës

Menaxhimin dhe Inkasimin sipas Rregullores e Kryen Komuna e Prishtinës. Mbulimi me shërbim për grumbullimin e mbeturinave është në tërë territorin e Prishtinës duke përfshirë edhe tërë zonat rurale si dhe menaxhimi i faturimit të qytetarëve me faturë të mbeturinave.

Sasia e mbeturinave komunale(të amvisërisë) të grumbulluara dhe të bartura brenda vitit 2018 është 65,254 t ,nga dyqanet dhe tregjet 5,077 t dhe mbeturina nga ndërtimi 899 t.

Një problem specifik mjedisor paraqitet nga gropat josanitare, si ajo Marec 1 Dhe Marec 2 deri të Përroi i Djaloshit – miniera e Artanës, që janë gropat të mbushura me metaletë rënda në sipërfaqe prej 2, 38 ha.

Është zhvilluar pilot projekte për ndarjen e mbeturinave për fillim në lagjen Dardani e një projekt i tillë së shpejti do të fillon edhe në lagje tjera të Prishtinës.

Është bërë hulumtim i hapësirave për vendosje Të kontejnerëve të mbeturinave duke përfshirë edhe hulumtime për caktimin e numrit të tyre në lagjet Dardani, Bregu i Diellit, Tasligje si dhe jemi në veprim e sipër edhe për zonën Qendër duke përfshirë lagjet Tophane Lakërishtë, Lagjen e Muhagjerëve.

Kanë filluar procedurat për ndërtimin e qendrës së Kompostimit , ku përfshihet përcaktimi i hapësirës nga ana e Komunës së Prishtinës për këtë qendër, si dhe marrja e Lejës Mjedisore në MMPH për ndërtim e së shpejti do të fillon edhe ndërtimi i kësaj qendre.

Qyteti për momentin e ka strategjinë për trajtimin e mbeturinave duke u bazuar në principet e

kontrollit dhe vendosjes në vend të sigurt. Hedhja e mbeturinave bëhet nëpër kontejnerë të

mëdhenj dhe të vegjël nëpër vende të caktuara ku me pas bëhet bartja e tyre në deponinë

qendrore në Mirash. Problem në vete janë vajrat

e ndërruara t automjeteve, gomat e vjetra, thaset e najlonit, shishet e plastikës, lirimi i gazrave

nga automjetet e vjetruara



Foto--- Mbeturiat në qytet dhe në deponi

Komuna e Prishtinës menaxhon Dy platforma digjitale të cilat lidhen drejtë për së drejti me mirëmbajtje të mjedisit

Platforma Digjitale për pjesëmarrje ne Publik dhe platforma “Ndreqe.com” në të cilat publikohen problemet mjedisore të raportuara nga qytetarët dhe intervenohet nga kompanitë e kontraktuara nga Komuna.

SIPËRFAQET E RREZIKUARA NGA ZJARRI

Në Kohën e fundit, ndodhja e zjarreve në Komunën ePrishtinës është shtuar si në numër e po ashtu edhe sipërfaqja e prekur, që të dy këta tregues janë mbi karakteristikat mesatare. Në komunën e Priahntinësse ka pasur numër tëkonsiderueshëm zjarresh kryesisht në qendrën urbane, rurale gjithashtu gjatë kësaj periudhe ka pasur zjarre në pyje fusha,në ndertesat e banimit familjar,ne objekte afariste – lokale afariste, zjarre në automjete të udhëtarëve, në trafo për shpërndarjen e rrymës elektrike e tjera. Ne komunën e Prishtinës janë djegur disa shtepi pas luftës ka pasur dëme ne njerzë dhe te mira matriale



Pyjet e Komunës së Prishtinës janë të prirura për të u prekur nga zjarret gjatë gjithë vitit e sidomos në pranverë dhe gjatë verës jashtëzakonisht të nxehtë dhe të thatë. Shkaqet e zjarreve janë në radhë të parë me karakter:

- 1 Antropogjenik (pa kujdesia e njerëzve),

2 Djegëja për kullota,

3 Venja e zjarreve me qellim e interesa personale dhe Natyrore (të rralla apo të pa mundshme).

Përgjegjësia për mbrojtjen e pyjeve u takon autoriteteve pyjore. Masat për menaxhimin e zjarreve nga autoriteti pyjor janë:

PËRMBYTJET

Faktori njeri me aktivitetin e vetë ka shkaktuar dëme të mëdha përgjatë shtratit lumor në rrjedhjen e mesme dhe të poshtme ku në disa raste janë edhe të pariparueshme.

Nxjerrja ilegale e inerteve përgjatë pellgut lumor pa kritere ka shkaktuar degradim të shtratit lumor ku pasojat janë të mëdha gjatë periudhave të lagështa të vitit që manifestohen me vërshime. Ndërtimi i objekteve të banimit, objekteve ekonomike dhe objekteve tjera përgjatë shtretërve të lumenjve si dhe hedhja e mbeturinave të ngurta dhe shkatërrimi i botës bimore përgjatë brigjeve lumore ka ndikuar që ato regjione të jenë të ekspozuara rrezikut permanent nga vërshimet.

Zonat (lokacionet) me potencial rreziku nga vërshimet:

- Përroska e ujit nga fshati Makoc deri te Fusha e Pajtimnit,
- Përroska e ujit nga fshati Lugmir, Mati 1 dhe Lagja e Spitalit dhe një pjesë e lagjes Kalabria – kolektori pjesa e pa përfunduar,
- Lumi nga fshati Llukar në mes të kolektorit dhe kanalit të hapur deri te fusha e pajtimnit,
- Përroska te përroi i njelmët,
- Përroska në fshatin Hajavli nga Pallati i Drejtësisë kalon përgjatë rrugës së vjetër nga Ambulanca deri në rrugën magjistrale Prishtinë Gjilan,
- Përroska e ujit në fshatin Mramur nga lagja Spahiaj dhe Balaj deri në Suteskë,
- Përroska e ujit në fshatin Barilevë lagja Verbovci dhe Brestovci,
- Përroska e ujërave atmosferike dhe ato fekale (të ndotura) nga Pallati i Drejtësisë – lagja Byqmeti dhe nën rrugën magjistrale Prishtinë- Gjilan deri te lumi Graçanka.
- Lumi Llap i cili kalon në fshatrat në territorin e Komunës së Prishtinës.



Foto Vërshimet në Prishtinë

Në mënyrë që të mënjanoen dëmet nga Vërshimet në të ardhmen, Komuna duhet të:

- Planifikohet mbrojtja nga vërshimet përmes rregullimit të shtretërve të lumenjve dhe përroskave të tokave të cilat Kan bonitet të lartë, dhe masa të tjera për të mbrojtur dhe ngritur shkallën e bonitetit;
- Pastrimi, përmirësimi i shtratit të lumenjve dhe planifikimi i argjinaturave (brigjeve të ngritura artificialisht) do të minimizonte përmbytjet.
- Rregullimi i sistemit të drenazhimit për zonat të ndryshme duke mundësuar kullimin e këtyre zonave nga uji i grumbulluar nga reshjet atmosferike.
- Ndërtimi i sistemit të drenazhimit në zonën hapësirave të lira për rekreacion.
- Rritja e hapësirave gjobëruse, mbjellja e pemëve të ndryshme në zonat ku janë të rrezikuara nga vërshimet

• **PËRPARSIT**

• **DOBËSIT**

• Pjesa më e madhe e territorit të Komunës së Prishtinës është e mbuluar me pyje • • Konuna ka një plane për mbrojtjen nga zjarri • Ka paisje për matjen e zhurmës • Prishtina nuk ka qenë asnjëherë e goditur nga ndonjë termet apo ortek ose vërshime të përmasave shkatruese • Komuna e Prishtinës e ka një plan për menaxhimin e mbeturinave • Ekzistojnë dokumente bazike kombëtare: Dokumenti për Vlerësimin e Rreziqeve nga FNFT (në nivel vendi dhe lokal) dhe Plani i Reagimit Kombëtar	• Mungesa e rezervave të ujit në vendet ku janë të rrezikuara potencialisht nga zjarret • Siperfaqe të Shpyllzura • Humbja e tokës bujqësore nga erozioni • Shtretër të ngushtë të lumenjve që rrit mundësinë për erozion dhe vërshime • Rrugë të ngushta për intervenimin e zjarrfikësve • Rrjeti i vjetër i ujësjellsit që qon shpesh në vërshime sipërfaqësore në disa lagje të prishtinës • Mungesa e zbatimit të ligjeve në fuqi • Shfrytëzimi jo racional i hapësirës • Zgjerim i qytetit me ndertime, zënja e tokës bujqësore • Buxheti • Zjarrvënja nga faktori Antropogjen (njeri) • Përmbajtja si rezultat i mungesës së rrjetit të dreazhimit
• MUNDËSIT	• RREZIQET
• Organizimi i trajnimeve, mbi vetëdijësimin e popullatës për rrezikun dhe pasojat që mund të vijnë nga veprimtaria e erozionit, ortekut, rrëshqitjet e dheut zjarret etj. • Pyllëzimi i hapësirave ku janë të afektuara nga erozioni, rrëshqitjet e dheut • Ndërtimi i mureve mbrojtëse në rrugët që janë të rrezikuara nga rrëshqitjet e dheut, p.sh. te lagja Arëria • Komuna e Prishtinës duhet të Përkrah përdorimin e lëndëve djegëse me cilësore. • Të pajisen dhe mbështeten zjarrfikësit me pajisje adekuate për menaxhim të zjarreve • Sigurimi i brezave mbrojtës për lartpërquesit elektrik në fshatrat malore për zvoglimin e mundësisë së zjarreve • Shfrytëzimi i ujërave nëntoksorë për ujitjen e parqeve, rrugëve • Krijimi i akumulimeve artificiale- Lagunave me destinim mbrojtjen nga vërshimet dhe shfrytëzimi i ujit për ujitje dhe rekreacion • Përcaktimi i zonave të evakuimit në rast të tërmetit	• • Paraqitja e sëmundjeve të organeve respiratore • Degradimi i tokës; • Humbja e pa kthyeshme e biodiversitetit • Humbja e peisazheve

Swot Analiza për siperfaqet me rrezikshmëri

IDENTIFIKIMI I SFIDAVE

Gjatë analizës së gjendjes ekzistues në fushën e Mjedisit dhe sipërfaqeve me rrezikshmëri janë identifikuar disa sfida të cilat vijnë si rezultat i problemeve administrative, ekspertizës dhe mungesës së investimeve në lëmin e mbrojtjes së mjedisit.

Sfidat e identifikuar në gjitha komponentet mjedisore janë:

- Sigurimi i fondeve për projektet mjedisore
- Parandalimi i ndotjes së ajrit;
- Menagjimi i mbeturinave është ndër sfidat më të mëdha mjedisore në Komunën e Prishtinës
- Edukimi mjedisor
- Trajtimi i i zonave ku ka deponi të Mbeturinave
- Parandalimi i humbjes së tokës bujqësore nga ndertimet
- Trajtimi i ujrave të zeza
- Ruajtja e cilësisë së ujit dhe burimeve ujore
- Parandalimi nga degradimi i tokave dhe ndotja e tyre përmes masave dhe politikave specifike për mbrojtjen e tokave
- Parandalimi i ndotjes nga zhurma
- Parandalimii Erozionit
- Vetëdijesimi i faktorit njeri për ruajtjen pyjeve nga zjarret

GJETJET KYÇE

Gjatë analizës së gjendjes ekzistues në fushën e Mjedisit dhe sipërfaqeve me rrezikshmëri janë identifikuar gjetjet kyçe të cilat vijnë si rezultat i problemeve administrative, ekspertizës dhe mungesës së investimeve në lëmin e mbrojtjes së mjedisit

- Mungesa e një trupe koordinuese nga nivelet e ndryshme qendrore dhe lokale për marrjen e masave për zvoglimin e ndotjes së ajrit dhe komponenteve tjera në kohët e pikut dimëror dhe pikut veror.
- Mos perputhja e dokumenave zyrtare të Komunës me dokumente të nivelit qendrorë
- Ndotje e lartë e Ajrit, Ujit dhe Tokës

IDENTIFIKIMI I PROBLEMEVE

Gjatë analizës së gjendjes ekzistues në fushën e Mjedisit dhe sipërfaqeve me rrezikshmëri janë identifikuar Problemet të cilat vijnë si rezultat i problemeve administrative, ekspertizës dhe mungesës së investimeve në lëmin e mbrojtjes së mjedisit

Ndotja e Ajrit

- Përdorimi i vazhdueshëm i lendeve djegëse fosile dhe drusore në qytet nga banoret dhe bizneset.
- Ndotja enorme e ajrit, zhurma e lartë, prania e vleve elektromagnetike nga transmetuesit e ndryshëm, kujdesi jo i duhur ndaj gjelbërimit në qendër të qytetit dhe mungesa hapësirave të gjelbërta në zona banimi sidomos gjelbërimit të lart të pershtatshëm dhe stabil për zona të caktuara, janë indikator kyç që alarmojnë për veprime të ngutshme në financim dhe përmirësim të mjedisit në Qytetin e Prishtinës.
- Një trafik shumë i dendur, me numër të madh makinash, vende të pakta për parkim dhe cilësi jo e duhur e karburanteve, që drejtpërdrejt ndikojnë në ndotjen e ajrit dhe rrezikimin e shëndetit të popullatës.
- Ndotja e Ajrit nga sektori Energjetik
- Monitorimi i cilësisë së ajrit
- Në qytetin e Prishtinës, problem të veçantë paraqet prania e pluhurit, në formë të PM10 dhe PM2,5, vlerat e të cilëve parametra tejkalojnë Vlerat e Lejuara Maximale (VML), përdorimi VML e lejuar është 40µg/m³.
- Ndikimi i madh i trafikut në cilësi të ajrit;
- Monitorim i pamjaftueshëm i cilësisë së ajrit (benzeni, metalet e rënda, komponimet organike të avullueshme, radioaktiviteti, zhurma etj.);

Ndotja Ujit

- Qasja akoma e ultë në kanalizime,
- Menaxhim i dobët i mbeturinave
- Shkarkimi i ujërave të zeza në lumenjë
- Përdorimi i pesticideve të tepërta dhe pa kritere në afërsi të zonave ujore;
- Deponit e mbeturinave përgjatë shtratit të lumenjeve
- Monitorimi i pamjaftueshëm i cilësisë së ujërave të zeza (detergjentet, sapunët, vajrat, pesticidet, metalet e rënda, radioaktiviteti etj.);
- Kontrolli i dobët i lejeve ujore dhe pëlqimeve mjedisore

Ndotja e Tokës

- Humbja e Tokës Bujqësore me bonitet të Lartë nga ndërtimet
- Humbja e tokës nga erozioni
- Mos Mbulesa e gjithë hapësirës ku ka tokë bujqësore me kanale të ujitjes për ta rritur bonitetin e tokës,
- Përdorimi i pesticideve të tepërta dhe pa kritere

Ndotja nga zhurma

- Niveli i lartë i zhurmës si ditën, ashtu edhe natën
- Mungesa e dokumentave për parandalimin e ndotjes nga zhurma

Biodiverziteti

- Humbja e sipërfaqeve pyjore, habitateve kryesore të llojeve shtazore dhe bimore
- Rrezikimi i specieve të rralla nga zhdukja .
- Gjuetia e pa kontrolluar në zonat rurale.

Vërshimet

- Shtretër të ngushtë të lumenjëve
- Mbeturina në proska dhe lumenj

Erozioni dhe shkarjet e dheut

- Shpyllzimi i hapësirava
- Nxerrja e rëres dhe zhavorit
- Rrëshqitjet e dheut ne Lagjen Arbëria dhe në Fshatrat Llukur, Koliq, Keqekollë, Prapashticë, Nishec, Dabishec, Hajkobillë, Gllogovicë, Zllash, Kukavicë, Dragoc
- Ndërtimet pa kriter dhe ne mos perputhje me planet e Komunës

Tërmetet

- Mungesa e Analizave Mikro-sizmike për Komunën e Prishtinës
- Cilësi Jo e duhur e ndërtimeve

Rrkullisja e masave shkëmbore dhe ortekët e Dëborës

Pasi që Prishtina nuk ka lartësi të lartë mbidetare nuk është e rrezikuar ose me mir të themi që është pak e rrezikuar nga Rrkullisja e masave shkëmbore dhe ortekët e Dëborës. Dhe në Baz te të dhënave që i kemi analizu nuk ka pas bllokime të rrugëve, dëmtime në njerëz ose dëme materiale.

Erërat

- Mungesa e një plani për gjelbërim mbrojtës dhe plan për peisazhe natyrore brenda qytetit

Sipërfaqet me ndotëje të lartë (HOT-SPOTET)

- Mungesa e Lokacionit për mbeturinat e ngurta
- Mos reciklimi i mbeturinave

Sipërfaqet e Rrezikuara nga zjarri

- Rrugët e ngushta si ne zonën urbane po ashtu dhe ne zonën Rurale
- Zjarrvënja e qëllimshme

KONSTATIMET KRYESORE

Ndotja e Ajrit Konstatimet

- ☐ Ulja e numrit të automjeteve, përmes nxitjës së transportit publik kundrejt atij privat
- ☐ Menagjimi i rrjetit rrugor
- ☐ Përmirësimi i transportit public
- ☐ Promovimi i teknologjive të pastërta
- ☐ Nxitja e qiklizmit
- ☐ Rritja e siperfaqeve të gjelbra
 - ☐ Bizneset të cilat përdorin lëndë djegëse të kontrollohen dhe të obligohen të paisen me LMK (permiresimi i ventilimit dhe cilesisë së lëndës djegëse).
- ☐ Vendosja e brezave dhe shiritave të gjelbër me kapacitete për absorbim të aerosolëve, gazrave azotike, të sulfurit dhe karbonike, metaleve të rënda për gjatë rrugëve kryesore të Prishtinës
- ☐ Rivitalizimin e parqeve ekzistuese dhe ngritjen e parqeve të reja në hapësirat e identifikuara si të lira dhe të mundshme për ngritjen e këtyre parqeve
- ☐ Mbrojtja, zhvillimi i sidomos kultivimi i pyjeve të reja edhe me kapacitete për thithje të gazrave që e Ndotin Ajrin.
- ☐ Përcaktimin e kriterëve për sipërfaqet e gjelbra të detyrueshme në lejet e reja të ndërtimit, me prioritet në qytetin e Prishtinës dhe nën – qendrat.

- ☐ Përmirësimin e qarkullimit rrugor për shmangien e fluksit të madh të makinave nëpër qendra të vendbanimeve, ku është e përqendruar dhe pjesa më e madhe e popullsisë;
- ☐ Pengimi i shkarkimeve të ndotësve në ajër nga Industria dhe makinat lëvizëse me vendosjen e katalizatorëve dhe rregullimeve tjera në aspektin teknik dhe largimin e të vjetrave nga trafiku.
- ☐ Shfrytëzimin e energjive alternative (kryesisht energjia diellore, rrjedhat e ujit, e erës dhe energjia gjeotermale)
- ☐ Minimizimin e shfrytëzimit të automjeteve dhe shfrytëzimin e transportit publik.
- ☐ Promovimin e lëvizjeve jo të motorizuara duke planifikuar edhe stazat për çiklist dhe ecje në këmb siç shihet në hartë.
- ☐ Rikonstruktimi rrugëve (çarkoreve dhe bajpaseve në qendrën urbane, kanalizimeve dhe

mënjanimi i deponive të mbeturinave që janë burim i ndotjes së ajrit nga djegiet dhe oksidimet

e mbeturinave etj.

Ndotja e Ujit Konstatimet

□ Të gjitha burimet e ujërave natyrale, dhe ujërave tjerë nëntokësorë dhe sipërfaqësor të mbrohen, bashkë me caktimin e zonës së mbrojtjes së obligueshme rreth burimeve, kaptazheve, rrjedhave të lumenjve dhe akumulacioneve, me regjim të caktuar të mbrojtjes, varësisht nga destinimi i objektit. Në këto zona nuk mund të ndërtohen objekte e të zhvillohen punime tjera, as të shfrytëzohet toka në mënyrën e cila rrezikon sasinë dhe kualitetin e ujit.

□ Merren masat për mos lejimin e ndotjes së lumenjve, ujërave nëntokësore dhe sipërfaqësore nga ujërave të përdorura dhe ndyta prej vendbanimeve duke rekomanduar trajtim në dalje me gropa septike dhe forma tjera vendosja e aparateve për pastrim deri te impianti.

□ Në të ardhmen është e domosdoshme të merren masa afatshkurtra dhe afatgjatë që ujërat e përdorura, të ndyta (urbane, industriale) para se të lëshohen, të pastrohen në pikëpamje fizike biologjike dhe kimike. Për këtë qëllim, është e nevojshme:

□ Dokumentacioni investivo-teknik për industrinë e reja duhet të përmbajë edhe vendimin e pastrimit të të gjitha ujërave të përdorura, të ndyta. Puna e kapaciteteve të reja industriale nuk duhet të lejohet pa u montuar më parë aparatet të cilat do të sigurojnë pastrimin e ujërave të ndyta në mënyrën e duhur.

□ Nevojat e popullsisë për ujë do të rriten vazhdimisht. Në periudhën e ardhshme Sigurimi i sasisë së nevojshme të ujit të shëndosh të pijes për popullsinë e Prishtinës do të jetë edhe në të ardhmen probleme serioze. Disa zgjidhje për qendrën komunale dhe vendbanimet për rreth janë paraparë edhe në këtë dokument, për sigurimin e sasive të parapara të ujit dhe të sasive plotësuese rezervë është e domosdoshme mbrojtja e disa burimeve, rrjedhave të lumenjve dhe akumulacioneve. Pas kësaj shfrytëzimi racional i ujërave në këtë komunë është detyrë me rëndësi e të gjithë faktorëve të planifikimit dhe të shfrytëzimit të ujit dhe hapësirës.

□ Mbrojtje e veçantë e ujërave duhet ti kushtohet edhe nga përdorimi i pa kontrolluar i plehrave artificiale për bujqësi (nitratat, nitritet, fosfatet dhe nutrient tjerë.)

□ Mbrojtje tjetër parashikohet edhe nga mbeturina (të gjitha tipat e mbeturinave) duke planifikuar deponi që janë të organizuara dhe të cilat kanë marr parasysh këtë faktor deri te planifikimi i varrezave kolektive të kafshëve në raste emergjente.

Ndotja e Tokës Konstatimet

- Parashikohet mbrojtja në kuptimin e hapësirës së tokës dhe resurseve tokësore nga

tjetërsimi për qëllime jobujqësore me kufizim të shtrirjes së ndërtimeve vetëm brenda kufijve ndërtimor të planifikua

- Mbrojtjen e tokës bujqësore nga ndotja nëpër mes të kufizimit dhe parandalimit nga bartja direkte, bartja përmes ujit dhe ajrit e matërëieve të dëmshme dhe ndërmarrja e masave për ruajtje dhe përmirësim të plleshmërisë si dhe:

Planifikohet të ndalohet lëshuarja e lëndëve të dëmshme dhe të rrezikshme, të cilat e dëmtojnë dhe ndryshojnë aftësinë prodhuese të tokës bujqësore apo kualitetin e kulturave

bujqësore dhe përdorimi jo i drejt i plehrave minerale, organike dhe mjeteve për mbrojtjen e

bimëve.

- Planifikohet të bëhen në mënyra të vazhdueshme monitorimi dhe kontrolla e plleshmërisë së tokës bujqësore.
- Me këtë plan parashihet të bëhet edhe faza e dytë dhe e tretë e rregullimit të tokës

bujqësore (me masa komosative: rregullimin e territorit të tokës me qëllim të krijimit të ngastrave më të mëdha dhe më të rregullta tokësore në mënyrë që të mundësohet punimi

më ekonomik i tokës dhe të krijohen kushte më të volitshme për zhvillimin e vendbanimeve

të karakterit bujqësor, rregullimi i kufijve me qëllim të krijimit të ngastrave të reja në formë

të rregullt dhe për tu përfshi në sistemin e hidromeliorimit deri te shënimet kadastrave dhe

ridefinimi i drejtës së pronësisë në parcelat e reja duke shfrytëzuar mjetin legal komasacionin).

- Parashikohen ujitje e tokës bujqësore dhe masa tjera për të ngritur shkallën e bonitetit të

toka e cila ka bonitet më të ulët.

- Parashikohet mbrojtja nga vërshimet përmes rregullimit të shtretërve të lumenjve dhe

përroskave të toka e cila ka bonitet të lartë dhe masa tjera për të mbrojtur dhe ngritur shkallën e bonitetit.

- Parashikohet në zonat të cilat janë destinime(për pos banimit)tjera dhe ndërtime të

përkohshme të hartohen projekte rikultivimi të tokës bujqësore

- Parashikohet mbrojtja nga erozionet nga në shpërlarja e elementeve përbërëse të tokës,

me anë të pyllëzimit dhe melorimit të zonave të degraduara.

- Parashikohet mbrojtja nga degradimi natyror ose ndikimi i njeriut.
- Parashikohet mbrojtja e pjellorisë natyrore të tokës, përmes qarkullimit bimorë në tokat

bujqësore dhe kthimit të materieve organike (të mos digjen serrishtat ose mbetjet bimore)

- Parashikohet ri-zhvillimi i tokës në zonat e mbuluara nga deponitë.

Ndotja nga Zhurma Konstatimet

Andaj për zvoglimin e zhurmës në Komunën e Prishtinës Parashikohet.

- Planifikimi i nivelit të tolerueshëm të ndotjes dhe zhurmës sidomos në zonat me veprimtari të ndjeshme (afër shkollave, spitaleve etj)

- Të Hartohet Harta Strategjike e zhurmës dhe Plani i Veprimit për mbrojtje nga zhurma.

Biodiverziteti Konstatimet

1 Ruajtja e biodiversitetit është detyrim i yni moral që t'u lëmë pasardhësve një mjedis po aq të pasur, sa kemi trashëguar nga paraardhësit tanë.

2 Çdo qenie e gjallë ka të drejtë të jetojë, ashtu si dhe vetë njeriu; qeniet e gjalla që kanë jetuar dhe evoluar në mijëra milionë vjet mund të zhduken shumë shpejt, por nuk mund të krijohen përsëri.

3 Shumë lloje bimore kanë vlera të jashtëzakonshme shëndetësore, andaj zhdukja e tyre do të thotë zhdukje e kësaj vlere.

4 Proceset natyrore biologjike janë rregullatorët më të mirë të ruajtjes së mjedisit të pastër dhe të jetës në komunën e prishtinës.

5 Biodiversiteti dhe llojllojshmëria biologjike e natyrës, paraqet një potencial të lartë për zhvillimin e turizmit dhe rekreacionit të një vendi.

6 Zhvillimi ekonomik i një vendi mund të sigurohet përmes ruajtjes dhe përdorimit të qëndrueshëm të pasurive natyrore e biologjike.

7 Dhe mbi të gjitha, vetë jeta e njerëzimit në tokë është e varur nga biodiversiteti- shfrytëzimit të bimëve dhe kafshëve.

8 Parashihet pasurimi i florës dhe faunës në të gjithë territorin e komunës, duke specifikuar çka duhet të mbrohet dhe çka mund shfrytëzohet .

9 Parashikohet rivitalizimi i ekosistemeve pyjore për parandalimin e shkatërrimit të habitateve të shumë llojeve bimore dhe shtazore në territorin e komunës së Prishtinës .

Pra, duke e konsideruar të rëndësishme edhe ruajtjen e habitateve të

fluturave, shpezëve mishngrënës etj. Shih hartën e biodiversitetit.

Erozioni

- Reduktimi i shkallës së erozionit përmes pyllëzimit në zonat e identifikuar me erozion të lartë dhe ndërgjegjësimi i qytetarëve për mbrojtjen e pyjeve nga shpyllëzimet e mëtejshme dhe kontrolli i duhur i zhvillimeve të reja.

Rrëshqitja e Tokës

Ndërtimi i mureve mbrojtse në fshatrat (Llukar, Koliq, Keqekollë, Prapashticë, Nishec, Dabishec, Hajkobillë, Glllogovicë, Zllash, Kukavicë, Dragoc) që janë sado pak të rrezikuara nga kjo dukuri

Tërmetet

- Analizat Mikrozonike për qytetin e Prishtinës

Rrkullisja e masave shkëmbore dhe ortekët e Dëborës

- Pasi që Prishtina nuk ka lartësi të lartë mbidetare nuk është e rrezikuar ose me mir të themi që është pak e rrezikuar nga Rrkullisja e masave shkëmbore dhe ortekët e Dëborës. Dhe në Baz të dhënave që i kemi analizu nuk ka pas bllokime të rrugëve, dëmtime në njerëz ose dëme materiale.

Erërat

- Komuna duhet pasur në konsideratë në procedurat e dhënies së kushteve të ndërtimit për objektet të etazhitetit të lartë si dhe objekteve të infrastrukturës teknike, të transportit dhe objekteve energjetike.
- Hartimi i Planit për gjelbrim Mbrojtës

Sipërfaqet me ndotëje të lartë (HOT-SPOTET)

- Caktimi i lokacionit për mbeturina të ngurta
 - Reciklimin e mbeturinave
 - Trajtimi i mbeturinave duhet të bëhet me metoda që mundësojnë ripërdorimin e plotë ose të pjesshëm të mbeturinave
 - Gjithashtu duhet parë mundësinë e shfrytëzimit i vlerave të dobishme të mbeturinave (përfshirë kompostim, shfrytëzimin e mbeturinave si burim energjie etj).
- masat e zbatuara nga ndërmarrja, me qëllim të pakësimit të mbeturinave në processin punës, në veçanti pakësimin e mbeturinave të rrezikshme;
- Ndarjen e mbeturinave, në veçanti mbeturinave të rrezikshme dhe mbeturinave qëpërsëri mund të përdorën, me qëllim të pakësimit të mbeturinave të cilat duhet deponuar

Sipërfaqet e rrezikuara nga zjarri

- Zhgjerimi i Rrugëve në qytet dhe fshatrat ku janë të rrezikuara nga zjarri
- Nderimi i rezervareve të ujit ne zonat rrurale për zjarrfiksit
- Trajnimi i Faktorit njeri për rendësin e pyjeve

Përmbytjet

- Zhgjerimi i i shtretërve të Lumejve dhe përroskave
- Mirmbajtja e rrjetit të ujësjellsit dhe kanalizimit në qytet që shpesh në rast defekti vershojn rrugët e qytetit
- Ndërtimi I argjinaturave mbrojtëse.

Analiza SWOT

IV. ANALIZA SWOT

Më poshtë paraqiten problemet më të rëndësishme mjedisore, zonat mjedisore dhe faktorët avantazhues, përkeqësues, kërcënues dhe mundesi për permiresim.

4.1 Zonat me Probleme Mjedisore

Ky seksion bënë një përmbledhje të analizës së mësipërme të kushteve mjedisore në Komunën e Prishtinës dhe vë në dukje:

- Zonat që vuajnë nga një degradim i thellë mjedisor apo që po kalojnë një shok mjedisor;
- Zonat me ndjeshmëri të veçantë mjedisore, të cilave mund të pësojnë ndryshime të pakthyeshme të ekosistemeve, nëse nuk u ofrohet një mbrojtje më e mirë mjedisore; dhe
- Përmbledhje të natyrës dhe shkallës së ndikimeve të mundshme në mjedis, nisur nga përshkrimet e bëra në këtë kapitull.

Diskutim i grupeve të faktorëve në analizën SWOT.

Zonat që vuajnë nga degradim i thellë mjedisor

Të gjithë lumenjtë dhe proskat, vuajnë degradim dhe ndotje mjedisore të shkaktuar nga depozitimi i vazhdueshëm i mbetjeve të ujërave të ndotura dhe i lëndëve të ngurta sidomos lumenjtë dhe proskat të cilin ka shkakime të mëdha të ujërave të zeza nga kanalizimet që hidhen në të. Pastrimi i lumenjve të Prishtinës sidomos lumi Llap, Prishtevka dhe disa përroska që kalojnë në territorin e Prishtinës kërkon një menaxhim më të mirë të mbetjeve të ngurta, sidomos në vendbanimet e mëdha, si dhe sigurimin e kolektorëve të duhur gjatë rrugës.

Nëse nuk kontrollohet rritja e numrit të automjeteve dhe nuk ndërmerren masa për të përmirësuar rrugët, standardet e karburanteve dhe të shkarkimeve, atëherë rritja eparashikuar me katër herë më shumë mjeteve do të ketë pasoja në cilësinë e ajrit. Masat e ndërmarra nga Qeveria për reduktimin e makinave të vjetra nëpërmjet taksimeve dhe renia e ritmit të ndërtimeve kanë dhënë efekte pozitive në ndotjen e ajrit, por janë të pamjaftueshme për të siguruar cilësi të ajrit dhe nivel të zhurmave brenda standardeve.

Zonat që kanë Nevojë për Mbrojtje Mjedisore

Gjatë planifikimit të rrugëve dhe zonave të reja apo objekteve tjera në Planin Zhvillimor Komunal në radhë të parë duhet të ruhen zonat me vlera natyrore, objektet e mbrojtura të natyrës siç janë trungjet e vjetra dhe interesante për shkencën, gjeomumentet dhe objekte tjera të cilat janë me vlera të veçanta për shkencën dhe kulturën.

Mbrojtja e karakteristikave natyrore ose gjysmë natyrore, pyjet, lumenjtë, liqenet, parqet edhe në qytet përbëjnë elemente kyçe për sigurimin e rrjetit ekologjik.

Trendi i rënies së biodiversitetit është trend në gjithë botën. Fragmentarizimi dhe shpërndarja e vendbanimeve, ndotja e ajrit, mbi përdorimi i zonave natyrore dhe krijimi i peizazheve artificiale rrisin shkallën e erozionit, duke reduktuar mundësinë e specieve për shpërndarje, migracion dhe shkëmbim. Rrjetet ekologjike mund të ndikojnë pozitivisht në kushtet për mbijetesën e specieve në zonat e fragmentuara dhe peizazheve natyrore njerëzore të dominuara. Përveç kësaj, ato lejojnë një përdorim të përshtatshëm dhe të qëndrueshëm të burimeve natyrore përmes lidhjes së brendshme të elementeve të tyre fizike me peizazhin dhe strukturat ekzistuese sociale/institucionale.

Vendbanimi	Emri	Kategoria	Statusi ligjor	Sipërfaqja (ha)
Prishtinë	Parku Gërmia	Pejzash i mbrojtur	I mbrojtur	1949
Prishtinë, Gazimistan	Rezervat bimor i Bozhures (Paenonia decora Anders)	Rezervat i natyrës	I mbrojtur	12

Asetet e trashëgimisë natyrore

Ndërkohë që këto zona dhe objekte të natyrës duhet të jenë të mbrojtura në mënyrë institucionale dhe trajtim ose rishikim të statusit të tyre. Komuna dhe institucionet përgjegjëse për këto zona duhet të marrin në konsiderat sugjerimet e PZHK-së për zonat me vlera të larta natyrore.

Duhet marrë vendime në lidhje me përdorimin e ardhshëm të tokës në zonat e parapara për vikende si dhe zonat tjera të pazhvilluara rreth vendbanimeve konform kufijve të propozuar ndërtimor.

Mjedisi i ndërtuar është një fushë tjetër shqetësuese. Monumentet kryesore të rëndësisë së Kosovës në Prishtinë do të vazhdojnë të ruhen, por ndërkohë duhet të merren vendimet në lidhje me atë se sa nga trashëgimia e ndërtimit në Prishtinë, e krijuar në periudha të ndryshme gjatë shekujve, do të ruhet. Këto vendime duhet marrë sa me pare, pasi komuna po transformohet me shpejtësi dhe mbushja e zonave të ndërtimeve tradicionale me godina mund të demtojë ose shkatërrojë vlerat e këtyre zonave.

Ajo që është e rëndësishme është se pjesa më e madhe e degradimit mjedisor të komunës nuk është i pariparueshëm. Problemet mjedisore të identifikuara të menaxhimit të mbetjeve, të ngurta apo të lëngëta, si dhe ndotja e ajrit janë të trajtueshme nëse investimet kryhen në kohe dhe në mënyrë efektive. Me këtë planë janë trajtuar:

- furnizimin me ujë;
- menaxhimin e ujërave të zeza;
- trafikun; dhe është në proces manaxhimi i integruar i mbetjeve.

Ekzistojnë ndërkohë edhe legjislacioni dhe politikat përkatëse të cilat po zhvillohen me qëllim që t'u përgjigjen problemeve mjedisore. Potencialisht eksizton problem i ndotjes dhe i rënies së nivelit të ujërave nëntokësore për shkak të lumenjve të ndotur dhe të degraduar nga eksploatimi i rërës dhe zhavorit dhe pompimit të ujërave

nëntokësore. Efekti i kësaj ndotjeje dhe i zvogëlimit të ujërave nëntokësore mund të jetë i vështirë për t'u parashikuar dhe riparuar.

Nëse nuk ndalohen ndërtimet pa kriterë në zonat e rëndësishme mjedisore, në mënyrë të veçantë, zhvillimi i cili po ndodh në rrethinë të disa vendbanimeve si në tokat me bonitet të lart ashtu edhe në zonat kodrinore, ndikon në aspektin biologjik, prishjen e zingjirëve ushqimor, ndërprerjen e korridoreve të rëndësishme për komunikim të ekosistemeve mes veti, si dhe në aspektin peizazhistik dhe mund të sjellë rritje të rrjedhjeve, gjë e cila mund të përshpejtojë proceset natyrore të erozionit dhe të shkaktojë rrëshqitje të tokës ose përmbytje.

Projektet të cilat janë realizuar më herët sidomos ato të infrastrukturës rrugore nuk janë përcjellë me vlerësim të ndikimit në mjedis, kështu duke rezultuar në degradim mjedisor në prishje të ashtuquajtura korridore të qarkullimit të shtazëve, vendstrehimit të tyre dhe duke i larguar përgjithmon disa lloje nga ky territor.

Deri më tani nuk rezulton të ketë studime që të lidhin në mënyrë të drejtpërdrejtë me ndikimin e cilesise se mjedisit, studime ka në nivel të përgjithshëm kryesisht për cilesin e ajrit, ujit të pishem, zhurmat, por jo vetem, në shëndetin e banoreve.

Në raportet e nivelit qendror ofrohen në formë të përgjithësuar informata të sektorit shëndetësor në Kosovë, duke vënë në dukje çështje si siguria e ujit të pijshëm dhe siguria rrugore si shqetësime madhore, por në këto raporte nuk trajtohet në mënyrë specifike, ndërkohë që vë në pah edhe natyrën kontraktore të disa prej treguesve shëndetësorë. Kto raporte që kanë edhe dimensionin mjedisor mundë shfrytëzohen për të rekomanduar që Qeveria e Kosovës dhe ajo komunale duhet të kalojnë nga ndërhyrjet me karakter kurativ në mjedis dhe shëndetësi, në ato me karakter parandalues. Raporti tregon se stili i jetës.

Analiza AWOT

Përparsitë	Dobësitë
Kushte të përshtatshme fiziko-gjeografik, turizëm në zhvillim dhe burime natyrore kryesisht të mjaftueshme (Pejzashi i mbrojtur i Gërmis);	Mungesa e disa informatave për thellim të analizave për zhvillimet e planifikuara me PZHK;
Interesim në rritje i qytetarve, autoriteteve shtetërore dhe shoqërisë civile për mjedisin;	Shkallë e lartë e ndërtimeve;
Qendër administrative qendrore;	Shpopullimi i zonave malore dhe përqëndrim i konsiderueshëm në zonat e ulta afër zonës urbane të Prishtinës,
Janë trajtuar shumë probleme dhe sfidat mjedisore me PZHK;	burim i ndotjes, nxanjet e tokës dhe gjenratorë i zhurmës;
Legjislacion mjedisor dhe planifikimi hapsinor i zhvilluar dhe përmirësuar;	Rrugë me përmbajtje jotë plotë (trotuar, parkingje, etj)
Prani e teknologjive inovative në procese industriale dhe ndërtimore;	Shkallë e konsiderueshme nga ndotja e zhurmës dhe gazrave të djegieve të brendshme motorike;
Kushte të mira të transportit të mallrave dhe njerzëve	Motivim i ulët në segment të caktuar të administratës publike dhe
Rritja e efektshmërisë së zbatimit të	qeverisjes lokale;

Ligjeve dhe detyrimeve financiare të popullsisë dhe biznesit në raport me taksat komunale; Përfshirja e ekipeve të kualifikuara në zbatimin e planeve dhe hartimin e projekteve të rendësishme në kuadër të PZHK-së;	Zvogëlimi i hapësirave të gjelbërta dhe hapësirave të tjera publike; Ndërtimi i banimit kolektiv pa norma të duhura urbanistike dhe ndërtimore; Mungesa e koordinimit me komunat për rreth; Infrastrukturë teknike jo shume e zhvilluar (jo shumefunksionale); Manaxhim i dobët i mbeturinave; Mos trajtimi i hot spoteve mjedisore; Menaxhim jo i mirë i turizmit; Shkallë e ulët e të hyrave vetanake në buxhetin e Komunës; Mos trajtimi i vendeve ku është gjuajtur me uranium të varfëruar gjatë luftës së fundit në Kosovë.
Mundësitë Masat për mbrojtje të komponenteve kryesore mjedisore; Gadishmërie donatorve dhe Qeverisë për trajtim të pikave të nxehta mjedisore; Zhvillimi i kapaciteteve manaxhuese të politikave, planeve dhe programeve në nivel komunal; Krijimi i një Forumi Qytetar gjithë përfshirës për kualitet të jetës më të mire, si një njësi për oponencë dhe edukim mjedisor; Ndërtimi i impjantit për trajtim të ujërave të zeza sipas planifikimit të parapra me këtë PZHK dhe trajtimi i përkohëshëm në pikat e fundit të derdhjeve të ujit të përdorur. Ndërtimi i deponive të përkohëshme të mbeturinave; Përmirësimi i shërbimeve në Mungesa e koherencës midis aksioneve të shoqërisë civile dhe pushtetit vendor, donacioneve dhe departamenteve universitare/studiove profesionale transportin publik; Përfshirja e biznesit privat në hapsirat pyjore, të gjelbra dhe rekreative (parqe, salla lojrash, sipërfaqe për lojra fëmijësh).	Kërcënimet Dëmtim i balancit ekologjik; Humbje e resurseve toksore, ujore dhe resurseve tjera; Degradim i ekosistemeve, biodiversitetit, florës dhe faunës; Rrezikim i shëndetit të popullatës; Shkatërrim i trashëgimisë kulturore dhe natyrore; Konflikte në lidhje me çështjet e pronësisë; Pakësimi i hapsirave publike për shkak të presionit ndërtues; Mungesa dhe/ose kosto e lartë për disponimin e sipërfaqeve të lira për projekte zhvillimore; Ulje e ndjeshme e biodiversitetit; etj. Humbje e llojeve organike nga ekosistemet në rajonin e Prishtinës, të cilat rreziqe vinë si rezultat i aktivitetit të pa kontrolluar njerzorë, sido,mos I gjuetisë.

PLANI ZHVILLIMOR KOMUNAL

V. PËRMBLEDHJE E PËRMBAJTJES SË PLANIT ZHVILLIMOR KOMUNAL

5.0. VIZIONI DHE SKENARET E ZHVILLIMIT

5.1. Vizioni i Komunës së Gjakovës

Komuna e Gjakovës me pozicion qendror në rrafshin e Dukagjinit, një e transportit dhe komunikacionit, me qëndrueshmëri ekonomike dhe sociale, infrastrukturë bashkëkohore, shërbime profesionale, inovative dhe inteligjente, mjedis të pastër dhe të gjelbërt për brezat e sotëm dhe atyre pasardhës. Komunë me një kualitet të lartë të jetës për të gjitha strukturat e banimit, mjedis atraktiv për rini, kulturë e sport dhe vlera të mbrojtura të trashëgimisë kulturore dhe natyrore.



QËLLIMET DHE OBJEKTIVAT E PZHK-së SIPAS FUSHAVE TEMATIKE

Zhvillim Ekonomik

Q1: Rritja, zhvillimi dhe diversifikimi i sektorit të bujqësisë dhe agro industrisë në komunën e Gjakovës;

- O1: Rritja e aftësisë konkurruese në sektorin agro-ushqimor dhe arritja e standardëve të BE-së deri në vitin 2028;
- O2: Nxitja e konkurrueshmërisë dhe qëndrueshmërisë të zingjirit agro-ushqimor;
- O3: Investime në infrastrukturën publike në të mirën e zhvillimit të zonave rurale, në aspektin ekonomik dhe social;
- O4: Diversifikimi i fermave dhe zhvillimi i bizneseve bujqësore si dhe hapja e vendeve të reja të punës në zonat rurale;
- O5: Zhvillim i qëndrueshëm i sektorit të shpeztaris;

Q2: Fuqizimi i zhvillimit industrial dhe TI shërbimeve;

- O1: Ngritja e kapaciteteve prodhuese dhe përpunuese të drurit deri në vitin 2025;
- O2: Ngritja e kapaciteteve prodhuese dhe përpunuese të metaleve deri në vitin 2025;
- O3: Nxitja e NVM të fushës TI shërbimeve deri në vitin 2024;
- O4: Mbështetja e bizneseve përmes subvencioneve komunale të fushave përpunuese të drurit, metalit dhe Shërbimeve TI;

Q3: Funkcionalizimi dhe plotësimi me infrastrukturës te zonave për zhvillim ekonomik;

O1: Zhvillimi dhe funksionimi i zonave ekonomike industriale dhe komerciale, deri në vitin 2026;

O2: Themelimi i Parkut industrial (si zonë e lirë - varësisht nga specifikat e sektorit ekonomik) deri në vitin 2025;

Q4: Zhvillimi i qëndrueshëm i turizmit;

O1: Zhvillimi i zonës turistike “ Maja Kunores” dhe “Shpella e Qirave dhe Kusarit”, deri në vitin 2027;

O2: Zhvillimi i turizmit rekreativ, deri 2025;

Q5: Fuqizimi i tregtisë;

O1: Zhvillimi i HUB-it rajonal (aeroport, hekurudha, zona e lire);

O2: Mbështetja e industrisë se ndërtimit;

O3: Nxitja e zhvillimi të sektorit të prodhimit të BRE-së të përshtatshme për sektorin privat dhe publik deri në vitin 2023 (studimi i potencialit për teknologji te ndryshme BRE ne K. e Gjakovës);

Q6: Fuqizimi i Partneritetit Publiko Privat (PPP)/Iniciativa Private të Financimit (IPF) dhe Investime direkte;

O1: Përdorimi i modelit PPP/IPF për shërbimet publike me experience dhe financim nga sektori privat sipas nevojave K. Gjakovës (Studimi i fizibilitetit);

Infrastruktura teknike

Q1: Furnizimi me ujë të sigurt të shëndetshëm dhe konstant të qytetarëve për një mirëqenie më të mirë;

O1: Furnizim i vazhdueshëm me ujë duke aplikuar standarde për cilësi dhe siguri të ujit, në vazhdimësi;

O2: Zvogëlimi dhe monitorimi i humbjeve të ujit të pijshëm në 36% deri në vitin 2028;

O3: Ofrimi i shërbimeve me ujë në shkallen 100% deri vitin 2022;

Q2: Zhvillimi dhe menaxhimi i qëndrueshëm i infrastrukturës së ujërave të zeza;

O1: Parandalimi i ndotjes së ujërave sipërfaqësore dhe nëntokësore nga ujërat e zeza deri në vitin 2028;

O2: Përmirësimi i vazhdueshëm i infrastrukturës ekzistuese të kanalizimit deri 2028;

O3: Mbulushmëria me rrjet të kanalizimit deri në 90% të vendbanimeve deri në vitin 2035;

O4: Zgjerimi dhe ri-vitalizimi i rrjetit të kanalizimit atmosferik dhe ndarja nga ujërat fekale;

Q3: Zgjerimi i kapaciteteve të sistemit të ujit për toka bujqësore dhe përmirësimi i rrjetit ekzistues të ujitjes;

O1: Rehabilitimi i rrjetit ekzistues të ujitjes dhe pajisjeve përcjellëse deri 2022;

O2: Zgjerimi i rrjetit të ujitjes së tokave bujqësore për 4800 ha deri 2025;

Q4: Furnizimi i qëndrueshëm dhe përballueshëm i qytetareve me energji elektrike;

O1: Sigurimi i furnizimit me energji të pandërprerë për të gjitha kategoritë e konsumatorëve dhe sigurimin e cilësisë në furnizimin me energji elektrike, deri 2028;

O2: Prodhim i energjisë së ripërtrishme elektrike dhe mbrojtje të mjedisit deri në vitin 2028;

O3: Shfrytëzimi maksimal i kapaciteteve ekzistuese të sistemit të ngrohjes qendrore që mbulon 40% të qytetit (energjisë termike) me sistem të biomases 2021;

Q5: Ofrime i shërbimeve të qëndrueshme dhe cilësore me furnizim me ngrohje të konsumatorëve nga ngrohja e qytetit;

O1: Shfrytëzimi maksimal i kapaciteteve ekzistuese të sistemit të ngrohjes qendrore që mbulon 40% të qytetit (energjisë termike) me sistem të biomases 2021

O2: Zgjerimi i rrjetit ekzistues të ngrohjes me qëllim të ofrimit të shërbimeve me gjithëpërfshirës deri 2028;

O3: Prodhimi i energjisë ripërtrishme (solare) për shfrytëzim të energjisë për ngrohje 2028;

Q6: Infrastrukturë e telekomunikimit modern me shërbim efektive, integruara të besueshme dhe në kohë për të gjithë qytetarët e komunës;

O1: Zhvillimi dhe avancimi i metodologjive moderne të nevojshme për infrastrukturë të telekomunikimit, në vazhdimësi 2028;

O2: Dizajnimi dhe centralizimi i infrastrukturës së telekomunikimit sipas praktikave efikase 2028;

O3: Ofrimi i shërbimeve efikase dhe qëndrueshme për të gjithë qytetarët në përmbushjen e kapaciteteve, deri 2028;

Q7: Menaxhimi i qëndrueshëm dhe i integruar i grumbullimit dhe trajtimit të mbeturinave duke përfshirë infrastrukturën përkatëse;

O1: Zgjerimi i aktiviteteve për rritjen e mbulueshmeris në grumbullimin e mbeturinave në teritorin komunal 2024;

O2: Aplikimi i teknologjive të reja në menaxhimin dhe grumbullimin e mbeturinave 2024;

O3: Avancimi i procesit të riciklimit të mbeturinave (impiant i riciklimit);

O4: Trajtimi i mbeturinave inerte/shtazore dhe atyre intelegjente sipas standardeve efikase të trajtimit;

Infrastruktura transportit dhe transportit

Q1: Zhvillimi i infrastrukturës rrugore;

O1: Devijimi i trafikut tranzit nga pjesa qendrore e qytetit përmes rrugëve unazore;

O2: Përmirësimi i kapacitetit dhe nivelit të shërbimit për rrugët ekzistuese deri në vitin 2023;

Q2: Kycja e Gjakovës në rrjetin e infrastrukturës hekurudhore;

O1: Lidhja e Gjakovës me rrjetin hekurudhor të Kosovës;

O2: Lidhja e Gjakovës me Shqipërinë dhe në zgjerimin për portet shqiptare;

Q3: Zhvillimi i transportit publik;

O1: Fuqizimi i rrjetit të ri të transportit publik në nivel komunal dhe regional deri në 2023;

O2: Fuqizimi dhe rivitalizimi i transportit publik urban deri në vitin 2024;

O3: Intermodaliteti ndërmjet transportit rrugor, hekurudhor dhe ajror;

Q4: Përmirësimi i mobilitetit urban;

O1: Zhvillimi i rrjetit për këmbësorë dhe çiklistë deri në vitin 2028;

O2: Zhvillimi i politikës për parkim në Gjakovë në mbështetje të transportit të qëndrueshëm;

Q5: Zhvillimi i aeroportit për shërbime ekonomike, civile dhe shërbime tjera;

O1: Krijimi i kushteve dhe kriterëve teknike për plotësimin e standardeve ndërkombëtare të aviacionit;

Q6: Zhvillimi i një sistemi të mobilitetit të mençur (Smart mobility);

O1: Menaxhimi i trafikut të automjeteve dhe këmbësorëve në mënyrë efektive;

Infrastruktura publike dhe sociale

Q1: Shërbime qasshme shëndetësore si dhe cilësore dhe te përgjigjen nevojave te komunitetit;

O1: Përmirësimi dhe kompletimi i infrastrukturës së Kujdesit Parësor Shëndetësor deri në vitin 2028;

Q2: Sigurimi i arsimit cilësor gjithëpërfshirës, të barabartë dhe tërëditor në të gjitha institucionet e arsimit parauniversitar;

O1: Krijimi i institucioneve parashkollore në lagje urbane me rreze të mbulueshmërisë 500m në zonë urbane në vitin 2028;

O2: Krijimi i institucioneve të Arsimit Themelor-Bazik në lagje urbane me rreze të mbulueshmërisë 600m dhe 1,900m në zonë rurale deri në vitin 2028;

O3: Krijimi i institucioneve të Arsimit të Mesëm të Lartë me rreze të mbulueshmërisë 1,500m në lagje urbane dhe 4,700m në zonë rurale deri në vitin 2028;

O4: Kompletimi i të gjitha institucioneve të arsimit parauniversitar me hapësira rekreative deri në vitin 2028;

Q3: Ofrimi i shërbimeve të efektshme dhe gjithëpërfshirëse institucionale;

O1: Ngritja e efikasitetit të shërbimeve administrative për 25% deri në vitin 2028;

Q4: Ofrimi i shërbimeve përkrahëse për shtresat në nevojë;

O1: Ngritja e ofrimit të shërbimeve sociale për 50% deri në vitin 2028;

Q5: Zhvillimi i aktiviteteve kulturore për të gjithë banorët dhe të gjitha moshat;

O1: Ngritja e aktiviteteve kulturore për 25% deri në vitin 2028;

Q6: Zhvillimi i aktiviteteve sportive dhe rekreative për të gjithë banorët dhe të gjitha moshat;

O1: Krijimi i fushat sportive dhe rekreative në lagje urbane me rreze të mbulueshmërisë 800m në zonë urbane dhe nënqendrat rurale deri në vitin 2028;

Q7: Sigurimi i sipërfaqes së mjaftueshme për varreza publike;

O1: Rritja e sipërfaqeve të varrezave publik për 40% deri në vitin 2028;

Mjedisi dhe sipërfaqet me rrezikshmëri

Q1: Programet remediate në hapësirat publike dhe private (Në hapësirat publike shkollat institucionet dhe tokat bujqësore);

O1: Menaxhimi i integruar i sistemit të mbeturinave 2023;

O2: Përmirësim i cilësisë së ajrit;

O3: Trajtimi i qenve endacak deri ne vitin 2022;

Q2: Mbështetja e zhvillimit të qëndrueshëm dhe integritetit mjedisor për Gjakovën;

O1: Parandalimi i ndotjes së ajrit në vazhdimësi deri në vitin 2028;

O2: Mbrojtja dhe shfrytëzimi i qëndrueshëm i resurseve ujore 2024;

O3: Parandalimi i ndotjes së tokës 2023;

O4: Përcaktimi dhe monitorimi i zonave të zhurmës në zonat e banimit dhe zonat rekreative turistike deri në vitin 2022;

O5: Mbrojtja e biodiversitetit dhe llojeve organike me rendësi në vazhdimësi deri në 2028;

Q3: Mbrojtja dhe menaxhimi i situatave që mund të ndodhin nga Fatkeqësitë Natyrore;

O1: Parandalimi i rreziqeve nga fatkeqësitë natyrore dhe fatkeqësive tjera 2028;

Asetet e trashëgimisë natyrore, kulturore dhe turistike

Q1: Përcaktimi i masave mbrojtëse për asetet e trashëgimisë natyrore;

O1: Përcaktimi i kufijve të perimetrit dhe zonës mbrojtëse për asetet e trashëgimisë natyrore nga MKRS në bashkëpunim me Komunën deri në vitin 2022;

Q2: Ruajtja dhe konservimi aktiv apo rigjenerimi i aseteve të trashëgimisë kulturore dhe natyrore si pasuri e çmuar territoriale dhe vlerë e përgjithshme kombëtare për identitetin dhe zhvillimin e qëndrueshëm të vendit

O1: Ruajtja, rigjenerimi/konservimi aktiv i hapësirave të trashëgmisë kulturore dhe natyrore në funksion zhvillimi shoqëror, kulturor dhe ekonomik;

O2: Sistemi i menaxhimit dhe finacimi për përkujdesje dhe rigjenerim të trashëgmisë kulturore, natyrore të ndërlidhur me turizëm, sport dhe rekreacion;

O3: Sistemi i dokumentimit, informimi dhe promovimi i ruajtjes së trashëgmisë kulturore dhe natyrore;

Vendbanimet, Zona Urbane

Q1: Planifikim për një zhvillim kompakt dhe të qëndrueshëm dhe fuqizim të zhvillimit të qendrës urbane të Gjakovës;

- O1: Planifikimi për një zhvillim kompakt duke adoptuar konceptin e mbushjes urbane në vendbanime dhe qytet, gjate vitit 2021;
- O2: Fuqizimi i zonës urbane qendrore bazuar në intensifikimin e dendësive për të mbështetur zhvillimin ekzistues dhe ato të së ardhmes, gjate vitit 2021;
- O3: Ridestnimi dhe rihvillimi i hapësirave/ ndërtesave vakante dhe jashtë përdorimit (ngrohtorja) ne kuadër te qendrës urbane dhe qendrave rurale, deri ne vitin 2028;
- O4: Intensifikimi i zhvillimeve përgjatë korridoreve ekzistues (Nene Tereza, dhe Krena) dhe fuqizimi i korridorëve të rinj zhvillimor (Tirana), deri ne vitin 2028;

Q2: Sigurimi i zhvillimit të kompakt dhe të baraspeshuar në vendbanimet për kualitet të jetesës në komunën e Gjakovës;

- O1: Fuqizimi i vendbanimeve (Rogove, Demjan, Ponoshec, Korenice, Skivjan, Crmjan, Novoselle e Eperme dhe Doblibare) me potencial të zhvillimit në qendra rurale te shërbimeve publike dhe zhvillimit social, në vazhdimësi;
- O2: Sigurimi i hapësirave të reja në fshatra (fshatrat në rritje) bazuar në principet e menaxhimit të qëndrueshëm, deri në vitin 2021;
- O3: Fuqizimi i fshatrave me potencial turistik (Koshare, Kusar, Zylfaj, Gerqine), në vazhdimësi;
- O4: Planifikim për zhvillim të ekuilibruar ndërmjet qendrave rurale, deri në vitin 2021;
- O5: Adoptimi i mbushjes urbane dhe densifikimit në fshatra (fshatra të pasur me tokë bujqësore dhe pasuri tjetër natyrore) të Gjakovës për një zhvillim kompakt, deri në vitin 2021;
- O6: Sigurimi i rrjetit të transportit, ndërmjet qytetit dhe qendrave sekondare, në vazhdimësi;

Vendbanimet joformale dhe ndërtimet pa leje

Q1: Trajtimi i vendbanimit joformal ekzistues në lagjen Brekoc dhe parandalimi i paraqitjes së vendbanimeve joformale tjera;

- O1: Trajtimi i çështjes pronësore në këtë vendbanim joformal, deri në vitin 2022;

Q2: Trajtimi i ndërtimeve pa leje;

- O1: Zhvillimi i fushatës informuese dhe vetëdijësuese për regjistrim dhe trajtim te ndërtimeve pa leje, deri ne vitin 2021;
- O2: Trajtimi i të gjitha ndërtimeve pa leje konform legjislacionit ne fuqi.

Banimi

Q1: Sigurimi i banimit të qëndrueshëm dhe cilësor për të plotësuar nevojat e tanishme dhe të ardhme;

- O1: Rritja e fondit banimor në zonën urbane deri në vitin 2028;
- O2: Minimizimi i konfliktit të mundshëm midis shfrytëzimeve të tokës për banim dhe shfrytëzimeve tjera, deri në vitin 2028;

O3: Rritja e densitetit të përgjithshëm të banesave në zonat ekzistuese urbane për të zvogëluar kërkesë për mirëmbajtje shtesë të infrastrukturës, deri në vitin 2028;

O4: Aplikimi i masave për efikasitet të energjisë për përmirësimin e performancës energjetike të ndërtesave deri më 2028+

Q2: Sigurimi i banimit të përbalueshëm dhe gjithëpërfshirës;

O1: Zgjidhja e problemit të strehimit për së paku 113 familje të identifikuar si raste të pastreha, deri në vitin 2023;

O2: Zgjidhja e problemit të strehimit për së paku 100 familje të kategorive të dala nga lufta e UÇK-së: Familjet e Dëshmorëve, Invalidëve dhe Veteranëve të Luftës së UÇK-së të cilët jetojnë në kushte tejet të vështira dhe të pa përshtatshme banimi, deri në vitin 2023;

Shfrytëzimi i tokës

Q1: Shfrytëzimi i tokës për projekte të interesit Nacional;

O1: Sigurimi i sipërfaqeve për interesa të projekteve nacionale;

Q2: Shfrytëzimi efikas i tokës për një zhvillim të qëndrueshëm socio-ekonomik dhe mjedisor;

O1: Ruajtja e harmonisë mes shfrytëzimit të tokës për banim dhe shfrytëzimeve të përziera, industrisë, rekreimit dhe infrastrukturës publike dhe sociale deri në vitin 2028;

O2: Zhvillimi i qëndrueshëm i shfrytëzimit të tokës deri në vitin 2028;

Q3: Gjakova komunë me vendbanime kompakte;

O1: Kompaktësimi i vendbanimeve dhe mbajtja nën kontroll të rritjes së vendbanimeve lineare deri në vitin 2028;

O2: Mbajtja nën kontroll të zhvillimeve të ndërtimit në vendbanimet e shpërndara deri në vitin 2028;

Q4: Zhvillimi i banimit të qëndrueshëm në komunën e Gjakovës;

O1: Promovimi i arkitekturës së gjelbër në sipërfaqet e destinuar për banim;

O3: Ndërtesa të banimit efikase në shfrytëzim të energjisë së ripërtitshme;

Q5: Qasja e integruar në zhvillimit të sipërfaqeve të infrastrukturës publike dhe sociale;

O1: Alokimi dhe zhvillimi i sipërfaqeve të planifikuara për infrastrukturë publike dhe sociale;

Q6: Qasje e integruar në mbrojtje të mjedisit dhe të sipërfaqeve me rrezikshmëri;

O1: Mbrojtje e vazhdueshme e mjedisit dhe rehabilitimi i sipërfaqeve të ndotura deri në vitin 2028 dhe në vazhdimësi;

Q7: Qasja e integruar në mbrojtje të sipërfaqeve të trashëgimisë kulturore në kuadër të shfrytëzimit të tokës drejt zhvillimit të qëndrueshëm;

O1: Promovimi i trashëgimisë kulturore si dhe aftësimi, ngritja e vetëdijes në mbrojtjen e trashëgimisë kulturore në funksion të shfrytëzimit të tokës dhe zhvillimit të turizmit;

O2: Ruajtja e zonave ekzistuese të mbrojtura deri në vitin 2028;

- O3: Promovimi i zonave të mbrojtura arkeologjike dhe historike dhe aftësimi, ngritja e vetëdijes në mbrojtjen e zonave të mbrojtura arkeologjike dhe historike, në funksion të shfrytëzimit të tokës;

Q8: Qasja e integruar në mbrojtje të sipërfaqeve për trashëgimi natyrore drejt zhvillimit të qëndrueshëm;

- O1: Mbrojtja e peizazheve të llojllojshme natyrore në komunën e Gjakovës deri në vitin 2028;
- O2: Menaxhimi dhe ruajtja e sipërfaqeve të trashëgimisë natyrore deri në vitin 2028 dhe në vazhdimësi;
- O3: Konservimi i resurseve natyrore dhe përmirësimi i komoditetit vizual në funksion të zhvillimit të turizmit deri në vitin 2028;
- O4: Promovimi dhe ngritja e vetëdijes në mbrojtjen e trashëgimisë natyrore në funksion të zhvillimit të turizmit në vitin 2028;

Q9: Qasje e integruar dhe e qëndrueshme e sipërfaqeve të tokës bujqësore;

- O1: Identifikimi, mbrojtja dhe zhvillimi i tokës bujqësore deri në vitin 2028;
- O2: Ruajtja dhe zhvillimi i Tokës bujqësore ekzistuese deri në vitin 2028;
- O3: Ruajtja dhe zhvillimi i Tokës bujqësore ekzistuese deri në vitin 2028;

Q10: Qasje e integruar dhe mbrojtja e sipërfaqeve të tokës pyjore;

- O1: Ruajtja dhe menaxhimi efikas i sipërfaqeve ekzistuese të tokës pyjore deri në vitin 2028 dhe në vazhdimësi;
- O2: Ripyllëzimi i sipërfaqeve të reja dhe rehabilitimi i atyre të dëmtuara të tokës pyjore deri në vitin 2028;
- O3: Promovimi dhe zhvillimi i pyjeve halore dhe gjetherënëse, sipërfaqet pyjore të komunës së Gjakovës;
- O4: Promovimi dhe zhvillimi i kultivimit të drunjëve industrial në sipërfaqet pyjore të komunës së Gjakovës;

Q11: Zhvillim i sipërfaqeve të reja për zona komerciale dhe krijimi i kushteve për hapësira të qëndrueshme komerciale;

- O1: Zhvillimi i sipërfaqeve për korridore ekonomike zhvillimore përgjatë rrugës Rajonale R107 dhe rrugës "Tirana" deri në vitin 2028;
- O2: Funksionalizimi dhe mirëmbajtja e zonave ekzistuese ekonomike e komerciale deri në vitin 2028;
- O3: Funksionalizimi i zonës ekonomike amerikane;

Q12: Turizëm i qëndrueshëm në funksion të zhvillimit ekonomik;

- O1: Ndërlidhja e zhvillimit të turizmit në mes të komunës së Gjakovës dhe Malësisë së Gjakovës;

O2: Zhvillim i qëndrueshëm i turizmit rural në zonat me potenciale për zhvillime të tilla, deri në vitin 2028;

Q13: Krijimi i hapësirave për zgjerim dhe fuqizim të infrastrukturës së rrugore;

O1: Krijimi i sipërfaqeve për rrugë të planifikuara në shërbim të një infrastrukture rrugore dhe hekurudhore të qëndrueshme, deri në vitin 2025;

O2: Alokimi i korridoreve për rrugë bujqësore dhe pyjore;



O3: Ndërlidhja e plotë e infrastrukturës tokësore me aeroportin e Gjakovës;



Q14: Shfrytëzimi i sipërfaqes për qëllime ushtarake;



O1: Ruajtje dhe menaxhimi i sipërfaqes për poligon ushtarak në vendbanimet Ponoshec, Shishmon i Bokës, Çerret, Babaj Bokës dhe Devë deri në vitin 2028 dhe në vazhdimësi;

5.2. KONCEPTI I ZHVILLIMIT HAPËSINOR


SKEMA KRAHASUESE E SKENARËVE TË PROPOZUAR

NYJET 	<i>Përcaktimi i disa Nyeve dhe trajtimi i tyre si pika hapësinore të oërqendruara ku promovohet densifikimi i banimit, intensifikimi i funksioneve dhe aktiviteteve</i>	Për NYJET si pjesë të kërkesave nga udhëzimi administrativ ky skenar bazohet në zhvillimin e disa nyeve që i konsideron të rëndësishme. Ky skenar propozon zhvillimin e qendrës urbane të Gjakovës si nyje kryesore. Nyet e tjera të rëndësishme Rogovë, Damjan, Ponoshec, Skivjan, Novosellë e Epërme, Cermjan, Doblibare dhe Korenicë zhvillohen si nën-qendra, ndërsa nyejt tjera ekzistues do trajtohen mjaftueshëm brenda kufijve aktual.
KORRIDORET 	<i>Trajtimi i disa lidhjeve/korridoreve ndërmjet nyeve, përgjatë të cilave natyrshëm mund të nxitet dhe inkurajohet një intensitet i rritur i zhvillimit</i>	KORRIDORET, në kuadër këtijë skenari trajtojnë vijat më të rëndësishme të zhvillimit dhe transportit e telekomunikacionit. Përfshijnë linjat e transportit që bëjnë ndërlidhjen e vendbanimeve në mes veti por edhe janë nyje kryesore për gjithë regjionin e Dukagjinit. Korridor i rëndësishëm i këtijë skenari është korridori hekurudhor që lidhë Gjakovën me portin e Durrësit, ndërsa linja kah veriu parasheh lidhjen e Gjakovës me aeroportin. Sa i përket korridoreve të zhvillimit ekonomik, ky skenar propozon fuqizimin e korridorit që kalon kah rruga Tirana, që lidhë segmentin Prizeren-Pejë. Korridoret zhvillimore ekzistuese monitorohen dhe rehabilitohen, kurse zhvillimi përreth korridoreve të reja planifikohet me kujdes.

PLOTËSIM DHE DENDËSIM 	<i>Paraqet mundësi dhe potencial të mbushjes dhe densifikimit të pakësirave me zhvillime të caktuara, për të arritur zhvillim hapësinor kompakt dhe për të rritur pragun e popullsisë</i>	Në lidhje me PLOTËSIMIN DHE DENDËSIMIN, Skenari 2 ofron plotësim dhe dendësim në zonën urbane, duke u zgjeruar lah linjda e qytetit. Sipas nevojave plotësim dhe dendësim planifikohet edhe në vendbanime tjera, mirëpo gjithmonë të monitoruara dhe duke ruajtur zonat bujqësore.
MBAJTJA NËN KONTROLL 	<i>Koncepti i Mbajtjes nën Kontroll i referohet nevojës për të kufizuar zhvillimin joefikas me dendësi të ulët, përmes përdorimit të kufirit për zhvillim urban për një periudhë të përkufizuar kohore</i>	Në lidhje me MBAJTJEN NËN KONTROLLË, synohet mbajtja nën kontrollë e të gjithë kufijve të ri ndërtimor qoftë të zonës urbane, qoftë të vendbanimeve rurale, e sidomos në zonat rurale ku jetojnë një përqindje më e vogël e banorëve, duke mos lejuar shtrirje të reja, dhe intensitet të ndërtimeve jashtë zonave të definuara për ndërtim.

MBROJTJA 	Koncepti i mbrojtjes i referohet nevojës për mbrojtjen e resurseve të vlefshme natyrore, kulturore, ekonomike dhe të trashëgimisë	Në lidhje me MBROJTJEN, mbrohet toka bujqësore, dhe gjithashtu synohet mbrojtja e pasurive të tjera qoftë nëntokësore, qoftë sipërfaqësore, për tu shfrytëzuar ose marrë masat e duhura sipas planit në funksion të qëndrueshmërisë afatgjate.
ZONAT E RRITJES 	Koncepti me Zona të Rritjes paraqet zhvillim të zonave ekzistuese me intensitet më të lartë dhe zhvillim të tokës së zbrazët të përshtatshme për plotësim, në mënyrë që të sigurohet shfrytëzimi i tokës	Në lidhje me ZONAT E RRITJES, ofrohet ri-zhvillimi i zonave ekzistuese në intensitet më të lartë. Zonat e rritjes përcaktohen duke u bazur në resurse dhe potencial për zhvillim, me mundësi drejt tokës së zbrazët të përshtatshme për plotësim për të siguruar shfrytëzim efektiv të tokës.

Koncepti i Zhvillimit Hapësinor përcakton bazën kryesore të zhvillimit dhe shfrytëzimit të tokës të paraqitur në hartat tematike të PZHK-së, kushteve dhe masave të HZK-së. Si përmbajtje dhe elemente të trajtuara gjatë analizës së skenarëve dhe të përvetësuar në konceptin kryesor janë nyejt; korridoret; plotësimi dhe dendësimi; mbajtja nën kontroll; mbrojtja; zonat e rritjes të cilat përpos aspektit hapësinor gjatë strukturimit të skenarëve është trajtuar implikimi financiar i zbatimit të secilit element.



Skenari 3 përzgjidhet të përpunohet tutje pasi vlerësohet si skenari më i mirë dhe më i mundshëm të realizohet, i cili do siguronte një ekuilibër hapësiror, zhvillim ekonomik, social, qasje në transport dhe mobilitet, rregullim dhe integrim të korridoreve zhvillimore ekzistuese dhe funksionalizimin e tyre.

Në mënyrë që ky koncept të zhvillohet në mënyrë të qëndrueshme, komuna duhet patjetër të përcaktojë kufirin e zonës urbane dhe kufijtë e vendbanimeve.

Harta. Koncepti kryesor për zhvillim të ardhshëm hapësinor të komunës së Giakovës

5.5. Disa nga aspekte kryesore të gjendjes aktuale mjedisore

Të dhënat më poshtë i referohen gjëndjes mjedisore të tanishme në komunën e Gjakovës. Qëllimi kryesor i diskutimit të të dhënave bazë është të identifikojë gjëndjen mjedisore në ballafaqim me vizionin, prioritetet dhe efektet e dëshiruara të zhvillimit dhe implementimit të Planit Zhvillimor Komunal të Komunës së

Gjakovës. Impaktet potenciale të zhvillimit të PZHK-së mund të vlerësohen nga ndryshueshmëria e kushteve mjedisore me ose pa implementimin e Planit nëpërmjet indikatorëve të gjendur/të supozuar sasiorë ose cilësorë. Esencialisht, gjëndja mjedisore e komunën e Gjakovës karakterizohet nga përshkrimi i receptorve mjedisore, siç kërkohet nga Direktiva e VSM, të përshkruara më poshtë:

- Popullsia dhe Shëndeti publik;
- Fitodiversiteti dhe Zoodiversiteti;
- Zonat e mbrojtura të natyrorës;
- Cilësia e ajrit
- Bezdisjet- zhurma kundërmimi pamjet e pa këndshme;
- Faktorët klimatikë, ndryshimet klimatike;
- Uji në përgjithësi;
- Toka bujqësore dhe peisazhi;
- Asete materiale/Infrastruktura fizike (transporti dhe administrimi mbetjeve);
- Trashëgimia kulturore (duke përfshirë trashëgiminë arkitekturale dhe arkeologjike);
- Trashëgimia natyrore (Zonat dhe monumentet e mbrojtura natyrore).

Popullsia dhe shëndeti publik

Ndikimet në shëndetin e publik për VSM, janë ato të cilat lindin si pasojë e bashkëveprimit me receptorët mjedisorë (komponente mjedisore të tilla si ajëri, uji apo tokë nëpërmjet të cilëve ndotësit bëhen potencial nëpërmjet transportit në ujë dhe kontaktit më njerëzit. Kapaciteti mjedisor i komunës do të thotë, para së gjithash, ruajtja në nivele të pranueshme e parametrave kryesore mjedisore. Dëndësia e popullsisë në disa vendbanime, zhvillimi pa plan i tyre, ulja e hapsirave publike rekreative dhe sidomos të gjelbërta sjell pa dyshim uljen e cilësisë së jetës, përkeqesimin e parametrave mjedisorë të pranuar si standarde, shpenzime të larta të shoqërisë për rregullimet e mëtejshme për njësi sipërfaqeje dhe shpenzime me të larta për mbrojtjen e shëndetit.

Ne komunën e Gjakovës, shërbimi shëndetësor parësor ofrohet nëpërmjet QKMF dhe QMF, kurse sekondar përmes Spitalit në Gjakovë.

Ndikimet mjedisore të lidhura me popullsinë dhe shëndetin

Më poshtë, janë identifikuar disa ndikime që janë të lidhura për shëndetin në tërësi:

- Ndertimi/rehabilitimi i kanalizimeve dhe trajtimi i ujrave të zeza si dhe manaxhimi i mbetjeve.
- Rehabilitimi i zonave me ndotje të lart dhe atyre që janë potencial për ndotje të komponenteve mjedisore;
- Ruajtja e burimeve të ujit të pishëm nga ndotja;
- Konsiderimi i kërkesës së rritur të infrastrukturës intensive në vendbanimet me densitet të lartë;
- Promovimi i mobilitetit, ecjesë dhe çiklizmit;

- Rikonsiderimi i trafikut publik për uljen e emetimit të gazeve dhe zhurmave;
- Cilësia e ndërtesave, densiteti dhe zonimi duhet të mbështeten në mënyrë adekuate nga shërbime dhe facilitetet të tjera komunale në disa vendbanime të komunës;
- Raportet ndërtimore me sipërfaqet e gjelbërta duhet të parashikojnë densitetin e popullsisë;
- Sipërfaqet aktuale të gjelbërta dhe parqet duhet të zhvillohen dhe mirëmbahen;
- Rritja e koordinimit me autoritetet paralele planifikuese për të vlerësuar impaktet mjedisore në shëndetin e njeriut;

Veçori natyrore kryesore të komunës dhe zonat që ndikohen

Te pjesa e gjendjes ekzistuese të komunës janë paraqitur mjaft të dhëna për veçrit natyrore dhe karakteristikat tjera natyrore.

Me zgjerimin e disa vendbanimeve janë të njohura edhe disa përzierje veprimtarish komerciale, të industrisë së lehtë e rezidenciale. Zhvillime dhe ndërtimet edhe në disa zona sensitivitet mjedisor, gjeomorfologjik dhe gjeologjik. Zhvillimet dhe ndërtimet në këto zona janë potencialisht të kërcënuara. Një pjesë e mirë e habitateve janë po ashtu të kërcënuara për pasojë të ndryshimit të sipërfaqeve të gjelbërta.

Ky ndryshim në përdorimin e tokës ilustron në disa nga shifrat që mund të jenë në dispozicion edhe se të pakta, ku tregohet shfrytëzimi i tokës në vitet e më hershme dhe tani. Shumfishimi i disa zonave ndërtimi ka ndodhur në kurriz të toke bujqësore, të zhdukjes disa pyjeve me pemë me gjethe, dhe ka shkaktuar zvogëlimin e një tërsie pejsazhesh e gjelbrimi.

Zonimi i territorit të komunës

Duke u bazuar në tipologjinë e vendbanimeve, popullsitë, infrastrukturën shoqëruuese arkitekturat, gjeomorfologjitë dhe sidomos çështjet mjedisore që mund të paraqesin komunën e Gjakovës me PZHK janë trajtuar si më poshtë:

Zonat e ndërtimit në vendbanime:

Zonat e pazhvilluara me ndërtim

PZHK-ja i ka identifikuar dhe trajtuar duke i destinuar si tokë bujqësore, tokë pyjore zona të mbrojtura natyrore dhe zona tjera të mbrojtura, zona për infrastrukturë hidrografike dhe infrastrukturë tjetër.

Zonat turistike

PZHK ka identifikuar zonat turistike për të gjithë llojet e turizmit të mundshëm në komunën e Gjakovës dhe janë të prezantuar në hartën e turizmit.

Zona të mbrojtura

PZHK-ja ka evidentuar gjithashtu zonën ku përfshihen zonat karakteristike me vlera të trashëgimis kulturore - historike, peisazhike, mjedisore e turistike të

Komunës. Në këto zona nuk mund të jepen leje ndërtimi për objekte e struktura, të cilat cënojnë identitetin e zonës. Objektet ekzistuese të zonës mund të restaurohen vetëm në kushte të cilat i japin institucionet kompetente, duke mos cënuar identitetin e tyre.

Zona Industriale dhe zonat për zhvillime industriale

Zona industrial planifikohet të jetë lokale, dhe do zhvillohen kryesisht ku tashmë është krijuar një bërthamë e një zone industriale në qytet ose aty ku vërtet ekzistojnë kushte të favorshme të zhvillimit të tyre dhe që nuk bie në konflikt me interesa tjera socio-ekonomike dhe mjedisore dhe zhvillimet industriale që janë identifikuar dhe trajtuar me PZHK dhe duhet propozuar masat mjedisore. Në hart nuk është e paraqitur kufiri i zonës industriale.

Pyllzimi, zhvillimi i pyjeve, zonat e gjelbërta dhe të pushimit

Komunën e Gjakovës sikurse në gjitha komunat tjera të Kosovës gjatë zhvillimit të tyre nuk i kanë favorizuar pyjet dhe zhvillimin e tyre, sidomos pyjet e zonave të ulta (Shpërdhit me qarr). Shumë nga zonat e gjelbërta, zonat rekreative natyrore, në shumicën e rasteve vëihen para shkatërrimit total të tyre, si pasojë prerjeve ilegale, djegjeve, zhvillimeve tjera dhe neglizhencës. Hapësira pyjore dhe zonat e shkurreve dhe kullosat janë planifikuar në PZHK. Deri tani shumë pak është bërë për zonat lokale rekreative apo hapësirat ku mund të organizohen pushime vikendi apo diçka të ngjashme.

Esenciale çka PZHK-ja duhet ofruar është sigurimi i korridoreve të gjelbërta që do të zhvillohen të bashkëshoqëruara me ndërtimin e rrugëve të reja dhe atyre ekzistuese, korsive për këmbësorët dhe bicikletat dhe tampon zonave të zhvillimit industriale dhe tjera të ndjeshme, si dhe rritjen e fondit të gjelbërt në komunë.

Çështje mjedisore që lidhen me mjedisin fizik

- PZHK duhet të tregoj çart në hart vendet ku kemi erozion dhe çfarë shkalle të erozionit nëse kemi erozion shumë të fort ose të fort atëherë të merren rreptsisht masa për parandalimin e tyre, poashtu duhet të tregoj për zonat e vërshimeve dhe masat të cilat duhet të merren kundër vërshimeve.
- Zhvillimi i zonës industriale duhet të bëhet në territorin e përcaktuar, i pa përzier me hapësirat e banimit duke e precizuar çart në hart (pjesa grafike);
- zhvillimet industriale duhet të zhvillohen sipas standardeve mjedisore të përcaktuara vetëm pas rivlerësimeve mjedisore;
- Zhvillimi i Pyjeve, hapësirave të gjelbërta, shiritave gjelbrues dhe tampon zonave duhet të konsiderohet në çdo plan e sidomos në Planin Rregullues të Hollësishme dhe projekte duke vlerësuar raportet e ndërtimit.

Biodiversiteti, Flora dhe Fauna

Në kuadër të shumëllojshmërisë së botës së gjallë-biodiversitetit, vend me rëndësi padyshim se ka edhe mbulesa bimëore apo thënë ndryshe flora dhe vegjetacioni. Sikur edhe në hapësira

tjera në kuadër të territorit të Republikës së Kosovës, bazuar në pozitën specifike gjeografike, duke konsideruar rolin e faktorëve orografikë, gjeologjikë, pedologjik e klimatik, territori i komunës së Gjakovës është vend i përshtatshëm për rritjen dhe zhvillimin e llojeve (specieve) dhe bashkësive (fitocenoza) të ndryshme bimore. Sipas ndryshimeve bazuar në lartësinë mbidetare, në shtrirje vertikale të florës dhe vegjetacionit të territorit tjetër komunës së Gjakovës dallojmë disa zona. Këto zona janë të ndryshme varësisht nga pozita gjeografike, përbërja gjeologjike, relievi, madhësia e masivit të caktuar etj. Flora dhe vegjetacioni i zonave të ulëta mbidetare Territori i komunës së Gjakovës ka hapësirë të konsiderueshme e cila i takon zonave me lartësi të ulët mbidetare. Këto hapësira janë të shtrira përgjatë rrjedhave të lumenjëve Drini i Bardhë, Ereniku (me të cilin bashkohen Lumbardhi i Deçanit, Trava, Llukavci dhe së bashku afër Bishtazhinit derdhen në Lumin Drini i Bardhë). Këto hapësira gjenden përgjatë rrjedhës së Lumit Drini i Bardhë, në relacionin: KralanRakovinë-Meqë-Doblibare-Berdosanë-Marmull-Bishtazhin-Rogovë. Pastaj, hapësira tjera gjenden përgjatë rrjedhave të lumenjëve dhe përrojeve e rrjedhave tjera ujore në relacionet: Zhdredhë - Bec - Vraniq - Doblibarë; Bitesh - Lugbunar - Qerim; Hereç - Plançor - Skivjan - Osek; Dobrosh - Nec - Smolicë - Duzhnje; Batushë - Mulliq - Brovinë - Ponoshec - Popoc - Shishman - Babaj Bokës dhe Brekoc - Bishtazhin. Në këto terrene në fragmente të shkëputura e shpesh të vogla si rezultat i veprimit antropogjen rriten lloje bimore të ultësirave të cilat hyjnë në kuadër të vegjetacionit të pyjeve respektivisht shkurreve me shelg e plep por edhe me verr e marinë (brukë) të cilat zhvillohen më tepër përgjatë luginave lumenjëve, ndërsa në aspektin sintaksonomik i takojnë klasëve Quercofagetea e Alnetea glutinosae, rendeve Alnetalia glutinosae dhe Populetalia albae si dhe alencave Alnion glutinosae, Salicion albae dhe Populion albae. Llojet më të shpeshta bimore të këtyre hapësirave në katin e drurëve janë prezente llojet Salix alba (dominon), Populus nigra, Ulmus effusa, Alnus glutinosa, Salix fragilis. Në katin e shkurreve janë prezente llojet bimore Salix purpurea, Frangula alnus, Cornus sanguinea, Tamarix tetrandra ndërsa në katin e bimëve barishtore gjenden llojet bimore Galium palustre, Alisma plantago aquatica, Veronica anagallis, Mentha aquatica, Agrostis alba, etj. Gjatë hulumtimit të realizuar në terren (EK / 07-17.09.2018) është konstatuar prezenca e llojit Quercus robur (Rrënjë, "Dushku rrënjë"). Prandaj, është e mundur që në të kaluarën këto terrene ishin të mbuluara nga vegjetacioni i dominuar nga fitocenoza Periploco-Quercetum PLVB të komunës së Gjakovës 2019-2024 33 roburis (bashkësia bimore e shkurreve Shtalpër me Dushkun rrënjë) e cila tani nuk gjendet e zhvilluar si fitocenoza.

Tipet e Habitave natyrore në Gjakovë

Disa nga habitatet në komunën e Gjakovës janë të klasifikuara si të mbrojtura në nivel qendror dhe lokal (disa zona të identifikuar me PZHK). Ato klasifikohen si më poshtë:

- Pyjet dhe korie (zabele)
- zonat e mbrojtura natyrorë;
- Ligatinat;
- Lumenjt;
- Kullosat dhe livadhet;
- Zona e lumenjve.

Çështje mjedisore të lidhura me biodiversitetin, florën e faunën

Ekzistojnë disa çështjesa të përket manaxhimit të biodiversitetit të komunës së Gjakovës. Çështjet në vijim janë identifikuar për zhvillim të mëtejshëm:

- Ndotja dhe degradimi i Ekosistemeve ujore, lumi është i degraduar në disa pjesë nga mbetjet që hudojnë nga qytetarët, dhe humbja e habitateve për specie të rëndësishme. Gjendja e tanishme nuk siguron dot nivele të pranueshme të habitateve natyrore;
- Shkatërrimi dhe prerja e pa kontrolluar e pyjeve si ekosisteme më të rëndësishme për bimët dhe kafshët. Kjo pastaj vjen deri te rritja e vëllimeve të ujit sipërfaqësor si pasojë edhe e ndërtimeve dhe deponimit të mbetjeve të ngurta në zonat e vendbanimeve. Kjo mund të rritë përmbajtjet duke shkaktuar vërshime dhe erozionin, kështu duke humbur direkte habitatet;
- Masa për të ruajtur biodiversitetin dhe balancin ekologjik në natyrë duhet marrë në konsideratë, në fazat e herëshme, në plane të reja zhvillimi;
- Harmonizimi i planeve rregulloreve dhe masave duhet koordinuar me njësi të tjera të qeverisë qendrore me qëllim sigurimin e korridoreve ekologjike të kalimit të shtazëve nga një ekosistem në tjetrin..

Përdorimi i Tokës dhe Peisazhi

Planifikimi i përdorimit të tokës dhe çështje të sigurimit të shërbimeve

Për të vlerësuar tokën si burim natyror i pa rinovueshëm dhe rolin që ka në hapsira banimi fillimisht po japin definicionin dhe funksionet bazë të saj. Toka përcaktohet si pjesa e sipërme e kores tokësore, veçanërisht komplekse, që luan rol të rëndësishëm në mjedis në zhvillimin social dhe ekonomik të cilat janë vitale për jetën. Direktiva kuadër e tokës (BE) identifikon shtatë funksione bazë të saj të cilat janë:

- Prodhimi i biomasës, përfshirë bujqësinë dhe pylltarinë;
- Mbajtjen, filtrimin dhe transformimin e ushqyesve, substancave dhe ujit;
- Mbajtëse e biodiversitetit;
- Mjedis fizik dhe kulturor për njerëzit dhe aktivitetet humane;
- Burim materiale;
- Si depozitë karboni;
- Vënd për trashëgiminë gjeologjike dhe arkeologjike.

Zhvillimet në komunën e Gjakovës sidomos ndërtimet e pa planifikuara nuk kanë bërë një përdorim efikas dhe të qëndrueshëm të tokës. Shumë nga zhvillimet e paplanifikuara nëpër vendbanime, mund të thuhet se i kanë përkeqësuar problemet e infrastrukturës dhe kanë çuar në degradim mjedisor. Shumë nga kanalizimet e furnizimit me ujë dhe të ujërave të ndotura tashmë gjenden në tokë me pronsi

private, për të cilat të drejtat e kalimit dhe përdorimit nuk janë plotësisht të përcaktuara, duke e kufizuar kështu mundësinë e hyrjes për mirëmbajtje.

Poashtu, pa ndonjë plan, apo edhe vlerësim të resurseve, janë aprovuar shumë projekte të reja. Nuk është e qartë se a është bërë vlerësimi i furnizimit të mjaftueshëm me ujë dhe energji i këtyre zhvillimeve të reja.

Infrastrukturën dhe shërbimet për vendbanimet, duhet ti siguroj Komuna. E kombinuar me një kërkesë për infrastrukturë dhe mobilizim të resurseve financiare, kushtet mjedisore në komunë vazhdojnë të jenë një problem.

Toka ndërtimore në territorin e komunës merr një rëndësi të posaçme; për efekt të mungesës së fondeve dhe planifikimeve, për gjatë 15 vjetëve të fundit në Kosovë, toka pronë publike është zvogëluar dhe prona private po dominon. Ritmet e çmimit të sipërfaqeve të konsideruara si truall kanë qënë të larta. Statuti privat dhe çmimi vështirëson sot komunën e Gjakovës të gjëjë hapsira për vepra publike. Kjo do të vazhdojë edhe më tutje duke kufizuar shpesh implementimin e PZHK-së në vepra publike (rrugë, lulishte, parqe, etj).

Çështje mjedisore që lidhen me përdorimin e tokës

- Përdorimi i tokës për ndërtim është në rritje dhe raporti ndërtim/sipërfaqe e gjelbërt është i disfavorshem duke krahasuar me normat europiane për etnitete me specifika të njejta në komunën e Gjakovës kemi shtrirje disperse të vendbanimeve;
- Planifikimi i zonave ndërtimore nuk duhet të prekë sipërfaqe të gjelbërta veç në raste të jashtëzakonshme dhe duke i rikompensuar ato;

Duke pasur parasysh keto specifika, në kapitullin më poshtë paraqiten masa të pershatshme për shtimin e sipërfaqeve të gjelbra. Për më tepër, paraqiten kriteret mjedisore që kufizojnë zhvillimin e ndërtimeve, që përfshijnë kriteret e forta mjedisore-shëndetsore, kriteret e trashëgimisë kulturore, kriteret peisazhike dhe ato inxhinierike dhe të infrastrukturës.

Rreziqet natyrore në mjedisin fizik

Me rritjen e ndërtimit dhe degradimit të pyjeve, rreziku i përmytjeve do të rritet shumë.

Kjo gjë përshkruhet më poshtë në seksionin mbi Menaxhimin e Mbeturinave të lëngshme dhe Ujërave të Shiut.

Adaptimi dhe Zvogëlimi i Rrezikut të Katastrofave, përmirësimi i informacionit dhe reagimi për zbutjen e efekteve të çdo katastrofe natyrore duhet parë me prioritet edhe atë në funksion të:

- Menaxhimit të Rrezikut të katastrofës;
- Forcimit të shërbimeve hidrometeorologjike;
- Caktimit të kodeve të ndërtimit për aktivitetin sizmik;
- Sigurimin e individëve dhe bizneseve nga katastrofat natyrore.

Mjedisi i ndërtuar dhe kultura

Cilësia e ajrit

Industria e pa zhvilluar ka ndikuar pozitivisht në cilësinë e ajrit, ndërkoh që zhvillime tjera pas luftës në Kosovë si komunikacioni, djegia e pa kontrolluar e mbeturinave, djegiet e biomasës, produkteve bujqësore lirimi i disa gazrave si freoneve, dhe gazrave azotike të cilat po përdoren kohëve të fundit në vend të karburanteve këto ndikojnë drejtpërsëdrejti në cilësinë e ajrit në hapësira të ngushta siç janë fshatrat që ndodhen në lugina ku lëvizjet e masave të ajrit janë të vogla. Zhvillimet ekonomike dhe sociale pas luftës veçanërisht rritja e numrit të automjeteve kur dihet se pjesa më e madhe e tyre janë të stërvjetruara të viteve të 80-ta, poashtu edhe veprimtarive ndërtuese kanë shkaktuar një ndotje të ajrit në Komunë. Në mënyrë të përbledhur po rendisim disa subfaktorë të cilat kanë ndikim në cilësinë e ajrit:

- Komunikacioni rrugor;
- Rritja e lartë dhe përdorimi i shpeshtë i makinave private;
- Shumica e këtyre automjeteve janë më shumë se 15 vjeçare dhe nuk janë në përputhje me Euro I apo II;
- Edhe pse të vjetër gjendja teknike e tyre jo e mirë, duke liruaz gazra dyfish më shumë se normal;
- Gati të gjitha mobjektet përdorin ngrohje individuale me dru dhe forma tjera të djegies;
- Një pjesë e madhe e tyre punojnë me naftë dhe me plin;
- Nga të gjitha rrugët që kalojnë nëpër territor të komunës së Gjakovës , shumica janë të asfaltuar;
- Djegiet e mbeturinave në deponi të egra;
- Djegiet e pyjeve dhe mbetjeve të biomasës.

Një tjetër problem që lidhet me cilësinë e ajrit është edhe cilesia e karburanteve që përdorin automjetet. Shumë gjeneratorë me naftë që përdoren për të kompensuar ndërprerjet e energjisë janë gjithashtu kontribues në këtë cilësi të dobët të ajrit, mbasi punojnë me naftë të cilësisë së dobët. Megjithatë lidhur me këta të fundit, ndikimi i tyre në cilësinë e ajrit të komunës është minimal.

Rrezatimi jonizues dhe jojonizues

Në komunën e Gjakovës janë të identifikuar vende ku është goditur me uranium të varfëruar në luftën e fundit.

Zhurma dhe Kundërmimi

Problem mjedisor në vete më të cilin po ballafaqohet gjithnjë e më shumë Komuna e Gjakovës është zhurma duke e pas parasysh se këtu gjenden koncentrim i vendbanimeve dhe dendësi e madhe e banimit. Komuna e Gjakovës ka një rrjet të dendur rrugor që cilësohet si burim i zhurmës. Me PZHK, janë trajtuar disa nga masat mjedisore për amortizimin e zhurmës. Për gjat rrugëve nacionale, dhe rrugëve

rajonale duhet të parashihihen masa mjedisore kundër zhurmës, siç janë barrierat fizike nga dheu, zona të gjelberta me pyllëzim dhe pahi të plastifikuara në vendet ku janë më të ndjeshme (si shkolla dhe hapësira tjera publike dhe banuese), por për shkak të implikimeve finaciare disa nga këto masa mund të mos zbatohen ose mund të mos implementohen në lokacione të caktuara. Komuna e Gjakovës këtu duhet të jetë vigjilente dhe të jetë e kyqur në kontrollin e ndërtimit të rrugëve.

Përpos këtyre akteve kemi edhe disa pika të ndotjes nëpër vendbanime. Megjithatë zhurma është në të gjitha rastet përtej vlerave limit që percakton Udhezimin “Per nivelet kufi të zhurmave në mjedise të caktuara” dhe limitet e përgjithshme për nivelin e zhurmave të OBSH. Një tjetër dukuri për tu vënë në dukje është niveli konstatnt i zhurmës gjat 24 orëve në zona banimi ku limiti i nivelit të zhurmës në orët e natës nuk duhet të kalojë 40 dBA, ndaj vlerave mbi 60 dBA. Sa i përket kundërmimit si aspekt tjetër i bezdisjes në komunën e Gjakovës vendet në të cilat kemi kundërmim janë deponit ilegale sidomos ato afër lumenjve për shkak të lagështisë të cilat sjellin në vazhdimësi bezdisje për qytetarët që jetojnë në ato zona. Vend shkarkimet e kanalizimeve të fshatrave dhe vendshkarkimet individuale të kanalizimit të ujërave të zeza janë poashtu burim i kundërmimit, bezdisjes dhe sëmundjeve për qytetarët dhe kalimtarët. Komuna duhet të eliminojë me prioritet deponit ilegale rreth lumenjve dhe të ndërtoj impiante për pastrim të ujërave të zeza në gjitha vendet ku kemi shkarkime.

Burimet ujore dhe furnizimi me ujë

Gjakovës deri diku i plotëson nevojat për ujë të pishëm pasi që ka burime të mjaftueshme ujore për t’iu përgjigjur kërkesave aktuale dhe në ardhmen. Aktualisht në gjithë komunën mungon furnizimi me ujë të pijes edhe për kundër faktit se ka burime të mjaftueshme ujore. Komuna furnizohet nga disa burime uji. Një pjesë e sistemit të furnizimit me ujë është i vjetër dhe punon nën kapacitetin e projektuar, ndërkohë që ka dhe shumë humbje në rrjet, nuk disponohet informacion i plotë i lidhjeve ilegale për përdorim shtëpiak dhe ujitje. Ka të dhëna që në disa puse të cekët, uji nëntokësor është i ndotur. Gjithësesi shifra e humbjeve mendohet të jete e lartë.

Monitorimi i cilësisë së ujit në lumenjtë kryhet nga disa institucione IKMN, MMPH, AKMM dhe institucione tjera. Cilesia e ujit të pishem, përfshirë aspektin bakterologjik monitorohet nga Ministria e Shëndetësisë, përmes Drejtorive të Shëndetësisë.

Ndërmarrja regionale e Ujësjellësit është gjithashtu përgjegjëse edhe për furnizimin me ujë tëfshatrave të Gjakovës. Në këto fshatra vetëm një pjesë e banoreve kanë kontratë me ndërmarrjen kurse disa të tjerë shfrytëzojnë burime individuale.

Çështje mjedisore që lidhen me ujin e pijshëm

- Në disa raste kur uji kontaminohet kryesisht nga ndotjet që pëson në linjat e transmetimit (ndotja nga ujrat e zeza, për shkak të intersektimeve të shumta të tubacioneve të ujit të pishem me ato të ujrave të zeza);
- Tubacionet me materiale kancerogjene azbest cimento;
- Keqpërdorimi i ujit të pijes është i madh duke ulur sasinë e nevojshme për popullsinë;
- Ujërat nëntokësore, sidomos ato deri në 20 m thellësi janë të rrezikuara nga ndotja sipërfqësore për shkak të përshkueshmerisë së lartë të shtresave mbrojtëse.

Në komunën e Gjakovës ekzistojnë disa zona të ndjeshme të ujrave nëntokësore të cilat duhet mbrojtur në mënyrë rigoroze.

PARIME, OBJEKTIVA E KRITERE MJEDISORE

VI. PARIME, OBJEKTIVA DHE KRITERE MJEDISORE

6.1. Objektivat e VSM-së

Duke u bazuar në qëllimin e VSM-së, që përkon edhe me qëllimin e mbrojtjes mjedisore të vetë PZHK-së së Gjakovës, janë përcaktuar objektivat mjedisore të VSM-së. Edhe objektivat mjedisore qëndrojnë po njëjloj për Planet e niveleve tjera. Për më tepër, këto objektiva janë ndërtuar në përputhje me politikat e strategjitë mjedisore kombëtare, me Planin Hapësinor të Kosovës, si dhe me qëndrimet e sektorëve përkatës (që preken nga objektivat). Për çdo objektiv janë listuar ndikimet e mundshme të Planit në mjedis, nëse objektivi nuk realizohet, pra nëse nuk merren masat zbutëse, eliminuese apo parandaluese të dëmit mjedisor.

Sipas rëndësisë së tyre, objektivat mund të ndahen në objektiva primare apo globale dhe në objektiva lokale të nivelit komunal. Objektivat kryesore të shqyrtimit të gjerë që lidhen me këtë plan mund të jetë i definuar si:

Objektivi Mjedisor 1 (OM1) - Ajri: Reduktimi i emetimeve të gazrave serë (p.sh., duke promovuar çiklizmin dhe përmbushja e standardeve të Bashkimit Evropian;

Objektivi Mjedisor 2 (OM2) - Uji: Përmirësimi, ruajtja e cilësisë së ujit, zbutja, kufizimi dhe parandalimi i efekteve negative të aktivitetit njerëzor në territorin, përmirësimi ruajtja e aftësisë për të deponuar ujin, minimizimi i përdorimit të panevojshëm të ujit.

Objektivi Mjedisor 3 (OM3) - Toka: Mbrojtja dhe përdorimi e manaxhimi i qëndrueshëm i tokës, parandalimi i erozionit të tokës, ruajtja e kapacitetit prodhues të tokës (kullosave)

Objektivi Mjedisor 4 (OM4) - Biodiversiteti: Mbrojtja dhe manaxhimi i qëndrueshëm i biodiversitetit, ruajtja e specieve organike dhe habitateve në funksion të ruajtjes së ekosistemeve, veçanërisht specieve endemike dhe endemorelikte të rralla dhe të kërcënuara;

Objektivi Mjedisor 5 (OM5) - Pyjet: Manaxhimi i qëndrueshëm i pyjeve në funksion të garantimit të aftësisë vetëripërtëritëse të ekosistemit pyjor, zbutjes së efekteve të ndryshimeve klimatike;

Objektivi Mjedisor 6 (OM6) - Peizazhi dhe Ekosistemet: Rivitalizimi i ekosistemeve dhe peizazheve të prekura nga aktivitetet njerëzore, ruajtja e karakteristikave të dallueshme të peizazhit dhe pamjeve, ruajtja e trashëgimisë kulturore, historike dhe arkitekturore, duke përfshirë traditat lokale

Objektivi Mjedisor 7 (OM7) - Ndryshimet klimatike: Ndërtimi i infrastrukturës për të mos kontribuar në ndryshimet klimatike, reduktimi i emetimeve të gazrave sere duke promovuar mobilitetin urban çiklizmin dhe ecjet;

Objektivi Mjedisor 8 (OM8) - Trashëgimia kulturore: Konservimi e restaurimi, ruajtja e trashëgimisë kulturore, historike dhe arkitekturore, duke përfshirë traditat lokale

Objektivi Mjedisor 9 (OM9) - Cilësia e jetës: Përmirësimi i shëndetit të populates njerëzore, garantimi i zhvillimit social dhe ekonomik në harmoni me mjedisin dhe burimet natyrore dhe ulja e ekspozimit ndaj rrezikut natyror.

Objektivat strategjike të mësipërme synojnë përmirësimin e cilësisë së jetesë në komunë (rritja e sigurisë, shtimi i mundësive për menyrë aktive të jetesës, shtimi i sipërfaqeve të gjelbra, përmirësimi i cilësisë së ajrit, etj.). Ato duhen shoqëruar me veprime operacionale konkrete që çojnë në përmbushjen e objektivave strategjike të planit.

Ndër të tjera, PZHK-ja duhet të zbatojë disa parime dhe modele zhvillimi të pranueshme gjerësisht, si p.sh. Komuna e Gjakovës komunë policentrike, ku qytetari gjen shërbimet pranë vendbanimit të tij dhe nuk ka nevojë të udhetojë për të siguruar shërbimet veç në qendërën administrative.

6.2. Parime, objektiva e kriteret mjedisore që kufizojnë zhvillimin komunal

Ky kapitull paraqet parimet për planifikimin hapësinor të qëndrueshëm, objektivat strategjike dhe veprime operacionale në kuadër të hartimit të PZHK-së. Më tej paraqiten edhe kriteret mjedisore që kufizojnë zhvillimin komunal në vendbanime të ndryshme të komunës dhe pjesë të caktuara të qytetit.

Parimet e përgjithshme për planifikim hapësinor

Parimet e përgjithshme për planifikimin hapësinor janë një tërësi rregullash të bazuara mbi eksperiencat ndërkombëtare, të cilat shkurtimisht mund të përmbledhen në dhjetë pika si mëposhte:

1. Nxitja e zhvillimit të qëndrueshëm;
2. Parandalimi i ndikimit të dëmshëm në mjedisin natyror;
3. Ruajtja e tipareve karakteristike natyrore, pejzazhore, të florës e faunës;
4. Zhvillim ekologjikisht i shëndetshëm, ruajtje e korridoreve ekologjike për të garantuar mbrojtjen e habitateve dhe komunikimin e habitateve mes veti;
5. Marrja e masave parandaluese dhe rigjenerimi i mjediseve natyrore;
6. Përfshirja e parimeve të tilla si „ndotësi paguan” ose „përdoruesi paguan”;
7. Përdorimi i teknikave dhe metodave më të mira për mbrojtjen e mjedisit;
8. Përdorimi i teknologjisë më të mirë të disponueshme bazuar në ndikimin minimal, ndërtimin pa ndotje dhe përgatitjen e sheshit;
9. Informimi i publikut, përfshirja e komunitetit në vendimmarrje dhe aksesimi i publikut në informacion; dhe
10. Bashkëpunim ndërkombëtar.

Në kuadër të hartimit të PZHK-së parimet e mësipërme përkthehen në përparësitë e mëposhtme (siç janë paraqitur edhe në këtë material):

- Densifikim përpara shtrirjes – kjo ka për qëllim përdorimin e tokës në vendbanime në mënyrë më efektive dhe ngadalësimin e shpërndarjes së disa vendbanimeve përtej kufijve të planifikuar;
- Strukturimi dhe ristrukturimi i zhvillimit koherent të vendbanimeve – kjo synon kryesisht të krijojë një përdorim më të efektshëm të tokës;

- Krijimi i rrugëve të reja brenda strukturës së vendbanimeve– aksesit nëpër vendbanime dhe komuna fqinje është një faktor madhor për udhëheqjen e zhvillimit;
- Rehabilitimi i tokës bujqësore;
- Rizhvillimi i pyjeve ekzistuese, pyllzime të reja;
- Ruajtja e trashëgimisë kulturo – historike dhe natyrore;
- Ruajtja e shumëllojshmërisë së aktiviteteve dhe përdorimeve nëpër vendbanime;
- Zgjerimi i zonave të banimit atje ku kushtet janë të favorshme.

Objektiva strategjike

Sipas rëndësisë së tyre, objektivat mund të ndahen në objektiva primare apo globale dhe në objektiva lokale të nivelit komunal. Objektivat kryesore të shqyrtimit të gjerë që lidhen me këtë plan mund të jetë i definuar si:

- Zhvillimi i mëtejshëm i vlerave, ku të gjithë aktorët e kryera të drejtën e tyre për të ditur, për t'u dëgjuar, për t'u dëgjuar dhe për të ndikuar në vendimet që ndikojnë në jetën dhe tendencat e tij. Një nga qëllimet globale është se gjatë zhvillimit dhe implementimit të këtij dokumenti ne kemi pjesëmarrje të cilësisë;
- Zhvillimi i qëndrueshëm, i shpejtë e intensiv dhe ndryshimet në strukturën socio-ekonomik, përfshijnë zhvillimin e barabartë në kuadër të komunës;
- Për të krijuar kushte për një rritje të përhershme në punësim, eliminimin e varfërisë, luftimin e sëmundjeve, përmirësimin e shëndetit dhe reduktimin e vdekshmërisë së fëmijëve në bazë të standardeve që do të ofrojnë qëllimet themelore të ndryshimit në strukturën sociale-ekonomike, zhvillimi dinamik i ekonomisë dhe nivelit të jetës dhe forcimin e rolit të sektorit privat në socio-zhvillimin ekonomik;
- Rritja e vazhdueshme e sigurisë në të gjitha dimensionet (krijimi i sigurisë për edukim themelor, siguri sociale dhe fizike, siguri të mjedisit etj.);
- Zhvillimi i një partneriteti global për zhvillim.

Objektivat strategjike të mësipërme synojnë përmirësimin e cilësisë së jetesës në komunë (rritja e sigurisë, shtimi i mundësive për mënyra aktive të jetesës, shtimi i sipërfaqeve të gjelbra, përmirësimi i cilësisë së ajrit, etj.). Ato duhen shoqëruar me veprime operationale konkrete që çojnë në përmbushjen e objektivave strategjike të planit.

Ndër të tjera, PZHK-ja duhet të zbatojë disa parime dhe modele zhvillimi të pranueshme gjerësisht, si p.sh. Komuna e Gjakovës komunë policentrike, ku qytetari gjen shërbimet pranë vendbanimit të tij dhe nuk ka nevojë të udhetojë për të siguruar shërbimet veç në qendërën administrative.

PZHK-ja parashikon zhvillimin e Komunës si një e tërë me vendbanime, lagjet, e deri tek zonat e vogla të banimit. Në këtë fazë, duke qenë Plan i Zhvillimor Komunal, do të jepen kufijt, kriteret, intensitetet, densitetet dhe standartet e

parashikuara për tërë komunën që nënkupton edhe refleksion në çdo vendbanim, dhe më pas puna do vijojë me Planin Rregullues të Hollësishme të detajojnë zhvillimin për çdo zonë banimi. Planin do perpiqet të përfshijë konceptin e formules së menaxhimit të pronës në mënyrë adekuate pa dallime të pronarve gjatë destinimeve në zonat ndërtimi gjelbrim etj. Sfidues është fakti nga se në PZHK nuk vërehen sakt të specifikuara si zona zhvillimet e reja të infrastrukturës, zonat industriale, etj., të cilat do të analizohen ndikimi i tyre në korridoret e qarkullimit të shtazëve ose a janë marrë masa të duhura për qarkullim natyror të shtazëve dhe llojeve bimë nga një habitat në tjetrin, pyllzimin, ripyllëzimin, krijimin e disa shiritave të gjelbër, tampon zonave, parqeve, etj. Këto zona apo vija të infrastrukturës përmenden vetëm në pjesën strategjike. Një sfidë e veçantë mbetet zbatimi në praktike të këtyre synimeve të PZHK-së; për pyllëzim, ripyllëzim, shiritat të gjelbër, tampon zona, dhe në përgjithësi shtimin e hapësirave të gjelbra, krijimi i zonave rekreative dhe permiresimi i treguesve mjedisorë të komunës.

Gjithashtu plani synon të integrojë dhe përmirësojë situatën aktuale komunale, si psh. zgjerimi i vendbanimeve në drejtimin më të favorshëm në kuptimin e shtrirjes në tokë më plleshmëri të dobëtdhe me përdorim të perzier.

Një tjetër aspekt mjedisor i Planit është rehabilitimi i pikave të nxehta mjedisorë (duke mos specifikuar sakt lokacionet e pikave të nxehta mjedisorë por kjo është trajtuar si problem).

Në mënyrë të përmbledhur objektivat për mbrojtjen e mjedisit në kuadrin e Planit mund të përmbledhen si mëposhte:

1. Pakesimi i sasisë së mbetjeve dhe manaxhimi i integruar i tyre;
2. Krijimi i njëkomune të qendrushme dhe të shëndetshme;
3. Identifikimi dhe krijimi i habitatve të reja, dhe korridoreve të gjelbër;
4. Permiresimi i cilësive së ajrit, përfshirë reduktimin e zhurmave;
5. Kursimi i energjisë dhe paksimi i emisioneve të gazeve sërë;
6. Cilësia e ujërave sipërfaqesore në përputhje me kërkesat e legjislacionit të Kosovës dhe Direktives në kuader për Ujin të BE-së;
7. Reduktimi i intensitetit të trafikut nëpërmjet promovimit të transportit publik, këmbësor dhe qarkullimit me bicikleta;
8. Shtimi dhe mbrojtja e vlerave kulturore, përfshirë arkeologjike dhe arkitekturore;
9. Konservimi dhe shtimi i zonave dhe elementeve peizazhistik;
10. Mbrojtja e mjedisit natyror në pyjet dhe malet;
11. Ripërdorimi i disa tokave të ndotura në vend të tokave të reja.

Veprime operacionale në mbështetje të objektivave strategjike

Veprime operacionale për shtimin e hapësirave të gjelbërta në Gjakovë:

1. Krijimi i projekteve për zbatim në zonat e mbrojtura të njohura në komunën e Gjakovës;

2. Krijimi i parqeve të reja nëpër dhe për rreth vendbanimeve;
3. Krijimi i koridoreve të reja ekologjike dhe zonave të Gjakovës zgjatimi dhe përmirësimi i kushteve ekologjike në koridorin përgjatë lumëve;
4. Krijimi i lulishteve dhe kopshteve në Gjakovë;
5. Kthimi i zonave të degraduara në sipërfaqe të gjelbra;
6. Gjelberimi i kopshteve të shtëpive private;
7. Gjelberimi me pemë dhe shkurre dekorative përgjatë rrugëve dhe trotuareve;
8. Ngritja e barrierave të dendura me gjelbërim si perde që ndajnë rrugët nga zonat e banimit dhe zonat tjera, përgjatë rrugëve me trafik të dendur me qëllime të shumëfishtë (rritje gjelberimi, përmirësim i cilësisë së ajrit përmes filtrimit të pluhurave, si edhe rritje e sigurisë rrugore).

Veprime operacionale për përmirësimin e sistemit të transportit dhe shtimit të përmbajtjeve:

1. Ndërtimi i një rrjeti rrugor që lidhin Gjakovën me rajonin dhe fshatrat mes veti;
2. Përmirësimi i gjendjes së rrugëve ekzistuese dhe zgjerim sipas mundësisë;
3. Krijimi i rrjetit të plotë rrugor në vendbanimet e mëdha me përmbajtje edhe për biciklistët dhe kembësorët;
4. Përmirësimi i sistemit, orareve dhe cilësisë së autobuzeve;
5. Përmirësimi i projektimit të rrugëve me parashikimin e trotuareve të plota dhe shiritave/korsive për biciklist sipas standarteve europiane të rrugëve;

Kriteret mjedisore që kufizojnë zhvillimin komunal

Më poshtë paraqiten disa kriteret mjedisore që duhet të kufizojnë zhvillimin komunal, të grupuara në katër kategori kryesore, përkatesisht (1) kriteret e forta mjedisore-shëndetësore, (2) kriteret e trashëgimisë kulturore, (3) kriteret e paisazhike dhe (4) kriteret inxhinierike dhe të infrastrukturës.

Kriteret e forta mjedisore-shëndetësore

Këto kategori kriteresh përcaktojnë zonat e përjashtuara nga zhvillimi komunal. Kriteret e forta përfshijnë (I) zona me vlera të veçanta mjedisore (psh. zonat e mbrojtura të natyrës), (II) zona të rrezikshme për zhvillim, dhe (III) zona të ndotura të njohura si "hot-spote" mjedisore (psh. mbetje kimike).

(I) Zonat me vlera të veçanta mjedisore përfshijnë:

- Zona e Maleve të Bjeshkëve të Nemuna
- Kompleksi i Maleve të Kosharës, Dushkajës, Qerretit Hasit etj.
- Zonat e Liqeneve (Liqeni i Radoniqit)
- Mbrojtja e burimeve të ujërave;

Nuk lejohen ndërtimet në zonat e mësipërme që bartin vlera të veçanta mjedisore.

(II) Zonat e rrezikshme për zhvillim përfshijnë:

- Shtrërit e lumëve dhe pjesët buferike rreth tyre
- Basenet nentokësore ujëmbajtëse;

- Zonat me pjerresi më të madhe së 15 apo 20%.

Nuk lejohen ndertimet në (apo pranë) shtretërve të lumenjve pasi ndërtimet mund të jenë në zonën e përmytjeve (qofte dhe shumë të rralla), mund të shkaktjnë erosion të brigjeve, si dhe të cenojnë rregjimin hidrologjik të sistemit ujqor.

Në mënyrë të ngjashme, nuk lejohen ndertimet ne zonat me pjerresi të madhe pasi në mjedis argjilor këto ndërtime mund të shkaktjnë (ose përkeqesojnë) situatë erodive të kodrave dhe janë një rrezik publik i përhershëm. Në këtë fazë të Planit Zhvillimor Komunal është vështirë të përcaktohen me detaje këto zona, por gjate hartimit të këtij plani është punuar një planë me pjerrëtësi dhe gjatë zhvillimeve të ardhëshme mundë të superpunohet me informata tjera dhe të shfrytzohet si bazë për Hartën zonale Komunale dhe për Plane Rregulluese të Hollësisheme dhe projekte tjera.

(III) Zona të ndotura të njohura si “hot-spote” mjedisore (psh. mbetje kimike) perfshijne:

- Deponia e e egra përgjat lumenjve dhe kanalizimet që derdhen drejt për drejt në lumenj;
- Vendet e goditura me uranium të varfëruar
- Thertore;
- Depo të kemikaljeve bujqësore
- Ndërmarrje të riparimit të automjeteve;
- Deponit e veturave “varrezat e veturave”.

Këto zona duhet të jenë objekte të studimeve për vlersimin e situates mjedisore mbi bazën e të cilit do të mund të gjykohet mbi nivelin e ndotjës së ujit dhe tokës dhe masat eventuale që duhen ndërmarrë për rehabilitim.

Kritere të trashëgimisë kulturore

Komuna e Gjakovës ka objekte të trashegimisë kulturore që duhen ruajtur për vlerat e tyre kulturore dhe potencialin turistik në të cilat nuk duhet të lejohet zhvillimi i pakontrolluar.

Vlerat e trashegimisë kulturore duhen të konsiderohen rast pas rasti me qellim rinovimin e objekteve në funksion të vlerës së tyre tradicionale, zhvillimin e qendrueshëm në përputhje me funksionin e tyre kryesor.

Lista e monumenteve të kultures do duhet rishikuar dhe lehtesuar ndjeshem. Disa prej monumenteve të kultures jane cenuar, tjetersuar apo zhdukur. Disa prej monumenteve kanë qenë shpallur për motive qartesisht politike dhe lista duhet avancuar.

Ka disa zona tradicionale me vlere konservimi qw mund të mbrohen. Duke pasur vlere të ndërtimit tradicional, këto zonaturistike duhet ruajtur me karakter të veçant.

Kriteret peisazhike

Kjo komunë ka vlera të llojeve të ndryshme si peizazhe që krijojnë pyjet dhe Malet që shtrihen në jug të komunës (Malet e Hasit), dhe në pjesën Veriore kompleksi i Maleve të Dushkajës, në pjesën Perendimore shtrihen malet Kosharës dhe Qerretit livadhet dhe fushat e mbjellura përgjatë luginave të lumenjve. Kriteret peisazhike janë vështirë për tu përcaktuar, pasi duhen konsideruar rast pas rasti dhe duhen caktuar në bashkepunim dhe pajtuesmeri me institucionet tjera.

Zona me vlera të larta peisazhike në të cilat nuk duhet të lejohet ndërtimi pa kriteret përfshijnë:

- Bjeshkët e Nemuna
- Kompleksi i Maleve Kosharës, Dushkajës, Qerretit Hasit etj

Bukuria e peizazhit është pasuri për turizmin. Për t'i mbrojtur sa më mirë, intervenimet e njeriut në pikat skenike-atraktive, duhet të minimizohen. Posaçërisht, në zonat e dedikuara për zhvillimin e turizmit. Shkaktarët kryesorë të degradimit të peisazhit janë minierat sipërfaqësore (gurthyesit), djegja e pyjeve dhe prerja e pakontrolluar e tyre.

Duke pasur parasysh se Ligji i Planifikimit ngarkon komunat me përgatitjen e Planeve Hapesinore, ndërkohë që Gjakova ka përgatit këtë planë duhet që të gjejë mirekuptim dhe bashkepunim me Institucionet tjera kompetente dhe akterët tjer për nevojën e mos-lejimit të ndertimeve në keto zona, qofte duke e sanksionuar këtë edhe me akt-normativ.

NDIKIMET E MUNDSHME MJEDISORE DHE MASAT PËR ZBUTJEN E TYRE

VII. TESTIMI I QËLLIMEVE TË PLANIT KUNDREJT OBJEKTIVAT TË VSM-së

Dihet që VSM-ja duhet të jetë efektive në mbështetjen e procesit të planifikimit, fokusi i tij duhet ngushtuar, duke identifikuar çështjet specifike mjedisore (në aspektin e problemeve dhe mundësive) të cilat janë të rëndësishme. Problemet paraqesin çështjet kritike të cilat ne dëshirojmë t'i adresojmë dhe përmirësojmë përmes planit. Mundësitë janë elemente të kontekstit mjedisor që mund të përdoren në planin për t'i arritur objektivat e tij, ose për t'i përmirësuar kushtet mjedisore. Një gjë e tillë mundëson identifikimin e objektivave specifike të VSM-së për t'i adresuar çështjet e tilla dhe për t'i përdorur këto objektiva si referencë gjatë hartimit të planit, po ashtu gjatë zbatimit të tij. Objektivat e VSM-së janë identifikuar duke marrë parasysh edhe objektivat e zhvillimit mjedisor dhe të qëndrueshëm të përcaktuara në ligjet përkatëse dhe veprimet strategjike (shih Kapitullin 2). Objektivi i gjerë i Vlerësimit Strategjik Mjedisor është të integrojë çështjet mjedisore të politikave, planeve dhe programeve në proceset e vendim marrjes, të tilla që informacioni mjedisor që rrjedhin nga shqyrtimi i politikave të propozuara, planeve, programeve apo projekteve që është përdorur për të mbështetur vendim marrjen. Pra ky studim parasheh:

Tabela. 26. Matrica e përputhshmërisë për të vlerësuar qëllimet e PZHK-së kundrejt objektivave të VSM-së (vazhdon në Tabelën.)

Objektivat e VSM- së	Qëllimet e PZHK-së Zhvillimi Ekonomik			Qëllimet e PZHK-së Infrastruktura Teknike			
	Qëllimi 1	Qëllimi 2	Qëllimi 3	Qëllimi 1	Qëllimi 2	Qëllimi 3	Qëllim 4
O1: Ajri: Reduktimi i emetimeve të gazrave serë	0	0	++	0	+	0	+
O2: Rritja e cilësisë së ujit	+/-	0	++	+	0	0	+
O3: Toka: Mbrojtja dhe përdorimi e manaxhimi i qëndrueshëm i tokës	++	0	+	0	+	0	+
O4: Biodiversiteti: Mbrojtja dhe manaxhimi i qëndrueshëm i biodiversitetit, ruajtja e specieve organike dhe habitateve	+/-	0	+	0	+	0	0
O5: Pyjet: Manaxhimi i qëndrueshëm i pyjeve	+	+	+	0	0	0	0
O6: Peizazhi dhe Ekosistemet	+/-	+	++	+	+	0	0
O7: Ndryshimet klimatike	+/-	?	0	+	0	0	+
O8: Trashëgimia kulturore	0	+	++	0	+	0	0
O9: Cilësia e jetës	+	+	++	+	+	0	0

Objektivat e VSM- së	Qëllimet e PZHK-së Infrastruktura e transportit dhe transporti			Qëllimet e PZHK-së Infrastruktura publike dhe sociale			
	Qëllimi 1	Qëllimi 2	Qëllimi 3	Qëllimi 1	Qëllimi 2	Qëllimi 3	Qëllim 4
O1: Ajri: Reduktimi i emetimeve të gazrave serë	0	0	++	0	0	0	0
O2: Rritja e cilësisë së ujit	+/-	0	++	0	0	0	0
O3: Toka: Mbrojtja dhe përdorimi e manaxhimi i qëndrueshëm i tokës	++	0	+	0	?	0	0
O4: Biodiversiteti: Mbrojtja dhe manaxhimi i qëndrueshëm i biodiversitetit, ruajtja e specieve organike dhe habitateve	+/-	0	+	0	?	0	0
O5: Pyjet: Manaxhimi i qëndrueshëm i pyjeve	+	+	+	0	0	0	0
O6: Peizazhi dhe Ekosistemet	+/-	+	++	0	?	?	0
O7: Ndryshimet klimatike	+/-	?	0	+	0	?	+
O8: Trashëgimia kulturore	0	+	++	0	+	+	0
O9: Cilësia e jetës	+	+	++	+	++	+	+

Objektivat e VSM- së	Qëllimet e PZHK-së Vendbanimet		Qëllimet e PZHK-së Vendbanimet joformale
	Qëllimi 1	Qëllimi 2	Qëllimi 1
O1: Ajri: Reduktimi i emetimeve të gazrave serë	0	0	?
O2: Rritja e cilësisë së ujit	+/-	0	0
O3: Toka: Mbrojtja dhe përdorimi e manaxhimi i qëndrueshëm i tokës	++	0	?
O4: Biodiversiteti: Mbrojtja dhe manaxhimi i qëndrueshëm i biodiversitetit, ruajtja e specieve organike dhe habitateve	+/-	0	?
O5: Pyjet: Manaxhimi i qëndrueshëm i pyjeve	+	+	?
O6: Peizazhi dhe Ekosistemet	+/-	+	0
O7: Ndryshimet klimatike	+/-	?	0
O8: Trashëgimia kulturore	0	+	0
O9: Cilësia e jetës	+	+	+

Objektivat e VSM- së	Qëllimet e PZHK-së Banimi		Qëllimet e PZHK-së Shfrytëzimi i tokës
	Qëllimi 1	Qëllimi 2	Qëllimi 1
O1: Ajri: Reduktimi i emetimeve të gazrave serë	0	0	0
O2: Rritja e cilësisë së ujit	+/-	0	+
O3: Toka: Mbrojtja dhe përdorimi e manaxhimi i qëndrueshëm i tokës	++	+	++
O4: Biodiversiteti: Mbrojtja dhe manaxhimi i qëndrueshëm i biodiversitetit, ruajtja e specieve organike dhe habitateve	+/-	0	+
O5: Pyjet: Manaxhimi i qëndrueshëm i pyjeve	+	+	++
O6: Peizazhi dhe Ekosistemet	+/-	+	+
O7: Ndryshimet klimatike	+/-	?	+
O8: Trashëgimia kulturore	0	+	0
O9: Cilësia e jetës	+	+	+

Sqarim:

- ++** Përputhshmëri në nivel të konsiderueshëm;
- +** Përputhshmëri e knaqshme;
- 0** nuk ka efekt;
- Konflikt i vogël i mundshëm;
- /-** Konflikt i mundshëm domethënëse;
- +/-** Elementet të puthshmërisë dhe konfliktit;
- ?** Përputhshmëria nuk mund të vlerësohet në këtë fazë (nevojiten më shumë detaje se si do të arrihet qëllimi.

6.1. Masat e nevojshme në PZHK për Mbrojtjen e Mjedisit

Konceptet zhvillimore të përdorimit të tokës, përfshi zhvillimin e qendrave

Në analizën e vendbanimeve është vërejt se në Gjakovë si në çdo vendbanim tjetër në Kosovë kemi problem me shtrirjen shumë disperse (objekte të shpërndara) të ndërtimeve të cilat më tutje paraqesin problem në ofrimin e infrastrukturës dhe elementeve tjera urbane. Cilësohet si problem me përmasa serioze zgjerimi i tokës ndërtimore në mënyrë spontane, pastaj shtrirja e ndërtimeve në tokat bujqësore sidomos në zonën përgjat rrugëve nacionale Gjakovë -Prishtinë, Gjakovë – Pejë dhe Gjakovë – Perzeren.

Harta e shfrytëzimit të planifikuar të tokës tregon destinimin për përdorim të tokës deri në vitin 2028+. Këtu prezantohen edhe kufijt e rinjë ndërtimor edhe zhvillme tjera. Kjo do të sjellë humbjen e mëtejshme të tokës bujqësore, por njëkohësisht do të sigurojë ruajtjen e pjesës së konsiderushme të tokës me plleshmëri, tokës së pasur me resurse dhe pyjeve. Kemi të prezantuar edhe zonat e shënuara me ngjyrë e cila potencialisht mund të paraqesin pikat e nxehta mjedisor.

Konfliktet e mundshme për hapsira mund të adresohen vetëm nëpërmjet zbatimit më të mirë të këtyre planeve. Masa e parë duhet të jetë arritja e një marrëveshje për mbrojtjen e këtyre zonave, e cila duhet të ndiqet nga plane rregulluese dhe tjera për komunën, të cilat do të vireshin më pas në zbatim. Kjo është një sfidë e madhe për qeverinë komunale, gjë që pranohet deridiku edhe në Planin Zhvillimit Komunal të Gjakovës. Gjatë procesit të hartimit janë organizuar takimet me komunitetin për të filluar këtë proces. Rreziku kryesor mjedisor do të ishte nëse nuk arrihet marrëveshja për një vizion të përbashkët për Gjakovën.

Zhvillimi dhe rritja e Gjakovës besohet se do të vazhdojë, e në fakt sa më shumë sukses ekonomik të prodhojë Gjakova, aq më shumë do të përshpejtohet rritja e saj. Kjo do të ishte e dëshirueshme dhe është në të mirë të Kosovës, duke supozuar se realizohen investimet në infrastrukturën mjedisore dhe menaxhimi efektiv komunal, komuna e Gjakovës ka mundësi të akomodojë një numër shumë më të madh popullsie me zgjerimin e kufinjeve ndërtimore dhe turistëve me zgjerimin e kapaciteteve receptive turistike. Burimet ujore nuk janë të mjaftueshme. Kapaciteti mjedisor mbajtës i Gjakovës nuk përbën problem, ndërkohë që problem përbëjnë menaxhimi dhe planifikimi urban jo-efektiv dhe nevoja për financimet mëdha në infrastrukturën mjedisore. Plani i njeh këto probleme dhe përpqet në mënyrë realiste të punojë brenda këtyre kufizimeve.

Ndikimi në klimë

Gjakova vlerësohet se nuk ka indikacione, se me aktivitetin aktual dhe atë që do të ketë në perspektivë të ndikoj në klimën globale, pasi që komuna e Gjakovës përpos disa industrive përpunuese si ajo e lëngjeve, drurit dhe plastikës dhe ndermarrjeve të vogla nuk ka ndonjë industri apo objekt industrial që do të emitonte gazra të serrës në atë mas sa të ketë ndikim në klimën globale. Është e rëndësishme

që të bëhen studime për të vlerësuar rritjen e temperaturës dhe faktorëve tjerë klimatik. Megjithatë komunikacioni rrugor sidomos tani me ndërtimin e autostradës në mënyrë të pashmangshme do të shkaktojë një ndikim në mikroklimën rajonale duke ndikuar edhe në ngritjen e temperaturave dhe praninë e ndotësve në ajër, ujë dhe tokë.

Mbrojtja e pyjeve, zonave të gjelbra ekzistuese dhe zhvillimi i zonave të reja

Destinimet për shfrytëzim të planifikuar të tokës të propozuara nga PZHK-ja krijojnë mundësinë për struktura reja të pyjeve, kryesisht për përdorim të ndryshëm, kështu duke krijuar edhe habitate natyrore dhe mjedise atraktive. Komuna duhet që në kuadër të zbatimit të planit të ketë në prioritet projektet si:

- Projekte pyllëzimi konform planit;
- Projekte ripyllëzimi dhe mirë mbajtje konform planit;
- Numrin e këtyre strukturave që do të lejohet dhe ku do të lejohet (apo nuk do të lejohet) ngritja e tyre;
- Projekte për ndërtim të infrastrukturës si rrugët malore melorim dhe drenazhim për pyjet, etj.
- Arkitekturën e objekteve e tyre për të siguruar harmoninë vizuale me mjedisin rrethues;

Cilësia e ajrit

Plani Zhvillimor Komunal adresonë problemet ajrit në aspektin e ndotjes dhe cilësisë së tij. Prania e komunikacionit përgjat rrugëve nacionaleve Gjakovë – Prishtinë, Gjakovë – Pejë dhe Gjakovë – Perzeren për këtë komunë është një element që tregon se ka shkarkim të konsiderueshëm të gasrave në atmosfer, si dhe lirim të zhurmave të ndryshme që vijnë nga komunikacioni. Ndërkohë që rritja e parashikuar për trafikun në vitin 2028+ do të bëjë që cilësia në përgjithësi e ajrit të përkeqësohet, veçanërisht për Pb, SO_x, NO_x, të cilat aktualisht janë brenda normave të BE-së dhe Kosovës. Zbatimi i standardeve më strikte për çlirimet në ajër nga automjetet, permiresimi dhe kontrolli i cilësisë së karburanteve menaxhimi më i mirë i trafikut, përfshirë përdorimin e rritur të bicikletave, si dhe furnizimi i plotë me energji (për të ulur përdorimin e gjeneratorëve) ka shumë gjasa të ngadalësojnë përkeqësimin e mëtejshëm të cilësisë së ajrit për një periudhë afat-shkurtër deri në afat-mesme. Grimcat e imëta PM₁₀ (të ngurta, të lëngshme ose gaz) mund të depërtojnë në mushkëri duke shkaktuar efekte të mëdha shëndetësore të tilla si sulmet në zemër, kanceri në mushkëri, bronkitin kronik dhe ndikim më seriozi katek të moshuarit, fëmijët dhe diabetikët. Efekte të vogla shëndetësore përfshijnë. Këto efekte shëndetësore ndikojnë në cilësinë e jetës së çdo kujt dhe ndërhyjnë në mirëqenien ekonomike, sociale, kulturore dhe mjedisore të banorëve të komunës së Gjakovës. Duhet bërë vlerësimi i ndikimit të cilësisë së ajrit mbi shëndetin dhe ekonominë nëpërmjet llogaritjes së shkallës së semundshmerisë me qëllim vlerësimin sasior të dëmit në shëndet dhe kostos ekonomike që sjell ndotja e ajrit për

Komunën. PZHK-ja adreson mirë problemet e zhurmës, si dhe ka dhënë disa rekomandime dhe ka propozuar masa se si zhurma të reduktohet.


Rrugët e propozuara

Plani propozon një kategorizim të rrugëve lokale dhe ndryshim ose zgjerim të traseve të disa rrugëve rajonale si dhe propozon unazën e jashtme komunale dhe unazën urbane. Komuna e Gjakovës është një territor tranzit në mes të qendrave nacionale dhe ndërshtetërore, vjen në shprehje edhe infrastruktura tjetër e cila diktohet nga niveli nacional si autostrada dhe e cila ka impaktet më të larta mjedisore. Me probleme të përafërta përballen edhe rrugë të tjera të propozuara, të cilat kalojnë nëpër zona të gjelbra në të cilat janë masat adekuate për ruajtjen e tyre.

Ndikimi i Planit në Ekosistemet natyrore

Në disa zhvillime të cilat janë planifikuar ka disa ndikime të cilat janë të kthyeshme dhe të riparueshme nëse merren masat e parapara. Në PZHK janë propozuar masa kundër zhurmës dhe masa kundër ndotjes në pjesët ku ndjeshmëria në ekosisteme është e lartë. Ekosistemet ku atakohen janë ekosisteme pyjore në disa korie (zabele) dhe në disa pjesë ekosisteme lumore por që ndikimi nuk është shumë i madh. Ndërkaq Plani parashe edhe projekte të cilat kanë ndikim pozitiv në ekosisteme siç shihen në hartat më posht.





Harta. 11. Parashikimi i ndikimeve të PZHK-së në aspektin hapësinor.

Efektet kumulative

VSM-ja nuk do të kufizohet vetëm në analizën e elementeve individuale të planit, por duhet të bëjë gjithashtu edhe një vlerësim të përgjithshëm në vazhden e të gjitha aktiviteteve dhe politikave të cilat përfshihen në Planin Zhvillimor Komunal të Gjakovës.

Tab. 30. Matrica e përmbledhjeve të efekteve kumulative të të gjitha elementeve të PZHK-së në komponentet mjedisore

Komponentet mjedisore	Elementete e PZHK-së							Vlerësimi i efekteve kumulative
	Rrugët e planifikuara		Autoudha “Agim Ramadani”	Hekurdha e planifikuar	Zonat e planifikuara të ndërtimeve	Zonat ekonomike dhe industriale	Pyllëzimi	
	Unaza e jashtme qytetit	Unaza e mbrendshme e qytetit						
Emetimi i gazrave serrë	+	-	-	0	+	-	+	Pa ndonjë efekt domethënës
Ndotja akustike dhe bezdisjet tjera	+	-	-	-	+	-	+	Pa ndonjë efekt domethënës
Burimet natyrore	+	0	0	+	+	+	+	Pozitive
Toka	+	+	0	0	+	0	+	Pozitive
Uji	0	0	0	0	+	0	+	Pa ndonjë efekt domethënës
Ajri	0	-	-	0	0	-	+	Pa ndonjë efekt domethënës

Biodiversiteti	0	0	-	0	+	0	+	Pa ndonjë efekt domethënës
----------------	---	---	---	---	---	---	---	----------------------------

Në këtë Raport ndikimet mjedisore kumulative percaktohen si një kombinim i ndikimeve të zbatimit të veprimeve të Planit në aspekte të ndryshme të mjedisit. Gjatë implementimit të zhvillimeve të planifikuara të Planit, impaktet mjedisore kumulative variojnë sipas aspekteve individuale të mjedisit. Kur vleresohen impaktet mbi token, ajrin dhe faktoret klimatike, biodiversitetit impaktet kumulative të zbatimit të veprimeve të Planit shprehen si shuma e impakteve të të gjitha masave, si të tilla në vlerësimin e impakteve kumulative mbi:

- ajrin, shkarkimet e ndotesve që pasojnë zbatimin e masave që kombinohen; dhe
- burimet natyrore si burimet ujore, minerale dhe resurseve tjera të cilat kombinohen;
- token, zona toke bujqesore dhe e pyjeve e fragmentuar për shkak të integritetit të strukturave të infrastrukturës së re që kombinohen si efekte;
- faktorët klimatik, shkarkimet e gazeve serrë që pasojnë zbatimin e masave që kombinohen.

Nga aspekti i impakteve mbi ajrin dhe faktorët klimatik, impaktet kumulative si shumë e impakteve të të gjithë veprimeve të PZHK-së janë të rëndësishme për realizimin e objektivave mjedisore:

- shkarkimet limiteve të ndotësve
- menaxhimin e mbetjeve inerte dhe
- sasia vjetore më e lartë e shkarkimit të gazeve serre.

Në vlerësimin e impakteve mbi ujin, natyren, trashëgiminë kulturore dhe peisazhin, efekteve kumulative zakonisht nuk mund të shprehën si një shumë e impakteve të të gjithë veprimeve për të arritur synimet e PZHK-së. Kur vleresohen efektet kumulative në aspektet e përmendura më sipër, karakteristikat e një impakti individual që kontribuon në efektet kumulative janë shumë të rëndësishme. Këto janë përgjithësisht karakteristika në të cilat impaktet ndryshojnë njëri nga tjetri sipas vendit (impakt direkt dhe në distancë) dhe kohës (afat-shkurter, afat-mesem dhe afat-gjate, perkohësisht dhe permanent) të efekteve.

Nëse vleresohen efektet mbi shëndetin njerëzor, efekti komulativ të PZHK-së shprehen si efekte të kombinuara kumulative dhe zakonisht referohen për:

- zvoglimin e ekspozimit në nivelet e tejkaluara të bezdisjes akustike;
- zvoglimin e ekspozimit në nivelet e tejkaluara të ajrit të ndotur në mjedis; dhe
- masat e marrura në PZHK që lehtësojnë veprimtari shlodhëse dhe rekreative në një mjedis.

Kur vleresohen impaktet mbi popullatën dhe asetet materiale, impaktet kumulative të zbatimit të PZHK-së shprehen si një kombinim i impakteve të ndryshme që ndikojnë në hapësirën e tyre të jetesës dhe në jetën e tyre. Masat për të

arritur synimet e PZHK-së janë positive nga aspekti i impakteve mbi popullsinë dhe asetet materiale, nëse efektet kumulative të tyre kontribuojnë në arritjen e kohezionit social, sigurinë dhe qëndrueshmërinë.

Në vlerësimin e efekteve kumulative në Biodiversitet të llojeve organike në zhvillimet e planifikuara shprehën si efekte të kombinuara duke rritur impaktin në biodiversitet, mirëpo me masat që janë marr me PZHK efekti do të jet më i zbutur deri te efekti pozitiv për biodiversitetin. Komuna në të ardhmen do të kërkoj nga niveli qendror për autoudhën dhe hekurudhën për urat e kalimit të shtazëve nga një ekosistem në tjetrin, si dhe masat kundër zhurmës në vendet e ndjeshme.

Probleme të mjedisit në Gjakovë dhe përgjigja që i jep PZHK

Tabela e mëposhtme bënë një përmbledhje të problemeve mjedisore që u identifikuan në Kapitullin më lart dhe të shkallës në të cilën PZHK-ja i u përgjigjet atyre, duke sugjeruar njëkohësisht edhe masa të tjera për mbrojtjen e mjedisit.

Tabela. 31. Përmbledhje e Problemeve Mjedisore dhe përgjigja sipas PZHK-së

Problemi mjedisor	Shkaqet	Ndikimi në mjedis	Ndikimi në shëndet	Propozimet e PZHK-së	Ndërhyrje të tjera të propozuara	Masa të tjera të nevojshme
1. Cilësi e ajrit.	Aktiviteti ndërtimor i pakontrolluar; Rrugë të ngarkuara në zonën urbane; Rritja e shpejtë e numrit të automjeteve; Karburante të cilësisë jo të mirë; Ngrohjet individuale gjatë dimrit si dhe përdorimi i lëndës djegëse i dyshimt. Djegia e mbeturinave, ndzja e zjarreve të qëllimshme	Të gjitha shkaqet e përmendura e ulin cilësinë e ajrit edhe pse kjo komunë është e mbuluar mjaft me vegjetacion, vlenë të përmenden maliet eDushkajës,H asit,Kosharës, Qerretit .	Nuk ka të dhëna që provojn këtë lidhje për sëmundjet, apo ndonje sëmundje tjetër që vjen si rezultat i cilësisë së ajrit.	Propozimet për pyllëzim Propozimet për shirita gjelbrues Propozimet për transportin publik dhe ciklizmit ka si qëllim ngadalësimin e rritjes së numrit të makinave private dhe reduktimin e ndotjes së ajrit të disa zonave të komunës. Rrugët e reja të cilat duhet të lehtësojë trafikun nëpër vendbanime.	Duhet të bëhen studime mbi pyllëzimin; Duhet të bëhen studime mbi transportin; Përdorimi i karburanteve më të pastra (përmbajtje e squfurit të bjerë); Përmirësimet e rrugëve nga Komuna e Gjakovës ndërtimi i rrugëve shkarkuese në bashkëpunim me Ministrinë e Infrastrukturës.	Studim për të përcaktuar ndikimin dhe koston e cilësisë së dëmshme të ajrit në shëndetin publik dhe në ekonominë në tërësi; Përmirësimi i teknikave të ndërtimit për të pakësuar ndotjen; Përmirësimi i trafikut edhe futja e korsive të biçikletave; Edukim më i mirë i publikut mbi shëndetin dhe cilësinë e ajrit; Përmirësimi i furnizimit me energji-zbutja e kërkesës nëpërmjet burimeve alternative të energjisë dhe përdorimit të gjeneratorëve; Vendosja e kriterëve strikte për pyllëzimin; Vendosja e kriterëve strikte për cilësinë e zonave të gjelbra (cilësia e mbulesës së tokës, dhe e mbulesës bimore).

2. Cilësi jo e mirë e ujit të lumenjëve	Mungesa e trajtimit të ujërave të zeza dhe mbetjeve industriale që shkaktohet nga mungesa e sistemit të grumbullimit dhe trajtimit adekuat të ujërave të zeza.	Ndikim në shëndetin e popullates njerezore, humbje e flores dhe faunes ne ekosisteeme ujore (mikrozoobent osit dhe makrozoobent osit); Ndotja e rezervave të ujërave nëntokësorë.	Ndikon në sëmundjet infektive, sëmundjet tjera të cilat lidhen me përdorim të ujit dhe përmes zingjirit ushqimor.	Skenari i zhvillimit të PZHK-së parasheh një impiant për trajtim të ujërave të zeza në afërsi të qytetit të Gjakovës, ku i gjithë sistemi i kanalizimit është i orientuar në drejtim të impiantit.	Përgatitja e Projekteve Sektoriale për Trajtimin e ujërave të zeza.	Zëvendësimi i tubacioneve të vjetra dhe të vogla qe do te shoqerohet edhe me minimizimi i rrjedhjeve. Maksimizimi i lidhjeve. Rregullimi i lidhjeve të paligjshme. Reduktimi i përdorimit të gropave septike dhe lidhja me sistemin e kanalizimeve per ujërat e ndotura, lidhja me kolektorin kryesor të fshatrave,dhe ndertimi i impiantit të planifikuar.
3. Cilësi dhe sasi jo e kënaqshme e ujit të pijshëm	Humbje në sistem të furnizimit, tubat jo të cilësisë së duhur dhe mungesa e kontrollit të ujërave	Ndotja e ujërave nëntokësore Konsum i ujit në shishe dhe gjenerimi i mbetjeve plastike.	Shpërthim i sëmundjeve gastro-enterike, por lidhja e qartë nuk është provuar nga të dhënat shëndetësore.	Skenari i zhvillimit i PZHK përputhet me studimet e mëhershme për cilësin dhe sasinë; Në PZHK janë parashikuar edhe përfshirja e infrastrukturës për shkak të interferencave që ka.	Duhet përgatiten projektet Sektoriale përkatës dhe trajtohet mundësia e financimit.	Zvogëlimi i humbjeve në rrjet. Shmangia e intersektimeve me linjat e ujrave te zeza. Reduktimi i lidhjeve të paligjshme. Përgatitja e projekteve për të shkuar drejt furnizimit të vazhdueshëm me ujë; Mbrojtja e burimeve mbi sipërfaqe, eliminimi i shfrytëzuesve individual të burimeve ujore.

4. Mbledhja dhe grumbullimi i mbeturinave	Mungesa e një sistemi reduktim-ripërdorim-riciklim për mbetjet e ngurta në nivel të Komunës Grumbullimi i mbetjeve në komunë nuk është plotësisht i rregulluar pasi shumë prej tyre hidhen në lumenj dhe zona të tjera. Nëse vazhdohet me këto ritme, Gjakovës do të ketë disa deponi ilegal brenda viteve të ardhshme. Mbetjet ndërtimore, dhe ato të tjera përzihen me mbetjet komunale.	Komuna gjeneron sasi të konsideruesh me të mbetjesh të ngurta. Në disa vendëbanime të Gjakovës pamjet e mbeturinave mbeten të shëmtuara. Në komuna, sidomos në shtratin lumenjve por edhe në prroskat tjera pamja është shumë e shëmtuar. Mund të jenë burim semundjesh veçanërisht në stinën e nxehtë.	Djegia e mbeturinave shton ndotjen e ajrit. Personat që jetojnë pranë ktyre deponive dhe her pas here kontrollojnë mbetjet janë të ekspozuar ndaj rreziqeve serioze për shëndetin. Rrezik potencial për shëndetin nga hedhja e mbetjeve të rrezikshme në zona afër dhe në disa raste edhe brenda vendbanimeve të komunës së Gjakovës.	PZHK sugjeron adoptimin e një sistemi të integruar të administrimit të mbetjeve në bashkupnim me kompaninë regjionale, bazuar në itinerarin reduktim-ripërdorim-riciklim-rekuperim. PZHK përmend riciklimin, selektimin, tregon për vendin e sakt ku do të grumbullohen selektohen dhe riciklohen mbeturinat në të ardhmen.	Duhet përgatitet Projekti Sektorial përkatës me mundësi financimi; duhet të propozoj vendet për deponim të përkohshëm në të cilat mundë të bëhet selektimi, grumbullimi dhe riciklimi i mbeturinave.	Grumbullim më i mirë në vendbanime dhe nivel komunal. Vënie në jetë e strategjive për reduktimin e mbetjeve dhe për riciklimin. Ndarje më e mirë e materialeve të rrezikshme. Për të shmangur hedhjet e paligjshme, organizimi mund të bëhet nga komuna për një numër të mjaftueshëm kamionësh, dhe të menaxhohet me transport nga deponia e përkohëshme drejt asaj regjionale njejtë të menaxhohet me pagesë për tone për hedhjen e mbeturinave në Deponin e regjionale duke krijuar sistem pagesash nga ata që hudhin mbeturina.
---	---	--	--	--	---	---

5. Rehabil-itimi /Inkapsulim i pikave te nxehta të ndotjes	Ndotja e tokes nga aktivitete e ndryshme ekonomike dhe bujqësore, depoja e materialeve kimike në Komunën Gjakovës.	Ndotja e tokes dhe ajrit nga perberje të demshme per shëndetin e njeriut dhe biodiversitet	Ne vartesi te lendeve ndotese,mund të shkaktojnë një game të gjerë semundjesh	Propozohet të studiohen të gjitha hapësirat,zonat me rrethinë ku janë zhvilluar industritë të vogla ose edhe sot ku pjesërisht funksionojnë në territorin e komunës së Gjakovës në zonat industriale kane perdorur ose gjeneruar kimikate te rrezikshme per shendetin, para, gjatë edhe pas viteve 90-ta dhe mbi bazen e shkalles se rrezikut të behen nderhyrja teknike siç është rasti me disa deponi.	Te mblidhet informacione më të thelluara për këtë gjendje, per nivelin dhe llojin e ndotjes,për ndikimet në tokë,ujë ajrë egzistencen e lidhjeve të territoreve te ndotura me kërcnimet për shëndetin, llojin e kërcnimit të bëhen analiza ne terren dhe laborator, të trajtohen me PZHK vendet ku dyshohet se është goditur me Uranium të Varfëruar gjat luftës së fundit në mënyr që në të ardhmen të bëhen studime lidhur me ndikimin në mjedis të këtyre zonave dhe të bëhet inkapsulimi apo izolimi i këtyre zonave nëse është e nevojshme.	Plani i menaxhimit dhe rehabilitimit të pikave të nxehta bazuar edhe në studim,analiz dhe VNM të detajuar; Masat adekuate për shëndetin e njerëzve; Masat tjera për konsolidim të tokës, mbrojtje të ujit dhe cilësisë së ajrit dhe Biodiversitetit dhe ekosistemeve tjera.
--	---	---	--	---	---	--

6. Shtrirja e ndërtimeve	Nevojat për banim; Zhvillim i pakontrolluar dhe i paplanifikuar brenda dhe rreth vendbanimeve sidomos nëpër terrene me tokë të plleshme bujqësore dhe ato kodrinore kryesore rrugore	Humbje e tokës së plleshme dhe gjelbrimit e pemëve të ndryshme, humbje e shtresës së sipërme të tokës, rrjedhje dhe mundësi për rrëshqitje/ përmytje. Humbje e vlerave estetike. Humbje e vlerave peizazhistike të teritorit komunal.	Jo i drejtperdrejte dhe i menjëhershëm; Por shtrirja pa përcjellë me infrastruktur normal që shkakton edhe pasoja në shëndet; Edhe rrëshqitjet e mundëshme të tokës dhe përmytjet mund të shkaktojnë dëme serioze për jetën dhe pronën. Edhe humbja e gjelbrimit ka ndikimin e vetë në shëndetin e njeriut	Planifikohet kufiri ndërtimor për të gjitha vendbanimet; Normat teknike të planifikimit sipas UA. të përdorura në PZHK bëhen automatikisht të vlefshme; Për të gjitha vendbanimet në Komunë. Parqe, zona të gjelbra rreth disa vendbanimeve.	PZHK ka propozuar për zonat jashtë kufijve të propozuar ndërtimor rreth vendbanimeve statusin e zonave ku nuk lejohet ndërtimi; PZHK ka propozuar për zonat jashtë kufijve të ndërtimit të marrin statusin e zonave bujqësore, Pyjore, parqe dhe infrastructure nën masa mjedisore.	Të përgatitet ekipi dhe një plan i Menaxhimit të ndërtimeve; Të përgatiten projekte për gjelbrim dhe parqe Moratoriumi për ndërtimet duhet të shtrihet edhe në gjitha zonat jashtë kufijve të propozuar ndërtimor. Është e nevojshme të hartohen Plane Rregulluese edhe për vendbanimet në konceptin e zhvillimit me nënqendra, dhe zonat ku i parasheh komuna, të hartohet Harta Zonale Komunale e cila jep kushte dhe masa adekuate për gjitha zonat.
--	---	--	---	---	--	--

7. Degradimi i pyjeve,	Prerja e pakontrolluar dhe ilegale e pyjeve; Djegëjet e pyjeve; Zhvillim i pakontrolluar dhe i paplanifikuar i disa vendbanimeve. Gurthyesit në zona të pyjeve dhe në afërsi të zonave me ndjeshmëri të lartë mjedisore.	Ndotja e ajrit; Ndotje e ujit, mungesë e kënaqësisë si për rezidentët ashtu edhe për vizitorët. Erozini në shkall të lart dhe prishje e balancit natyror, ndikimi i lartë në rezervatin strikt të natyrës.	Ndotja e ajrit edhe e ujit kan ndikim dhe pasoja në shëndet;	Revitalizimi i pyjeve ekzistuese; Propozohen mbulim me fidane të reja sipërfaqet e zhveshura; Dhe parqe tjera të reja në disa vendbanime.	Projekte konkrete pyllëzimi, revitalizimi, sanim për pyjet e Gjakovës në zonat e parapara me PZHK. Përgatitja e projekteve për shfrytëzimin e burimeve tjera alternative për ngrohje dhe energji tjera në mënyr që mos të shfrytëzohet druri për djegie.	Ngritja e një mekanizmi bashkpunues në nivel të komunës dhe ministrive për këto projekte; Kushtëzimi i projekteve të reja të infrastrukturës me gjelbrim dhe tampon zona; Aktivizim i gjykatave, policis inspektorëve në mënyr cilësore. Në ish vendëdpozitimet legale dhe ilegale masat rehabilituese dhe ri gjelbrim ose rivitalizim të atyre ekosistemeve.
8. Degradimi dhe eksplotimi i gurit nga Gurëthyesit dhe degradimi natyror i tokës	Është karakteristike numër i madh i gurëthesve. Degradimi i pjesëve të ndryshme të tokës gjat eksplotimit të gurëve nga gurëthyesit për ndërtimtari, mos rehabilitimi i zonave ku jan marr gurët.	Degradim i tokës, pyjeve dhe hapësirave me pesazhe të bukura duke i shëndrruar në hendeqe të pa këdëshme ,dhr të rrezikshme.	Natyrrshëm ka ndikim në shëndet të popullatës njerzore dhe organizmave tjerë.	PZHK ka trajtuar ndotjen që vjen nga nxjerrja e mineraleve duke lënë hapësirë për trajtim të mëtutjeshëm në të ardhmen.	Duhet të parashihen masa për kthimin në gjendjen e më parshme të vendeve ku janë nxjerrur gurët.	Në bashkpunim me nivelin qendror të merren masa për rehabilitimin e vendeve ku është eksplotuar.

9. Humbje e trashëgimisë së ndërtuar	Zhvillimet me trende të ndryshme nëpër vendbanime nuk janë në harmoni me arkitekturën ekzistuese.	Humbja e disa nga karakteristikat unike të vendbanimeve, cenim i identitetit dhe e kujtesës historike, kryesisht hubja e kullave karakteristike për këtë zonë.	Të dhëna të pa disponueshme por aspektin psikologjik dhe shpirtor mendohet se do jetë prezent.	Identifikon zonat brenda studimit të cilat do të ruhen. Propozon masat për ruajtjen. E orienton presionin për ndërtime drejt vendbanimeve dhe zonave më pak të pasura me këtë lloj trashëgimie	Identifikimi i instrumentave ekonomike dhe të valorizimit të territorit (psh, itinerare apo shtigje kulturore) që mund të bëhen mbështetje për komunitetet autoktone të Gjakovës që banojnë në këto vendbanime dhe zona.	Zgjerimi dhe mbajtja/pasurimi i listës së monumenteve të kulturës, e cila është përgatitur nga Instituti i Monumenteve të Kulturës dhe institucione tjera qendrore dhe lokale për të mirëmbajtur zonat, ndërtesat që kanë vlerë të trashëgimisë së ndërtuar
--	--	---	---	---	---	--

10. Rrezik për tërmete, rrëshqitja e tokës, vërshimet dhe element tjer rreziku	Rajoni i Gjakovës është një nga vendet më të rrezikuara nga tërmetet, bënë pjesë në zonë sizmike aktive të nivelit mesatar; Ka erosion e dhe reshqitje të dheut në disa pjesë të identifikuar me PZHK, por ka edhe burime tjera rreziku.	Varsisht por dine të jetë me ndikim të lartë mjedisor sidomos nga ndikimet idirekte	Mund të rezultojë me dëme të mëdha.	PZHK paraqet në mënyr specifike zonat e rrezikuara nga tërmetet, tregon në mënyr të sakt për zonat ku ka erozion dhe shkarje dheu por nuk tregon për se çfar shkalle. PZHK tregon në mënyr precise zonat të cilat janë nën ndikim të vërshimeve dhe përmbetjeve.	Komuna duhet të hartoj projekte të detajuara për caktimin e shkallës së ndikimeve për zonat të cilat janë nën ndikim të rreziqeve të përmendura. Komuna duhet të ndërtojë brenda standarteve të larta anti-sizmike,	Studim i terreneve për qëndrueshmëri sizmikenë rast se do të duhet të ndërtohet ndonjë pikë karburanti, duhet patur parasysh raporti i vlerësimit të ndikimit në mjedis dhe raporti i vlerësimit të sigurimit teknik të karburantit, i cili duhet të ketë standarde shumë të larta.
11. Rreziqe nga rrezatimi jonizues dhe jo jonizues.	Hedhja e predhave dhe mjeteve tjera eksplozive gjat luftës në Kosovë në disa pika në Gjakovë	Është e mund të shkaktoj probleme të shumta shëndetësore, por më kryesore është kanceri dhe sëmundje tjera.	Ekspozimi i vazhdueshëm ndaj radioaktivitetit mund të shkaktojë kancer dhe sëmundje tjera.	Me PZHK parashihen masa për rehabilitim profesional.	Kërkohen studime dhe hulumtime shtesë për të përcaktuar rrezën e veprmit	Duhet të bëhen studime të mëtejme në nivel vendi dhe sipas nevojës do duhej hartuar strategji e veçant për këtë problematikë.

12. Rreziqe nga zjarret.	Shkatërrimi i pyjeve, rrezikimi i pasurisë dhe pronës së qytetarëve, ndotja e ajrit.	Shkatërrimi i pasurisë qytetare duke djegur pronën dhe pasurit tjera të paluajtëshme.	Rrezikimi i jetës së qytetarëve dhe pasurisë.	Bënë identifikim të zonave me probabilitet të zjarrndezjes dhe krijon kushte që zjarret të menaxhohen më lehtë.	Duhen ndërhyrje bonifikuese në ndërtesat me përmbajtje amianti - asbesti.	Duhet bëhenë studime të mëtejme mbi shkaqet e zjarrvënjes, kohen dhe lokacionet më të atakuara.
13. Rënie e biodiversitetit dhe humbje e florës dhe faunës.	Infrastruktura rrugore , Rritja e disa vendbanimeve por edhe zhvillimet me karakter ndërtimi po shkaktojnë humbje në pyje dhe habitat. rritje e ndotjes, zhurmës dhe forma tjera të bezdisjes dhe gjuetia e pa kontrolluar.	Nuk njihet plotësisht, por ka probleme të përgjithshme të humbjeve ekologjike. Rënie e efektit zbutës të florës për gjurmën e karbonit në disa zona të komunës	Humbje e zingjirit ushqimor, Aspekti kulturor, shkencor dhe rekreativ. Ndikim negativ në gjendjen psikologjike të banorëve.	Përkufizimi i ndërtimit është propozim i drejtpërdrejtë, dhe ulja e zhvillimit të çrregullt të vendbanimeve do të sjellë edhe uljen e humbjes në biodiversitet.	Projekte të asistuara nga BE, me qëllim fuqizimin e monitorimit të mjedisit në komunëduhet zhvilluar studime të situatës.	Nevoja për të pasur një studim bazë për Gjakovën me qëllim identifikimin e humbjeve në biodiversitet dhe inventarizimin e florës dhe faunës, mundësitë për përmirësimin e situatës.
14. Zonat e ndikimit të aktiviteteve në Gjakovë	Të gjitha problemet e lartpërmendura, por nuk ka informacion të detajuar mbi ndikimin	Ndotje e lumenjve dhe tokës	Nuk dihen në hollësi por nënkuptohen	Jashtë studimit, por problemet janë të njohura, sidomos rritja vendbanimeve dhe zhvillimet tjera industriale dhe ndërtimore.	Projekte të asistuara nga MMPH,BE etj për identifikimin e nivelit të ndikimit dhe zones së veprimit loka, komunal, kombëtar ose edhe ndërkombëtar	Nevoja për të pasur një studim bazë për Gjakovën me qëllim identifikimin e ndikimit të aktiviteteve në zona dhe mundësitë për përmirësimin e situatës

15. Ndotje-bezdisja nga zhurma (ndotja akustike) në Gjakovë	Komunikacioni Rrugorë, qarkullimi i dendur dhe kaotik rrugor vlen të ceket me theks rrugët nacionale dhe rajonale mosrespektimi i rregullave të qarkullimit rrugor, numri i lartë i automjeteve private për shkak të mosefiçensës së transportit publik, ushtrimi i aktiviteteve argëtuese jashtë standarteve, cilësia e ulët e automjeteve,	Nivel i lartë i zhurmës në vendbanimet pran arterieve kryesore rrugore, si dhenë zonat turistike.	Efekte kronike dhe akute në sistemin e dëgjimit, dhe dëmtim i sistemit nervor.	Krijim i një rrjeti më të disiplinuar dhe më të mirë rrugor.	Edukimi qytetar për mosshkaktimin e ndotjes akustike. Aplikmi ne ndertesat ekzistuese dhe te reja te materialeve izolues të zhurmave.	Masa të karakterit rregullator për standartet e mjeteve që lëvizin në komunë dhe penalitetet ndaj shkaktuesve të zhurmave në vendbanimet e Gjakovës. Përmirësim i transportit publik; Krijimi i barrierave me bimësi aty ku është e mundur anës rrugëve si dhe pengesa tjera të përshtatëshme për zonat e banimit ku kalon autoudha.
---	---	--	---	---	--	---

MONITORIMI

VIII. MONITORIMI

Monitorimi i aspekteve të mjedisit është element kryesor për të mbajtur nën kontroll zbatimin e strategjive, planeve, programeve dhe projekteve. Në ligjin e “Vleresimit Strategjik Mjedisor”, kërkohet monitorimi i pasojave të ndjeshme mjedisore ose shendetesore të zbatimit të planit apo programit, në mënyrë që të identifikohen në fazë të hereshme pasojat negative të paparshikuara dhe me qëllim marrjen e masave rregulluese.

E njëjta kërkesë është parashikuar në nenin 10 të Direktives se BE për VSM-n. Sipas po kësaj direktive, me qëllim që të shmangen dublikimet në procesin e monitorimit, mund të perdoret sistemi aktual i monitorimit, nëse konsiderohet i përshtatshëm.

Institucioni përgjegjës për monitorimin e mjedisit në vendin tonë është MMPH-ja nëpërmjet AKMM Agjensise Kosovare të Mbrojtjes së Mjedisit, e cila zbaton Monitorimin në bashkëpunim me institucionet përkatëse të Ministrive të tjera dhe institucioneve në nivel qendror dhe lokal.

Me qëllim që PZHK-ja të zbatohen me efektivitet dhe të realizohen objektivat dhe synimet që janë përcaktuar në Plan, është e domosdoshme dhe siç e parashtruan edhe më sipër; është kërkesë ligjore, që të monitorohet zbatimi i Planit, për të shmangur që në fazat fillestare ndikimet eventuale negative në mjedis.

Për të qenë sa më racional dhe efektiv në monitorimin e mjedisit, do të referohemi atyre tregueseve që kanë rezultuar nga objektivat dhe synimet që janë përcaktuar për mbrojtjen e mjedisit dhe kapitullin mbi ndikimet dhe masat zbutuese të PZHK-së. Plani Monitorimit përmbledh shumë treguesë që perfaqësojnë një numër të konsiderueshëm të elementeve të mjedisit.

Realizimi me sukses i kësaj ndermarrje kërkon angazhimin e mjaftë institucioneve të cilët duhet të bashkërendojnë aktivitetet përkatës monitoruese nën drejtimin e Agjensise Kosovare të Mbrojtjes së Mjedisit.

Mbeshtetur në Ligjin për Mbrojtjen e Mjedisit, Ligjin për VSM dhe VNM Komuna e Gjakovës ka për detyrë të kryej monitorimin e aktiviteteve që kryen në kuadrin e zbatimit të PZHK-së. Këtu perfshihen qoftë Planet, projektet e Infrastrukturës që po hartohen ndërkohe, edhe detajimi i PZHK-së në Plane Rregulluese të Hollësishme për vendbanimet me nënqendra, lagje apo blloqe banimi.

Komuna e Gjakovës ka karakter administrativ dhe pa struktura të plota dhe të afta për të kryer veprimtari si monitorimi mjedisor dhe për rrjedhojë, nuk mund të mbulojë me kapacitetet dhe burimet e saj njerezore dhe financiare të gjithë këtë veprimtari. Megjithatë ajo, duke angazhuar Drejtorin Urbanizmit dhe Mjedisit dhe struktura të tjera në vartesi të saj mund të kryej një pjesë të programit të monitorimit si cilesinë e ndertimeve, ecurinë e pyllzimit dhe zhvillimit të pyjeve, zgjerimit të parqeve dhe siperfaqeve të gjelbra, ecurinë nderimit të rrugëve të reja perfshirë ato

për qarkullimin me bicikleta dhe të tjere indikatore që janë paraqitur në programin e monitorimit të PZHK-së.

Rezultatet e monitorimit, komuna e Gjakovës sipas ligjit për VSM-n, duhet ti publikoj në menyre periodike çdo vit. Për elementet e tjere të mjedisit duhet të procedohet sipas ligjeve që mbulojnë fushën VSM për monitorimin dhe rezultatet ti përcillen komunës së Gjakovës dhe Agjensisë Kosovare për Mbrojtjen e Mjedisit. Kjo e fundit ka detyrimin ligjor ti publikoj në kuadër të Raportit Vjetor për Gjendjen e Mjedisit në Republikën e Kosovës.

Tabela. 32 tabela e monitorimit të zbatimit të VSM-së

Receptoret mjedisor	Objektivat e Mbrojtes së Mjedisit	Synimi	Indikatori	Raportimi	Institucioni pergjegjes
Shendeti i banoreve	Promovimi per krijimin e nje komune të qendrueshem dhe të shëndetshme	1. Cilesia e burimeve te ujit te pishem konform stand. te BE ujrut siperfaqsores dhe nentokesore destinuar per uje te pishem 2. Cilesia e ujit te pishem konform standardit 3. Dendesia e popullsise e qendrushme në vendbanimet me trend të rritjes së popullësisë	1. Cilesia e burimeve te ujit te pishem, kundrejt standardit te BE. 2. Cilesia e ujit te pishem ne perputhje me standardin 3. Dendesia mestare për këto vendbanime	1. Rap.Vjetor 2. Rap.Vejtor 3.Rap.Vjetor	1. Drejt. E Urbanizmit e Gjakovës dhe Ministria e Mjedisit dhe Planifikimit Hapësinor. 2. Drejt. Shërbimeve Publike e Gjakovës; 3. Komuna e Gjakovës
Biodiversiteti	Ruajtja e llojeve të cilat janë në rrezik të zhdukjes nga aktiviteti njerzor	1. ndalimi i gjuetis së egër 2. marrja emasave per mbledhesit e bimeve mjekuese 3.Rehabilitimi i siperfaqeve te pyjore në zonat pyjore dhe ato të gjelbra ne zonat e banimit 5. Krijimi i korridoreve të gjelbra dhe tampon zonave	1. Siperfaqet e reja te krijuara, sip. m ² 2. Siperfaqe te reja, m ² 3.Siperfaqet te rehabilituara, m ² 5. Siperfaqe te kthyer ne zone te gjelber, pjese e koridorrit dhe tampon zona; m ²	1. Raportim 1 here vit 2. Raportim 1 here ne vit. 3. Raportim 1 here ne vit 4. Raportim 1 here ne vit 5. Raportim 1 here ne vit	1. Komuna e Gjakovës dhe MMPH 2. komuna e Gjakovës dhe MMPH 3. komuna e Gjakovës dhe MMPH 4. komuna e Gjakovës dhe MMPH & MBPZHR 5. komuna e Gjakovës dhe MMPH & MBPZHR dhe Ministria e Infrastrukturës
Ajri	Permiresimi i cilesise se ajrit	1. Ulja e niveli te ndotjes se ajrit per: NO _x ; CO ₂ ; O ₃ , PM ₁₀ . 2. Rruge te asfaltuara rishtas 3. Ulja e nivelt te zhurmave ne zonat e ndjeshme ndaj zhurmave 4. Aplikimi ne banesat e reja i materialeve termizolues dhe mbrojtje akustike	1. Arritja e vlerave te standardit per cilesin e ajrit lidhur me tregusit mbi norme 2. Gjatesia e rrugëve te asfaltuara rishtas 3. Respekt i niveleve te lejuara te zhurmes gjate dites dhe nates 4. Ulja e niveli te zhurmave ne mjediste e banimit	1. Raportim 1 here ne 6 muaj 2. Raportim 1 here ne vit 3. Raportim 1 here ne 6 muaj 4. Raportim 1 here ne vit	1. AMMK dhe Komuna e Gjakovës 2. Komuna e Gjakovës 3. Komuna e Gjakovës 4. Komuna e Gjakovës

Faktoret klimatik	Kursimi i, energjise dhe paksimi i emisioneve te gazeve serre	1. Promovimi i objekteve me izolim adekuat. 2. Promovimi i paneleve diellor per gjenerim energjie ne ndertesat residenciale dhe sociale dhe energjia e krijuar nga era	1. Siperfaqja e objekteve (m ²) me izolim adekuat 2. Siperfaqja (m ²)e paneleve te instaluar dhe sipërfaqja e ngrohur nga energjia e erës (m ²)	1. 1 here ne vit 2. 1 here ne vit	1. Komuna e Gjakovës 2. Komuna e Gjakovës
Uji	Cilesia e ujrave sip.ne perputhje me kerkesat e legjislacionit të Kosovës dhe Direktives kuadre per ujin te BE	1.Shmangia e shkarkimeve te ujrave te ndotura ne Lumenj 2. Sigurimi i hudhjeve të mbeturinave në lumenj. me qellim ruajtien e niveleve minimal të ndotjes	1a. Vellimi i ujrave qe shkarkohen ne Lumenj; 1b. Vellimi i ujrave mbi normat e lejuara qe shkarkohen Lumenjë; m3. 2. Siperfaqja e ndotjes (m ²) vllimi i mbeturinave (kg ose m ³) ,lloji mbeturinave shkruhet emir i saktë i mbeturinave të forta të gjetura në shtrat të lumit	1.Dy here ne vit 2. Dy here ne vit	1. Komuna e Gjakovës, AMMK. 2. Komuna e Gjakovës dhe AKMM
Mbetjet	3)Pakesimi i sasise se mbetjeve dhe manaxhimi qendrueshem i tyre b) Shnderrimi i pikave te nxehta mjedisore ne siperfaqe te gjelbra/parqe ose zona residenciale	a.1. Pakesimi ne burim dhe riciklimi i mbetjeve a.2. Vendosja e sistemit me disa konteniere per ndarjen ne burim te mbetjeve urbane b.1. Rehabilitim/inkapsulimi i pikave te nxehta ne territoret te mbyllura	a.1. Sasia e mbetjeve urbane/person/vit dhe sasia(ton) e mbetjeve te ricikluara. a.2. Numri i residenteve qe mbulohen nga sherbimi me kontenier b.1. m ² te rehabilituara ose inkapsuluara	a.1. 1 here ne vit a.2. 1 here ne vit b.1. 1 here ne vit	a.1. Komuna e Gjakovës, kompania regjionale e mbeturinave dhe MMPH gjegjësisht AKMM a.2 Komuna e Gjakovës ,kompania regjionale e mbeturinave dhe MMPH gjegjësisht AKMM b.1. Komuna e Gjakovës, kompania regjionale e mbeturinave dhe MMPH gjegjësisht AKMM
Rruget dhe Transporti	Reduktimi i intesnsitetit te trafikut nepermjet	1.Zgjerimi i rrjetit rrugor per trafikun publik 2. Zgjerimi i rrjetit te korsive per bicikleta	1. Km rruge shtese qe mbulohen nga trafiku urban. 2. Km korsi shtese per levizje me bicikleta. Numuri i	1.1 here ne vit 2. 1 here ne vit 3. 1 here ne vit 4. 1 here ne vit	1. Komuna e Gjakovës ,Ministria e infrastrukturës dhe MMPH 2. Komuna e Gjakovës.

	promovimit të transportit publik, qarkullimi me bicikleta ku mundet me ndodhë	3. Ndertimi i rrugëve të reja me hapsira të pershtatshme trotuaresh (përfshirë korsitë e bicikletave). Zgjerimi i trotuareshave gjatë rehabilitimit të rrugëve ekzistuese. 4. Rehabilitim/asfaltimi i rrugëve lokale	bicikletave në qarkullim. 3. Km rrugë të reja dhe të rehabilituara. m ² trotuarre dhe korsitë e bicikletave të shtuara. 4. Km rrugë lokale të rehabilituara ose/dhe asfaltuara		3. Komuna e Gjakovës, Ministria e infrastrukturës dhe MMPH 4. Komuna e Gjakovës.
Trashëgimia kulturore	Shtimi dhe mbrojtja e vlerave të kulturore, përfshirë ato arkeologjike dhe arkitekturore	Rehabilitimi, mirëmbajtja dhe ruajtja e objekteve të trashëgimisë kulturore	1. Numri i objekteve/ndertesave me status mbrojtës 2. Numri i objekteve/ndertesave të restauruara	1. 1 herë në vit 2. 1 herë në vit	1. Komuna e Gjakovës, Instituti për mbrojtjen e Monumenteve 2. Komuna e Gjakovës, Instituti për mbrojtjen e Monumenteve
Trashëgimia natyrore dhe zonat e mbrojtura	Mbrojtja e vlerave të trashëgimisë natyrore, llojeve të cilat janë në listën për mbrojtje	Promovimin e vlerave natyrore rekreative, turistike dhe shkencore të këtyre zonave dhe rendesish të llojeve të cilat janë në Listën për mbrojtje.	Gjetja e formave për sensibilizim dhe kërkime shkencore me të shumta.	1 herë në vit	Komuna e Gjakovës, Ministria e MMPH-ja dhe instituti i Kosovës për Mbrojtje të Natyrës

Peizazhi, pyjet dhe toka	1.Konservimi dhe shtimi i zonave dhe elementeve peizazhistik 2. Mbrojtja e mjedisit natyror ne hapësirat për rreth vendbanimeve 3. Riperdorimi i tokave te ndotura 4.Mirmbajtje dhe zhvillim i pyjeve 5.Kultivim i pyjeve të reja	1. Shtimi i hapsirave te reja dhe numurit te pemeve e shkurreve. 2. Dhenie e statusi mbrojtje dhe hartimi i nje plani manaxhimi mjedisor i ktyre hapësirave. 3. Rehabilitimi i tokave te ndotura(pikat e nxehta mjedisore) dhe venia ne efciense per zona te gjelbera/parqe ose rezidenciale 4.Zhvillimi i pyjeve ekzistuese 5. Pyllëzimi I hapësirave të zhveshura	1. Siperfaqet ne m² dhe numuri i pemeve te mbjella 2.Progresi i zbatimit te planit 3. Siperfaqe toke e ndotur e rehabilituar (m²) dhe e vene ne perdorim sipas PZHK. 4. Siperfaqe toke së zhvilluar pyjore (ha) 4. Siperfaqe toke së re pyjore (ha)	1.Një here ne vit 2. Një here ne vit 3. Një here ne vit 4. Një here ne vit 5. Një here ne vit	1. Komuna e Gjakovës 2. Komuna e Gjakovës 3. Komuna e Gjakovës 4. Komuna e Gjakovës dhe MBPZHR 5. Komuna e Gjakovës dhe MBPZHR
---	--	---	--	--	---

IX. PËRFUNDIME

Raporti i Vlerësimit të Ndikimit në Mjedis të PZHK-së së Gjakovës ka për qëllim të integrojë sistematikisht qështjet mjedisore. Gjatë implementimit të Planit Zhvillimor Komunal si dhe procesin e vendim marrjes VSM synon të merr masa plotësuese për projektet të cilat do të realizohen. VSM si e tillë përkufizohet si:

- Vlerësimi Strategjik Mjedisor (VSM) është një nga instrumentet kyç për integrimin e çështjeve mjedisore dhe parimeve të zhvillimit të qëndrueshëm në planifikimin strategjik dhe vendim-marrjen. Ai është një mjet i njohur globalisht për planifikimin me pjesëmarrje që përdoret për të analizuar dhe përfshirë çështjet e mjedisit në politikat, planet dhe programet e propozuara.
- Instrument i cili do të sigurojë udhëzime për menaxhimin e qëndrueshëm të aspekteve dhe konsideratave mjedisore të PZHK-së;
- VSM do të jep udhëzime për përfshirjen e çështjeve mjedisore në projektet të cilat do të realizohen në të ardhmen;
- Raporti i VSM-së propozon rregullore institucionale për menaxhimin e qëndrueshëm të aspekteve mjedisore të PZHK-së.

Duke analizuar PZHK-në e Gjakovës shihet qartë se PZHK-ja prezanton një profil, koncept të zhvillimit hapësinor, Vizion, prioritete strategjike, strategji e masa zbatimi, në PZHK vërehen edhe përpjekje për të orientuar rritjen e mundshme dhe të parashikuar të popullsisë në disa vendbanime të Gjakovës bazuar edhe në disa shembuj të përkufizimit të zonave të ndërtimit (jo në definim të zonave në bazë të analizave profesionale) e me qëllim dendësimin në zonat që janë ende në proces zhvillimi dhe kanë synim zgjerimi edhe në zonat e reja të banimit duke marrë parasysh edhe shërbime të qëndrueshme rreth këtyre vendbanimeve aktuale në komunën e Gjakovës.

PZHK-ja ka rol përmbajtësor edhe në ruajtjen e trashëgimisë kulturore dhe trashëgimisë së ndërtimeve. PZHK-ja dhe sugjerimet që dalin nga VSM duhet të ndikojnë pozitivisht në revitalizimin e ekosistemeve të degraduara, ripyllëzimin e zonave të zhveshura, pyllëzimin e disa zonave që vazhdimisht janë nën ndikimin e erozionit. Pozitivisht do të ndikoj edhe në ruajtjen e zonave të pasura me ujëra nëntokësore, ekosistemeve të lumenjve nga degradimi dhe nga ndërtimet në brigje të lumenjve.

Gjatë përpilimit të Raportit të VSM-së kemi hasur disa sfida por ndër ato kryesore gjatë hartimit të VSM-së ka qenë nga se për territorin e Gjakovës ka pak studime në fushën e mjedisit, informata, hulumtime, analiza profesionale. PZHK-ja ka definuar disa tregues numerik ose kualitativ për disa pika, vija dhe sipërfaqe të rëndësishme për trajtim adekuat të aspektit mjedisor të planit, vlen të vihet theksi në zonat e zhvillimeve të reja të infrastrukturës (korridoret rrugore), zona industriale (sipërfaqja), ndikimi i tyre në korridoret e qarkullimit të shtazëve, masa të duhura



për qarkullim natyrorë të shtazëve dhe llojeve bimore nga një habitat në tjetrin, zonat me ujëra nëntokësore, zonat me erozion, zonat me deponi dhe ndotje, zonat me mundësi pyllëzimi dhe ripyllëzimi, shiritat e gjelbër, tampn zonat, parqet, si dhe janë treguar disa vende si zona të ndotur por kan munguar informatat për tokat e ndotura nga pesticidet. Këto zona apo vija të infrastrukturës përmenden edhe në pjesën strategjike. Një sfide e veçante mbetet zbatimi në praktike i synimeve të PZHK-së; për pyllëzim, ripyllëzim, shirita të gjelbër, tampon zona, dhe në përgjithësi shtimin e hapësirave të gjelbra, krijimi i zonave rekreative dhe përmirësimi i treguesve mjedisore të komunës.

Rekomandimet që dalin nga VSM-ja janë:

- Në bashkpunim me institucione tjera si Universiteti etj. rekomandohen studime mbi gjendjen e biodiversiteti dhe i habitateve natyrore në komunën e Gjakovës;
- Ndërtimi i “urave për kalim të shtazëve” gjatë realizimit të rrugëve të planifikuara si dhe atyre të ndërtuara siç është rasti me propozimin e urës kaluese të shtazëve në autoudhë;
- Hartim i projekteve për rehabilitim të zonave me potenciale rrezatimi, por edhe planifikimi i mundësive për trajtimin e rrezatimit jonizues në vendet ku është goditur me bomba në luftën e fundit mendohet të paraqitet si një burim vazhdueshëm i ndotjes në komunën e Gjakovës;
- Hartim i projekteve për rehabilitim të zonave erozive dhe të vërshimeve por edhe planifikimi i mundësive, masave dhe projekteve për trajtimin e Erozionit dhe vërshimeve në aspektin e zonave dhe shkallëve të erozionit;
- Definimi i zonave ekonomike në aspektin e tipit të industries apo afarizmit dhe krijimit të bazave për hartimin e Planit Rregullues të Hollësishme të zonave duke ofruar bazat për trajtim të zonave ekonomike me masa fizike, natyrore dhe teknologjike që të jetë miqësor edhe në aspektin mjedisor;
- Të bëhen projekte duke u bazuar edhe në PZHK vendet dhe mundësit, projektet dhe zhvillime për pyllëzim dhe ripyllëzim si mas të rëndësishme mjedisore;
- Projekte për rehabilitim të zonave, vijave ose mundësisht edhe pikave të zeza të ndotura nga mbeturinat dhe planifikohen mundësi trajtimi edhe se është përmend riciklimi si një mundësi por ka edhe mundësi tjera, definimi i hapësirave për deponi tranzite dhe sistemit të grumbullimit dhe menaxhimit të mbeturinave dhe proceset tjera;
- Definimi dhe trajtimi si zona konform standardeve dhe ligjeve në fuqi për ujrata nëntokësor dhe sipërfaqësor;
- Konservimi i veçorive natyrore (Monumentet e Natyrës) si objekte natyrore dhe si zona;
- Definimi i pejsazheve, parqeve me vlera ose ndikime mjedisore dhe parashikimi i masave;
- Trajtimi i ngrohjes së qytetit të Gjakovës por edhe vendbanimeve si një dimension i rëndësishëm i ndotjes dhe ndikimit në ekosisteme;
- Projekte për caktimin e zonave të zhurmës;
- Definimi dhe trajtimi i zonave të pasura me florë dhe faunë.



LITERATURA

1. American Planning Association (Steiner Frederick and Butler Kent eds.). 2010.
2. Standartet e planifikimit dhe projektimit urban, Ufo University Press.
3. Assessment Study for the Proposed Eastern Industrial Park Njiru area, Nairobi County;
4. Konventa e UNECE Mbi Qasjen në Informacione, Pjesëmarrjen Publike në Vendim-marrje dhe Qasjen në Drejtësi në Çështjet Mjedisore (Konventa Aarhus), 1998;
5. Ernest A. Lowe (1997-2001) Eco-industrial Park Handbook for Asian Developing Countries;
6. Agjensia Kosovare e Mbrojtjes së Mjedisit. Raport i Gjendjes së Monitorimit të Mjedisit per vitin 2010.
7. Agenda 21, UN-Habitat (2009). Planning for Sustainable Cities, UN-Habitat. Nairobi, Kenya.
8. Ministria e Mjedisit dhe e Planifikimit Hapësinor (2011). Strategjia për Mjedisin 2013-2022). Prishtinë, 2013
9. Komuna e Gjakovës 2020 Hartat e prezantuar në PZHK.
10. Emetimi i gazeve serrë në Kosovë 2008 – 2009; UNDP- Kosovë;
11. Gjendja e Mjedisit në Kosovë 2008-2010;
12. Strategjia dhe Plani i Veprimit për Biodiverzitetin; 2011 – 2020;
13. Millennium Development Goals Global Targets-Local Approaches;
14. Qendra Rajonale e Mjedisit. REC.